

Nën Hijen e Besimit - 2

PREZANTIM

Është një e vërtetë dhe realitet në nivelin e çështjeve mbi besimin dhe Islamin se, në parashtrimin e tyre, ndodhemi në një periudhë kur kërkohet të bëhet më shumë shpjegimi i *pse*-ve dhe *përse*-ve, sesa i *si*-ve. Ndërkaq, asnjë mendje e shëndoshë dhe ndërgjegje e kulluar që është e denjë jo vetëm për t'i klasifikuar dukuritë, por edhe për të bërë sintezat e duhura, nuk mund ta mohojë këtë të vërtetë. Sepse në ditët tona, shkencat e natyrës dhe filozofia, duke marrë forcë edhe nga zhvillimet marramendëse të zhvillimeve teknike, po jetojnë ditët më të pamëshirshme të veprimtarive për ta tharë nga rrënjët pemën e besimit e cila duhet t'i ketë rrënjët në mendjen e njeriut, kurse degët dhe frutat, në zemrën e tij!

Siç është e pamundur për të marrë fruta nga një pemë me rrënjët të thara, ashtu është e pamundur për të mbledhur fryte cilësore të llojit *si* nga një *besim* i tharë prej *pse*-ve dhe *përse*-ve.

Hapësira e shkatërruar në fillim duhet meremetuar, pastaj, rregulluar e forcuar dhe, më pas, po të duhet, duhet stolisur. Stolisja para meremetimit dhe përforcimit është pa dobi, përforcimi para meremetimit është i panevojshëm, kurse meremetimi që nuk ndiqet nga rregullimi dhe përforcimi, është, shpesh, që t'i vret sytë. Prandaj, si në çdo çështje, edhe këtu, çlirimi prej qëndrimit të paqëlluar të skajshëm majtas apo djathtas për të ndjekur rrugën e mesme, do të ishte parimi i pashmangshëm i gjetjes së të drejtës.

T'i bësh qëllim në vetvete argumentet racionale për të rënë në idenë fikse të dialektikës dhe demagogjisë, është po aq një deviacion ideor sa ç'është shterpëzim në ide t'i nënvlehtësosh ato duke i kundërshtuar plotësisht. Në fakt, që të dyja këto ide fikse janë dy fytyrat e të njëjtës së vërtetë. Gabimi në diagnostikim qëndron te pranimi i këtyre dy fytyrave të të njëjtës së vërtetë si dy të vërteta më vete. Sidomos, duke parë vetëm pasqyrën fikse të të vërtetave të veta, këto dy mënyra të ndryshme mendimi kanë krijuar dhe krijojnë humnera shumë të vështira për t'i mbyllur. Mirëpo pak mendim larg sentimentalizmit dhe arsyetim i gjithanshëm mund t'i bashkojë këto dy skaje për t'i bërë të pashkëputshme. Dihet se burrat e mëdhenj të Islamit si imam Gazaliu dhe poeti Xhelaledin Rumi, i mbiquajtur Mevlana, në shumë vende të veprave të tyre, duke përdorur edhe ndikimin e diagnozës mbi sugjerimin, kanë vërtetuar se preokupimi me argumente racionale për të arritur te e vërteta është humbje kohe dhe se njeriu që i shpenzon përpjekjet vetëm për të mbledhur argumente racionale, për rrjedhojë, nuk do të ketë më fuqi për të arritur te e vërteta. Njeriun që përpiqet ta arrijë të vërtetën me argumente racionale, Gazaliu e përngjason me njeriun që, megjithëse ka vënë si qëllim të shkojë në haxh (pelegrinazh), mbetet pa u nisur ngaqë merret me përgatitjen e kalit! Sipas tij, ky preokupim nuk e çon njeriun te e vërteta, por e privon prej saj. Kurse Mevlana e përngjason njeriun që përpiqet ta gjejë të vërtetën me argumente, me të mjerin që, megjithëse ndodhet para Qabes, kërkon kiblen!

Shqyrtimi i specifikave që i kanë detyruar Gazaliun dhe Mevlanën për t'u sjellë ftohtë ndaj argumenteve racionale, është një çështje më vete. Çdo fjalë e thënë pa analizuar etimologjinë e koncepteve dhe shprehjeve që i përkasin asaj periudhe, nuk mund të shpëtojë nga sipërfaqësia. Ndërkaq, një analizë e tillë etimologjike është e mundur duke rishqyrtuar çështjet e apologjetikës

islame të formuar gjer në atë periudhë, lidhur me çështjen në fjalë, dhe duke u bërë atyre një shqyrtim të ri. Duke ua lënë këtë aspekt të çështjes penave kompetente të asaj fushe, ne të përpiqemi ta paraqesim çështjen me nja dy analiza të vogla.

1) Preokupimi me argumente racionale në periudhën kur patën jetuar njerëzit e mëdhenj të Islamit që i përmendëm më sipër, ka qenë jo më shumë nevojë sesa fantazi paradoksale, sepse besimi ka qenë i shëndoshë e i fortë dhe nuk kishte nevojë për meremetim dhe përforsim me argumente. Në të njëjtën kohë, meremetimi që do të kërkohej të bëhej pa qenë e domosdoshme e pa patur nevojë, nuk do të kishte ndryshim nga rrënimi. Prandaj u qenë kundërvënë ata argumenteve racionale që bartnin mundësinë për t'u bërë shkak për një rrënim të tillë.

2) Preokupimi me argumente racionale në një periudhë të pushtuar nga filozofia greke me anë të përkthimeve të bëra prej saj, që shndërruar në një pasion të sëmure, të tillë që diskutimi në këtë atmosferë i vlerave të argumenteve racionale ishte aq i pakuptimtë, sa ç'mund të ishte e pakuptimtë nxitja për ta dashuruar Mexhnunin! Në të njëjtën kohë, duhet të ishte dikush që t'u kërkonte një parullë mendimeve filozofike të pranuar pa u bërë asnjë kritikë, dhe ata këtë bënë.

3) Ndërsa argumentet racionale duhet të ishin vetëm pretekste dhe mjete në rrugën që shkonte për tek e vërteta, ato ishin shndërruar në qëllim dhe synim. Ja pra, edhe Gazaliu me Xhelaledin Rumiun, edhe të gjithë autoritetet që mendonin si ta, kërkonin t'i jepnin orientim këtij devijimi.

4) Këtë qëndrim e bënte të domosdoshëm etika e gjendjes dhe pozitës ku ndodheshin ata. Gjithashtu, mjekimi i sëmundjeve moral-shpirtërore të shfaqura në periudhat e tyre kërkonte metodën mjekuese të përdorur prej tyre.

5) Njerëzit e mëdhenj i ngjajnë ujit të pastër e të kthjellët. Ata formësohen sipas përmasave dhe konfiguracionit të periudhës kur jetojnë. Dhe ky zhvillim merr formë plotësisht në vartësi të kushteve përkatëse. Veprat e shkruara në atë periudhë janë shembulli më domethënës i kësaj.

Njeriu i ditëve të sotme ka nevojë më shumë se kurrë më parë për përforsimin e mundshëm me argumente racionale të të gjitha çështjeve të parashtruara atij me anë të informacionit të përcjellë. Por kjo duhet mbajtur në nivelin e veprimit të thyerjes së guaskës për të zbritur në bazë. E thënë ndryshe, thyerja e guaskës është kusht për ta shijuar origjinën, por jo kushti i vetëm. Kurse përsëritja e këtij veprimi nga të mëdhenjtë është që atë që e kanë shijuar vetë, t'ua mundësojnë për ta shijuar edhe atyre që e kanë një kapacitet të tillë.

Me shikimet dhe vështirimet e tyre të hedhura mbi faktet e jetuara, ata ishin të çliruar nga nevoja për çdo lloj argumenti dhe prove. Këta të lumtur që shëtisnin me njërën këmbë në pozita tejet të larta, këmbën tjetër nuk e shkëputnin nga toka në mënyrë që të kapnin nga dora edhe shumë të tjerë për t'i ngjitur atje. Kishte nevojë për ta që t'i ngjisnin në nivelin e jetës së shpirtit dhe zemrës të mjerët që kishin ngecur të shtrënguar në pengesën e lëndësorës. Por duhet pranuar se kthimi i tyre, për këtë qëllim, te argumenti dhe prova, ishte vetëm një sakrificë.

Sepse këtë moral ata e patën mësuar kështu nga Zotëria i Dy Botëve (s.a.s.) që kishte vënë këmbën në pikat ku s'kishte arritur askush tjetër, ku s'kishte mundur të arrinte as dhe vështirimi i Xhebrailit! Kthimi pas i tij nga miraxhi është mësimi filozofik më i madh. Qëllimi, të gjendej mjalti i mjalteve, të aftësoheshin edhe të tjerët për ta gjetur!

“Nën hijen e besimit” u përgatit për t'i shërbyer një qëllimi të tillë. Dhe po me këtë qëllim po ju ofrohet edhe juve, lexues të dashur duke shpresuar se do të mbeteni të kënaqur e të lumtur!

A. TEURATI DHE UNGJILLI JANË ARGUMENTE TË PROFETËSISË SË MUHAMEDIT (S.A.S)

Së bashku me profetët e kaluar, edhe librat e kaluar, Teurati dhe Ungjilli (Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re), janë argumente dhe dëshmitarë të profetësisë së profetit Muhamed. Megjithëse Teurati dhe Ungjilli janë të korrigjuar, eruditë të tillë si Hysejin Xhisri kanë gjetur në ekzemplarët e tyre shumë shenja në lidhje me këtë çështje. Këtu do të mjaftohemi duke dhënë vetëm katër prej tyre.

1. *"Unë do të nxjerr për ta një profet nga gjiri i vëllezërve të tyre dhe do të vë në gojën e tij fjalët e mia, dhe ai do t'u thotë atyre të gjitha ato që unë do t'i urdhëroj."* (Ligji i Përtërirë, 18:18)

"Vetë Moisiu, në fakt, u tha etërve: "Zoti, Perëndia juaj do të ngjallë për ju një profet si unë nga mesi i vëllezërve tuaj; dëgjojeni në të gjitha gjërat që ai do t'ju thotë! Dhe do të ndodhë që kushdo që nuk do ta dëgjojë atë profet, do të shkatërrohet në mes të popullit". Gjithashtu të gjithë profetët, të gjithë ata që kanë folur qysh nga Samueli e këtej, i kanë shpallur këto ditë." (Veprat e Apostujve, 3:22-24)

"Nuk doli më në Izrael një profet i ngjashëm me Moisiun" (Ligji i Përtërirë, 34:10)

Në sentencat e mësipërme të cituara nga Dhiata e Re dhe Dhjata e Vjetër'

a) Me fjalën *"vëllezërit tuaj"*, me të cilën profeti Musa u drejtohet të bijve të Izraelit me prejardhje nga Is'haku, i biri i Ibrahimit, shënohen të bijtë e Ismailit, vëllait të Is'hakut. Kurse profeti që ka për të ardhur nga të bijtë Ismail, mund të jetë vetëm profeti Muhamed, sepse vetëm ky ka rrjedhur nga soji i Ismailit. Jusha dhe Isai (Joshua dhe Jezusi) e kanë prejardhjen jo nga Ismaili, por nga të bijtë e Izraelit.

b) Me fjalën *"si unë"*, profeti Musai e ka fjalën për profetin e ardhshëm Muhamed, sepse, në rreth njëzet veçori të detyrës profetike e të legjislacionit që solli, ku futen xhihadi ose lufta fetare, ligjet dhe ndëshkimet, autoriteti i fjalës mes bashkësisë, etj., Musait i përngjet Muhamedit (s.a.s), jo Jusha dhe Isai.

c) Pohohet hapur se nga të bijtë e Ismailit s'ka për të dalë më një profet si Musai.

ç) Shprehja *"do t'i vë në gojë fjalët e mia"* aludon për faktin se profeti i ardhshëm (Muhamedi) s'do të dijë shkrim e këndim, pra, fjala e Zotit do t'i përcillet me gojë, ndërsa ai do ta mësojë lehtë dhe do t'ua përcjellë, pastaj, njerëzve.

2. “Zoti erdhi nga Sinai dhe u ngrit mbi ta në Seir; u paraqit në madhësinë e tij nga mali Paran, arriti nga mesi i një morie shenjtorësh; nga e djathta e tyre dilte për ta një ligj i zjarrtë.” (Ligji i Përtërirë, 33:2)

a) “Ardhja nga Sinai” do të thotë se Musait iu dhanë ligjet e Zotit në malin Sina. “U paraqit në madhësinë e tij nga mali Paran”, është aludim për profetin Muhamed. Paran që në arabishte është në trajtën Faran, është jo vetëm emri i vjetër i Mekës; në kapitullin Zanafilla në Dhiatën e Vjetër thuhet se Ismaili jetonte në shkretëtirën *Paran*. (Zanafilla, 21:21)

b) Me shenjtorët nga mesi i të cilëve do të dilte profeti i ardhshëm, shënohen familja e Profetit, e përfaqësuar nga Aliu, si dhe sahabët, shokët e profetit Muhamed.

c) Me ligj i zjarrtë aludohet për xhihadin në Islam.

3. “...Guri, që ndërtuesit e nxorën të papërdorshëm, u bë guri i qoshes. Kjo është vepër e Zotit, dhe është e mrekullueshme në sytë tonë”? Prandaj unë po ju them se juve do t’ju hiqet mbretëria e Perëndisë dhe do t’i jepet një kombi që do ta bëjë të japë fryt. Dhe ai që do të bjerë mbi këtë gur do të bëhet copë-copë; dhe ai mbi të cilin do të bjerë ai do të jetë i thërrmuar.” (Mateu, 21:42-44)

a) “Guri i qoshes” që përmendet më sipër nuk mund të jetë profeti Isa, sepse s’ka ndodhur ndonjë copëtim nën Isain dhe gjërat që solli ai, apo thërrmim si pluhur, por nën profetin Muhamed, si dhe, sepse Isai nuk solli ligj, nuk sundoi, por solli ligj dhe sundoi profeti Muhamed; vetë Isai thotë se nuk ka ardhur për të vënë ligje e për të sunduar. (Gjoni, 12:47)

b) Në rivajetet e Buhariut dhe Muslimit, profeti Muhamed pohon vetë se është guri i qoshes i ndërtesës profetike, për rrjedhojë, duke u vënë “gur qosheje”, me të plotësohet misioni profetik.

4. “Dhe unë do t’i lutem Atit dhe ai do t’ju japë një Ngushëllues tjetër, që do të qëndrojë përgjithmonë me ju,” (Gjoni, 14:16)

“... Ai do t’jua mësojë juve çdo gjë dhe do t’jua kujtojë çdo gjë që ju kam thënë...” (Gjoni, 14:26)

“... Ai do të dëshmojë për mua...” (Gjoni, 15:26)

“... është mirë për ju që unë të shkoj, sepse, po nuk shkova, nuk do të vijë te ju Ngushëlluesi;... dhe kur të ketë ardhur, ai do ta bindë botën për drejtësi dhe për gjykim.” (Gjoni, 16:7-8)

Origjinali i fjalës Ngushëllues që përmendet më sipër, në greqisht është në trajtën Piriklitos që ka për përgjegjëse fjalën arabishte Ahmed. Ahmed është emri i profetit Muhamed dhe në Kuran pohohet hapur se emri i tij në ungjill është Ahmed. Të gjitha cilësitë dhe vetitë me të cilat përshkruhet Ahmedi në ungjill, janë vetëm te profeti Muhamed. Ndërkaq, ne sot nuk kemi ndër duar shumë nga ungjijtë që flasin hapur për të ardhmen dhe vetitë e profetit Muhamed.

B. EDHE JETA E HZ. MUHAMEDIT PARA PROFETËSISË ËSHTË ARGUMENT I PROFETËSISË SË TIJ

1. Ngjarjet e jashtëzakonshme që shoqëruan ardhjen e tij në këtë botë, vëzhgimet e të afërmeve në periudhën e fëmijërisë dhe kuptimet e nxjerra në lidhje me të nga njerëz me aftësi për të hyrë në thelbin e fshehtë të gjërave, s’ishin gjë tjetër veçse shprehje kuptimplote të faktit se në të ardhmen ai kishte për të hyrë nën përgjegjësinë e një detyre të madhe.

2. Në periudhën gjer në profetësi, ai pati dalë vazhdimisht kundër dhunës dhe padrejtësisë dhe, duke marrë pjesë aktivisht në një shoqatë si Hilful Fudul që mbronte viktimat e padrejtësisë, që pozicionuar në krah të të dobtëve dhe atyre që kishin pësuar padrejtësi.

3. Gjer në 40 vjeç ai s'pati jetuar me madhështi dhe salltanet, përkundrazi, pati mbetur jetim qysh në moshë të vogël, që rritur nën mbrojtjen dhe kujdesin e gjyshit dhe xhaxhait dhe s'ishte aq i fuqishëm si person, pasuri dhe përkrahës.

4. Me gjithë prostitucionin e përhapur në mjedisin e tij, ai e pati ruajtur nderin, virtytin dhe dinjitetin në shkallën më të lartë. Vetë ai tregon se si, duke shkuar për herë të parë në një dasëm, e kishte zënë gjumi në rrugë. Kur ishte 25 vjeç, pra, në lulën e moshës, në kulmin e zhvillimit të bukurisë rinore, u martua me zonjën Hatixhe, një e vejë 40-vjeçare dhe me fëmijë. Dhe rrëfëhet se skuqej si një vajzë që po bëhej nuse. Gjithsesi, ky duhej të ishte *i riu-përmendore nderi dhe virtyti* që u shkonte në çastin e parë ndërmend atyre që, ndërsa do të largoheshin për një farë kohe nga vendi për arsye të ndryshme, kërkonin njeri të besuar për t'ia lënë amanet familjen!

5. Në periudhën para profetësisë nuk pati ndodhur kurrë që dikush të bëhej dëshmitar se ai gënjeu, tradhtoi apo nuk e mbajti fjalën. Lidhur me këtë çështje, askush, përfshi edhe armiqtë e tij, nuk tregojnë ndonjë rast, përkundrazi, të gjithë pohojnë njëzëri dhe pa lëkundje se ai kurrë nuk pati gënjyer, nuk pati tradhtuar apo nuk e pati mbajtur fjalën! Edhe armiqtë më të tërbuar të tij e quanin *Muhamed Emin, i Besueshmi*. Gjatë meremetimit të Qabes, fiset patën rënë në mosmarrëveshje se kujt i takonte ta vendoste Gurin e Zi në vend dhe acarimi mes tyre pati ardhur në pragun e përleshjes me armë. Atëherë, i caktuar njëzëri prej fiseve si gjykatës i çështjes, Muhamedi e pati zgjidhur në një mënyrë shumë të thjeshtë e paqësore si mënyrën e vendosjes së gurit, ashtu dhe grindjen mes fiseve. Ai pati shtruar rrobën e vet përtokë, pati vënë në mes të saj Gurin e Zi dhe u pati thënë përfaqësuesve të fiseve ta kapnin rrobën nga një cep për ta bartur të gjithë së bashku gjer në vend. Pastaj, në mur e pati vendosur vetë. Kështu e pati zgjidhur ai këtë çështje të vështirë!

6. Edhe fakti që, pas ditëve të kaluara plot ankth në shpellën e bekuar të Hiras, ai u shfaq i ngarkuar me një kauzë të madhe, është një nga argumentet e rëndësishme të profetësisë së tij. Sepse të gjithë e dinin se ai ishte i pamësuar, s'dinte as të shkruante, as të lexonte, pra, në jetën e tij s'kishte mësuar prej askujt asgjë! Fakti që, pas kalimit të muajve të tërë i vetëm, i mbyllur në një shpellë, ai doli para njerëzve me një shprehje që sfidonte poetët dhe oratorët, tregon se deklarata e mrekullueshme që kishte në dorë ishte hyjnore. Pas një përgatitjeje të tillë sublime u shfaq ai në horizontin e Mekës dhe u vu ta përhapë kauzën e tij.

7. A është e mundur që një njeri, qysh nga fëmijëria gjer në moshën 40-vjeçare, të jetë model i drejtësisë, ndershmërisë, fjalës, besnikërisë dhe moralit të lartë dhe këto cilësi t'i jenë kthyer në shprehje dhe atribut dhe, pastaj, menjëherë të ndryshojë?

C. EDHE ARMIQTË E HZ. MUHAMEDIT JANË DËSHMITARË TË DREJTËSISË SË TIJ

1. Fakti që njerëzit të cilët gjer në moshën 40-vjeçare e patën thirrur atë Muhamed Emin e që ia patën besuar pa lëkundje të gjitha amanetet, iu bënë armiq sapa u shfaq si profet, e kundërshtuan dhe e mohuan, s'është gjë tjetër veçse shfaqje e kontradiktës së tyre me vetveten! Me këtë qëndrim, këta njerëz që e quanin veten të mençur, të kulturuar dhe mendimtarë, a nuk e pranonin se ishin gënjyer dhe vënë në gjumë për dyzet vjet me radhë? Atëherë, mohimi i tyre kishte një synim të

caktuar, sepse nuk kishte ndryshuar dhe kthyer Profeti, por kishin ndryshuar dhe kthyer ata vetë; ishin ata vetë që kishin mbyllur sytë për të mos e parë Diellin!

2. Armiqtë nuk e akuzonin për gënjeshtar, nuk ia mohonin mesazhin që kishte sjellë, vetëm i thonin magjistar, poet, i marrë. Kurse mesazhit të tij mrekullor që s'ia mohonin dot ekzistencën dhe vërtetësinë, i thoshin thjesht “magji”!

3. Politeistët, të cilët s'donin t'ia pranonin kurrsesi profetësinë, thoshin se “Muhamedi flet drejt”, por, krenarë dhe mendjemëdhenj, justifikoheshin duke thënë se “pse nuk iu dha profetësia këtij apo atij nga parësia, por një jetimi!”

4. Fakti që, megjithëse politeistët mekas kishin arritur, në atë kohë, nivele të larta në poezi dhe oratori dhe, megjithëse Kurani i sjellë nga një person që s'dinte shkrim e këndim, i sfidonte ata duke i ftuar të mblidhnin të gjithë përkrahësit e tyre për të bërë një libër të ngjashëm, ose edhe vetëm një sure, politeistët mekas nuk zgjodhën kundër Kuranit dhe kauzës profetike rrugën më të lehtë për ta, ku ata ishin më të aftë e ndikues, luftën me fjalë, por rrugën më të rrezikshme, atë me shpatë, ky fakt, pra, është një argument krejt i hapur i profetësisë së tij!

5. Politeistët gjithashtu mbeteshin të paafte kur ishte puna për të debatuar, për t'ia gjetur të metat dhe dobësitë si rruga më e mirë për t'ia mbyllur gojën. Pa dyshim, po t'i gjenin qoftë edhe një gënjeshtër ose pikë të dobët, menjëherë do t'ia shpallnin botës!

6. Edhe fakti që armiqtë e betuar, ata që kishin nxjerrë shpatën kundër tij dhe i kishin bërë çdo të keqe, me kohë u zbutën një e nga një, u përgjunjën dhe u futën në rrethin e tij duke u bërë myslimanë, është argument i veçantë i drejtësisë dhe ndershmërisë tek ai, i pafajësisë, zgjuarsisë dhe tërheqjes së tij. Armiqtë më të betuar të tij, si Safvan, Ebu Sufjan, Amr ibn As, Halid, Ikrimë, Hind, Vahshi dhe sa e sa të tjerë, u përlulën më në fund para drejtësisë së tij dhe, për më tepër, u bënë kumtues të shquar të asaj drejtësie!

Ç. EDHE JETA E HZ. MUHAMEDIT PAS SHPALLJES SË PROFETËSISË ËSHTË NJË DËSHMITAR TJETËR I PROFETËSISË DHE DREJTËSISË NË ÇËSHTJEN E TIJ

1. Nuk mund të mendohet që një njeri, zemra e të cilit vlon vazhdimisht me ideale dhe mendime të larta, të mos i shfaqë mendimet e tij, të rrijë pa mbledhur përkrahës për mendimet dhe kauzën e tij.

Edhe një mendim ose ide të thjeshtë ne nuk e mbajmë dot brenda por kërkojmë dhe përpiqemi t'ua përcjellim të tjerëve. Mendimet, idetë dhe kauzën e tij njeriu përpiqet t'i përhapë në vitet më të gjalla dhe entuziaste, ato të rinisë. Historia botërore është dëshmitare se si mijëra e dhjetëra mijëra të rinj 15-20-vjeçarë, për të përhapur ide të rreme e bestypte kanë luftuar e luftojnë me parulla e pankarta në duar duke marrë pjesë edhe në ngjarje dhe përleshje të përgjakshme. Kurse Kryeprofeti e pati nisur kumtimin e kauzës së tij në moshën 40-vjeçare! Kjo do të thotë se ai vepronte jo nga vetja dhe për vete, por nën një urdhër, dhe bënte atë që e urdhëronin!

2. Fakti që një njeri nuk bën apo pëson asnjë ndryshim moral-etik dhe të karakterit edhe pasi ka arritur suksese të ndryshme e të mëdha, fitore, mundësi materiale, poste e pozita, tregon moralin e tij të lartë, nivelin e tij të drejtësisë dhe ndershmërisë. Ja, pra, jeta e tij krejt e hapur (pa anë të fshehta) dhe e shkëlqyer si dielli e periudhës para profetësisë dhe e periudhës së profetësisë! Me të vërtetë, atij nuk i qe turbulluar shikimi edhe pas fitoreve të mëdha, nuk i qenë marrë mendtë dhe e

pati përfunduar funksionin dhe detyrën siç e pati nisur dhe, nëse të gjitha këto s'janë argument të profetësisë së tij, ç'janë?

D. EDHE INDIVIDUALITETI I HZ. MUHAMEDIT DËSHMON PËR DREJTËSINË DHE PROFETËSINË E TIJ

1. Për atë që kupton dhe sheh, fytyra është pasqyra e shpirtit dhe si një libër që reflekton rreshtat njohës të botës së brendshme. Dijetari çifut që pati parë fytyrën e ndritshme të Profetit që reflektonte vërtetësi, qysh në shikimin e parë pati shprehur besim duke thënë, *“në këtë fytyrë nuk ka gënjeshtër”*!

2. Sikur ta supozojmë se në fjalët dhe sjelljet e atij Individualiteti do të kishte gënjeshtër dhe falsitet, qoftë para profetësisë, qoftë pas saj, patjetër do të shfaqte ndonjë mangësi, do të bënte ndonjë gafë dhe, si rezultat, edhe kundërshtarët dhe armiqtë që prisnin rastin, do t'ia shpallnin botës duke ia arritur qëllimit pa qenë nevoja për të përdorur shpatën.

3. Gjëja artificiale, imituese dhe e gabuar kurrë nuk është si gjëja e vërtetë dhe e natyrshme. Sytë e shkruar të lindur të tillë janë tjetër gjë, sytë e bojatisur janë tjetër gjë! Sa mund t'i shëmbëllejë e ta imitojë miza palloin, xixëllonja diellin, çobani guvernatorin apo shkencëtarin? Sidomos në çështje si profetësia, imitimi dhe gënjeshtër kurrë nuk mund të kenë vend!

4. Për shkak të natyrës së vet krijuese, njeriu e ka pothuaj krejt të pamundur që, i ndodhur mes një shoqërie shumë të vogël e të kufizuar, ku çdo njëri e njeh çdo njërin gjer në imtësi, të thotë qoftë edhe gënjeshtër në më të vogël për çështjen më të parëndësishme duke i bërë opozitë asaj shoqërie. Ndërkaq, po qe se, përkundrazi, ai Individualiteti i lartë mundej që, i ndodhur brenda një shoqërie krejt armiqësore ndaj tij, të thoshte krejt i sigurt dhe pa asnjë shqetësim gjëra në emër të një kauze shumë të madhe, a mund të mendohet se në fjalët e tij kishte gënjeshtër dhe dredhi?

5. Sidomos në kushtet kur ky personalitet i pakënduar, megjithëse ndodhej mes një bashkësie të zgjuar, të kulturuar, të aftë në të folur dhe me nivel të lartë poetik dhe oratorik, fliste dhe sillej pa drojë e pa pengesë, a do të ishte e mundur të vazhdonte kështu për një kohë të gjatë pa u përgënjeshtruar?

6. Po qe se njeriu sheh se, pasi ka parashtruar një mendim, ide ose tezë, gjen përballë një kundërshtim në formën e një debati idesh të qytetëruar, mund të vazhdojë t'i mbrojë idetë e veta qofshin edhe të rreme ose të gabuara. Por nëse një njeri i vetëm bën durim dhe qëndresë para kërcënimit me vdekje për çdo çast, veçanërisht nëse nuk kthehet nga kauza e tij dhe nuk bie në pesimizëm edhe përballë fyerjeve tronditëse ndaj shpirtit dhe personalitetit të vet, përballë talljeve dhe pështyrjeve në fytyrë, kjo është një argument i palëkundur i drejtësisë së tij.

7. Sot shihni shumë njerëz që, bie fjala, kërkojnë të duken të justifikuar që s'kanë agjësuar dot në ditët e nxehta. Tani shkoni në atë shekull dhe mendoni një njeri në atë klimë shkretëtire, të shtrirë mbi rërën përvëluese duke pasur sipër diellin gjithashtu përvëlues dhe, sikur e gjitha kjo të ishte pak, të durojë edhe tortura vrasëse, e përse? Për një kauzë të rreme, frytet e së cilës s'ka për t'i parë kurrë në këtë jetë? Pastaj, përsëri po për atë kauzë të rreme, mendojeni të ketë për shtrat degë e gjethe hurme, të rrijë ditë të tëra pa ngrënë dhe një pjesë të madhe të jetës ta kalojë në fushat e betejës, dhe gjykoni: A janë të mundura të gjitha këto?

8. E rëndësishme s'është të dalësh në shesh me një kauzë të caktuar; e rëndësishme është t'i zbatosh dhe praktikosh vetë parimet që sjell dhe të bëhesh model i përsosur i kauzës tënde! Në histori ka sa e sa njerëz të quajtur të mëdhenj që kanë sjellë sisteme dhe ligje, por që nuk janë pranuar sepse nuk i kanë jetuar vetë thëniet dhe pretendimet e veta, nuk i kanë vënë dot në zbatim kauzën dhe sistemin e vet ose nuk i kanë mbajtur dot për një kohë të gjatë në këmbë, si dhe nuk kanë gjetur dot përkrahës të sinqertë, të plotë dhe besnikë. Dhe shihni, tani, namazet që ka falur ai Individualiteti që u thoshte të tjerëve "falni namaz", pasurinë që ka dhuruar ai që u thoshte të tjerëve të jepnin zekat, agjërimet e atij që u thoshte të tjerëve të agjëronin, dhe qëndrimin ndaj haramit (gjërave të këqija, të palejuara, të pabekuara, të ndaluara) të atij që dilte kundër haramit!

9. Njeriu zhvillohet fizikisht gjer në moshën 18 vjeç, kurse tharmimi i shprehive, karakterit dhe moralit fillon në moshë shumë të vogël. Pastaj shprehitë, karakteri dhe morali zhvillohen gjer në pubertet, zënë rrënjë në periudhën e rinisë dhe, pas moshës 30 vjeçe, marrin formë përfundimtare duke u kthyer në veti tipike. Ndryshimi i moralit dhe karakterit pas moshës 40-vjeçare *pa një operacion të gjerë kokë-zemër* është po aq i vështirë sa do të ishte ndërrimi i lëkurës! Tani le ta shohim Profetin: gjer në moshën 40 vjeç ka jetuar si i besueshëm, i ndershëm e i virtytshëm, duke i bërë të gjithë t'ia pranojnë dhe pohojnë drejtësinë dhe ndershmërinë. Po qe se, mos e dhëntë Zoti, do të bartte ndonjë ves a karakter të keq të bashkëlindur, kjo do t'i dilte në shesh nën ndikimin e moshës së rinisë. Është e pamundur që shprehitë e ngulitura gjer në moshën 40-vjeçare të ndryshojnë si me thikë. Dhe tani, a mund të mendohet që dikush i cili s'ka gënjyer kurrë gjer më 40 vjeç, të nisë, pas kësaj moshe, papritmas, të gënjejë?

10. Është mjaft e vështirë që një njeri gënjeshtar, fals dhe joserioz të gjejë një shok të mirë e të moralshëm për të bërë një bisedë, jo më të ketë shokë që të japin me gjithë dëshirë ç'kanë e ç'nuk kanë e të bëjnë fli jetën për të! Dhe shihni ju, tani, përreth tij, shokët me të cilët ai, pavarësisht nga mundimet dhe vështirësitë, e kreu misionin e tij profetik, pas tyre, tabiinët, ndjekësit dhe, pas tyre, mijëra dhe miliona njerëz të urtë e të shquar, specialistë të çdo dege të shkencave dhe miliona shpirtra të ndriçuar të grumbulluar rreth këtyre njerëzve gjigantë! A është e mundur, vallë, që kaq shumë njerëz të mblidhen bashkë rreth një çështjeje kontradiktore?

11. Po qe se edhe ky Individualitet, Zoti mos e dhëntë, s'është profet, atëherë s'mbetet gjë për t'u thënë për profetësinë e asnjë profeti tjetër. Sepse mesazhi i ofruar nga të gjithë profetët e tjerë, mrekullitë e treguara dhe shenja e lënë prej tyre janë një gjë pakrahasimisht e pakët dhe e vogël ndaj veprës së Kryeprofetit!

12. Është e pamundur që të dalë dikush tjetër me kauzën dhe veçoritë e tij, sepse është Allahu që na e ka mësuar neve këtë sfidim. Ai i fton njerëzit kështu në Kuran: "*Po qe se keni ndonjë dyshim mbi atë që i kemi zbritur robit Tonë, ejani dhe silleni edhe ju një sure si ato...*" (Bekare, 23) Dhe ka mbi katërmbydhjetë shekuj që askush nuk i është përgjigjur kësaj sfide!

13. Më në fund, si është e mundur që një njeri që nuk thotë gënjeshtër para njerëzve, të thotë para Zotit? Si është e mundur t'i paraqesë fjalët e tij si fjalë të Zotit?

DH. EDHE MORALI I PASHOQ I HZ. MUHAMEDIT ËSHTË DËSHMITAR I PROFETËSISË DHE DREJTËSISË SË TIJ

1. Morali i bukur është fiksuar në natyrën krijuese të njeriut në formën e farërave. Njëri prej kushteve kryesore për zotërimin e moralit të bukur që do të thotë shfaqje e natyrës së kulluar, dalje në dukje e krijimit të pastër dhe reflektim i shpirtit në pasqyrën e jashtme, ndoshta i pari, është edukata dhe sugjerimi. Po, morali i bukur, kthehet në autoritet që ushqehet në mjedisin e vet.

Tani le të shohim periudhat e jetës së Profetit para dhe pas profetësisë. Kush ia pati sugjeruar atij moralin më të bukur e më të lartë dhe kush e pati edukuar atë me këtë edukatë të përsosur? Nuk mund të themi për prindërit sepse ata i pati humbur qysh i vogël. Kurse duket krejt e pamundur që i gjyshi dhe xhaxhallarët t'i kenë dhënë atij një edukatë të tillë në shoqërinë ku jetonin. Mirë, po kush është edukatori i tij? përgjigjen le ta japim me vetë fjalët e tij: *"Eddebeni Rabbi, fe ahsene te'dibi!"* *"Mua Zoti im më edukoi dhe sa bukur më edukoi!"*

2. Në zhvillimin e moralit të mirë apo të keq ka shumë rëndësi edhe ndikimi i mjeteve, mjedisit dhe shoqërisë. Dhe tani, po të kthehemi në Mekën e shekullit të tij, shohim se njerëzit i kishin kaluar edhe vetë egërsirat në egërsi, se sundonin padrejtësia, dhuna, kamata dhe shfrytëzimi, se vajzat e vogla groposeshin përsëgjalli, se gratë shiteshin në tregun e robërve dhe skllevërve, se femrat përsillehin lakuriq përreth Qabes sepse s'gjenin dot baba për fëmijët e tyre... Mendoni vështirësinë e edukimit të brezave të rinj në kushtet e sotme kur ka nga një xhami për çdo lagje, dhe pamundësinë e zotërimit të moralit më të bukur e më të lartë në atë shekull e në ato kushte!..

3. Si çdo profet, edhe profeti Muhamed zotëronte me plot të drejtë dhe në shkallën më të lartë vetitë e drejtësisë, besnikërisë, kumtimit, zgjuarsisë dhe pafajshmërisë.

4. Po t'u hedhim një sy vetes sonë, mjedisit tonë dhe njerëzve të mëdhenj e të dukur si të mëdhenj që kanë ardhur e shkuar gjatë gjithë historisë, shohim se tek ta janë shfaqur vetëm bukuri morale të caktuara, por te asnjëri nuk vëmë re të jetë shfaqur morali i bukur e i lartë në tërë pasurinë e vet të gjithanshme! Dikush duket bujar, por jo falës në atë gradë; dikush është guximtar, por është dorështrënguar. Veçanërisht, asnjë bukuri morale s'është përfaqësuar te askush në shkallën kulmore. Kurse te ai Individualitet, të gjitha llojet dhe tiparet e moralit të lartë ishin të pranishme në nivelin më të lartë dhe kishin karakter të përhershëm dhe mbetës.

5. Është mjaft e vështirë që te një person, tiparet e moralit të bukur të jenë plotësisht në harmoni me njëri-tjetrin dhe vetveten në mënyrë që të mos dalin në pah mospërputhje e kontradikta cilësore. Konkretisht, dikush është bujar, por e çon bujarinë gjer në shpërdorim; është i mbledhur, jo dorëlëshuar, por kjo shkon gjer në dorështrëngesë dhe koprraci; është guximtar, por gjer në marrëzi! Kurse Profeti, të gjithë moralin e bukur e pati grumbulluar në vete në atë mënyrë që do të formonte një personalitet të lartë dhe asnjë tipar nuk e pati çuar në kufirin e të kundërtës. Bie fjala, Profeti ishte tejet guximtar dhe i ashpër, por, në të njëjtën kohë, ishte tejet i thjeshtë, modest, i butë e paqësor. Më e rëndësishmja, ashtu siç guximi dhe ashpërsia e tij nuk arritën kurrë në pikën e thyerjes së zemrave, ashtu dhe modestia dhe ndjenja e faljes nuk ranë kurrë në nivelin e frikës dhe turpërimit. Krahas rëndësisë dhe seriozitetit, ai ishte i buzëqeshur dhe qetësues; sa ishte i ashpër e i vështirë, ishte edhe falës dhe mëshirues me sa mundej; edhe kur sfidonte botën, ishte po aq modest sa ç'ishte kur, i ulur mbi rërë, bisedonte me një fëmijë. Është vetëm ai Individualitet që pati grumbulluar në vetvete në mënyrën më të përsosur dhe pa i ngatërruar me njëri-tjetrin, tiparet më kulmore të moralit të bukur e të lartë!

6. Askush nuk mund të bëhet prijës dhe specialist në çdo fushë e në çdo çështje. Në ditët tona, kur janë formuar qindra degë të shkencave, specializimi në një fushë çfarëdo kërkon vite, ndoshta

kërkon studim e përpjekje një jetë të tërë në atë fushë. Sigurisht, është e pamundur që një njeri të jetë edhe një njohës e përsosur i mjekësisë, edhe një ushtarak i përsosur, edhe një administrator i mençur, edhe një edukator, edhe një sociolog, edhe një mësues... Mirëpo të gjitha këto qenë realizuar në nivelin më të lartë të Profeti ynë. Këtë do ta shihni hapur kur të lexoni jetën e tij të shquar. Ndërkaq kur e mendojmë se për të bërë specializim jo në shumë fusha, por edhe në një fushë, madje, duhet një kohë e caktuar, duhen mjete dhe shpenzime të caktuara si dhe një atmosferë e qetë, puna na komplikohet krejt.

7. Shkoni në atë shekull të lumtur dhe shihni se si ai person që s'kishte marrë asnjë arsim pedagogjik, që s'kishte mbaruar asnjë shkollë ushtarake, që s'kishte dalë nga asnjë shkollë shoqërore, që jetonte në një kohë kur s'njiheshin teleskopi e mikroskopi, veçanërisht që s'dinte as të shkruante, as të lexonte, pra, shihni se si ky person, si të ishte një specialist i çdo fushe, thotë fjalë të gjalla e të pavdekshme, që s'gabojnë e s'i zbeh koha, që kryen përmbysje, që flet e vepron i sigurt e i qetë si udhëzues e specialist i çdo fushe! Më e rëndësishmja, duke i bërë tërë këto punë që kërkonin specializim, ai përdori si kapital vetëm një periudhë kohore të shkurtër 23-vjeçare dhe, duke e kaluar pothuajse tërë jetën në vuajtje e mundime, në fushën e luftës, duke marrë pjesë në çështjet e shoqërisë dhe, duke mos e lënë mënjatë drejtimin e përkryer të familjes së tij të madhe, duke vënë parimet shekullore të fesë së fundit, duke ngritur dhe vendosur një sistem që do të sundonte mbi tërë njerëzimin, si kishte mundur të thoshte fjalë autoritare në çdo fushë?

8. Tani, fakti që në shumë çështje, zgjidhja e të cilave kërkon kushte speciale, si kohë, mundësi dhe një atmosferë sigurie e qetësie, një njeri

a) do ta përfaqësojë moralin më të bukur e më të lartë;

b) do të ndodhet në kulmin e çdo lloj morali të bukur;

c) do ta zotërojë moralin e lartë në atë mënyrë që tiparet e tij të përbëjnë një harmoni tërësore pa rënë në kundërshtim me njëri-tjetrin dhe pa hyrë në fushën e njëri-tjetrit;

ç) dhe, duke u paraqitur me një moral të bukur, do të mos i harrojnë gjërat e tjera, do të mos i lërë pas dore e të mos i ngatërrojë me njëra-tjetrën, të gjitha këto, a s'argumentojnë drejtësinë dhe profetësinë e atij njeriu?

9. Mjeku i ndryshon ilaçet sipas të sëmurit dhe gjendjes së tij si dhe bën rregullimet e duhura në dozën e tyre. Edhe njeriu është i detyruar t'i llogarisë dhe rregullojë sjelljet, shprehjet dhe zakonet e veta sipas njerëzve me të cilët ka të bëjë. Sjelljet moralo-etike paraqesin ndryshime sipas kohës dhe vendit, cilësinë e postit dhe gjendjes së bashkëbiseduesve ose auditorit. Shpesh ne nuk i rregullojmë sjelljet sipas vendit dhe bëjmë gabime. Për shembull, po qe se kryeministri sillet në shtëpi sikur të ishte në kryeministri e të kishte të bënte me vartësit, kjo do të ishte vetëpëlqim dhe mendjemadhësi. Po qe se mëshirën dhe dhembshurinë që duhet të tregoni ndaj njerëzve, e tregoni në fushën e betejës ndaj armikut, kryeni një akt padrejtësie dhe mungese mëshire për njerëzit tuaj. Të mos e ngresh fëmijën për namazin e mëngjesit me ndjenjën e justifikimit se i prishet gjumi, nuk është dhembshuri për të, përkundrazi, është t'i bësh të keqe të madhe. T'ia radhitësh bashkëbiseduesit, në emër të orientimit të tij në rrugën e besimit, të gjitha të drejtat aty për aty, pa marrë parasysh gjendjen dhe nivelin e tij si dhe kushtet konkrete, jo vetëm s'është orientim, por, është tradhti dhe krim ndaj të drejtave në fjalë! Kur i shqyrtojmë një e nga një të gjitha fjalët dhe sjelljet e Profetit, shohim se si i ka rregulluar ai fjalët dhe sjelljet sipas vendit, personit, pozitës, kohës dhe kushteve

duke respektuar të gjitha imtësitë dhe se nuk ka bërë as stonimin më të vogël në këtë fushë. Dhe kjo përbën një argument të qartë për profetësinë e tij.

10. Le të themi se i rregulluat fjalët dhe sjelljet tuaja në çdo situatë dhe, duke treguar forcë vullneti, mundët ta caktonit formën e veprimit. Mirëpo shpesh herë njeriu mbetet i detyruar të marrë vendim të çastit pa patur mundësi të mendohet gjatë. Për shembull, nëse jeni në front dhe, para një situatë të re, ju duhet të merrni vendim në çast, po të mos veproni siç jua do situata, por të rrini e të mendoheni pak a shumë gjatë, mund të pësoni një humbje dhe fatkeqësi të madhe. Ndërkaq, nga ana tjetër, ndodh shpesh që vendimet e marra në çast, fjalët e lëshuara pa e menduar pasojën e tyre dhe hapat e hedhur pa bërë llogari e fusin njeriun në situata pa rrugëdalje. Prandaj duhet që, kur flitet, kur planifikohet një punë, duhen futur në llogari edhe ngjarjet në të ardhmen, kundërvajtjet e mundshme dhe vështirësitë që mund të dalin. Dhe tani mendoni: ç'do të bëni nëse vendimet që do të merrni, hapat që do të hidhni dhe fjalët që do të thoni, do të kenë të bëjnë jo vetëm me disa ditë, madje disa muaj, disa vjet, ose disa shekuj më tej, por me të gjitha kohërat gjer në kiamet? Atëherë, nëse personi, çdo fjalë, çdo sjellje dhe çdo hap i të cilit, për shekuj të tërë ka gjetur miratimin e njeriut të çdo periudhe, të çdo botëkuptimi dhe të çdo niveli, është parë si shumë i përshtatshëm për zbatim, është bërë zgjidhje për të gjitha pengesat dhe vështirësitë e përballura dhe, me kalimin e kohës, jo që s'është zbehur dhe humbur, por është rinuar edhe më shumë, është fuqizuar dhe ka dalë mbi kohën, nëse një person i tillë, pra, nuk është profet, ç'është?

11. Po qe se na pyesin për këtë person, moralin e bukur të të cilit e përshkruam vetëm në pikat kryesore, themi: "Po, ai është një profet, Kryeprofeti, kurse ne jemi dëshmuesit e tij, dëshmuesit e të vërtetës në emër të të Vërtetit!" Sepse një moral kaq i bukur e i lartë gjendet vetëm te njerëzit e drejtë! Morali i bukur mund të mbijë, të rritet e të çelë burbuqe vetëm në dheun e drejtësisë. Është e pamundur që njeriu që gënjen të mos ketë dobësi dhe njolla edhe në fjalët dhe sjelljet e tjera të tij. Gënjeshtria është pothuaj si fillimi i një rrethi vicioz. Në mënyrë zinxhir, ajo sjell pas të gjitha llojet e moralit të keq. Ashtu siç sjell fjala e drejtë moralin e bukur. Tani, është e qartë se ai përfaqësuesi i moralit të lartë me kryet në qiell, qysh në krye të punës, duke formuar një rreth të hapur, e pati filluar këtë detyrë të lartë, misionin profetik, me drejtësi dhe në emër të së vërtetës dhe, si rezultat, e pati mbyllur me sukses të plotë.

12. Të njëjtën ide mund ta shohim edhe nga një këndvështrim tjetër. Mes gjërave të përshtatshme e të përputhshme me njëra-tjetrën, ka prirje dhe tërheqje, kurse mes gjërave antagoniste dhe opozitare ka neveri dhe shtytje. A nuk janë shokët që zgjedhim, më të përshtatshmit ndaj karakterit dhe botës sonë mendore? Ndërsa vendet dhe mjediset plot tym dhe kundërmim të ndyrë tërheqin personat e përshtatshëm për to, është e qartë se shtëpitë e Allahut do të tërheqin njerëzit e bekuar, të përshtatshëm për to! Sigurisht, e drejta gjithmonë do të tërheqë njerëzit e drejtë dhe do t'i strehojë në gjoksin e saj. Atëherë, a është e mundur që njeriu i cili ka tërhequr pas vetes gjer më sot miliona njerëz të drejtë, të mos jetë thelbi dhe konkluzioni i drejtësisë? Nëse tërheqësi është më i bukur, edhe i tërhequri do të jetë i bukur. Ç'tërheqje e lartë dhe e paarritshme ajo e tij që për shekuj të tërë i ka bërë milionat të pasionuarit e vet!

13. Te njeriu që ka një moral të tillë të lartë e të bukur, gjithsesi do të ketë respekt për vetveten, dinjitet dhe nder dhe, duke qenë i tillë, ai kurrë nuk ka për t'u prirur nga gënjeshtria dhe dredhia.

14. Jeta, fjalët dhe sjelljet e asnjë njeriu në histori sa të Profetit tonë nuk janë hulumtuar, studiuar, saktësuar e zbatuar në praktikë. Veçanërisht, sot, në të gjithë botën, është vetëm emri i tij

që përmendet së bashku me emrin e Allahut, Zotit të gjithësisë, pesë herë në ditë, pa intervale e pa pushim!

E. TRANSFORMIMET E KRYERA NGA HZ. MUHAMEDI NË ÇDO FUSHË JANË ARGUMENTE TË PROFETËSISË SË TIJ

1. Ç' mund të jetë përgjigja që mund t'i jepet pyetjes "cili është profesioni më i rëndësishëm, më i nevojshëm, më i vështirë e më i dobishëm në botë?" A mos është administrimi profesioni që i mbledh në vetvete këto katër veçori, apo politike, apo gjykatësia, hetuesia, avokatia, ushtria, policia? A mos është bujqësia, artizanati, tregtia, apo mësuesia, shkenca, prijësia shpirtërore, mësuesia fetare? Po t'i pyesni ata që kanë një profesion, secili do të zërë t'ju flasë për nevojën, dobitë, vështirësitë dhe rëndësinë e profesionit të vet. Sigurisht, çdo profesion ka, sipas tij, dobinë, rëndësinë, vështirësinë dhe domosdoshmërinë e vet, por, ndërkaq, thelbi dhe baza e çdo profesioni dhe veprimtarie duhet të jetë, pa asnjë diskutim, *elementi njeri*, domethënë, rritja e individit dhe përgatitja e tij për t'u bërë i dobishëm.

2. Për të rritur dhe përgatitur "njeriun e veçantë (të zgjedhur)" që është shtylla qendrore e shoqërisë, para së gjithash duhet që edukuesi të jetë i veçantë (i zgjedhur) dhe i përsosur në aftësi dhe moral. Veç kësaj, edukuesi duhet të jetë në gjendje që ligjet e krijimit të individit që merr në dorë, natyrën e tij, aspektin psikologjik, strukturën shpirtërore, aftësitë dhe mundësitë, kulturën dhe botëkuptimin, botën ndjesore, ndjenjat, mendjen dhe veçorinë e të menduarit, prirjet dhe dëshirat, dobësitë dhe anët e dobëta, pozitën shoqërore dhe, më të rëndësishmen prej këtyre, veçoritë që ka për të fituar në të ardhmen, fushat ku do të mund të bëhet i suksesshëm dhe produktiv, shkurt, edukuesi duhet të jetë në gjendje ta lexojë si një libër dhe ta kuptojë njeriun me të gjitha aspektet e tij. Pastaj, as ky përkufizim dhe analizë nuk janë të mjaftueshëm. Është me mjaft rëndësi të orientohen dhe drejtohen individët duke marrë vendimin më të qëlluar pa i ngatërruar dhe harruar të gjitha këto aspekte të secilit individ, në kohën dhe vendin e vet, sipas bashkëbiseduesit dhe gjendjes së tij, duke thënë atë që duhet thënë dhe duke mbajtur qëndrimin më të përshtatshëm dhe duke marrë vendime ku të jenë llogaritur përfundimet. Përtej kësaj, pas njohjes në mënyrën më të mirë të çdo individ një e nga një dhe pas zgjedhjes dhe përcaktimit të sjelljes së përshtatshme dhe mënyrës së bisedimit me secilin prej tyre, t'i fshish me metodat më pozitive moralin dhe veset apo shprehitë e këqija të pranishme te çdo individ, ta kalosh çdo individ nëpër operacionin e kokës dhe zemrës duke futur në llogari efektet anësore dhe reaksionet e mundshme, ta pastrosh prej të gjitha mikrobeve dhe tumoreve të këqija dhe, pas të gjitha këtyre, të bësh që grafiku i nxënësit të marrë prej niveleve të ulta, të ndjekë vazhdimisht një vijë ngjitëse duke e pajisur me shprehitë më të larta por pa kaluar në ekstremin tjetër, pra, pa e tepruar, ashtu siç bën bujku që, për të marrë prodhime të mbara, pasi e ka përgatitur siç duhet tokën për mbjellje dhe ka hedhur farën më të zgjedhur, ia pastron barërat e këqija që bima të rritet e shëndoshë, të gjitha këto përbëjnë një çështje të veçantë me rëndësi jetësore, ndjekjen e vazhdueshme të edukimit të personit dhe kujdesin për të.

3. Besimi i një njeriu mund të duket i shëndoshë, por është pa adhurim. Flet për atdhedashurinë, por as veten s'e shpëton dot nga sëmundja e ryshfetit. Është i hollë në sjellje, i edukuar, por ç'e do që nuk është i ndjeshëm kur vjen puna për ta mbrojtur mallin dhe pasurinë e popullit. Pastaj, mund t'i ketë mbledhur në vetvete të gjitha llojet e moralit të bukur, por ç'e do se ky moral nuk i është

qëndisur në mendje dhe zemër, për rrjedhojë, nuk i është kthyer në pjesë të pashkëputur të personalitetit. Duke qenë kështu, atë që fiton sot, mund ta humbë nesër, ndërsa sot duhet, nesër mund të kthehet në person të padëshiruar ose të neveritur. Dhe tani mendoni një njeri që beson, që i bën të tjerët të besojnë dhe i ngre peshë zemrat besimtare me të gjitha llojet e adhurimit. Thotë “moral”, e jeton vetë dhe i bën edhe të tjerët ta jetojnë dhe pastaj siguron vazhdimësinë e të gjitha këtyre me të njëjtën dëshirë gjer në varr. A mund të dyshohet, vallë, në faktin se ky njeri bart një fuqi të shenjtë? Zoti na ruajttë! Ja, pra, Edukatori më i madh i njerëzimit i ka bërë të gjitha këto punë dhe ka përgatitur individët më të përsosur dhe me këta individë që njerëzimi ndoshta s’ka për t’i parë edhe një herë tjetër, formoi shoqërinë më të përsosur. Në këto kushte, nëse ai s’është profet, kush mund të jetë?

4. Një tjetër specifikë e rëndësishme në edukimin e individit është mospërdorimi i detyrimit. Sanksionet ndëshkimore, masat shtrënguese, forcat ushtarake dhe policore mund të jenë të efektshëm vetëm gjer në një shkallë, vetëm se mund t’i hapin rrugë lindjes ndër zemra të ndjenjës së urrejtjes kundër sistemit dhe vlerave që kërkohet t’u dilet për zot dhe të mbrohen. Prandaj, të hysh në zemra, t’i bësh ndërgjegjet ta bëjnë të vetën çështjen, ta qëndisësh atë në mendje e në zemra dhe, po qe e mundur, ta bësh të dashur, është esenciale në përgatitjen e individëve në emër të kauzës që mbrohet. Dënimet dhe masat shtrënguese ndoshta mund të zbatohen, pasi kauza të jetë përvetësuar me të gjitha aspektet e saj, kundër atyre që përpiqen të kthehen mbrapsht dhe atyre që i lënë aftësitë t’u atrofizohen. Sepse tharmi dhe eliksiri që ua fusin individëve në shpirt kauzën si në fillim, ashtu dhe në fund, duhet të jenë gjithmonë afërsia, dashuria, dhembshuria dhe mirëkuptimi dhe vetëm në çastet kur është tejet e domosdoshme, mund të përdoren kudhra dhe çekiçi!

5. Po, është e pamundur të tregosh një njeri të dytë i cili, elementin njeri, atë qenien më komplekse që është objekt studimi i universiteteve me qindra degë dhe i mijëra specialistëve, ta kuptojë më mirë se Profeti ynë, ta mbrujë dhe përgatisë më mirë se ai, t’ia lërë vendeve e kohëve si model dhe personat që përgatiti, t’i bëjë mësues dhe prijës për popujt e qytetëruar!

6. Është sheshit se sa e vështirë është t’i ndërrosh apo ndryshosh besimet, bindjet, sidomos bestytnitë dhe idetë fikse të shtresuara në mendje e në zemër. Pa le t’i bësh njerëzit që i kanë kaluar të dyzetat, t’i braktisin bindjet e gabuara dhe bestytnitë, që është më e vështira e të vështirave! Mirëpo këtë punë nga më të vështirat arriti ta bëjë Kryeprofeti i cili, nga njerëzit e egër, kokëfortë, kundërshtues dhe që u pëlqente vetja, nxori udhëzuesit më të shquar të njerëzimit.

7. Profeti ynë hyri në zemra pa përdorur kurrë kërcënim, detyrim, frikësim dhe shtrëngim. Ai ngriti fron në skajet më të zgjedhura të zemrave dhe i bindi mendjet duke mënjanuar dhe fshirë dyshimet. Kurrë gjatë jetës së tij s’u vu re që ai të përdorë shtrëngimin dhe urdhërimin nga lart. Fundja, po të kishte përdorur kërcënimin dhe detyrimin, as që mund të mendohet që Feja e sjellë prej tij të arrinte gjer në ditët e sotme duke kapërcyer shekujt, sidomos të përhapej me një shpejtësi të panjohur në histori dhe të bëhej nëna e qytetërimeve. Asnjë sistem mendimi dhe besimi s’mund të vendoset duke këputur koka e duke copëtuar zemra; edhe nëse vendoset përkohësisht me këto mënyra dhe mjete, është tejet jetëshkurtër. Ata që kanë përdorur forcën dhe shtypjen, janë shembur dhe kanë marrë fund së bashku me sistemet që kanë ngritur, duke mbetur përgjithmonë në faqet e errëta dhe të zeza të historisë!

8. Personat që dalin në shesh me ndonjë kauzë çfarëdo, shpesh u premtojnë partnerëve gjëra me karakter temporal, si pushtet, pasuri, post, pozitë, etj. Por Kryeprofeti që gjatë gjithë jetës s’pati shijuar gjë tjetër veç papasjes, urisë, ankthit e vuajtjes, nuk bëhet fjalë t’u ketë premtuar të tjerëve

gjëra të tilla, por për vete i pati hedhur poshtë me vendosmëri të gjitha premtimet e këtij lloji që i qenë bërë vazhdimisht në Mekë, duke parapëlqyer *miratimin e Zotit dhe shpërblimin shpirtëror!* Shihni familjen dhe shokët e tij që patën parapëlqyer pa asnjë ngurrim skamjen ndaj kamjes, thjeshtësinë ndaj popullaritetit dhe famës, jetën e pasosur ndaj kësaj bote!

9. Një person i pasinqertë në çështjen apo kauzën e tij dhe që s'është profet, e ka të pamundur jo më të hyjë në zemrën e armiqve e t'i bëjë t'i besojnë drejtësisë së tij, por as t'ua fitojë zemrat miqve dhe të marrë mbështetjen e tyre, madje as të krijojë një mjedis miqësor rreth vetes! Kurse Profeti ynë, pa përdorur asnjë lloj detyrimi, me dhembshurinë, mëshirën, dashurinë, mirëkuptimin dhe ndjenjën e faljes që e karakterizonin, pati triumfuar zemrat jo vetëm të miqve, por edhe të armiqve që kishin nxjerrë shpatën kundër tij, si Ebu Sufjan, Ikcrime, Halid, Vahshi, Hind, Amr dhe Safvan.

10. Ta zëmë se jeni mësues në një shkollë ose drejtues në krye të një institucioni. Qëllimi juaj është të hyni në zemrat e nxënësve ose punonjësve, t'ua përçoni mesazhin tuaj mendjeve dhe zemrave të tyre dhe, për t'i arritur këto, jeni gati të pranoni çdo lloj vështirësie, t'u vini gjoksin të gjitha fyerjeve, dëmeve moralo-materiale dhe rreziqeve. Dhe, tani, pasi keni vendosur kështu, provojeni veten duke supozuar se njerëzit me të cilët keni të bëni, kur kaloni pranë tyre, ju pështyjnë në fytyrë, kur jeni në sexhde, ju hedhin fëlliqësira mbi kokë, herë pas here ju japin ndonjë shpullë, në rrugën nga kaloni, ju shtrojnë ferra ose hedhin gurë, ju presin në qoshet e rrugës ose të shtëpive kërcënues me kama në duar, mes popullit tallen me ju dhe ju vënë në lojë, shpifin për familjen tuaj, ju vrasin të afërmit duke ua nxjerrë zemrën dhe mëlçinë jashtë për t'ua copëtuar, jua vrasin shokët e ju plagosin ju vetë dhe, më në fund, ju detyrojnë ta braktisni vendlindjen... Ç'do të bënit po qe se do të ndodhte me të vërtetë kështu me ju? A do bënit lëshim, a do të tregonit dot durim? A do të vazhdonit dot në rrugën tuaj pa pësuar as lëkundjen më të vogël? A do t'u përgjigjeshit dot me mirëkuptim dhe falje këtyre trajtimeve duke e vazhduar dashurinë, dhembshurinë dhe mëshirën ndaj tyre? A do të luteshit dot për ta, "*O Zot, fali se s'dinë dhe futi në rrugë të mbarë*"? Për më tepër, a do të ktheheshit përsëri mes tyre pasi të kishit rrokur qiejt e të kishit soditur parajsën? Kështu, pra, të mos e pranosh profetësinë e atij Individualiteti që nuk u tund kurrë para të gjitha fyerjeve e torturave e që, me mëshirën, dashurinë, dhembshurinë dhe mirëkuptimin e palëkundshëm të tij, njerëzit më të egër i ktheu në njerëz model, është një mijë herë punë e keqe dhe verbëri!

11. Po të merrni të shqyrtoni jetën e sahabëve, do të shihni se si e kërkonin vdekjen në shërbim të fesë që kishte sjellë ai Personalitet, se si e prisnin vdekjen duke qeshur në fushën e luftës, se si e nënvleftësonin jetën e kësaj bote dhe vini re se si, nga 80-vjeçari te fëmija, nga burri te gruaja, bënëin garë për të rënë dëshmorë. Të mendosh për falsitet në një çështje që e bën kaq të dashur vdekjen, që i bën ndjekësit e saj ta kërkojnë vdekjen e të vrapojnë të apasionuar pas saj, do të thotë të mos e dish se ç'është e drejta dhe e vërteta!

12. Sigurisht, për ta bartur dhe çuar më tej një kauzë, është shumë e rëndësishme të përgatitësh ndihmësit që do t'i vënë supet asaj. Ndërkaq, është, të paktën, po kaq e rëndësishme të sigurosh që këta ndihmës të qëndrojnë atje ku ua do puna me durim, qëndresë dhe vendosmëri edhe në kohët më të vështira, atëherë kur shqetësimet, vuajtjet, ankthet, ngatërresat dhe fatkeqësitë të vërshojnë si lumë. Historia tregon për shumë e shumë raste shthurjeje e disfate në kushte të tilla. Kurse e njëjta histori flet vetëm për durimin, qëndresën dhe vendosmërinë e sahabëve, shokëve dhe ndihmësve të Profetit në kauzën e përbashkët.

13. Njerëzit e drejtë e të ndershëm janë mjaft të singertë në dashuri dhe respekt. Njeriu që duan këta, është me të vërtetë i denjë për atë dashuri dhe respekt. Dhe po që se kjo aureolë dashurie premton për të qenë e vazhdueshme në këtë botë dhe e orientuar për në botën tjetër, e këtyre përmasave është edhe vlera e njeriut që duhet. I Dërguari i Allahut, i cili është bërë fokusi i dashurisë së miliona dhe miliarda njerëzve, është njeriu më i dashur ndër njerëzit që kanë ardhur e shkuar nga kjo botë. Dhe kjo, vetëm si rrjedhojë e profetësisë së tij. Po të mos ishte profet, ai përsëri do të duhej dhe duhet, por atëherë kjo dashuri nuk do të vulosej me vulën e përjetësisë!

14. Çdo komb bën të vetat idetë dhe idealet e parashtruara e të sugjeruara nga mendimtarët e vet, synimet e caktuara prej tyre. Këto shfaqen të dobëta apo të fuqishme, modeste apo aktive, të fshehura apo të hapura në botën mendore, në shtyp, përgjithësisht në mjetet e informacionit masiv dhe në jetën shoqërore e politike të atij kombi. Por arritja e një uniteti ideor dhe ideal në përmasa kombëtare si në cilësi, ashtu dhe në sasi, mund apo s'mund t'u ketë rënë në pjesë në histori një numri kombesh sa gishtat e dorës. Më e rëndësishme se kjo, mundësia për ta mbajtur këtë unitet besimi dhe ideali jetëgjatë dhe të gjerë sa të kapërcejë shekujt dhe kontinentet, dhe për ta treguar në praktikë, i pati rënë në pjesë bashkësisë së bekuar të formuar prej atij Personaliteti mëse katërmëdhjetë shekuj më parë dhe që arritur në sajë të përpjekjeve të asaj bashkësie për t'ua bërë të njohur emrin e Allahut të gjithë njerëzve “me zemër” dhe për t'i ngopur ata njerëz me të vërtetat e amshuara dhe me jetën e amshuar. Kështu që formuar historia dhe që mbushur me fitoret e këtij ideali. Dhe tani, ju, nëse nuk do ta shihni të denjë për profet Individualitetin që ndezi ndër zemra këtë ideal sa në përmasa cilësore, aq dhe sasiore, kë do të shihni?

15. Ka ndodhur dhe ndodh që ne, si mësues, shërbyes fetar, administrator ose, thjesht, baba, herë pas here të mbetemi të paaftë para pyetjeve shumë të zgjuara të fëmijëve dhe nxënësve tanë të vegjël. Veçanërisht, është e qartë se pyetjet që na duhet t'u japim personave me kultura dhe mendësi të ndryshme, do të ndryshojnë sipas gjendjes së tyre. Në raste të tilla, shpesh nuk arrijmë dot ta bindim bashkëbiseduesin dhe ndjejmë nevojën për të studiuar literaturë dhe bibliografi. Ndërkaq, edhe pyetjet që kemi mundur t'u përgjigjemi, u përkasin, përgjithësisht, çështjeve të fushave tona. Kurse Profeti, megjithëse s'dinte shkrim e këndim, u përgjigjej të gjitha pyetjeve të çifutëve, veçanërisht, edhe pyetjeve të beduinëve dhe sahabëve u përgjigjej në atë mënyrë që i bindte si mendje dhe i ngopte si zemër. Dhe kjo ishte një mënyrë e tillë përgjigjeje që i mënjanonte dyshimet e çfarëdo niveli që do të lindnin për të njëjtën çështje shekuj më vonë. Bie fjala, mënyra e faljes së namazit në polet me gjashtë muaj ditë e gjashtë muaj natë zgjidhej qysh me përgjigjen e dhënë njerëzve të asaj kohe. Dhënia e përgjigjes në këtë mënyrë, edhe për sot, edhe për nesër, edhe për të ardhmen e largët dhe për të gjitha nivelet është një punë që mund ta bëjë vetëm njeriu që është profet dhe Ai e ka bërë këtë ashtu siç duhet!

16. Aftësia konceptuese, rrokëse, vizionare, parashikuese dhe parandjerëse janë cilësi që ndodhen te pak njerëz. Ta shohësh të ardhmen, t'i zbulosh dhe njohësh shumë mirë njerëzit që ke përreth me të gjitha veçoritë e tyre, duke ua parandjerë aftësitë, mundësitë, dhuntitë dhe talentet, t'i vësh në punë secilin në fushën më të përshtatshme për të, atje ku ai mund të japë rendimentin më të lartë pa ndërë nevojën, pastaj, për të thënë “s'doli gjë, s'bëri gjë” dhe për të bërë ndryshime, të gjitha këto janë shprehje të një parandjenje, kuptimi dhe njohjeje tejet të thellë e të qëlluar. Ndërkaq, po që se kjo aftësi parandjenjeje, kuptimi dhe njohjeje vazhdon të ekzistojë dhe veprojë gjatë gjithë jetës pa treguar asnjë shmangie ose gabim, do të thotë se personi me këto cilësi ka një zgjuarsiri të nivelit të gjeniut. Më tej, po që se kjo cilësi është e tillë që të përfshijë gjithë jetën, bëhet

një mrekulli. Ja, e tillë ka qenë zgjuarsia e Profetit. Të gjitha cilësitë tek ai kanë qenë tërësisht përsosmërisht mrekullore!

17. A nuk janë dëshmitarët më të pakundërshtueshëm të profetësisë së tij, së bashku me bashkësinë e sahabëve që u patën dhënë dritë shekujve, që u patën shërbyer tërë kombeve si mësues shkence, ideje, administrimi e qeverisjeje, politike, sociologjie, ekonomie, shkurt, mësues të çdo fushe, dhe që kanë ngritur qytetërime, pra, bashkë me sahabët, edhe personalitete të tillë si Ebu Hanife, Shafii, Bistami, Gejlani, Rabbani, edhe tabiinët, tebei tabiinët dhe brezat e ndritshëm të mëvonshëm?

18. Është mjaft e vështirë ta bësh një njeri t'i braktisë zakonet dhe shprehitë e ngulitura në shoqëri. Lërinijet pijet alkoolike, bixhozin, prostitucionin, ryshfetin, mashtrimin, vjedhjen dhe krimin, sot konsiderohet sukses i madh ta bësh një njeri ta lërë cigaren! Megjithë këmbënguljen e predikuesve dhe shkencëtarëve për t'i bindur njerëzit për dëmet e tyre, si duhani, edhe alkooli, edhe bixhozi nuk po lihen. Ç'nevojë kemi për të shkuar më tej? A jemi në gjendje t'i pakësojmë tri vakte ushqim në dy, t'i braktisim pijet joalkoolike të shtrenjta, madje, kafën dhe çajin, apo të heqim dorë nga llojshmëria e veshjes?

Po le të shkojmë edhe në atë Shekull Drite dhe të bëhemi dëshmitarë sesi ai Personaliteti i cili, megjithëse s'ishte pushtetar dhe sundues, megjithëse nuk përdori asgjë urdhër dhe shtrëngim, se, fundja, as që kishte mundësi të urdhëronte dhe shtrëngonte kënd, hoqi nga individët dhe fiset e mëdha e të ndryshme që u ishin rrënjësuar në gjak zakonet, shprehitë dhe veset, që ishin jashtëzakonisht kryeneçe, fanatikë, të egër dhe të lidhur gjer në fund pas traditave, brenda një kohe të shkurtër, me fare pak përpjekje e këmbëngulje, jo një e pesë, por, ndoshta, me dhjetëra dhe qindra zakone e vese të këqija. Përtej edhe kësaj, shohim se, duke mos u mjaftuar vetëm me heqjen e zakoneve dhe shprehive të këqija, nguliti me lehtësi, sikur të injektonte serum, të gjitha llojet e moralit të bukur. Dhe, pas kësaj, a s'na bie në të ulemi me duar në prehër para tij e të themi *"eshhedu enneke Resulullah"*, *"dëshmoj se ti je i dërguari i Allahut?"*

Po, Personaliteti i cili është autori i veprimtarisë së përshkruar më sipër, është figura e vetme dhe unike, për të cilin historia nuk tregon ndonjë shembull të dytë!

19. Ju kërkoni të pajtoni dy vëllezër që rrinë të zemëruar me njëri-tjetrin qysh prej tre vjetësh. Ose keni dy fqinj që janë grindur dhe ju duhet t'i afroni. Ose jeni para një grupi shoqëror ose shoqërie, individët e të cilit janë vrarë me njëri-tjetrin për shkaqe politike e ideologjike. Ose jeni brenda një grupi shoqëror ose shoqërie të bërë copë-copë nga gjaqet që vazhdojnë prej vitesh... Ja, pra, në këto kushte, si mund të sigurohen paqja, vëllazëria dhe bashkëjtesa njerëzore?

Po të kthehemi mëse katërmëdhjetë shekuj pas në shekullin e Tij, do të na dalë para një shkretëtirë e egër dhe, në të, grindjet e pambaruara mes fiseve, luftimet mes tribuve, konkurrenca mes gjaqeve familjare, degë gjenealogjike vëllazërore të ndara më dysh nga hakmarrjet e gjakut dhe kontradikta me bazë kusarish e punësh të ulëta që mezi presin të mbarojnë muajt e ndaluar për të rifilluar përleshjet. Gjithashtu do të shohim femrat të shiten në treg si një mall i zakonshëm, të bëhen lodra epshi dhe vajzat e vogla të groposen përsëgjalli. Veç këtyre, do të shohim të dobëtit dhe të varfrit të shtypen gjer në fund, tregun të mbahet nën presionin e kamatës, akaparimit dhe korrupsionit, vlerën e njerëzve të përcaktohet sipas gjakut, prejardhjes dhe fisit, përhapjen e pakufizuar të çdo lloj shpërdorimi dhe forcën të bëhet ligj. Dhe tani le të shohim atë Personalitet pa shkrim e këndim, në kushte të tilla dhe brenda një kohe të shkurtër 23-vjeçare, t'i qytetërojë ato fise

të egra, të nxjerrë nga ato egërsira, modele të mëshirës dhe dhembshurisë që druhen të vrasin edhe një milingonë, t'i kthejë ata njerëz që grabisnin mallin e njëri-tjetrit, në njerëz-engiëj që e ndajnë me gjithë zemër dhe tërë gëzim me vëllanë gjithçka që kanë dhe që, para se të ngopen vetë, kërkojnë të ushqejnë dhe ngopin vëllanë... E, pra, para gjithë kësaj përmbysjeje gjigande, a s'do të themi edhe një herë *"Muhammedun Resulullah"*, *"Muhamedi është i Dërguari i Allahut"*?

20. E pse të duket e papranueshme profetësia e një personi që i përfshin të gjitha kohët dhe vendet, që i zgjidh çdo personi çdo çështje dhe të gjitha çështjet e të gjitha shtresave, që mundet ta trajtojë të gjithë jetën me të gjitha aspektet e saj, që është i pastër nga të meta të tilla si zbehja e vlerave dhe e personalitetit, zhvlerësimi me kalimin e kohës, pamjaftueshmëria dhe nevoja për rikuperim, që e fillon vënien në jetë të një sistemi gjithëbotëror me një burrë, me një fëmijë, me një skllav dhe me një grua dhe e vendos plotësisht brenda një kohe të shkurtër prej 23 vjetësh?

21. Po që se s'është e mundur të tregohet një njeri i dytë i cili, me Kuranin dhe traditën e tij profetike, u shërben si model jete miliona njerëzve, i cili, i përshkruar në mijëra libra, ka zënë dhe vazhdon të zërë vend për të mos u fshirë kurrë në mendje dhe në zemra, në personin e të cilit, në transformimet që kreu dhe në asnjërin prej parimeve që solli nuk tregohet as gabimi më i vogël, as e meta më e parëndësishme, as pasaktësia më pak e dukshme, emri i të cilit i njoftohet tërë botëve pesë herë në ditë në çdo pikë të globit, dhe s'është e mundur të tregohet, atëherë, a s'na takon që edhe një herë tjetër të ulemi me duar në të lidhura në brez për të thënë *"ue eshhedu enne Muhammeden abduhu ue resuluhu"*, *"dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij"*?

22. Siç do të trajtohet më tutje, njëri prej dëshmitarëve më të mëdhenj të profetësisë dhe drejtësisë së tij është *koha*. Ashtu siç e ka kryer këtë dëshmi e kaluara me një shkëlqim si të diellit, ashtu dhe e ardhmja do të njoftojë dhe dëshmojë për të me një shkëlqim si të diejve. Madje agimi i pranverës së të ardhmes e grisi perden e natës dhe nisi të zbardhë. Sigurisht, ndërsa shkohet drejt shekullit XXI, kalimet si ortek në Islam në Europë dhe në zonat e tjera të botës, formimet e reja dhe shembja një nga një e të gjitha izmave të mbështetura në materializëm a nuk janë sihariqe të reja të kësaj pranvere të re?

23. Librat e shumë shkencëtarëve dhe mendimtarëve vendas e të huaj, miq e armiq, të vdekur e të gjallë janë plot me miratime dhe admirime në çështje të tilla si personaliteti i tij, morali, suksesi në zgjidhjen e vështirësive, përsosmëria e rendit dhe rregullit që solli si dhe nevoja e njeriut të sotëm për të!

Ë. NJOFTIMET E HZ. MUHAMEDIT MBI TË KALUARËN JANË ARGUMENTE TË PROFETËSISË DHE TË DËRGIMIT TË TIJ SI PROFET

1. Historia është një degë shkence. Edhe pse mund të duket e lehtë në vështrim të parë, po të shihet thellë dhe me rrënjë, kuptohet se ç'degë shkence e vështirë dhe e koklavitur është! Historia nuk bëhet provë, nuk eksperimentohet në laborator dhe te ajo nuk arrihen përfundime të shpejta si në shkencat eksperimentale. Është e pamundur që ngjarjet e kaluara, ndodhitë historike dhe heronjtë e atyre ndodhive të nxirren sërish në skenë për t'u vëzhguar si film. Prandaj, ato që dimë për historinë, janë, nga një anë, ato që parashtrajnë dokumentet dhe që tregojnë librat. Veçanërisht, meqë vlerësimi i personave varet vetëm nga ngjarjet ose fjalët e dëshmitarëve okularë, qëllimet dhe synimet e vërteta fshihen.

Mendoni një teatër. Lojtarët në skenë, pas saj regjisorit me skenaristin dhe, përballë skenës, shikuesit. Janë edhe aktorët e vërtetë të lojës që po luhet. Tani, kur ta dëgjoni këtë lojë vetëm nga goja ose pena e shikuesve, ç'mund të kuptoni dhe sa mund ta kuptoni? Nga ana tjetër, a nuk do të jenë të ndryshme mendësia, kuptimi, vlerësimi dhe tregimi i çdo shikuesi? Pastaj, sa mund të dihen dhe njihen nga shikuesi qëllimi i lojës, individualiteti dhe qëllimi i atyre që e kanë vënë lojën në skenë? Nëse puna qenka kështu në një lojë skenike të thjeshtë, do të jetë e pamundur të mësohen dhe vlerësohen me fytyrën e tyre të vërtetë ngjarjet e skenës me marrëdhënie shumë të ndërlikuara, me kurthe që s't'i merr mendja, me përpjekje të atyre që i mbajnë fijet e lojës në dorë për t'i treguar xhuxhat diva e divat xhuxha. Dhe po e patëm kaq të vështirë për t'i kuptuar ngjarjet që na zhvillohen para syve, si mund t'i vlerësojmë saktë ngjarjet që shtrihen në errësirat e historisë?

2. Besueshmëria e dokumenteve që kemi në dorë do të ndikojnë gjithmonë në raport të drejtë mbi saktësinë e vendimit që kemi për të marrë. Mirëpo, s'është aspak e mundur të flitet pozitivisht mbi besueshmërinë e historisë së vjetër. Prandaj ndodh që historia të mos ruhet dot nga pasaktësi të ndryshme. Mos shkoni shumë larg, por hidhini një vështrim Testamentit dhe Ungjillit me gjendjen e tyre të sotme dhe do të shihni ç'bestytini, ç'shpifje do të gjeni mbi ata njerëz të zgjedhur që edhe engjëjt i kanë pasur zili për nderin dhe virtytin! Po që se, qoftë, kjo, korrigjim, ndodh kështu me librat që përmbajnë hyjnitet, në ç'gjendje janë, vallë, librat, tërësisht produkte të zbrazëtirave njerëzore? Dhe si do ta kapë njeriu të drejtën me informacionin që do të marrë prej këtyre librave? Ose ku do ta dijë se ajo që ka gjetur është e drejtë? Ja, pra, shumë çështje si kjo dhe të ngjashme me këtë e tregojnë mjaft hapur se ç'punë e vështirë është të konkludosh dhe të marrësh vendim të qëlluar mbi ngjarjet e vjetra historike!

Në duar s'kemi burime historike si librat e hadithit të Buhariut, Muslimit, etj., të mbështetur mbi dokumente të sakta, që të mund të japim konkluzione të prera. Edhe pamundësia për t'u gjetur udhë të vërtetave historike duke përfituar nga burimet ekzistuese që kemi në duar, është sheshit.

3. Informacioni historik më i drejtë është informacioni i dhënë nga njeriu më i drejtë. Mes njerëzve, njeriu më i drejtë në histori, i pranuar si i tillë edhe nga armiqtë, është Hz. Muhamedi (s.a.s). Atëherë, informacioni më i drejtë do të jetë informacioni i dhënë prej tij. Para kësaj teze dhe konkluzioni nuk mund të ketë asnjë njeri me mend në kokë që të kundërshtojë, dhe nuk ka. Vetëm se ai nuk pati lexuar asnjë libër historie ose vepër historike, sepse dihet që s'dinte shkrim e këndim, pra, gjërat që kishte mësuar, s'i kishte mësuar me këtë rrugë.

Ndërkaq, në kohën e tij, shumë dijetarë çifutë dhe krishterë i patën bërë shumë pyetje mbi çështje të ndryshme të Testamentit dhe Ungjillit dhe patën marrë gjithmonë përgjigje bindëse. Disa herë, duke i kritikuar dhe shpjeguar pikat kontradiktore, u pati dhënë atyre informacion të saktë. Gjithashtu, ai nuk ndalonte dhe mendohej duke dhënë përgjigje për pyetjet, as bënte përgatitje për bisedat e këtij karakteri që kishte për të zhvilluar. Në këto kushte, jetën e profetëve të kaluar dhe rrëfimet mbi bashkësitë e tyre i tregonte gjer në hollësitë më të vogla, si mënyrat e tyre të folurit e gjer te ndjenjat e brendshme dhe gjendjet psikologjike. Veçanërisht, ato që tregonte, i tregonte jo si ngjarje historike dhe ngjarje të mbetura e të mbyllura në histori, por, meqë natyra dhe karakteri njerëzor i shfaqur me njeriun e parë, Ademin, do të mbeteshin të pandryshuar gjer në kiamet, jetën e profetëve dhe të bashkësive të tyre si dhe ngjarjet e jetuara prej tyre i tregonte dhe i paraqiste si parime dhe ligje shoqërore, njerëzore dhe historike, se dhe të vërteta dhe skena shembullore që do të përjetoheshin gjer në kiamet duke u përsëritur vazhdimisht. Gjithashtu, tregimi i tij nuk ishte një

parashtrim i thjeshtë. Në të njëjtën kohë, ai bartte një pasuri të jashtëzakonshme kuptimi, një shprehje dhe oratori të pashoqe, një delikatesë stili të paparë dhe një bukuri shprehjeje.

Asnjëri prej informacioneve të dhëna prej tij mbi popujt e kaluar nuk është përgënjeshtuar nga kërkimet shkencore dhe gërmimet arkeologjike katërmëdhjetë shekuj me radhë, përkundrazi, janë vërtetuar çdo ditë me gjetje dhe zhvillime të reja.

Po, para këtij Personi të pashkolluar që ka treguar për shekuj para tij dhe për shekujt pas tij me një drejtësi dhe stil të përsosur, nuk mund të bëjmë pa u përkulur edhe një herë tjetër duke thënë “*enneke Resulullah*”, “*padysim ti je i dërguari i Allahut*”!

4. Po qe se një ose disa libra që popujt e botës për qindra vjet i kanë pranuar dhe vënë në krye të vendit, kërkon t'i kritikoni me pretekstin se “kanë shtesa dhe mungesa dhe se vuajnë nga gabime të ndryshme”, objekti i kritikuar jo, kritikuesi merr plafë dhe bie në vlerë nëse një punë e tillë e rëndësishme dhe e vështirë nuk mbështetet në argumente kategorike. Prandaj, një kritikë e tillë s'bëhet spontanisht. Ndërsa e vërteta qëndron kështu, fakti që Profeti që s'dinte shkrim e këndim, ka kritikuar libra të tillë me burim hyjnor si Testamentin dhe Ungjillin, duke ua miratuar të vërtetat dhe rregulluar gabimet dhe korrigjimet, me ç'mund të shpjegohet veçse me qenien e tij profet?

5. Gjer në mesin e këtij shekulli, historianët e mohonin ekzistencën historike të fiseve Ad, Themud dhe Irem për të cilët flitet në Kuranin e sjellë e të kumtuar nga Profeti, madje duke sfiduar gjithë botën. Por kur u gjet *Historia e Ptolemeut*, historianëve mohues u mbeti goja hapur, por ç'e do se, për shkak të krenarisë dhe mendjemadhësisë, zemra s'iu hap dot kurrë ndaj të vërtetës së përjetshme!

F. NJOFTIMET E HZ. MUHAMEDIT MBI TË ARDHMEN JANË ARGUMENTE TË PROFETËSISË DHE TË DËRGESËS SË TIJ PROFETIKE

1. Nuk është një çështje aq e thjeshtë që një njeri t'i shqyrtojë dhe tregojë ngjarjet aktuale me të gjitha hollësitë gjer në pikat më të imta, aq më pak të flasë për të ardhmen! Kështu, cili politikan, sociolog apo gjeni i madh mund të bëjë pohime kategorike për 50-100 vjet më vonë? Gjithçka që mund të bëhet në këtë drejtim, janë disa parashikime duke u mbështetur mbi parimin shkak-pasojë dhe mbi një sërë ligjesh e përvojash historike.

2. Sipas shprehjes së Kuranit, të fshehtën s'mund ta dijë askush veç Allahut dhe, duke ua treguar Allahu, profetët dhe disa njerëz të favorizuar nga Allahu. Sigurisht, i takon vetëm Allahut të thotë fjalë të prerë mbi ngjarjet që kanë për të ndodhur në të ardhmen. Megjithëkëtë, po qe se del një njeri dhe bën një parashikim kategorik mbi të ardhmen, do të thotë se ai mund të jetë një profet që meriton ta njoftojë Allahu.

Në Kuran dhe në hadithet profetike ka shumë shembuj mbi këtë çështje, por ne do të mjaftohemi vetëm me disa prej tyre duke ia lënë lexuesit shqyrtimin e të tjerave.

A. Në ajetet 1-5 të sures Rum njoftohet se bizantinët u mundën, por brenda nëntë vjetësh do të dalin fitues dhe kjo fitore e tyre do t'i gëzojë besimtarët. Këtu na duhet të sqarojmë veçanërisht disa pika.

a) Lajmi mbi një fitore të ardhshme jepet në një kohë kur kushtet s'janë aspak të përshtatshme, e thënë ndryshe, menjëherë pas një disfate të rëndë.

b) Rrjedhojat që do të shkaktonte vërtetimi i kundërt i këtij lajmi, do të lindnin të kundërtën e synimit të tij.

c) Kur dihet se, normalisht, në ç'gjendje të vështirë e vënë personin fjalët dhe premtimet e paralizuar, *delikatesa dhe rëndësia e lajmërimit kaq të hershëm të një ngjarjeje* në një kohë kur vetë çështja profetike kishte nevojë për t'u vërtetuar dhe bëheshin përpjekje për këtë gjë, s'kanë nevojë për sqarim.

ç) Lajmi për gëzimin e myslimanëve, në të vërtetë, aludonte për fitoren e Bedrit. Lufta e Bedrit ndodhi dy vjet pas hixhretit, kurse shtatë vjet para hixhretit, kur u dha lajmi, gjendja e myslimanëve s'ishte aspak e tillë që të paralajmëronte një fitore në një të ardhme të afërt! Të lajmërosh pranverën kur fillojnë të çelin lulet, është e lehtë, por duhet të mendohesh mirë para se t'u japësh njerëzve lajmin e gëzuar se po vjen pranvera në mes të dimrit, nën borë e akull!

B. Edhe fakti që surja Fet'h zbriti dhe lajmëroi triumfin e Mekës në një kohë kur dukej sikur pothuaj të gjitha kushtet ishin në disfavor të myslimanëve dhe menjëherë pas paktit të Hudejbijes që i kishte hapur rrugë pothuajse rebelimit të sahabëve, tregon se Profeti ndodhej nën mbështetjen e Allahut. Në kushte krejt të pafavorshme, kjo sure thoshte me një siguri kategorike se myslimanët do të hynin në siguri të plotë në Qabe dhe se Islami do të triumfonte mbi të gjitha fetë!

C. Personi të cilit i garantohej jeta me dekretin "*Uallahu ja'simuke minen nas*", "*Allahu do të të mbrojë nga njerëzit*" (Maide, 67) në një kohë kur mbi krye i vërtitëshin shpata, kur mbi të dërgoheshin ushtri dhe kur vdekja mund ta prekte në çdo çast, personi i cili, në një kohë kur ndiqej këmba-këmbës nga armiqtë për ta vrarë dhe kur vdekja i qe afruar në thembër të këmbëve, mundej t'i thoshte të vetmit shok që kishte me vete, "*mos u mërzit, Allahu është me ne*", dhe personi i cili, ndërsa armiqtë që u ishin errur sytë, bënëin garë me njëri-tjetrin se kush ta vriste më parë, mundej ta qetësonte të bijën me fjalët "*mos u shqetëso, bija ime, se Allahu nuk do ta lërë të humbë tët atë*", ky person, pra, kush mund të ishte veçse profeti vetë?

Ç. Personi që ka thënë se kufoma e faraonit i cili kishte jetuar 2500 vjet para tij, do të nxirret nga deti dhe do të ruhet për t'iu treguar brezave të mëvonshëm (Junus, 92), mund të jetë vetëm një profet. Ky paralajmërim që nuk ishte në Testament, u realizua në vitin 1881 me zbulimin e varrit të mbretërve dhe kufoma e pakalbur e faraonit, shekuj më pas u vendos në një muze të Anglisë.

D. Profeti ynë ka paralajmëruar me hollësira të ndryshme për shumë ngjarje të së ardhmes sikur të rrinte para ekranit të televizorit e t'i vështronte dhe këto paralajmërime janë vërtetuar siç i ka bërë ai, përveç edhe shumë paralajmërimeve të tjera që kanë për të dalë. Por ne përsëri do të mjaftohemi vetëm me pak shembuj.

a) Sipas rrëfimit të Buhariut, kur ndodhej ende në Mekë, Profeti i ka thënë kështu Habab bin Eretit: "*Allahu do ta plotësojë këtë fe, do t'u japë humbjen armiqve të saj dhe myslimanëve fitoren. Dhe atëherë, një grua e vetme do t'i hipë devesë në Sana për të bërë katër ditë udhe në shkretëtirë gjer në Jemen pa pasur frikë prej askujt veç Allahut!*" Ky paralajmërim i Profetit që vërtetuar qysh në kohën e kalifëve rashidinë!

b) Profeti pati thënë: "*Pas meje, të mos largoheni nga rruga ku shkojnë Ebu Bekri dhe Omeri.*" Me këto fjalë ai pati aluduar edhe se kishte për të vdekur para tyre, edhe se Ebu Bekri dhe Omeri do të ishin kalifët e parë.

c) Profeti pati paralajmëruar: *“Kalifati vazhdon edhe tridhjetë vjet pas meje, pastaj fillon sulltanati!”* Edhe ky paralajmërim qe vërtetuar po kështu.

ç) Sipas rrëfimit të Tirmidhiut, Profeti ka thënë: *“Osmani do të vritet duke kënduar Kuran!”* Edhe ky paralajmërim është vërtetuar siç është bërë.

d) Profeti pati thënë se *“pushtimi i kalasë së Hajberit do të bëhet me dorën e Aliut”* dhe ashtu pati ndodhur.

dh) Kur Sad bin Ebi Vakas ndodhej i sëmurë rëndë, Profeti i pati shkuar për vizitë e i pati thënë kështu: *“Do të rrosh edhe shumë gjatë dhe ndërsa shumë vetë do të kenë dobi prej teje, shumë të tjerë do të pësojnë dëm!”* Sadi u shërua, jetoi edhe shumë vjet të tjerë dhe e shembi shtetin iranian duke vërtetuar thënien e Profetit!

e) Profeti pati paralajmëruar se Ebu Dheri do të jetojë i vetëm dhe do të vdesë i vetëm, se Amari do të vritet nga njerëz të ulët dhe gjëja e fundit që do të pijë, do të jetë qumësht, se Thuraka do të vërë byzylykët e Kistrës, se i pari pjesëtar i familjes së tij që do të vdesë pas tij, do të jetë e bija Fatime, se Umu Harami do të marrë pjesë në fushatën e Qipros dhe të gjitha këto paralajmërimet qenë vërtetuar.

f) Profeti pati paralajmëruar pushtimin mongol të Çengiz Hanit, duke thënë: *“Kiameti nuk shpërthen para se ju të luftoni me banorët e vendbanimeve joarabe Hudh dhe Kirman. Njerëzit e atij populli e kanë fytyrën të kuqe, hundën të shtypur e të rënë dhe sytë të vegjël, kurse në këmbë mbathin opinga leshi.”* Hollësisht në lidhje me fytyrat në këtë paralajmërim mund t'i japë vetëm një profet!

g) Para se të fillonte beteja e Bedrit, Profeti pati treguar me gisht vendet ku do të vriteshin politeistët mekas dhe shenjat e tij qenë vërtetuar.

gj) Profeti pati paralajmëruar se nga fisi Thekif do të dilte një gënjeshtar dhe një gjakderdhës. Më pas, Muhtaru Thekafi dhe Haxhaxhi Dhalim e patën vërtetuar paralajmërimin e tij.

h) Profeti pati paralajmëruar në mënyrë të veçantë për triumfin mbi vende të tilla si Stambolli, Egjipti, Irani, India, Jeruzalemi dhe Qiproja.

Pas të gjitha këtyre, a mund të lindë dyshim mbi faktin se personi, në paralajmërimet e të cilit nuk ndodhi kurrë ndonjë lajthitje ose kundërshti, është një profet i ngarkuar me këtë detyrë nga Zoti? Dhe a nuk përbën fakti se paralajmërimet e tij mbi të ardhmen qenë vërtetuar plotësisht, argument se edhe paralajmërimi i tij për të ardhmen e amshuar do të vërtetohet pa asnjë dyshim?

3. Meqë njeriu, për shkak të natyrës së tij, është kërkues dhe i dhënë pas shpërblimit paraprak dhe në dorë, pra, sot për sot e jo nesër për sot, premtimet për të ardhmen, sado të mëdha a të kënaqshme të jenë, mbeten të pamjaftueshme për ta vënë në lëvizje. Kështu, duke mos marrë parasysh kënaqësitë e xhenetit, parajsës, bëhet viktimë e kënaqësive që ka në dorë, kënaqësi të një lloji si lojërat e fëmijëve! Ja, pra, në kundërshtim me këtë cilësi të natyrës së njeriut, Profeti, duke mos bërë asnjë premtim paraprak veç premtimit të jetës tjetër pas ringjalljes, pati hyrë në zemrat e njerëzve, i pati vënë në lëvizje ata dhe pati bërë që ata ta rregullonin jetën e tyre sipas këtij premtimi. Ta drejtosh njeriun e dhënë pas shpërblimit konkret, paraprak dhe në dorë, me premtime dhe shpërblime të mëvonshme ose pas vdekjes, mund dhe duhet të jetë cilësi e posaçme vetëm për profetët!

Nuk kanë qenë vetëm sahabët që duke u besuar premtimeve të së ardhmes të Profetit, e kanë rregulluar jetën sipas tyre pa u gënjyer nga shpërblimet e çastit dhe duke e nënçmuar jetën e kësaj bote. Ka mbi katërmëdhjetë shekuj që ata që kanë ecur dhe vazhdojnë të ecin në gjurmët e Tij, të lidhur pas sistemit të sjellë prej Tij, duke e sakrifikuar jetën e vdekshme me jetën e pavdekshme siç patën bërë të parët, edhe e kanë pranuar dhe vërtetuar drejtësinë e Tij, edhe e kanë treguar praktikisht se thëniet e Tij mbi të ardhmen do të vërtetohen identikisht!

4. Njerëz me zgjuarsiri të lartë që kanë njohuri të thella historike, që dinë të përfitojnë nga ngjarjet e ndodhura dhe përvojat dhe janë të pajisur me aftësinë dhe mundësinë për ta vlerësuar mirë të kaluarën, mund të bëjnë parashikime mbi të ardhmen, por, ndërkaq, këto janë si parashikimet e motit ose njohja e gjendjes së fetusit në mitër në bazë të shenjave të caktuara të shfaqura jashtë, pra që nuk përbëjnë më gjë të fshehtë. Kurse e ardhmja e paralajmëruan nga Profeti ynë është një e ardhme pa asnjë tregues, pa shenja paraprake dhe veçori të tjera të shfaqura, të dala në shesh, të dukshme, për më tepër, një e ardhme që, në kushtet krejt të pafavorshme kur paralajmërohet, duket e pabesueshme se do të realizohet! Dhe të shprehesh në mënyrë të prerë dhe në siguri të plotë mbi një të ardhme të tillë, mund të shpjegohet vetëm me anë të mësimit dhe mbështetjes hyjnore!

5. Në paralajmërimet e tij mbi ngjarje të së ardhmes, Profeti kurrë nuk pati përdorur shprehje supozimi, dyshimi apo mundësie të kundërt, si *pandeh, mendoj, shpresoj, parashikoj, ndoshta, mbase, mundet, ka mundësi, ka shumë mundësi, mundet edhe që*, etj. Ai që shprehur kurdoherë në mënyrë krejt të sigurt e të prerë: *do të bëhet, do të shihni, do të bëni*, etj.

6. Njeriu e ka krejt të pamundur të flasë për të ardhmen në tema dhe çështje që nuk i ka jetuar vetë, që nuk i ka provuar, me të cilat nuk është përballur në veprimtarinë e tij profesionale dhe që nuk hyjnë në fushën e tij. Kurse Profeti ynë, para profetësisë as pati formuar ndonjë ushtri, as pati zhvilluar ndonjë luftë, as pati formuar ndonjë grup apo shoqatë, as pati ngritur ndonjë shtet dhe as pati arritur ndonjë fitore. Por pastaj ai u bë prijës në çdo fushë dhe bëri parashikime dhe njoftime të prera mbi të ardhmen dhe një gjë e tillë është një dukuri krejt e veçantë që mund të shpjegohet vetëm me profetësinë!

7. Për të ardhmen mund të bëhen vetëm parashikime të mundshme (jo të prera, kategorike), kurse e kaluara njihet jo me anë të mendjes (duke e vrarë mendjen, duke arsyetuar), por me anë të informacionit të përcjellë. Nuk mund të thuhet gjë për të kaluarën pa pasur libra të shkruar mbi të, dokumente historike, gjetje dhe prova objektive të nxjerra nga gërmimet arkeologjike, pa kërkime, hulumtime dhe studime. Kurse Profeti, para së gjithash, nuk dinte shkrim e këndim që të mund të lexonte diçka. E dyta, në kohën e tij, pra, në shekullin VII, as zhvillim shkencash dhe shkenca të zhvilluara, as dokumente s'kishte, kurse për gërmime arkeologjike as që bëhej fjalë. Atëherë, me se do ta arsyetojmë dhe shpjegojmë faktin që, në këto kushte personale e të përgjithshme, ai dha njoftime si për të kaluarën, ashtu dhe për të ardhmen, veçse me profetësinë dhe detyrën e tij profetike?

Përfundim. Një njeri që, pasi ka mësuar për njoftimet dhe parashikimet e sakta të një Personi pa shkrim e këndim mbi të shkuarën dhe të ardhmen, përsëri nuk e pranon Atë si profet dhe nuk ushqen afërsi dhe dashuri për të, është i detyruar të zgjedhë njërën prej këtyre dy alternativave:

a) Ky njeri me zgjuarsiri të mprehtë mbinjerëzore dhe me gjenialitet tejet të gjerë e efektiv, i sheh dhe i di si një pikë të vetme të shkuarën e të ardhmen, i përfshin, i zbulon dhe i njeh të gjitha kohët pa asnjë mundësi lajthitjeje e vetëmashtrimi, i sheh dhe i vëzhgon centimetër për centimetër të

gjitha hapësirat, nga lindja në perëndim, nga detet dhe oqeanet, në kontinentet dhe çdo ngjarje, çdo ndodhi të mbaruar e që ka për t'u bërë, i vëzhgon në të njëjtin çast me të gjitha hollësitë, i mban në kujtesë dhe ua përcjell të tjerëve pa i harruar dhe pa i ngatërruar. Por këto veti dhe cilësi janë jo njerëzore, por sublime, hyjnore dhe gjenden vetëm te Allahu!

b) Ky njeri është i dërguar nga Allahu, krijuesi dhe zotëruesi i të gjitha kohëve dhe hapësirave, Zoti i gjithësisë, pra, është një profet i cili, nën drejtimin e Allahut, i zotëron këto cilësi dhe veti si mrekulli, dhe ky njeri është i Dërguari i Allahut, Hz. Muhamedi, i dërguar si profet i mëshirës për të gjitha botët!

Ndërsa e vërteta qëndron kështu, ata që tentojnë ta mohojnë Atë duke e karakterizuar me shprehje të pahijshme për dinjitetin profetik, si *“njeri shumë i mençur, gjeni i mençur e i zgjuar që i dha disa gjëra njeriut të shkretëtirës”*, janë trutharë të mjerë që s'bëjnë tjetër veçse përpiqen t'i çorientojnë dhe paralizojnë mendjet e reja me një dialektikë të këtij lloji!

G. MREKULLITË E HZ. MUHAMEDIT JANË DËSHMITARE TË PROFETËSISË DHE TË DËRGESËS SË TIJ PROFETIKE

1. Ç'JANË MREKULLIA DHE AFTËSIA PARASHIKUESE

Mrekullitë janë, në dorë të profetit, situata të jashtëzakonshme të krijuara nga Allahu me qëllim për të provuar profetësinë e tij, për të thyer kryeneçësinë dhe kundërvënien e mohuesve dhe për të forcuar bindjen e besimtarëve.

Mrekulli do të thotë anulimi, me anë të vullnetit të Allahut, i funksionit normal të shkaqeve dhe ligjeve, funksion me të cilin është mësuar njeriu dhe që i duket i zakonshëm, duke e kthyer atë në funksion të jashtëzakonshëm, gjë, kjo e pamundur për vullnetin dhe fuqinë e njeriut. Mrekullitë nuk mund të shqyrtohen dhe shpjegohen me anë të shkencave të natyrës, me anë të vëzhgimeve, provave dhe eksperimenteve, me mikroskopët e laboratorëve dhe teleskopët e observatorëve.

Mrekullitë nuk futen në llojin e gjërave të zakonshme, domethënë në zakonet hyjnore të librit të gjithësisë që përbëjnë bazë për shkencat. Mrekulli s'mund të ketë në punët dhe veprimtarinë tonë të përditshme që lidhet me shkaqe dhe ligje të ndryshme, si ushqyerja dhe fjetja e përditshme, puna në kopsht e në arë, rritja e frutave dhe perimeve duke përfutur nga drita dhe energjia diellore, uji, ajri dhe toka, etj. Një pjatë gjellë mund ta hanë disa vetë e të ngopen, etjen e shuajmë me një gotë ujë, kur kemi të ftohtë, ngrohemi me anë të zjarrit, po të sëmuremi ose të thyejmë ndonjë gjymtyrë, shkojmë te mjeku dhe mjekohemi me ilaçet e tij dhe sipas këshillave të tij. Ne i përdorim kafshët për shërbim, por nuk mund të flasim me ta. Pemët na duken të ngulura në të njëjtin vend. Me të vdekurit s'mund të flasim dhe s'mund të hyjmë në lidhje të drejtpërdrejtë. Malet dhe gurët as na përshëndesin, as bëhen gjyle në duart tona. Ne s'mundemi ta ndryshojmë ose anulojmë ligjin e tërheqjes dhe të ngjitemi lart pa ndonjë mjet ngjitës që e kundërshton këtë ligj. Ja, pra, dukuri si këto që zhvillohen në jetën tonë të përditshme në kuadrin e shkaqe-pasojave dhe ligjeve, i quajmë gjëra të zakonshme, të rregullta, shkurt, *rregullsi*. Kurse *mrekullitë*, në kundërshtim me rregullsitë, janë dukuri mbi të zakonshmen që zhvillohen mbi mundësitë e njeriut, mbi ligjet dhe mundësitë natyrore dhe përtej fuqisë, forcës dhe vullnetit të njeriut.

Veç mrekullive, janë edhe disa ngjarje të krijuara nga Allahu në dorë të njerëzve të shquar me nivel të lartë shpirtëror dhe aftësi të lartë parandjerëse dhe parashikuese, të cilat janë, përgjithësisht,

parashikime (*keramet*) me karakter simbolik të cilat, në fakt, vërtetojnë mrekullitë. Veç kësaj, këtu bëhet fjalë edhe për veprime me karakter shenjtëror, që i kapërcejnë mundësitë e njeriut të zakonshëm dhe rregullsitë ligjore e të karakterit shkak-pasojë. Kështu, kapërcimi i largësive të mëdha brenda një çasti, zgjerimi i kohës (kryerja e shumë punëve brenda një kohe shumë të shkurtër, të pazakonshme), leximi i mendimeve dhe ndjenjave, zbulimi i gjendjes së të vdekurve në varre, parashikimi i ngjarjeve të së ardhmes në ngjashmëri me profetët, etj., janë dukuri të jashtëzakonshme që shërbejnë si argumente të tjera të profetësisë, fesë islame të sjellë nga profeti Muhamed dhe drejtësisë së tyre.

Siç u tha diku në vëllimin e parë të këtij libri, fakte të tilla si parashikimet e Muhjedin Arabiut në librin e tij, “Pema Gjenealogjike”, të shkruar një shekull para themelimit të shtetit osman, mbi daljet e osmanëve në skenën e historisë, mbi pushtimin e Sirisë dhe Egjiptit, mbi zbulimin e varrit të vet me hyrjen e Javuz Selimit në Damask, mbi daljen e Muratit IV në fushatën e Bagdatit dhe pushtimin e tij brenda 41 ditëve, mbi vrasjen e Sulltan Abdulazizit duke ia prerë damarët me gërshërë, parashikimi i Mushtak Dedesë 71 vjet para se Ankaraja do të bëhet kryeqytet i Turqisë pas luftërave, etj., janë shembuj aftësie parashikuese dhe shenjtërie.

Edhe ëndrrat e vërteta lidhur me të ardhmen që mundet t'i shohë çdo besimtar dhe parandjenjat janë dhurata të Zotit për njerëzit.

Ndërkaq, mrekullia e parë dhe më e madhe e Profetit është Kurani.

Ashtu siç të vërtetat që u përpoqëm t'i tregojmë gjer këtu, janë argumente të hapura të profetësisë dhe drejtësisë së profetit Muhamed, edhe Kurani, si mrekullia më e madhe, është argumenti më i qartë dhe dëshmitari më i madh edhe i profetësisë së tij, edhe i faktit që është fjalë e Allahut. Kjo çështje do të trajtohet thellë më tej.

Meqë profetësia e Muhamedit (s.a.s.) përfshin të gjitha kohët dhe hapësirat si dhe, përveç të gjithë njerëzve, edhe krijesa të tilla si xhindet, mrekullitë e tij kanë qenë të shumta. Ndërkaq, në çështjen e mrekullive, profetësia e tij ndryshon nga profetësia e profetëve të tjerë. Çdo profet ka treguar mrekulli mbi çështjet më të njohura, të kthyer në zakon, të kohës së vet. Për shembull, meqë në kohën e tij, në Egjipt, kishte marrë zhvillim veçanërisht magjia duke u kthyer në një farë mjeshtërie, edhe profeti Musa, për t'i bindur njerëzit për profetësinë e tij, pati përdorur magjinë duke treguar para publikut një mrekulli: me shkopin e tij të famshëm, ai pati gëlltitur të gjithë gjarpërinjtë e magjistareve të njohur, të mbledhur për të bërë garë me të, duke i mundur ata. Në kohën e profetit Isa (Jezus) ishte e zhvilluar shumë mjekësia ose, më saktë, mjeshtëria e shërimit të sëmundjeve të ndryshme dhe ai pati treguar shumë raste mrekullie në këtë fushë duke shëruar sëmundje të rënda, të sëmurë të pashërueshëm, si dhe duke ngjallur të vdekur. Kurse në kohën e profetit Muhamed, poezia, letërsia, shprehja stilistike ose stilizimi, ligjërata dhe oratoria qenë ngritur në nivele të larta duke u bërë treguesit kryesorë të nivelit kulturor të njerëzve. Duke menduar edhe se, ndoshta, arti i shprehjes së bukur dhe ligjërimit do të jenë armët më me ndikim mbi opinionin publik, themi se profeti Muhamed u dërgua me një mrekulli ligjërata siç është Kurani si dhe, meqë u dërgua si mëshirë për të gjitha qeniet, ka treguar mrekulli të ndryshme të këtij karakteri.

Ashtu siç ndodh që, kur një mbret i madh e dërgon adjutantit ose përfaqësuesin e vet në një zonë të mbretërisë ku jetojnë fise dhe popuj të ndryshëm, përfaqësuesit e atjeshëm të fiseve, popujve, klasave dhe shtresave shoqërore, në emër të atyre që përfaqësojnë, e presin të dërguarin

me duartrokitje, me “mirë se erdhe” dhe duke ia parashtruar përgëzimet dhe falënderimet e tyre, ashtu dhe kur Allahu, Zoti i gjithësisë, e dërgoi Hz. Muhamedin, më të madhin përfaqësues të Tij në botë, jo vetëm si të ngarkuar me detyrë, por edhe si mëshirë për të gjitha qeniet, malet dhe gurët, pemët dhe kafshët, dielli, hëna dhe yjet si dhe të gjitha dukuritë dhe ngjarjet, duke shpëtuar nga dukja si gjë boshe e pa kuptim, morën kuptim dhe fituan vlerë. Dhe me këtë rast, engjëjt, njerëzit dhe xhindet, dielli, hëna dhe yjet, uji dhe gjërat ushqimore, pemët, malet dhe gurët si dhe të gjitha llojet e kafshëve ia paraqitën atij falënderimet e llojit të vet dhe u bënë në dorën e tij mjete nga mund të nxirreshin mrekullira. Kështu, ata dëshmuuan në mënyrë të pakundërshtueshme për drejtësinë dhe profetësinë e Zotërisë së Gjithësisë dhe e shpallën profetësinë e tij në tërë gjithësinë. Ja, pra, tregimi i mrekullive të tilla në dimensione universale është e posaçme vetëm për Kryeprofetin!

Ndërkaq, megjithëse profeti Muhamed ka treguar afro një mijë mrekulli, çdo fjalë, çdo veprim, çdo gjendje e tij s’janë të jashtëzakonshme dhe mrekullore. Allahu e krijoi atë njeri, e ngarkoi me detyrën e prijësit dhe udhërrëfyesit personal, familjar dhe shoqëror për t’u bërë model me shembullin e vet personal për njerëzit e kohës së vet dhe të kohërave të ardhshme për lumturinë materiale dhe shpirtërore të tyre. Meqë të gjithë njerëzit s’ishin e s’janë të një niveli dhe meqë shumicën e njerëzve e përbën populli i thjeshtë, po qe se çdo gjendje, sjellje dhe veprim i tij do të ishte i jashtëzakonshëm dhe mrekullor, ai nuk do të mund të bëhej shembull dhe prijës. Prandaj, profeti Muhamed jetoi gjithmonë në kushtet e njeriut të zakonshëm dhe në kushtet natyrale të zakonshme, hëngri e piu, u martua, u bë me fëmijë dhe krijoi familje, u plagos e vuajti, e reflektoi jetën njerëzore me të gjitha anët e saj dhe u bë një pasqyrë përmbledhëse e të gjithë arteve, veprimeve dhe shfaqjeve të emrave të Allahut!

Të gjitha mrekullitë e Profetit, siç do t’i shohim më poshtë, nuk kanë ndodhur në çdo vend, në çdo kohë dhe të dukshme për çdo njeri, si dhe nuk janë përgjithësuar. Po të ndodhte e kundërta, atëherë urtësia e mendjes do ta humbte qenien dhe kuptimin dhe njerëzit që u ishte hequr vullneti, do të shtrëngoheshin të besonin. Dhe, si rezultat i kësaj, nuk do të kishte më propozim, nuk do të kishte sekret prove. Për rrjedhojë, mes shpirtmargaritarit Ebu Bekër dhe shpirtziut Ebu Xhehl nuk do të kishte ndryshime, njerëzit do të kishin të njëjtin nivel besimi. Për këtë shkak, për shembull, mrekullia e ndarjes së hënës përgjysmë, një dukuri, kjo, e madhe, ndodhi natën, para një numri të kufizuar dëshmitarësh dhe zgjati vetëm pak çaste, kështu që s’iu cenua e drejta e vullnetit as të pranishmëve, as të tjerëve, as dhe njerëzve të kohëve të ardhshme dhe porta e mendjes, e mendimit të pavarur mbeti e hapur!

Shumicën e mrekullive e përcjell një grup njerëzish që e kanë pasë të pamundur të merren vesh për të gënjer. Kurse një pjesë e mrekullive, megjithëse nuk përcillet nga një bashkësi në këtë nivel, fakti që sahabet e tjerë nuk i kanë kundërshtuar, u përfton atyre pothuaj të njëjtën vlerë rrëfimi. Meqë e ngjashmja ose e njëjta e një mrekullie çfarëdo të treguar në një vend të caktuar, është treguar edhe në vende të tjera, nuk ekziston mundësia e mohimit të asnjë mrekullie.

Mrekullitë, shembujt e të cilave do t’i lexoni në vijim, i përkasin profetit Muhamed, për drejtësinë, ndershmërinë dhe profetësinë e të cilit ka me mijëra dëshmi dhe dëshmitarë. Në fakt, edhe sikur ai të mos kishte asnjë mrekulli, vetë personalisht do të mjaftonte si argumenti dhe dëshmia më e madhe e drejtësisë, ndershmërisë dhe profetësisë së vet!

2. SHEMBUJ TË MREKULLIVE TË PROFETIT MUHAMED

Mrekullia e miraxhit

Në ajetin 1 të sures Isra thuhet: *“Allahu që e çoi një natë robin e vet (Muhamedin), për t’i treguar disa prej provave tona, nga Mesxhidi Haram në Mesxhidi Aksa, mjedisin e të cilës e kemi begatuar, është i pastër prej attributeve të mangëta. Pa dyshim, Ai dëgjon dhe shikon gjithçka!”*

Kurse në ajetet 8-11 të sures Nexhm, duke aluduar për ngjarjen e miraxhit, thuhet: *“Pastaj u afrua dhe u var sa largësia prej dy harqesh ndoshta më afër. Dhe (Allahu) ia zbuloi robit të vet ç’kishte për t’i zbuluar. Dhe zemra (e Muhamedit) nuk i përgënjeshtroi ato që ia panë sytë...”* Ndërkaq, në librat e hadithit flitet me hollësi mbi këtë udhëtim të shenjtë.

Allahu, i cili, me hyjnitetin e tij, ua ndryshon përmbajtjen dhe cilësinë trupave materialë, masivë e të patejdukshëm duke i bërë, si shpirti, të tejdukshëm e të aftë për të kapërcyer pengesat dhe kufizimet e ligjeve të natyrës, e ka favorizuar të dërguarin e vet, Muhamedin, me audiencën e tij hyjnore duke i dhuruar mundësinë për ta parë. Në udhëtimin e miraxhit *si një fryt dhe përfundim i të qenit rob i Zotit dhe i adhurimit ndaj Tij*, Profeti, duke i kapërcyer ligjet dhe shkaqet e natyrës, duke i kaluar pengesat njerëzore, ka kapërcyer me një lëvizje largësi të pallogaritshme duke i përdorur yjet dhe sistemet yjore si shkallë, ka lënë pas dimensionet-pengesë për ta parë Zotin dhe, nga pozicioni ku ka arritur trupërisht dhe shpirtërisht, e ka parë Zotin. Është përshëndetur me profetët, i ka parë engjëjt, i ka soditur xhenetin dhe bukuritë e tij, xhehenemin dhe pamjen tronditëse të tij.

Pasi u ngjit në audiencën hyjnore me qëllim për t’ia treguar bashkësisë së tij çështjet që i duheshin treguar duke i parë vetë me sy dhe në mënyrë ngopëse, për të na i përcjellë neve gjërat që i besojmë si të fshehta, si vëzhgime të tij, për më tepër, për ta parë Allahun dhe për të na thënë neve “është” duke u mbështetur te vëzhgimi i vet, për t’i parë dhe njoftuar botën engjëjllore, engjëjt, xhenetin dhe xhehenemin; pasi e soditi xhenetin, me një orë soditje të të cilit nuk mund të barazohen një mijë vjet jetë të tokës dhe pasi u nderua me vëzhgimin e Bukurisë hyjnore, me një çast vëzhgimi të së cilës nuk mund të barazohet jeta parajsore, Profeti u kthye në tokë në një kohë kur mbi të provoheshin të gjitha llojet e torturave ndërsa ai përpigëj t’i kuptonte dhe t’ua tregonte edhe të tjerëve të gjitha të vërtetat e çështjeve që kishin lidhje me Kuranin dhe cilësitë e tij metaforike, kuptimet dhe urtësitë e adhurimeve, ta plotësonte detyrën e tij profetike për ta shpëtuar umetin, bashkësinë e tij nga errësira e për ta nxjerrë në dritë. Duke u kthyer në tokë, Profeti ka sjellë edhe namazin si dhuratë për myslimanët. Kaq mundëm të thoshim gjer këtu për këtë mrekulli ose një tërësi mrekullish. Hollësitë janë në veprat e ndritshme të hadithit.

Mrekullia e ndarjes së hënës në dy pjesë

* Abdullah b. Mesud tregon: Një herë, ndërsa ndodhesha me të Dërguarin e Allahut në Mina, papritmas hëna u nda në dy pjesë: njëra pjesë në këtë anë të malit, tjetra, në anën tjetër. Para kësaj ngjarjeje, i Dërguari i Allahut na tha:

“Jini dëshmitarë!”¹

¹ Buhari, Menakib, 27; Muslim, Kitabi Sifatil Munafikin ve Ahkamihin, 44; Musned, I, 377.

Begatimi i të ngrënave

* Enes b. Malik tregon: Ebu Talha i tha Umu Sulemes: “Unë e dëgjova të Dërguarin e Allahut të fliste me zë të dobët dhe e kuptova se është i uritur. A ke ndonjë gjë për të ngrënë me vete?” Umu Seleme iu përgjigj “po” dhe nxori një copë bukë elbi. Këputi një copë nga buka, e mbështolli dhe ma futi nën rrobë. Pastaj më dërgoi te i Dërguari i Allahut. Unë e gjeta të Dërguarin e Allahut tek po rrinte në faltore me shokët. Unë zura vend. I Dërguari i Allahut më pyeti:

“Ebu Talhai të dërgoi ty?”

“Po!”, i thashë.

“A për të ngrënë?”

“Po!”, iu përgjigja. Atëherë, i Dërguari i Allahut u tha të pranishmëve “ngrihuni” dhe vetë eci para. Edhe unë dola para dhe arrita i pari te Ebu Talhaja për ta lajmëruar. Ebu Talha i tha Umu Selemes:

“O Umu Seleme, i Dërguari i Allahut po vjen me shokët, kurse ne s’kemi aq gjë sa për t’i ushqyer dhe ngopur ata!”

“E dinë Allahu dhe i Dërguari i Tij!”, tha Umu Seleme

Ebu Talha doli dhe e pritë të Dërguarin e Allahut dhe, pastaj, së bashku u futën në shtëpi. I Dërguari i Allahut i tha Umu Selemes:

“Ç’të kesh, nxirre, o Umu Seleme!”

Ai e solli bukën dhe i shtroi sipër gjalpë nga tullumbi. I Dërguari i Allahut bëri një lutje për bukën. Pastaj i tha Ebu Talhait:

“Thuaju dymbëdhjetë vetëve të hyjnë!”

Ebu Talhai futi brenda dymbëdhjetë vetë. Ata hëngrën, u ngopën dhe dolën.

Pastaj i Dërguari i Allahut i tha sërish Ebu Talhait:

“Thuaju dymbëdhjetë vetëve të hyjnë!”

Ebu Talhai futi brenda dymbëdhjetë vetë të tjerë që hëngrën, u ngopën dhe dolën.

Kështu, me radhë, të gjithë shokët hëngrën dhe u ngopën. Ata ishin rreth shtatëdhjetë-tetëdhjetë vetë!²

* Në një rrëfim të Buhariut dhe Muslimit, Abdurrahman b. Ebu Bekr tregon:

Gjatë një ekspedite, ishim njëqind e tridhjetë vetë bashkë me të Dërguarin e Allahut. Ai na pyeti:

“A ka ndokush nga ju ndonjë gjë për të ngrënë?”

Dikush nga ne kishte miell. Menjëherë zumë brumë. Ndërkaq, një idhujtar shtatë gjatë me një tufë dhen u afrua tek ne. I Dërguari i Allahut e pyeti:

² Buhari, Ejman, 22; Muslim, Eshribe, 142.

“Për t’i shitur i ke, apo për t’i falur?”

“Jo, për t’i shitur!,” iu përgjigj burri.

Ne blemë një dele. Delen e therëm dhe i Dërguari i Allahut urdhëroi t’i skuqej mëlçia. Pastaj i Dërguari i Allahut i dha secilit nga ta njëqind e tridhjetë vetët një copë nga mëlçia e pjekur dhe la mënjanë edhe për ata që s’ndodheshin aty. Pastaj mishin e gatuar e ndau në dy çanakë. Të gjithë hëngrëm dhe u ngopëm, kurse enët vazhdonin të rrinin plot sikur s’ishin prekur fare!

Sipas rrëfimit të Xhabir b. Abdullahit te Buhariu, një gjë e ngjashme ka ndodhur edhe gjatë luftës së Hendekut. Njerëzit që hëngrën atë radhë ishin një mijë.³

Mrekullitë me ujin

* Ndërsa ndodhej në Zerva së bashku me shokët, i Dërguari i Allahut kërkoi një enë ku të kishte ujë. Ai futi dorën në enë dhe veç kur nga gishtat e tij filloi të rrjedhë ujë. Të gjithë shokët morën abdes.

Rrëfyesi i kësaj ndodhie e kishte pyetur Enes b. Malikun, të cilin e thërrisnin edhe me pseudonimin Ebu Hamza:

“Sa vetë ishin, o Ebu Hamza?”

“Rreth treqind vetë!,” i ishte përgjigjur ai.

Edhe në Hudejbije ndodhi që shokët t’i ankoheshin të Dërguarit të Allahut për mungesë uji. Ai nxori atëherë një shigjetë dhe ua dha shokëve duke u thënë që ta ngulnin në burimin Themed. Vallahi, uji i burimit filloi menjëherë të gurgullojë dhe ashtu vazhdoi gjersa të gjithë shokët pinë, u ngopën dhe u kthyen.⁴

Shërimi i të sëmurëve dhe i të plagosurve

* Siç na përcjellin Buhariu dhe Muslimi, në Hajber, i Dërguari i Allahut pyeti:

“Ku është Ali b. Ebu Talibi?”

“O i Dërguari i Allahut, ai është i sëmurë nga sytë!,” iu përgjigjën shokët:

“Dërgojini menjëherë fjalë të vijë!,” urdhëroi i Dërguari i Allahut.

Aliu erdhi. I Dërguari i Allahut ia fërkoi sytë me gishtërinjtë të lagur me pështymën e vet duke i bërë një lutje. Aliut iu shëruan sytë aty për aty! Madje i dukej se s’kishte pasur dhimbje fare!⁵

* Osman b. Hunejf tregon: Te i Dërguari i Allahut erdhi një burrë i verbër dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut, a po lutesh për mua të më hapen sytë?”

I Dërguari i Allahut i tha:

³ Buhari, Et’ime, 6; Hibe, 8; Muslim, Eshribe, 175.

⁴ Buhari, Shurut, 15.

⁵ Buhari, Fedailus Sahabe, 9; Muslim, Fedailus Sahabe, 34.

“Po deshe, le ta shtyjmë këtë lutje sepse kjo do të ishte më e dobishme për ty në jetën tjetër, por, po deshe, e bëjmë!”

I verbëri i tha: *“Lutu Allahut, o i Dërguari i Allahut!”*

Dhe i Dërguari i Allahut mori abdes mirë e mirë, fali dy rekate namaz dhe ia mësoi të verbrit lutjen që duhej të bënte gjersa t'i shëroheshin sytë. Ai veproi siç u porosit dhe u shërua.⁶

Njohja e Profetit nga kafshët

* Duke u nisur për në hixhret, Profeti që fshehur në një shpellë së bashku me Ebu Bekrin. Atëherë, një merimangë e kishte mbyllur hyrjen e shpellës duke thurur një pezhishkë që zinte tërë hyrjen. Dhe politeistët që i kërkonin të dy shokët gjithandej, patën ardhur edhe te hyrja e asaj shpelle, por, kur patën parë se hyrja e saj ishte e zënë e gjitha me një pezhishkë merimange, patën kujtuar se aty s'mund të kishte hyrë njeri dhe qenë kthyer.⁷

* Xhabir b. Abdullah tregon: Gjatë një ekspedite ishim bashkë me të Dërguarin e Allahut dhe ecnim krah për krah. Ndërkaq, deveja ime mbeti pas.

I Dërguari i Allahut u kthye dhe e nxiti devenë time për të ecur më shpejt. Deveja u hodh para dhe nisi të ecte aq shpejt, sa, për t'i dëgjuar fjalët e të Dërguarit të Allahut, tashmë më duhej t'ia shtrëngoja frerët që të ecte më ngadalë, por, prapëseprapë, s'e ndaloja dot!⁸

* Enes b. Malik tregon: Një grua çifute prej Hajberi i solli të Dërguarit të Allahut një qengj të gatuar por të helmuar dhe ai hëngri. Pastaj gruan e sollën para të Dërguarit të Allahut dhe ai e pyeti se pse e kishte bërë këtë.

“Desha të të helmoj që të vdesësh!”, i tha gruaja.

“Allahu s'të lëshon ty mbi mua që të më bësh keq!”, ia ktheu i Dërguari i Allahut.⁹

Kurse në rrëfimin e Ebu Davudit shënohet se vetë shpatulla e qengjit tregoi se ishte e helmuar.¹⁰

* Hz. Aishja tregon: Në dhomën e të Dërguarit të Allahut kishte një zog që, kur dilte ai jashtë, këndonte, luante, lëvizte andej-këtej, por, kur i Dërguari i Allahut hynte brenda, qetësohej dhe nuk bënte zë fare që të mos e shqetësonte.¹¹

* Enes b. Malik tregon: I Dërguari i Allahut ishte më i bukuri, më bujari dhe më i guximshmi i njerëzve. Një natë, popullsia e Medines u tremb me të vërtetë dhe disa njerëz shkuan në drejtimin

⁶ Tirmidhi, Davaat, 119; Musned, IV, 138; Ibn Maxhe, Ikame, 189.

⁷ Musned, I, 348.

⁸ Buhari, Nikah, 10, 22; Muslim, Musakat, 112-113.

⁹ Muslim, Selam, 45.

¹⁰ Ebu Davud, Dijat, 6.

¹¹ Musned, VI, 112; 150.

nga vinte zëri. Ndërkaq, i Dërguari i Allahut që kishte shkuar para tyre, po kthehej. Kishte hipur mbi një kalin e pashaluar të Ebu Talhait dhe po u thoshte njerëzve:

“Mos u frikësoni, mos u frikësoni!”

Kurse Ebu Talhait i tha se e kishte kapur kalin në revan. Ai kalë njihej si i pashtruar. Mirëpo atë ditë e pas u bë i urtë e i shtruar.¹²

Dëshmimi i maleve dhe gurëve për Profetin

* Hz. Xhabiri tregon: *I Dërguari i Allahut na tha: “Njoh në Mekë një gur që, para se të bëhesha profet, më përshëndeste. Unë edhe tani e njoh mirë atë!”*¹³

* Abdullah b. Mesud tregon: *“Kur hanim gjellë bashkë me të Dërguarin e Allahut, dëgjonim se si gjella e madhëronte atë!”*¹⁴

* Muslimi na përcjell prej Ebu Hurejres: I Dërguari i Allahut, Ebu Bekri, Omeri, Osmani, Aliu, Talhai dhe Zubejri ndodheshin në majë të malit Hira. Ndërkaq, mali nisi të dridhej (nga gëzimi ose dashuria). Atëherë, i Dërguari i Allahut iu drejtua malit me këto fjalë:

*“Qetësohu, Hira, se mbi ty është një profet, një besnik dhe një dëshmor!”*¹⁵

Mbrojtja e Profetit si një mrekulli

* Sipas rrëfimit të Xhabir b. Abdullahit që pati marrë pjesë në ekspeditën Dhatu Rika, në kthim, Profeti pati dhënë pushim diku rreth një oazi, pati zbritur nga kali dhe, si të tjerët që ishin shpërndarë nën hijet e pemëve, që shtrirë nën një pemë për të pushuar pasi e kishte varur shpatën në një degë të saj. Xhabiri thotë se kishin pak që i kishte zënë gjumi kur kishin dëgjuar zërin e Profetit që po i thërriste. Ata ishin ngritur dhe kishin shkuar pranë Profetit. Pranë tij kishin gjetur një arab beduin. Profeti u kishte treguar se ç’i kishte ngjarë me beduinin.

“Kur unë po flija, ky beduin arab kishte ardhur, kishte rrëmbyer shpatën time prej dege dhe, sapo e nxirrte nga milli, mua më doli gjumi. Në dorë mbante shpatën time të zhveshur! Ky më tha:

“A po ke frikë nga unë tani?”

“Jo, nuk kam!”, iu përgjigja.

“Po kush do të të mbrojë tani nga goditja ime?”, më pyeti.

“Allahu do të më mbrojë!” - i thashë unë. Atëherë, Xhebraili e goditi me një grusht në gjoks këtë, kështu që i ra shpata nga dora. Unë e rrëmbeva shpatën dhe i thashë:

“Po ty, kush do të të shpëtojë tani prej meje?”

¹² Buhari, Edeb, 39; Xhihad, 117; Muslim, Fezail, 48; Musned, III, 147.

¹³ Muslim, Fedail, 2; Darimi, Mukaddime, 4.

¹⁴ Buhari, Menakib, 25; Musned, I, 460; Mukaddime, 5.

¹⁵ Muslim, Fedailus Sahabe, 50.

“Askush s’më shpëton dot!”, më tha beduini.”¹⁶

* Ebu Hurejre tregon: Duke e pasur fjalën për sexhden, Ebu Xhehli na tha:

“Akoma Muhamedi i juaj e fërkon fytyrën për dheu?”

“Po!”, iu përgjigjëm ne.

“Betohem në Latin dhe Uzën se, po ta shoh duke vepruar kështu, do ta shkel mu në zverk! Ose do t’ia ngul fytyrën në tokë!”, tha ai.

Më pas, Ebu Xhehli i shkoi pranë të Dërguarit të Allahut tek po falte namaz. Sapo do ta ngrinte këmbën për ta shkelur, siç e kishte qëllimin për të cilin i kishte shkuar aty, befas e la dhe u zbraps me ngut duke mbrojtur fytyrën me pëllëmbë. Ata që ndodheshin aty pranë, e pyetën:

“Ç’të ndodhi?”

“Me të vërtetë, mes atij dhe meje u shfaq një hendek i zjarhtë, një gjë e frikshme dhe ca flatra...”, tha Ebu Xhehli.

Kurse i Dërguari i Allahut tha:

“Po të më afrohej, engjëjt do t’ia kishin këputur gjymtyrët një e nga një!”¹⁷

* Hz. Aishja tregon: Gjersa zbriti ajeti që thoshte, *“pa dyshim, Allahu do të të mbrojë ty nga njerëzit”*, i Dërguari i Allahut mbrohej nga sahabet, shokët e tij. Pas zbritjes së këtij ajeti, ai u tha shokëve: *“O njerëz, shpërndahuni, se tani mua më mbron Zoti im!”¹⁸*

Pranimi i lutjeve të Profetit

* Enes b. Malik tregon: Ditën e xhuma, ndërsa i Dërguari i Allahut po mbante hutben, erdhi një burrë dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut, s’po bie shi fare. Lutiu Allahut të na lëshojë shi!”

I Dërguari i Allahut e bëri lutjen menjëherë dhe ja ku filloi të bjerë shi që u bë aq i dendur, sa nuk do të arrinim dot nëpër shtëpi. Dhe gjer në xhumanë tjetër mbi ne vazhdoi të bjerë pa pushim mëshirë!

Xhumanë tjetër, ai apo dikush tjetër u ngrit e tha:

“O i Dërguari i Allahut, lutiu Allahut ta largojë këtë shi prej nesh!”

Dhe i Dërguari i Allahut u lut kështu:

“Allahu im lëshojë shiun rreth nesh, jo mbi ne!”

Dhe unë ju betohem se e kam parë se si u copëtuan retë e u shpërndanë andej-këtej dhe, ndërsa në të gjithë zonën sa të hante syri, binte shi, kurse mbi Medine, jo!¹⁹

¹⁶ Buhari, Megazi, 31, 33; Muslim, Fedail, 13; Texhridi Sarih (përkth.), X, 235.

¹⁷ Muslim, Sifatul Munafikin, 38.

¹⁸ Mustedrek, II, 313.

* Abdullah ibn Omer tregon: I Dërguari i Allahut lut kështu:

“Allahu im! Bekoje Islamin me më të dashurin për Ty nga këta dy vetë (nga Ebu Xhehli ose Omer b. Hatabi)!”

Të nesërmen në mëngjes, Omer b. Hatabi doli para të Dërguarit të Allahut dhe u bë mysliman!²⁰

* Abdullah b. Abasi tregon: I Dërguari i Allahut kishte hyrë për të kryer nevojën. Unë vura jashtë ujë që të merrte abdes. Kur doli jashtë dhe pa ujin, pyeti:

“Kush e vuri këtë ujë?”

“Unë e vura!”, iu përgjigja unë. Atëherë ai u lut:

“Allahu im, bëje atë dijetar në fe!”

Ne të gjithë e dimë se kjo lutje e të Dërguarit të Allahut u pranua. Ibni Abasi qysh i ri pati zënë vendin e tij në kuvendin e dijetarëve të Hz. Omerit dhe është bërë i njohur me titujt “Habrul Ume” (I dituri i umetit) dhe “Terxhumanul Kuran” (Interpretuesi i Kuranit).²¹

Kurse në Musned, lutja e Profetit është kështu:

*“Allahu im, bëje atë ta njohë frymën e fesë dhe mësoja interpretimin!”*²²

* Enes b. Malik tregon: Nëna më solli te i Dërguari i Allahut dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Ky është im bir, Enesi i vogël! Ta solla ty që të të shërbejë. Lutiu Allahut për të!”

Dhe i Dërguari i Allahut u lut kështu:

“Allahu im! Bëje këtë fëmijë me pasuri dhe fëmijë dhe shumoja pasurinë dhe fëmijët!”

Dhe unë po ju them se, vallahi, kam shumë pasuri, kurse rreth njëqind fëmijë e nipër!²³

* Enes b. Malik tregon: Një ditë, i Dërguari i Allahut erdhi për vizitë te Umu Haram. Tezja e gostiti me të ngrëna. Pasi hëngri, i Dërguari i Allahut u shtri pak për të fjetur. Ai u zgjua duke qeshur. Umu Haram e pyeti:

“O i Dërguari i Allahut, ç’të bëri të qeshësh?”

“Pashë në ëndërr ca njerëz të hipur dhe shtruar mbi ca gjemi që vozitnin në det të gjerë si sundimtarë të shtruar mbi fron dhe po shkonin për të luftuar në rrugë të Allahut. Kjo më kënaqi dhe më bëri të qeshja!” -* tha ai.

Atëherë, Umu Haram i tha:

¹⁹ Buhari, Istiska, 7; Muslim, Istiska, 1.

²⁰ Tirmidhi, Menakib, 18; Musned, II, 95.

²¹ Buhari, Ilm, 17; Vudu, 10, Itisam, 2; Muslim, Fezail, 137; Isabe, 3/186.

²² Musned, I/266.

²³ Muslim, Fedailus Sahabe, 143.

“O i Dërguari i Allahut, lutu për mua që edhe unë të jem mes atyre fitimtarëve të asaj ekspedite detare!”

Dhe i Dërguari i Allahut u lut për Ummu Haramin.

Me të vërtetë, në kohën kur Muavije b. Ebu Sufjan ishte guvernator i Sirisë, Ummu Haram hipi në një gjemi të ekspeditës së Qipros nën komandën e Muavijes. Pasi dolën në tokë dhe do të fillonin marshimin, Ummu Haram hipi në kalë por u rrëzua dhe vdiq si dëshmore e asaj fushate!²⁴

Dukja e engjëjve dhe xhindeve për Profetin dhe bisedimi me të

* Abdullah b. Omer tregon: Im atë, Omer b. Hattab, tha: Një ditë, kur po rrinim me të Dërguarin e Allahut, papritmas na u shfaq pranë një person me rrobën krejt të bardhë dhe flokët krejt të zinj. As dukej se ishte udhëtar, pra, s’kishte shenja se po vinte nga rruga, as e njihnim. Ai u ul gju më gju me të Dërguarin e Allahut. Kurse duart i vuri mbi gjunjët e tij.

Ai filloi t’i bënte pyetje të Dërguarit të Allahut. E pyeti për Islamin, besimin, mirësinë dhe kiametin. Pasi mori përgjigje, personi u largua. Unë ndenja një copë herë të gjatë i heshtur. më në fund, i Dërguari i Allahut më tha:

“O Omer, a e di se kush ishte ai personi që më bëri ato pyetjet?”

“Allahu dhe i Dërguari e dinë!”, iu përgjigja unë.

I Dërguari i Allahut më tregoi:

*“Ai ishte Xhebraili. kishte ardhur t’ju mësonte fenë!”*²⁵

* Sad b. Ebi Vakas tregon: Ditën e Uhudit pashë dy vetë, njëri në anë të djathtë të të Dërguarit të Allahut, tjetri, në të majtë. Mbi trup kishin rroba të bardha. Ata luftonin për të me rreptësinë më të madhe. Ata dy vetë s’i kisha parë as më parë kësaj ngjarjeje, as i pashë më pas. (Ata ishin engjëjt Xhebrail dhe Mikail).²⁶

* Siç na përcjell Muadh b. Rifa prej të atit, Rifa b. Rafi që pati marrë pjesë në luftën e Bedrit, i ati ka thënë kështu: Gjatë betejës së Bedrit, në një çast, Xhebraili erdhi te i Dërguari i Allahut dhe e pyeti:

“Si i njihni ndër ju ata që kanë marrë pjesë në këtë luftë?”

“Ne i njohim ata si më të virtytshmit e myslimanëve!”, iu përgjigj i Dërguari i Allahut. Ose tha diçka të ngjashme me këtë.

*“Edhe ne, ia ktheu Xhebraili, engjëjt që po marrin pjesë në luftën e Bedrit, i njohim si më të virtytshmit e engjëjve!”*²⁷

²⁴ Buhari, Xhihad, 3; Muslim, Imare, 160, 161.

²⁵ Buhari, Iman, 37; Muslim, Iman, 1.

²⁶ Buhari, Megazi, 18; Muslim, Fedail, 46-47.

²⁷ Buhari, Megazi, 11.

* Në veprën e vet “Musned”, Ahmed b. Hanbel përcjell prej ibn Mesudit se, në ngjarjen e Natës së Xhindëve, i Dërguari i Allahut u pati dhënë mësim Kurani xhindëve.²⁸

Shëmbëllimet dhe mrekullitë e Profetit lidhur me të fshehtën

* Hz. Aishja tregon: Një ditë që zënë dielli. Pasi fali namazin e eklipsit, i Dërguari i Allahut tha kështu:

“Pa dyshim, dielli dhe hëna janë dy nga provat e Allahut! Kur ta shihni se u zu dielli apo hëna, falni namaz gjersa zënia të kalojë. Betohem se, duke falur namazin e këtij eklipsi, unë pashë gjithçka që më është premtuar! Kur të jem në namaz dhe të shihni se po bëj para, ta dini se po e shoh veten të përpiqem për të këputur një vesh rrushi nga të xhenetit. Dhe po të shihni se jam duke u prapsur, ta dini se po shoh se si disa po i bëjnë copë-copë disa të tjerë!”²⁹

* Abdullah b. Abas tregon: I Dërguari i Allahut shkoi pranë dy varreve dhe tha:

“Kini kujdes! Këta me siguri po ndëshkohen. Madje, po ndëshkohen për një gjë të madhe. Njëri prej këtyre merrej me thashetheme, kurse tjetri nuk ruhej kur përmirrte!”³⁰

Dëshmimi i pemëve për Profetin

* Xhabir b. Abdullah tregon: Po ecnim së bashku me të Dërguarin e Allahut. Më në fund, zbritëm në një luginë të gjerë. Ai u largua për të kryer nevojën, kurse unë e ndoqa nga larg me një enë me ujë. Diku, i dërguari i Allahut u ndal, pa përreth por nuk i zuri syri ndonjë gjë për t’u fshehur. Pastaj, në skaj të luginës i zunë sytë dy pemë. I Dërguari i Allahut u nis menjëherë drejt tyre, u afrua te njëra pemë, zuri me dorë një degë të saj dhe u lut:

“Me lejen e Allahut, përkulu para meje!”

Dhe dega u përkul para tij si deveja që i nënshtrohet të zot dhe e zuri krejt pamjen në atë anë. Pastaj i Dërguari i Allahut shkoi te pema tjetër, zuri një degë dhe u lut:

“Me leje të Allahut, përkulu para meje!”

Dhe dega u përkul para tij duke ia zënë edhe atë anë. Pastaj, mes dy pemëve, i Dërguari i Allahut u lut:

“Me lejen e Allahut, më mbuloni nga sipër!”

Dhe degët e pemëve e mbuluan të Dërguarin e Allahut edhe nga sipër.³¹

* Abdullah b. Omer tregon: I Dërguari i Allahut e mbante hutben duke u mbështetur mbi një trung hurme. Kur iu ngrit minberi, filloi t’i mbante nga shkallën e tij. Kur i Dërguari i Allahut u

²⁸ Musned. I, 455.

²⁹ Buhari, Ebvabu’l Amel fi’s-Salat, II; Muslim, Kusuf, 3.

³⁰ Buhari, Edeb, 46; Muslim, Taharet, III.

³¹ Muslim, Zuhd, 74.

ngjit për herë të parë në minber, nga trangu doli një zë rënkues. I Dërguari i Allahut i shkoi menjëherë pranë dhe e fërkoi me dorë. Zëri rënkues u shua!”³²

* Ebu Said el Hudri tregon: Një ditë, pas namazit të jaciesë, i Dërguari i Allahut i dha Katade b. Numanit një shkop dhe i tha:

“Ky shkop do të të ndriçojë dhjetë arshin para dhe pas. Kur të hysh në shtëpi, në një qoshe të saj do të shohësh një gjë të zezë. Godite menjëherë, pa i dhënë rast të të thotë gjë!”

Dhe ai veproi siç i tha i Dërguari i Allahut.³³

MBI MREKULLITË

Mrekullitë nuk mund të mohohen

1. Para së gjithash, mohimi i mrekullisë, i Krijuesit të mrekullisë dhe i personave të krijuar në dorë të mrekullisë nuk i përftojnë njeriut asgjë në lidhje me mendimin. Prandaj, gjëja që i ka hije njeriut të mençur është jo të thotë menjëherë “s’ma merr mendja”, por të mendohet dhe të vlerësojë.

Të mendosh se “s’ta merr mendja” ose ta shndërrosh këtë paragjykim në mënyrë të menduari është krim kundër mendjes, diturisë dhe shkencës. Sa e sa zbulime, shpikje dhe gjetje teknike të cilat në fillim në përgjithësi ose mendja e disave nuk i ka marrë, janë arritur gjithmonë me grindje dhe luftë mendore, ashtu që kjo ethe të menduari s’i ka lënë kohë personit të rruhet, s’i ka dhënë rast të nxjerrë këpucët dhe këmishën, e ka bërë shpesh ta harrojë rrugën e shtëpisë dhe e ka katandisur të përsillet nëpër rrugë me një veshje qesharake!

Qeniet e privuara nga aftësia e të menduarit, megjithëkëtë, e kryejnë atë që u takon në mënyrën më të përsosur. Nëse njeriu nuk e përdor me vend këtë aftësi, të paktën të mendojë se pas kujt do të mbetet dhe në ç’masë!

Pretendimi “nuk ma merr mendja” nuk mund të jetë justifikim për njeriun. E kundërta, ne mendojmë dhe mendja na e merr fare mirë se Profeti mund t’i tregojë shumë lehtë mrekullitë. Mendojmë dhe nuk shohim ndonjë mundësi tjetër veç pranimin se nuk mund të ketë gënjeshtër në mrekullitë e atij personi, prej të cilit nuk ka dalë asnjë gënjeshtër; nuk shohim dhe, më shumë se sa me ata që i kanë quajtur mrekullitë e tij “magji” ngaqë s’kanë mundur t’i mohojnë dot, habitemi veçanërisht me qëndrimet mohuese dhe mendjet “që s’marrin” të atyre që përpiqen sot me interpretime të ndryshme t’i turbullojnë mendjet.

2. T’i mohosh mrekullitë, në një vështirim, do të thotë t’i mohosh ekzistencën e Allahut, Kuranin si fjalë të Allahut dhe profetësinë e Muhamedit, një mohim, ky, që i kapërcen shumë edhe mendjen, edhe mendimin! Sepse, ndërsa për këto të vërteta edhe një argument është i mjaftueshëm, ka me mijëra argumente, kurse në dorë të mohuesit në ka asnjë argument që ta nxjerrë të drejtë mohimin e tij dhe, në fakt, nuk mund të ketë. Gjëja që ai e quan argument, mund të jetë errësira e krijuar

³² Buhari, Menakib, 25; Tirmidhi, Menakib, 6; Nesai, Xhuma, 17; Ibni Maxhe, Ikame, 199; Musned, 1/149; Mukaddime, 6.

³³ Musned, III/65.

nga që ai i ka mbyllur sytë ndaj diellit ose dhoma e vogël e shpirtit dhe e zemrës së tij që ai e ka zhytur në errësirë duke e shuar qiriun!

Përballë dhjetëra mijëra profetëve, miliona të urtëve dhe miliarda besimtarëve, gjendja e mohuesit me “jo”-në e tij më të dobët e të paqëndrueshme se filli i pambukut dhe pezhishka e merimangës dhe me vlerën të barabartë me zero, nuk është e ndryshme nga gjendja e atij fatkeqi të mjerë që përpiqet të nxjerrë ujë nga pusi me një kovë pa fund, që, pasi ka hyrë në një pallat madhështor vepër arti e arkitekture, sheh një gur të lënë diku në mes me një qëllim të caktuar dhe thotë se *në atë pallat s’ka rregull dhe se çdo gjë është e rastit*, ose, pasi sheh të vetmen derë të mbyllur ndër mijëra dyer të hapura të tij, thotë se *në atë pallat s’mund të hyhet!*

3. Miraxhi është fryti i adhurimit të Profetit ndaj Zotit, i pozitës së tij si rob i Zotit dhe i zbatimit gjer në fund prej tij të domosdoshmërive të pozitës së robit ndaj Zotit. Kush e edukon frymën, egon e tij, menjëherë shpirtin t’i marrë zhvillim e t’i lartësohet. Bëni dy vjet një jetë të përkorët dhe duke e pastruar egon dhe do ta dalloni menjëherë se po ngjiteni drejt lartësirave. Këto dukuri të vëna re shumë te njerëzit e afërt të Zotit, mund të kuptohen dhe shpjegohen me anë të aftësisë vlerësuese të shpirtit dhe aftësisë ndjerrëse e konfidenciale të zemrës. Ai që nuk shijon, nuk sheh, nuk ndjen, nuk mund të kuptojë e dijë asgjë. Po qe se kjo do të ishte halucinacion, atëherë duhet të ngjante edhe te njeriu në mejhane, edhe te njeriu që viziton, nderon apo adhuron tempujt. Këto janë gjëra që shfaqen si favor i Allahut në përfundim të vetëpërkushtimit në adhurim. Prandaj, tentativa për ta matur këtë ngjitje lart, këtë lartësim, fizikisht, është njësoj sikur të përpiqesh t’i matësh çështjet që i përkasin botës së përtejme me njësitë e matjes ose kriteret e kësaj bote. E ku është parë të peshohen floriri e margaritari me kandin ku peshohen thasët me miell?

4. Edhe profetët e ardhur para profetit Muhamed kanë treguar mrekulli që pranohen nga çifutët dhe krishterët. Atëherë nuk ka asnjë pengesë që dukuri të ngjashme të përsëriten te një profet tjetër. Sipas botëkuptimit të njerëzve që e pranojnë se kanë bërë transformime në qytetërim dhe teknikë, lartësimi i profetit Isa në qiell dhe biseda e profetit Musa në malin Sina janë të mundura, gjë që e pranojnë edhe ne. Mirëpo, kur këto janë të mundura, pse të mos jetë i mundur realizimi i mrekullive edhe për një profet tjetër?

5. Krijimi i Ademit, Havasë dhe Isait janë një çështje që i kapërcen ligjet dhe shkaqet dhe dukuri që nuk mund të shpjegohen me kriterë shkencorë. Në dukuritë dhe ngjarjet që nuk i shpjegojmë dot me shkencën dhe shkaqet, a ka rrugë tjetër veçse t’i dorëzohemi shpjegimit të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij? Ademi dhe Havaja kanë ardhur në botë pa nënë e pa baba, kurse Isai, pa baba. Në krijimin e Ademit s’ka as spermë, as vezore. Ai është mbledhur nga elementët e ndryshëm të tokës dhe skeleti i është bërë nga një koncentrat proteinash gjithashtu të nxjerra nga esenca e dheut. Edhe Hz. Havaja, sipas një këndvështrimi, është krijuar nga një copë e marrë prej trupit të tij, gjë që s’është veçse mrekulli. Përpjekja për ta shpjeguar çdo gjë me shkencën dhe, kur s’e shpjegon shkenca, ta anashkalosh duke e quajtur “legjendë”, është, në fakt, legjendizim i vetë shkencës. Në këtë botë ka aq shumë dukuri e ngjarje që shkenca s’i shpjegon dot. Me ç’parime shkencore do ta shpjegoni faktin që një indian ecën mbi thupra metalike me majë, mbi gjemba e mbi zjarr dhe as shpohet e as digjet? Ose faktin që e shpon gjuhën tejprtej me një shtizë dhe nuk i del pikë gjaku?.. Fundja këto s’janë as mrekullira!

6. Sikur dukuritë e përditshme që ne i quajmë gjëra të zakonshme, që na kalojnë para syve pa na lënë ndonjë përshtypje, të ndalemi për t’i parë më me vëmendje, shohim se kemi para sa e sa dukuri e ngjarje të pashpjegueshme me shkencën. Kurse ne këtu tani po bëjmë fjalë për mrekullinë.

7. Mrekullitë i quajmë ngjarje të jashtëzakonshme sikur në punët tona të përditshme të mos kemi jashtëzakonshmëri! Ardhja në botë e një njeriu pa nënë e pa baba qenka jashtëzakonshmëri; po a nuk është jashtëzakonshmëri një dukuri krejt e zakonshme e jetës siç është shndërrimi i vezës së fekunduar nga spermatozoidi në një qenie prej 60 trilion qelizash me jetë dhe shpirt, që sheh, njeh, di, mendon dhe flet? Por neve na duket krejt e zakonshme ngaqë jemi mësuar me këtë. Meqë mekanizmin tonë të arsyetimit dhe vlerësimit e kemi rregulluar gjithë sipas marrëdhënieve shkaktuese dhe veprimit të ligjeve, përpiqemi që çdo gjë që shohim e dëgjojmë dhe çdo gjë që ndodh në mjedisin tonë, t'ia adaptojmë kësaj mekanizme. Kurse neve na takon që, para së gjithash t'i kalomë të gjitha përmes një operacioni ideor.

8. A nuk është një burimi dhe argumenti ku mbështeten të gjitha gjërat, qoftë gjërat e zakonshme, qoftë ato të jashtëzakonshmet, qoftë shkaqet, qoftë ligjet? Origjina e njëjtë, pamjet, të ndryshme; burimi i njëjtë, metodat, të ndryshme; baza e njëjtë, zbatimet, të ndryshme. Pastaj, mes krijimit të Ademit dhe krijimit tonë nuk ka dhe shumë ndryshim. Për krijimin e tij u mor esencë nga toka, u gatua në kushte të caktuara dhe, kur erdhi koha, iu fry shpirt. Edhe krijimi i njeriut fillon nga një esencë që i përmban të gjitha elementet e tokës, e cila, pastaj, zhvillohet në kushte të caktuara dhe, kur i vjen koha, i fryhet shpirt. Krijuesi, po ai, vetëm në zbatim ndryshojnë kushtet, pra, mbulesa e shkaqeve dhe ligjeve. Ja, ky është ndryshimi!

9. Fryrja e shpirtit është esenciale; ndryshimi është vetëm te cilësia fizike e trupit. Zhvillimin fizik sipas shkaqeve dhe ligjeve e shohim “normal”, kurse përtej shkaqeve e ligjeve, e quajmë “mrekullor”.

10. Në gjithësi, edhe fuqi të tilla si koha janë relative. Ashtu siç akrepat e sekondave, minutave dhe orëve tregojnë kohë të ndryshme dhe ashtu siç ndodh që koha është tjetër në tokë, tjetër në hënë e tjetër në planete të tjerë, edhe fuqitë dhe forcat janë relative. Dëshirojmë të kujtojmë, këtu, se, në kuadër të zhvillimeve të fundit, po bëhet fjalë për ekzistencën në gjithësi të fuqive të pestë e të gjashtë.

Ashtu siç ka ndryshime fuqie mes njerëzve, edhe në qeniet mbinjerëzore dhe nënjerëzore ka ndryshime force e fuqie. Për shembull, rrethi i fuqisë së engjëjve dhe xhindeve në fusha të caktuara është shumë më i gjerë se yni. Ndërsa ne nuk mund të ngremë 100 kg., është e vërtetë se xhindet lëvizin nga vendi tonelata dhe se ka engjëj të ngarkuar me detyrën e ekuilibrit të tokës të quajtur tërheqje. Sipas nesh, kjo është një dukuri e jashtëzakonshme dhe mrekullore. Kështu është edhe cilësia e engjëjve dhe xhindeve për t'u ndodhur në të njëjtin çast në vende të ndryshme. Nga ana tjetër, ka edhe qenie me fuqi shumë më të ulët se ne. Për shembull, punën që mund ta bëjnë 100 milingona bashkë për një vit, një njeri mund ta prishë dhe ribëjë në një minutë, gjë që, “në sytë e merimangave”, është një mrekulli. Ja, pra, ekziston Allahu, Zoti, me fuqi mbi të gjitha fuqitë, me një fuqi për të cilën s'ka gjë të pamundur, prandaj dhe para të cilës janë njëlloj molekula me planetin. Dhe, meqë për Allahun nuk ka jashtëzakonshmëri, Ai e krijon një gjë me duart e njeriut po deshi si mrekulli, po deshi, si një gjë të zakonshme.

11. Mrekullitë na vijnë me rrëfime kategorike dhe të vërtetuara në mënyrë përfundimtare.

Mendja ka një fushë të caktuar. Ashtu siç nuk mund të vihen 100 kg. peshë mbi një peshore që peshon gjer më 10 kg., ashtu dhe mendjes nuk mund t'i bëhet e njohur një fuqi mbi kapacitetin e saj. Në një çështje mbi kapacitetin dhe jashtë fushës së vet, mendja është e detyruar ose të mohojë, ose të përulet e paaftë dhe të pohojë. Për shembull, mendja kurrë nuk mund ta konceptojë individualitetin e Zotit, nuk mundet të mendojë mbi të, nuk mund të pretendojë se e ka njohur apo

e njeh, sepse individualiteti i Zotit është përtej gjithçkaje që mund t'i vijë njeriut në mendje. Ajo që i takon njeriut është ta besojë Zotin dhe, me anë të atributiveve dhe emrave të Tij, të mendojë mbi shfaqjet, aktet, administrimin dhe veprat e Tij dhe të përpiqet t'i afrohet Zotit me intuitën e vet. Mendja, e cila është arti dhe vepra e Krijuesit, nuk mundet ta konceptojë Artistin. Për këtë arsye, konceptimi i entitetit, domethënë i natyrës dhe cilësisë esenciale të mrekullive, pra, i ekzekutimeve tejshkakësore të Allahut, është po aq i vështirë sa konceptimi i shpirtit. Për rrjedhojë, rruga më e mençur është t'i pranosh mrekullitë e ardhura me anë të kanaleve të rrëfimeve të evidentuara e të vërtetuara përfundimisht.

12. Mendja ka dy lloj fushash përvoje. E para është fusha e dukurive dhe ngjarjeve të ndodhura për herë të parë, pra, që s'kanë të ngjashme dhe s'mund t'i nënshtrohen analogjisë apo krahasimit. Këto disa herë mbeten dukuri dhe ngjarje të veçuara që s'përsëriten më, kurse, disa herë, përsëriten dhe shumëfishohen. Krijimi i parë i njeriut është nga ato dukuri dhe ngjarje të veçuara që nuk janë përsëritur më, prandaj dhe nuk është krijuar mundësia për analogji.

E dyta është fusha e dukurive dhe ngjarjeve në përputhje me ligjet dhe që mund të krahasohen, pra, mbi to mund të bëhet analogji, sepse kanë plot shembuj të ngjashëm. Meqë shkaqet dhe ligjet që janë bërë diçka e zakonshme në këtë fushë, shërbejnë si një perde që fsheh pas saj veprimtarinë hyjnore, mendja merret më shumë me këto. Prandaj, të tentosh për ta mohuar krijimin e parë vetëm sepse është unikal, pra, nuk ka një shembull të dytë të tij, më e pakta do të thotë ta ngushtosh fushën e mendjes në funksionet e saj të mendimit, meditimit dhe konkludimit, ta kapërcësh kufirin tënd, për rrjedhojë, duke dashur të veprosht me logjikë, të shfaqësh mungesë arsyeje e logjike.

13. Dukurive dhe ngjarjeve që mbeten të veçuara dhe që zhvillohen jashtë të zakonshmes, ne u themi "përrjashtime hyjnore". Në fakt, dukuri dhe ngjarje të tilla hasim herë-herë edhe brenda kuadrit të shkaqeve dhe ligjeve brenda të cilit jetojmë dhe, duke mos i mohuar kurrsesi, presim nga dijetarët dhe shkencëtarët t'i studiojnë dhe shpjegojnë duke u mbështetur edhe në zbulimet dhe zhvillimet aktuale. Për shembull, dëgjojmë që diku bëhen përpjekje për ta mjekuar ulcerën e stomakut jo me mjetet dhe metodat mjekësore të njohura gjer më sot, por me hipnozë. Ndërkaq, nëse mjekimi me lutje dhe sugjerim është një dukuri e veçuar dhe përrjashtimore, a duhet ta mohojmë se s'na e merr mendja ose s'e pranon shkenca? Prandaj, si mendja, ashtu dhe shkenca nuk mund t'u kthejnë shpinën mrekullive të cilat dalin jashtë kuadrit të shkaqeve dhe ligjeve.

14. Si domosdoshmëri e dinjitetit dhe madhështisë së Tij, Allahu vepron brenda kuadrit të shkaqeve dhe ligjeve. Në të njëjtën kohë, Ai është i Urtë, pra, nuk bën punë të kotë, në çdo punë të tij ka patjetër "urtësi". Megjithëkëtë, nuk është i detyruar as të veprojë brenda shkaqeve dhe ligjeve, as të ndjekë patjetër "urtësi" në çdo punë. Sigurisht, nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë detyrim mbi Allahun. Prandaj Allahu herë pas here bën veprime përrjashtimore dhe na ballafaqon ne me dukuri dhe ngjarje që i kapërcejnë shkaqet dhe ligjet me qëllim për të treguar se s'është i detyruar për asgjë, për të parandaluar ngecjen e mendjeve dhe zemrave në rrjetën e shkaqeve dhe ligjeve, për t'i parashtruar hapur parapëlqimin dhe vullnetin e vet dhe për t'i bërë vështirimet të kthehen nga Ai. Në jetën tonë të përditshme shpesh lexojmë në shtyp ose dëgjojmë se një i rritur ka rënë nga kati i dytë dhe ka vdekur, kurse një fëmijë të vogël fare që ka rënë nga kati i pestë, s'i ka dalë as gjak nga hunda! Ky dhe dukuri e ngjarje të tjera analoge që i kemi përmendur disa herë në vende të ndryshme të këtij libri, janë përrjashtime, pra, dhe që s'përputhen me mendjen dhe shkencën. Por, meqë janë fakte reale, na duhet t'i mohojmë mendjen dhe shkencën ose të themi se meqë mendja

dhe shkenca nuk i pranojnë, edhe pranimi i mendjes dhe shkencës nga ana jonë nuk ka asnjë kuptim.

15. Mendja dhe shkenca nuk mund të konsiderohen të posaçme vetëm për racionalitetin, lëndën dhe lëvizjet e atomit. Kjo, sepse, para së gjithash, njeriu, i cili zotëron mendje dhe bën shkencë, nuk është identiteti i lëndës dhe trupit. Si botë materiale, njeriu është vetëm njëra prej mijëra botëve. Po qe se njeriu që s'ia merr dot mendja mrekullitë, do t'i ndiqte sadopak zhvillimet shkencore dhe do t'i njihnte ato që ngjajnë në mjediset shkencore, atëherë edhe mendja e tij që vërtitet si një meteor endacak në boshllëk, do të formojë një orbitë të caktuar. Te njeriu ka shpirt dhe ky shpirt ka shumë funksione të pakuptueshme. Dhe studimet e sotme mbi shpirtin është bërë një nga preokupimet kryesore të rretheve shkencore. *Atyre që e kërkojnë çdo gjë te materia, mendja u ka zbritur te sytë, kurse sytë janë të verbër ndaj shpirtërores.* Ata që i mohojnë mrekullitë, mbajnë një qëndrim të tillë ndoshta ngaqë e ndjejnë veten të huaj ndaj fesë dhe të shqetësuar. Por vetëm feja është ajo që, siç sundoi të djeshmen, do të sundojë edhe të ardhmen.

16. Shkencat moderne shpesh thonë “e drejtë” për diçka që gjer dje kanë thënë “e padrejtë” ose anasjelltas. Prandaj, askush nuk jep dot garanci se ajo që sot quhet e drejtë, nuk do të hidhet poshtë nesër. Ndërkaq, për shumë çështje shkencore të pashpjegueshme sot për sot, nuk mbahet qëndrim mohues, por thuhet se *nesër shkenca ka për t'i shpjeguar*, kurse ngjarjet e së kaluarës mohohen duke thënë se “s'është e mundur”, dhe ky qëndrim është i pashpjegueshëm me anë të mendjes dhe logjikës. Pse edhe mrekullitë nuk i shohim më butë duke thënë se “këto na i kapërcejnë kufijtë e mendjes dhe përvojës sonë”?

17. Shkaqet dhe ligjet shkencore të zgjedhura si mbështetje nga mendja mohuese, nuk mund të jenë krijues, për rrjedhojë, nuk mund të konkludojnë mbi mrekullitë dhe nuk mund të konsiderohen njësi mase dhe mjete krahasimi për t'i kuptuar mrekullitë. Ashtu siç shkaqet që nuk mund të zgjaten pas pafundësisht, ashtu dhe mrekullitë janë vepër e Fuqisë Krijuese. Ata që supozojnë sundimin e një determinizmi shtrëngues në gjithësi, ngecin kur vjen puna për shkakun e parë dhe, duke mos i dhënë përgjigje “pse”-së, merren me “si”-në!

18. Ata që i mohojnë mrekullitë në emër të shkencës, kur ta kuptojnë të vërtetën, do të turpërohen. Sepse siç do të shohim më tej duke shqyrtuar zbulimet dhe zhvillimet shkencore e teknike ku kanë vënë gishtin Kurani dhe hadithet, para çdo zbulimi dhe zhvillimi shkencor e teknik ka një mrekulli që u ka shërbyer atyre si flamur. Në periudhat kur mendjet kanë qenë tejet larg për ta kuptuar të sotmen, profetët dhe Profeti i Fundit, me mrekullitë e tyre, kanë bërë parashikime që edhe mendjet e sotme janë të paafta për t'i kuptuar dhe kanë vënë për dituritë dhe shkencat gurë kufiri dhe kanë treguar maja që ende duken shumë larg.

ÇËSHTJA E MARTESËS SË PROFETIT ME SHUMË GRA

Le të theksoj menjëherë se ata që flasin poshtë e përpjetë për këtë çështje, janë të tillët që s'lexojnë e s'e vrasin mendjen për asgjë. Po qe se do të merrnin pakëz mundimin t'u hidhnin një sy librave biografikë të jetës së Profetit, nuk do ta ulnin veten duke u marrë me gjëra të paqena.

Në martesat e Kryeprofetit, Individualitetit Autentik të Misionit, ka aspekte të ndryshme: specifikat përkatëse të Individualitetit të Nderuar, përgjithësisht objektivat dhe synimet që mund të jenë mbajtur në martesat e tij, disa detyrime e domosdoshmëri dhe, në fund, disa situata të tilla që

kanë të bëjnë me plotësimin e kërkesave të veçanta të martesës. Tani le t'i analizojmë këto aspekte një e nga një.

Le ta fillojmë shqyrtimin e çështjes duke parë nga personaliteti i pastër e i pamëkat.

Mbi çdo gjë, duhet të dihet se ai Individualiteti i Lartë nuk u martua gjer më njëzet e pesë vjeç. Po të kemi parasysh klimën posaçërisht të nxehtë të atij vendi, një jetesë e virtytshme gjer në këtë moshë tregon se tek ai virtyti ishte një element bazë, se ai kishte një vullnet të jashtëzakonshëm dhe se i zotëronte dëshirat trupore – të gjitha këto, të pranuar pa kusht dhe e sot. Po që se në këtë moment do të ekzistonte edhe shmangia më e vogël, dushmanët e tij të djeshëm e të sotëm nuk do të ngurronin qoftë edhe për një çast për t'ia njoftuar botës këtë gjë. Mirëpo armiqët e tij të vjetër e të rinj, ndërsa i kanë ngarkuar gjëra të paqena, këtu nuk kanë patur guxim të thonë diçka.

Martesën e parë, profeti ynë e bëri në moshën njëzetepesëvjeçare. Kjo martesë u lidh me një grua të rrallë e të respektuar në lartësinë e Allahut e të të Dërguarit të Tij, por në moshë dyzetvjeçare dhe e martuar dy herë më parë. Kjo fole e lumtur vazhdoi plot njëzet e tre vjet dhe në vitin e tetë të profetësisë u mbyll sipari i saj duke lënë pas një mall të hidhur. Kështu, si gjer më njëzet e pesë vjeç, edhe kësaj radhe, Profeti mbeti sërish krejt i vetmuar. Pas asaj jete njëzetetrevjeçare me familje e me gjithçka, sërish jetoi si beqar katër-pesë vjet, ndërsa mosha iu afrua të pesëdhjetetretave.

Ja, pra, të gjitha martesat e tij të tjera fillojnë pas kësaj moshe, kur pakësohet interesimi për martesë. Në një vend të nxehtë, të kërkosh apo të shohësh sensualitet apo erotizëm në martesat pas moshës pesëdhjetë e pesë vjeç, është krejt e palogjikshme dhe e papranueshme.

Këtu më vjen ndërmend edhe një çështje tjetër, interpretimi i temës së poligamisë në institucionin e profetësisë. Edhe këtë dua ta trajtoj me nja dy-tri fjali.

1. Pikësëpari, ata që kapen pas kësaj, janë ose të tillët që nuk pranojnë asnjë fe apo parim, kështu që kurrë s'kanë të drejtë ta dënojnë një gjë të tillë, sepse ata dalin kundër të gjitha parimeve, hyjnë në marrëdhënie me shumë femra pa iu nënshtruar asnjë ligji apo rregulli, madje e quajnë të lejueshme kurorën me të afërmit. Ose janë adhuruesit e librave të shenjtë, çifutët dhe krishterët. Edhe sulmi i tyre ka qenë i pangopur, i verbër e plot maraz, madje i tillë që të shkakton keqardhje për vetë emrin e tyre. Sa profetë të mëdhenj ka që i kanë pranuar dhe që u janë nënshtruar pasuesit e ungjillit, që i kanë njohur si profetë të tyre dhe u kanë shkuar pas pasuesit e Teuratit, të cilët kanë pas lidhur kurorë me shumë gra. Sikur të kujtohen vetëm profetët Sulejman dhe Daud, del sheshit se në ç'pozicion padrejtësie dhe sulmi ndodhen të dy bashkësitë në fjalë. Për rrjedhojë, duhet thënë se, ashtu siç martesën me shumë gra nuk e ka filluar profeti ynë, edhe martesa e shumtë nuk është në kundërshtim me frymën profetike. Pas kësaj, mbetet të themi se, ashtu siç do të vërehet në specifikat që do të përpiqem të shpjegoj më poshtë, nga pikëpamja teorike, poligamia e profetëve përmban dobi të nivelit konceptual.

Martesa me shumë gra, në një pamje, është e detyrueshme posaçërisht për profetin që vjen me një sistem ligjshmërie, pasi ekzistojnë disa aspekte të fesë që përshkohen nëpër intimitetin e martesës, aspekte për të cilat mund të ketë njohuri vetëm një i martuar. Për rrjedhojë, për t'i shpjeguar këto aspekte të fesë pa iu drejtuar ndonjë çfarëdo aluzioni apo ngjashmërie që shpesh herë e turbullojnë këtë mënyrë të treguari, ekziston nevoja e njerëzve të përkushtuar që do ta tregonin çdo gjë përmes qartësisë e thjeshtësisë me të gjitha mundësitë e tyre.

Ja, pra, këto bashkëshorte të pastra, të singerta e të vërteta të mjedisit profetik, duke u nisur mbi gjithçka nga përgjegjësia si dhe nga roli transmetues i tyre në detyrën e kumtimit e të prijësisë profetike, para botës femërore bëhen të domosdoshme si për profetin, si për profetësinë, si për botën femërore, madje, të paevitueshme.

2. Një çështje tjetër ka të bëjë, në përgjithësi, me bashkëshortet e profetit tonë.

a) Duke u nisur nga fakti se mes bashkëshorteve kishte të moshuara, me moshë të mesme e të reja, tek të gjitha zbatoheshin rregulla të ndryshme përkatësisht të asaj epoke e të atyre periudhave. Në sajë të këtyre bashkëshorteve të pastra që ndodheshin në banesën profetike, Profeti gjente mundësi zbatimi praktik.

b) Meqë secila nga bashkëshortet vinte nga një tribu e veçantë, ato i hapnin udhë një lidhjeje e dashurie me rrënjë së pari midis tribeve, pastaj midis gjithë kuvendeve në të cilat kishin mundësuar sendërtimin e një farefisnie me anë të personalitetit të vyer. Në sajë të lidhjes përkatëse, pranë lidhjes fetare, çdo tribu e fis e njihte Profetin si të vetin dhe ndjente interesim të thellë për të.

c) Gratë e marra prej fiseve të ndryshme mundën të bëheshin pretekst për shumë shërbime fetare serioze mes bashkësisë së vet sa që gjallë ai si dhe pasi ndërroi jetë. Ato u bënë interpretë të Personalitetit të Fshehtë e Prezent tek farefisi i tyre i afërt apo i largët. Në sajë të këtij shërbimi, edhe fisi i tij, me burra e gra, mësonin Kuran, koment dhe hadithe, si dhe përvetësonin shpirtin e fesë.

ç) Më i përsosuri i profetëve, ashtu siç kishte krijuar afërsi pothuaj me të gjithë Gadishullin Arabik, me anë të këtyre bashkëshorteve ishte bërë edhe miku i padrojtë i çdo banese. Me anë të kësaj afërsie, çdokush mundej t'i afrohej atij Personalitetit Monumental dhe të gjente rastin për të mësuar urdhrat e fesë. Në të njëjtën kohë, secili nga fiset e quante veten njëlloj të afërt ndaj tij dhe krenohej me këtë. Të bijtë Mahzum nëpërmjet Umu Selemes, emevitët nëpërmjet Umu Habibes, hashimitë nëpërmjet Zejneb binti Xhahsh, duke pohuar afërsinë me të, ndjeheshin fatbardhë!

3. Evenimentet e përmendura gjer këtu, në kuptim të përgjithshëm si dhe në disa aspekte të caktuara, do të ishin karakteristike për të gjithë profetët. Tani ta trajtojmë çështjen në kuptim të ngushtë, konkret dhe në përvojën e secilës bashkëshorte një nga një. Dhe edhe këtu do të shohim se logjika mbetet tejet e dobët para jetës së nderuar të atij personaliteti të mbështetur nga revelacioni hyjnor. E shprehur ndryshe, mendimi njerëzor përthyeret më dysh para zgjuarsisë profetike!

I. Bashkëshortja e parë e Profetit është zonja jonë, Hatixhja (r.a). Pesëmbëdhjetë vjeçe më e madhe, martesë me këtë grua të rrallë përbën shembullin më të lartë për çdo martesë. Ai, ashtu siç mbeti një jetë të tërë i lidhur pas grave të veta me një besnikëri të thellë dhe miqësi që buronte nga nderimi ndaj Zotit, pas vdekjes s'e pati harruar kurrë Hatixhen, madje pati hapur diskutime rreth saj sa herë që i qe dhënë rasti.

Pas Hatixhes, Profeti nuk u martua për 4-5 vjet. Megjithëse i kishin mbetur në ngarkim disa jetimë, iu vu kujdesit dhe ushqimit të tyre të përditshëm duke kryer edhe detyrën e nënës, edhe të babës. Sikur më parë a më pas të kishte patur ndonjë dobësi të vogël për femrat, kështu do të vepronte?

II. Edhe pse jo sipas radhës, gruaja e dytë është Aishja besnike. Vajza e shokut më të afërt, dhurata më e zgjedhur për Profetin, me të cilën ai kaloi një jetë të tërë së bashku, në hidhërime e gëzime. Atë ditë kur morën fund të gjitha afërsitë e kur profeti ndërroi jetë, nderi për t'iu ndodhur pranë Profetit do t'i takonte vetëm asaj në sajë të një afërsie të pafundme. Po, Aishja besnike dhe i

ati, Ebu Bekri, ishin bërë konfidentë profetikë pa asnjë të çarë materialo-shpirtërore me tël veçanërisht një krijesë e rrallë si Aishja, për nga krijimi, zotëronte cilësitë e trashëgimitarit të mundshëm të kauzës profetike në kuptimin e plotë të fjalës. Ajo qenie e lartë që me jetën pasmartesore dhe me shërbimet e mëvonshme fitoi tipare përfundimtare, mund të bëhej vetëm një bashkëshorte profeti. Sepse duke e treguar veten si njohësja më e madhe e *hadithit* dhe e *tefsirit*, dhe si *juristja* më e rrallë, me shpjegimet e saj të qarta e të pashembullta e përfaqësonte me të drejtë Muhamedin si në formën e jashtme, ashtu dhe në përmbajtje.

Është për këtë arsye që Profetit i jepej në ëndërr lajmi se do të martohej me të, ndërsa ajo, ndërsa pa iu shfaqur ndonjë iluzion tjetër ndër sy, hidhte këmbën në banesën e Tij...

Në sajë të këtij hapi, ajo do të bëhej për të atin, Ebu Bekrin, pretekst nderimi dhe, brenda botës femërore, duke i përparuar të gjitha dhuntitë dhe aftësitë e saj, me identitetin e njërit prej nxënësve më të dalluar të Profetit, do të përgatitej për t'u bërë një edukatore dhe prijëse e madhe. E, kështu, pra, ajo, edhe si bashkëshorte, edhe si nxënëse, ishte bërë, tashmë, pjesëtare e banesës së lumturisë!

III. Përsëri jo sipas radhës, bashkëshortja e tretë është Umu Seleme. Me prejardhje nga tribuja Mahzun dhe një ndër myslimanët e parë, ajo u shtyp e u persekutua në Mekë, emigroi së pari në Etiopi, pastaj në Medine dhe, sipas kushteve të asaj kohe, zuri vend ndër besimtarët e radhës së parë. Në udhëtimet e saj plot vështirësi e vuajtje, ajo pati përkrah edhe të shoqin i cili, në sytë e saj, ishte një njeri i pakrahasueshëm. Pasi e humbi në Medine Ebu Selemen, njeriun me të cilin jetoi gjithë atë periudhë brengje, atë shok të pangjashëm, Umu Seleme mbeti e vetme, kokë më kokë me fëmijët e saj. Kësaj gruaje të mbetur larg vatanit dhe shtëpisë së vet me një tufë jetimësh, që kishte ngarkuar mbi supe barrën e jetës, të parën dorë dhembshurie ia zgjatën Ebu Bekri dhe Omeri, por ajo i refuzoi këto kërkesa sepse në sytë e saj nuk ekzistonte një njeri që të zinte vendin e Ebu Selemes.

Më në fund, asaj i zgjati dorën i Dërguari i Allahut duke i propozuar për martesë. Edhe kjo martesë ishte mjaft e natyrshme sepse kjo grua e lartë që s'i ishte shmangur asnjë sakrifice në synimin drejt Islamit dhe besimit, që kish jetuar një kohë të gjatë mes tribusë arabe më fisnike, kish mbetur e vetmuar, nuk mund të braktisej në udhën e lypjes. sidomos po të mendoheshin pastërtia e saj shpirtërore, sinqeriteti dhe punët që u kishte hyrë për Islamin, asaj duhej t'i zgjatej dora pa diskutim.

Kështu, pra, duke e marrë atë nën kurorë, Krenaria e Gjithësisë i kishte zgjatur dorën e ndihmës e të favorit. Sigurisht, ashtu siç kishte vepruar që në rini, detyrën e kujdesit ndaj të vetmuarve dhe dorën e ndihmës ndaj jetimëve e zbatonte në përshtatje me kushtet e asaj kohe.

Ashtu si dhe Aishja, Umu Seleme ishte një grua e mençur dhe e zgjuar. kishte talentin e një prijëseje dhe edukatoreje. Për këtë arsye, duke e marrë dora e dhembshurisë nën mbrojtje atë nga njëra anë, në anën tjetër, në shkollën e diturisë dhe prijësisë pranohej edhe një nxënëse tjetër, ndaj së cilës bota femërore do të mbetej veçanërisht e detyruar për falenderim.

Nuk mund të bëhet asnjë shpjegim tjetër, i kundërt me ç'u tha gjer këtu, për martesën e Profetit me këtë grua që u ish afruar të gjashtëdhjetave dhe po hynte nën barrën e një sërë detyrimesh , sidomos ndonjë shpjegim lidhur me ndonjë gjë tjetër, si me erotizëm a me pasion pas grave, kurrë, kategorikisht!

IV. Një bashkëshorte tjetër e Profetit është edhe Remle binti Ebu Sufjan (Umu Habibe). Vajza e njeriut që kishte përfaqësuar një kohë mohimin dhe blasfeminë kundër Profetit dhe profetësisë. Edhe kjo, nga myslimanët e parë dhe nga të radhës së parë. Një grua e hequr dhe e vuajtur, e cila, në periudhën e brengës pati emigruar në Etiopi, kishte përjetuar në fillim kthimin e të shoqit në krishter, pastaj dhe vdekjen e tij.

Atëherë, shokët dhe ndjekësit e Profetit ishin të pakët në numër dhe të varfër. Ata s'kishin mundësi të kujdeseshin për ndokënd, t'i siguronin ndokujt mjetet e jetesës. Në këto kushte, ç'mund të bënte Umu Habibe? Ose të bëhej krishtere e të përfitonte nga ndihma e krishterëve, ose të kthehej në shtëpinë atërore, në atë çerdhe blasfemie, ose të lypte portë më portë. Asnjëra nga këto zgjidhje nuk ishte e mundur për gruan më besimtare, më të fisme e më të pasur për nga prejardhja. Mbetej vetëm një zgjidhje: ndërhyrja dhe kujdesi i Profetit.

Ja, pra, edhe në martesën me Umu Habiben ndodhte e njëjta gjë. Kjo grua që kishte pranuar çdo sakrificë për fenë, e mbetur larg vatanit dhe çerddes familjare, mes zezakëve, ato ditë që jetonte zemërthyer nga tradhtia dhe vdekja e të shoqit, thirrej në audiencë të sundimtarit të Etiopisë, Nexhashiut dhe i lidhej kurorë me Profetin, një akt, ky, tepër i natyrshëm. E kjo s'duhet dënuar, por, e konsideruar si realizimi i një domosdoshmërie të rrjedhur nga funksioni i *Rahmeten lil alemin*, i *Mëshirës së të gjitha botëve*, duhet duartrokatur.

Mbetet të themi se edhe kjo grua e madhe, në të njëjtën mënyrë, kishte mjaft gjëra për të sjellë në botën diturore të myslimanëve burra e gra. Në të njëjtën formë, edhe kjo futej në atë mjedis lumturie edhe si bashkëshorte, edhe si nxënëse.

Në të njëjtën kohë, në sajë të kësaj martese, edhe familja Ebu Sufjan përfitonte mundësi të hynte e të dilte pa drojtje në banesën profetike dhe zbutej duke fituar një portret tjetër. Kjo martesë ishte e një karakteri të tillë që do të ushtronte ndikim jo vetëm mbi familjen Ebu Sufjan, por ndoshta edhe mbi tërë emevitë. Madje mund të thuhet se kjo familje e ashpër dhe fanatike në kulm, në sajë të kurorës së Umu Habibes, u zbut mjaft dhe u bë gati të pranonte çdo lloj bekimi.

V. Një nga ato që hynë në banesën e lumtur profetike që edhe Zejneb bini Xhahsh. Zotëruese e një bote të brendshme krejt të veçantë dhe, po ashtu, delikate, ishte fis me Profetin dhe ishte rritur e zhvilluar pranë tij. Kur Profeti e kishte kërkuar atë për Zejdin, familja e saj kishte ngurrar pak dhe, në këtë mes, kishte shfaqur prirjen për t'ia dhënë vajzën Profetit. Më në fund, me këmbënguljen e tij, familja kishte pranuar t'ia jepte Zejd b. Harithes.

Zejdi ishte një libert që dikur kishte pas humbur lirinë, kishte pas rënë rob dhe e kishte pas rifituar, pastaj, nëpërmjet Profetit. Me këmbënguljen në këtë martesë, Profeti donte të sendërtonte, të fuqizonte e të përçonte te njerëzit barazinë shoqërore mes tyre duke ia filluar edhe kësaj pune ndër më të vështirat përsëri te të afërtit e vet. Por ç'e do që një femër me një natyrë shumë superiore si Zejnebi dukej sikur nuk do ta shtynte gjatë një martesë të tillë konvencionale. Edhe për Zejdin kjo martesë nuk kish sjellë diçka, veçse pritje e ankth.

Më në fund erdhi divorci, ndërsa Profeti ende përpiquej që Zejdi të hiqte dorë nga divorci dhe martesa e tyre të vazhdonte. pikërisht në ato rrethana erdhi engjëlli Xhebrail dhe, me një dekret qiellor, solli urdhrin e martesës së Zejnebit me Profetin. kjo provë së cilës duhej t'i nënshtrohej ai, ishte mjaft e rëndë sepse ishte diçka që s'kishte guxuar ta bënte askush dhe, ndaj zakoneve të rrënjësura e të ngulitura prej kohësh, ishte një *shpallje* e vërtetë *lufte*. Kjo ishte një përpjekje tejet e vështirë, por bëhej vetëm se kishte urdhëruar Allahu. Dhe ja, Profeti, me vetëdijen e thellë të robit, e

bëri këtë punë që përplasej shumë rëndë ndaj personalitetit të tij të dëlirë. Ashtu siç thoshte Aishja, sikur t'i lejohej Profetit të fshihte diçka nga revelacioni hyjnor, do të mbante të fshehur ajetet që urdhëronin martesën e tij me Zejnebin. Sigurisht, aq rëndë i kishte ardhur kjo gjë individualitetit profetik!

Kurse Urtësia Hyjnore donte që këtë qenie të pastër e të lartë ta fuste në banesën profetike, ta përgatiste në dituri dhe kulturë dhe ta ngarkonte me detyrën e kumtesës profetike e të prijësisë besimore. Më së fundi ashtu edhe u bë. Dhe më pas, në tërë jetën e saj moralo-etike të kulluar, ajo iu përgjigj hollësive që përbënin domosdoshmërinë e bashkëshortësisë profetike.

Në periudhën e injorancës, veçanërisht, djalit të adoptuar i thuhej *djalë* dhe, po ashtu, gruaja e djalit të adoptuar pranohej si gruaja e djalit të vërtetë. Kur u urdhërua qëllimi për ta hequr këtë zakon që i përkiste injorancës, përsëri zbatimi filloi te Profeti. Ashtu siç nuk mund të jetë djalë dikush i thirrur djalë, edhe gruaja e tij nuk mund të konsiderohet nuse e djalit.

Ka akoma shumë gjëra që do të duhej të thuheshin për Zejnebin, por, meqë e kapërcejnë masën e trajtimit të këtushëm, po e lëmë me kaq.

VI. Njëra nga gratë e nderuara me banesën e lumturisë është edhe Xhujerije bintul Harith. Në një ekspeditë kundër fisit të saj jomysliman, ajo ra rob bashkë me burra e gra të tjera. Bota ndjesore iu përmbys, krenaria iu thye dhe, kur u soll para Profetit, kjo grua e shoqërisë së lartë ishte plot zemërim e urrejtje.

E pikërisht atëherë, logjika profetike e zgjidhi çështjen me një lëvizje.

Duke lidhur kurorë me Profetin, Xhujerije u ngrit në pozitën e nënës së besimtarëve dhe, në sytë e shokëve dhe ndjekësve të Profetit, u shndërrua në një përmendore nderi i respekti. Sidomos thënia e shokëve të Profetit se *farefisi i Profetit nuk zihet rob*, pasoi lëshimin e të gjithë robërve, gjë që bëri të triumfohej menjëherë zemra e Xhujerijes dhe e fisit të saj.

Duket qartë se me këto martesë të realizuara rreth moshës gjashtëdhjetëvjeçare, Profeti zgjidhte shumë çështje me një lëvizje dhe bënte që mes ndodhive të përgjakshme të frynin flladet e paqes e të qetësisë.

Ndër ato fatbardhat është edhe Safije binti Hujei. Vajza e njërit nga emirët e Hajberit. Në ngjarjen e njohur të Hajberit i qenë vrarë i ati, vëllai dhe i shoqi, kurse pjesëtarët e fisit i ishin marrë rob. Safija digjej nga dëshira e vrullshme për të marrë shpagim. Me aktin e kurorës, duke u ngjitur në lartësinë e pozitës së bashkëshortes së Profetit, përballë nderimit të besimtarëve, apelativit *nënë* të pasuesve profetikë dhe madhështisë zbutëse e mpakëse të Profetit, Safija i harroi gjithë ç'kishin ndodhur dhe filloi të ndjehej krenare për qenien e saj bashkëshorte e Profetit.

Veçanërisht krijohej edhe mundësia që, me anë të Safijes, shumë çifutë ta shihnin dhe njihnin nga afër Profetin dhe të zbuteshin. Allahu i Lartë që prej diçkaje krijonte gjithçka dhe në çdo veprim të të cilit do të kishte mijëra urtësi, ashtu siç ndodhi tek të gjitha bashkëshortet, edhe te kjo pati sjellë shumë dobi dhe bekim.

Përveç kësaj, nga pikëpamja e mundësisë për t'u bërë i njohur me botën e brendshme të armiqve, pandeh se është me vend të kujtoj që me këtë ai i jepte edhe një mësim bashkësisë së vet. Sidomos ndaj çifutëve!..

Po ashtu nga kjo pikëpamje, ishte shumë i rëndësishëm fakti që Safija dhe gratë e tjera vinin, në mënyrë të ngjashme, nga popuj të ndryshëm. Mjaftonte që, duke i njohur qëllimkëqinjtë mes tyre, njeriu të mos ia tregonte sekretet e veta armikut!

VIII. Nga këto fatbardha ishte edhe Sevdaja, nga ato të radhës së parë, që kishte emigruar në Etiopi bashkë me të shoqin dhe, ngjashëm me fatin e Umu Habibes, që kishte mbetur në mes të udhës pas vdekjes së të shoqit.

Profeti ia lidhi plagën kësaj zemërthyerë, e shpëtoi nga shkatërrimi dhe iu bë shok në ndjenja. Për më tepër që kjo grua e madhe që mendonte të jetonte nën kurorën e Profetit, nuk dëshironte gjë tjetër veç kësaj.

Ja, pra, me këto synime dhe urtësi që orientuar Profeti ynë në këto martesë dhe kurrë nuk u kish hyrë për dëshira trupore. Ose që martuar për dhuntitë dhe aftësitë e grave që iu bënë bashkëshorte, për të ngritur një ngrehinë farefisnie me ndihmësit e tij, siç ndodhi me dy kalifët e parë rashidinë, Ebu Bekrin dhe Omerin, ose që martuar me të tjera urtësi dhe qëllime duke hyrë nën përgjegjësi dhe detyrime të mëdha.

Përveç këtyre, sigurimi në formën më të drejtë i nevojave të kaq grave për banesë, nevoja të përditshme dhe veshje, kujdesi i jashtëzakonshëm në trajtimin e tyre, respektimi i drejtësisë dhe i të drejtave, parandalimi i pakënaqësive që mund të shkaktoheshin midis tyre, zgjidhja e lehtë dhe e qetë e pashkuarjeve eventuale, janë argumente në favor të profetësisë së atij individualiteti të veçantë që, siç shprehej Bernard Shou, i zgjidhte problemet më të mëdha me lehtësinë e pirjes së një filxhani kafeje...

Ne që shohim dhe dimë se sa i vështirë është administrimi i një gruaje dhe nja dy fëmijëve, përballë atij njeriu të madh që trajtoi në një ritëm dhe harmoni poetike disa gra të cilat më parë kishin pasë krijuar çerdhe të tjera, të cilat ishin bërë dëshmitare të konstrukteve të tjera familjare, të cilat kishin fituar zakone e vese të ndryshme në ato familje, përballë tij, pra, përthyerimi më dysh me nderim.

Mbeti vetëm një çështje e veçantë, ajo e numrit të bashkëshorteve, e numrit të tyre mbi atë të lejueshmin për bashkësinë e tij. Kjo është një çështje ligjëvënësie. Sigurisht, ky është një përjashtim ligjor që përfshin shumë urtësi dhe synime të njohura e të panjohura prej nesh. Një farë kohe që dhënë një liri e pakushtëzuar për numrin e grave, kurse më pas, në një datë të caktuar, u vu një kufizim dhe u ndaluan martesat jashtë atij kufizimi.

PJESA E DYTË

KURANI

INTRODUKTE

“Sikur ta kishim zbritur këtë Kuran mbi një mal, do ta shihje kokulur e copë-copë nga frika e Allahut. Këto shembuj ua japim njerëzve që të mendojnë.” (Hashr, 21)

Kurani është një fjalë hyjnore e zbritur për njeriun e krijuar me mundësi për t’u bërë bashkëbisedues i Zotit dhe të merituar të të fshehtës “krijim i bukur”. Po, Kurani i është zbritur njeriut! Po që se, duke iu marrë parasysh madhështia, do t’u ishte zbritur maleve, do të shihnit se si malet do të bëheshin copë-copë. Sigurisht, nga impresionimi dhe tronditja para Allahut, malet do të rrënoheshin, kurse njeriu s’pëson gjë sepse e mban mendjen dhe zemrën larg Kuranit! Njeriu, i cili nuk i bën vend Kuranit në mendje dhe në botën e vet të brendshme, gjithsesi nuk do të ketë pjesë prej tij!

Kurani është një libër. Me madhësinë e tij hyjnore, Zoti e ka zbritur atë të tillë që t’u japë përgjigje nevojave të njerëzve. Gjithashtu, Kurani është një libër shumë i begatshëm. Është i bekuar, i shenjtë. Ai nuk ka shok në lartësi dhe shenjtëri. Kurani është vetë begatia!

Kur njerëzit bëjnë sipas urdhrave të Kuranit, jeta u begatohet dhe dalin mbi gjithë të tjerët. Dhe të gjitha fushat e jetës, me këtë bindje ndaj urdhrave të tij blerohen dhe kthehen në parajsë.

Kurani që na është dërguar për t’i menduar dhe matur të gjitha këto, duhet mbajtur në mendje çdo çast dhe gjithmonë duke e vrarë mendjen për të kuptuar një gjë të re, si dhe specifikat që përbëjnë nevojë për çdo periudhë, duhen nxjerrë nga Kurani me një përpjekje dhe mundim të tillë. Ndryshe, është e pamundur ta kuptosh Kuranin.

Kurani është thelbi i jetës. Jeta e njeriut bëhet e dobishme, e mbarë dhe e bekuar me aq sa njeriu e bën Kuranin parim të jetës. Jeta larg Kuranit është jo e mbarë, jo e begatë. Në jetën e një populli apo kombi larg Kuranit, ka thashetheme, grindje dhe anarki sipas masës së largësisë prej tij.

Në një porosi të tij, Profeti thotë: “*Më i dobishmi prej jush është ai që e mëson Kuranin (duke zbritur te e vërteta dhe momentet themelore të tij) dhe ua mëson edhe të tjerëve pastaj!*” Po deshëm të bëhemi më të dobishmit, duhet të përpiqemi ta kuptojmë dhe ta tregojmë Kuranin, t’i trazojmë dhe studiojmë komentet (tefsiret) e shkruara mbi këtë çështje duke bërë përpjekje për të hyrë në të vërtetën dhe momentet themelore të tij gjersa t’ia tregojmë botës se, në këtë drejtim, i kemi dalë për

zot Kuranit. Ndryshe nuk mund të mendohet se mund të përfitojmë sa duhet nga drita dhe begatia e Kuranit!

Në mes është një e vërtetë e madhe: e vërteta e Kuranit! Ne jemi të ngarkuar me disa detyra para tij. Por përgjegjësia jonë nuk është vetëm ruajtja e teksteve të Kuranit. Ndoshta kjo është e nevojshme, por më shumë se zarfi, duhet respektuar ajo që ka zarfi brenda. Nuk mund të themi se e kemi kryer detyrën për ta respektuar Kuranin vetëm duke e futur në një mbështjellëse të bukur e duke e vendosur apo ekspozuar në këndin më të zgjedhur të shtëpisë. Po qe se do t'ju vinte një letër nga një sundimtar, ç'do të bënit ju? A vetëm do ta merrnit, do ta puthnit dhe vinit në ballë dhe, pastaj do ta linit pa e hapur fare në një kënd, apo, me interesimin për përmbajtjen e saj, do ta hapnit me kujdes të veçantë, do ta lexonit dhe do të përpiqeshit për ta kuptuar? Ja, pra, sundimtari i sundimtarëve, zotëruesi i pasurisë dhe pushtetit, Allahu i Lartë, ju ka dërguar një thirrje, një thirrje të tillë që përmban rëndësi jetësore për ju dhe ku ka shumë e shumë çështje që kanë të bëjnë edhe me jetën tuaj në këtë botë, edhe me jetën në botën tjetër. Po qe se ju do ta merrnit këtë, do ta puthnit dhe vinit në ballë me nderim të thellë dhe, pa e hapur fare, do ta vinit në raft, a do ta linit të kënaqur Atë?

Deklarata-Mrekulli Kuran është një thirrje sovrane e dërguar bujarisht për ju me qëllim që ta vini jetën tuaj në rregull. Në këtë thirrje, Allahu thekson: *“Pa dyshim, Ne e krijuam njeriun me krijimin më të bukur!”*

Sigurisht, me Kuranin, ne jemi nderuar bujarisht. Për ata pa Kuran, Allahu thotë: “... si kafshët, ndoshta më poshtë se to!” Kjo do të thotë se njerëzimi i zhveshur prej tij, nuk merr prej atij nderi. Përvetësimi i Kuranit është pjesë shumë e konsiderueshme e nderit tënd.

Në lidhje me këtë çështje, në një porosi tjetër të tij, Profeti thotë kështu: *“Njeriu që e shpall Kuranin hapur dhe e lexon me qëllim për t’ia bërë të ditur gjithë botës, është si njeriu që e jep sadakanë hapur, kurse ai që e lexon fshehtas, është si njeriu që e jep sadakanë fshehtas!”* Ashtu siç jepen sadakaja dhe zekati haptas me mendimin për t’i nxitur të tjerët dhe synimin që në këtë garë të marrin pjesë të gjithë, edhe me leximin e Kuranit haptas nxiten të tjerët që edhe ata ta përvetësojnë atë.

Të mbetesh vetëm për vetëm me Kuranin në errësirën e natës, është si ta japësh sadakanë fshehtas. Njeriu që e rrok dhe e përvetëson këtë fshehtësi dhe konfidencë, heton se ku e ka vendin në Kuran dhe kërkon t’i gjejë një vend vetes në të. Është tejet e rëndësishme për një besimtar që ta kërkojë vendin e vet në Kuran dhe ta rregullojë veten sipas Kuranit. Omer b. Abdulaziz, Muhamed ibn Ka’bil Kuradi dhe shumë e shumë të tjerë, gjithë me këtë mendim e kanë lexuar Kuranin gjer në mëngjes dhe vetëm me këtë rrugë kanë arritur ta rrokin kuptimin dhe thellësinë e vërtetë të tij!

Kurani i kënduar me një mënyrë të sinqertë e të bukur, u fal jetë shpirtit dhe botës ndjesore të tij. Sidomos ta dëgjosh Kuranin sikur të derdhej nga buzët e bekuara të Profetit, kjo e mbështjell njeriun me një prehje e kënaqësi të amshuar. Të ngrihesh lart në një farë shkalle, të shkosh mik te Xhebraili dhe ta dëgjosh Kuranin prej tij, i përfton shpirtit frymëzime të papërshkruara. Pastaj, përtej të gjitha këtyre, të bëhesh bashkëbisedues i Ligjëruesit Eternal sikur ta dëgjosh Kuranin nga vetë Ai, do të thotë të marrësh cilësi qiellore, të qiellorizohesh, ndonëse nuk e di nëse shpirti i njeriut ka mundësi apo jo për këtë!..

I. ARGUMENTET MBI FAKTIN SE KURANI ËSHTË FJALA E ALLAHUT DHE DËSHMIA MË E MADHE E PROFETËSISË SË HZ. MUHAMEDIT

KURANI

1. Një analizë e thjeshtë do të mjaftonte për të nxjerrë në shesh se, nga ana e gjuhës dhe e shprehjes, Kurani nuk i përngjet asnjë libri. Veçanërisht, edhe nga stili, kuptimi dhe përmbajtja, Kurani është i pashembullt e i pashoq. Në këto kushte, ose Kurani zë një vend nën të gjithë librat e shkruar gjer tani – gjë që as djalli nuk e pretendon dot – ose zë një vend mbi çdo libër tjetër. Atëherë, Kurani nuk është fjalë njeriu!

2. Në Kuran, duke iu drejtuar personalisht, Profetit i thuhet kështu: *“Para kësaj ti as mund të lexoje ndonjë shkrim, as dhe mund të shkruaje me dorën tënde, ndryshe, ata që mendojnë keq, do të dyshonin!”* (Ankebut, 48) Pa dyshim, ashtu si dje, edhe sot, është po ai Person i pashkrim e i pakëndim që u ka bërë e u bën sfidë të gjithave ç’janë shkruar e thënë, dijetarëve dhe letrarëve më të mëdhenj, në të njëjtën kohë, gjithë njerëzimit! Sot, kur pranohet se shkencat, në një këndvështrim, kanë arritur majat, ai u thotë fizikanëve, kimistëve, astronomëve, mjekëve, sociologëve, poetëve e shkrimtarëve, të gjithë njerëzve të shkencës e të letërsisë, kështu: *“Bëhuni bashkë e sillni jo shumë, por vetëm një pjesë sa një sure e Kuranit!”* A nuk është edhe kaq, madje, një argument i mjaftueshëm se Kurani është fjalë jo e atij Personit të pamësuar, por e Allahut?

3. Gjithashtu në Kuran thuhet: *“Po qe se dyshoni në atë që i zbritëm robit tonë, ejani, silleni një sure të ngjashme me të dhe thirrni edhe dëshmitarë të tjerë tuaj veç Allahut nëse jeni të drejtë në atë që pretendoni!”* (Bekare, 23) *“A po thonë se e ka sajuar Muhamedi? Nëse e keni me të vërtetë, thirrni në ndihmë të gjithë që mund të thirrni dhe sillni një sure të ngjashme me suret e tij!”* (Junus, 38)

Në fjalën e cilit njeri s'ka mangësi, gabim dhe kundërshti? Kurse Kurani, me ajetin në vijim, vë gishtin mbi këtë të vërtetë dhe se në të nuk gjendet as kundërshtia më e vogël: *"A nuk mendojnë mbi Kuranin se, po të kishte ardhur nga dikush tjetër veç Allahut, do të gjenin në të shumë kundërshti?"* (Nisa, 82) Ndërkaq, gjërave që parashtrojnë disa njerëz që s'e njohin veten se kush janë, të cilët përpiqen, gjoja, të gjejnë në fjalën e Allahut kundërshti, mangësi e gabime, pandeh se edhe ata vetë nuk u besojnë!

4. Ndryshimi mes mënyrës së shprehjes së Kuranit dhe mënyrës së shprehjes së Profetit dallohet mjaft lehtë. Është krejt e pamundur që një njeri ta arrijë nivelin e lartë të shprehjes dhe ligjëritimit të Kuranit. Si për anët e tjera të Kuranit, edhe për shpjegimin e kësaj ane të tij janë shkruar vëllime të tëra veprash; bie fjala, vetëm për një *elhamdulil'lah* janë shkruar shumë e shumë faqe. Vendi i çdo fjale të zgjedhur dhe i çdo shkronje, numri i tyre, harmonia e tingujve dhe e melodisë së brendshme, lidhjet dhe marrëdhëniet e çdo fjale me fjalët e tjera dhe të gjithë tekstin në tërësi duke formuar një të tërë matematike, etj., janë ndër veçoritë e posaçme të tekstit të Kuranit.

5. Në periudhën kur zbriti Kurani, poezia kishte marrë një zhvillim të jashtëzakonshëm. Njerëzit e përdornin të folurit poetik pothuajse edhe në bisedat e zakonshme dhe grindjet. Çdo vit organizoheshin konkurse poetike dhe poezia fituese shkruhej mbi një copë me shkronja të arta dhe varej në muret e Qabes për të qëndruar aty gjer në konkursin e vitit të ardhshëm. Me fjalët e poetëve, të cilët konsideroheshin si heronj kombëtarë, fiset hynin në luftë ose bënë paqe. Meqë Muhamedi ish rritur mes tyre, të gjithë mekasit e dinin fort mirë se ai s'ishte marrë kurrë as me poezi, as me prozë poetike, as me ligjëratë prozaike. Ndërkaq, shprehjet enigmatike dhe mrekullore të Kuranit nuk u ngjanin as shprehjeve të tij, as të të tjerëve, ato nuk hynin as në fushën e poezisë dhe as të prozës së zakonshme dhe asaj poetike, por, me origjinalitetin e tyre të posaçëm i mrekullonin dhe i magjepsnin të gjithë! Prandaj, parësia e politeistëve të cilët kërkonin t'i largonin njerëzit nga Kurani, përpiqeshin t'i kundërviheshin, sipas tyre, me këto fjalë: *"Po të themi se është poezi, s'është, po të themi se është prozë poetike, s'është, po të themi se është fjalë orakulli, s'është; as si vepër e një të çmenduri s'ngjan; po u themi njerëzve se është magji, prandaj t'i mbyllin veshët se, ndryshe, i zë magjia!"* Por, ndërsa mblidheshin, diskutonin e vendosnin së bashku kështu, kur vinte nata, nuk rrinin dot pa shkuar fshehurazi nga njëri-tjetri për të dëgjuar Kuran! Njerëz që e donin të vërtetën, si poetët e njohur Hansa dhe Lebid, pasi u bënë myslimanë, e lanë poezinë dhe, kur u kërkohej të bënin poezi, shkruanin një sure nga Kurani dhe ua dërgonin kërkuësve duke ua theksuar këto fjalë: *"Pas këndimit të Kuranit, unë kam turp të shkruaj poezi!"*

6. Megjithëse në atë kohë poezia që zhvilluar shumë dhe pati arritur një nivel të caktuar, gjuha arabe nuk kishte një fjalor bashkëkohor ku të përmbaheshin kuptimet metafizike, konceptet dhe shprehjet shkencore, fetare dhe filozofike. Kjo gjuhë që në atë kohë shërbente vetëm për shprehur ndjenjat dhe mendimet e beduinit të shkretëtirës, jetën e tij të ngushtë, me Kuranin fitoi menjëherë një vlerë dhe pasuri të tillë dhe u ngrit në një nivel aq të lartë sa që të mund të shprehte të gjitha temat dhe çështjet shkencore, ekonomike, juridike, shoqërore, politike, administrative dhe metafizike. Në historinë e gjuhësisë është e pamundur të haset një ndodhi e tillë. Një transformim i tillë filologjik dhe një zhvillim i tillë i madh gjuhësor që do të përfshinte të gjitha kohët dhe vendet nuk mund të pritet jo më nga një person pa shkrim e pa këndim, por as dhe nga qindra gjuhëtarë e filologë. Arritja që realizoi gjuha arabe nuk ishte një zhvillim gradual, por revolucionar në kuptimin e një hopi të menjëhershëm me të cilin ajo u ngjiti në një nivel të lartë dhe të përsosur, me të cilin u ngjiti menjëherë nga fusha e logjikës primitive (naive) në nivelin që të mund të bartte mendimin dhe

shprehjen e një kulture dhe qytetërimi të ri. Ja, pra, është e qartë si dielli se një zhvillim i tillë nuk mund të jetë vepër e një njeriu!

7. A është shkruar, gjer më sot, vallë, një libër i cili t'i përshtatet njeriut të çdo shtrese, moshe e niveli, qoftë ai me shkollë fillore, universitar, mendimtar, njeri i thjeshtë, fizikan, kimist apo çoban, dhe nga i cili të kuptojë e përfitojë kushdo? Kurani është libri i vetëm që shfaqet në çdo vend gjer në fshatrat dhe skajet më të vetmuara me komunikacionin më të vështirë, që shpërndan dritë si diell, të cilin e lexojnë duke përfituar prej tij dhe te i cili gjejnë parime e zgjidhje për rrugën dhe profesionin, shërim për hallet dhe shkëlqim për idetë e tyre poeti, muzikanti, oratori, sociologu, ekonomisti, juristi, administratori, politikani, edukatori, nxënësi, anëtar i rrugës së dhikrit, meditimit dhe tarikatis.

8. Ndoshta nuk ka libër tjetër veç Kuranit që mund të lexohet disa herë pa u mërzhitur, kurse Kurani lexohet me herë të tëra, plotësohet vazhdimisht, këndohet në namaze dhe me pretekste të ndryshme pa shkaktuar kurrë ngopje, lodhje dhe mërzhitje. Sa e sa vepra të zgjedhura, shkrime ideore dhe poezi e humbin origjinalitetin dhe vlerën, sa e sa vepra aktuale durojnë a s'durojnë vetëm disa vite, madje disa muaj. Ato e humbin edhe vlefshmërinë, edhe vlerën aktuale dhe hidhen e grisen si një gazetë. Kurse Kurani jo vetëm që nuk zbehet e vjetrohet as si fjalë, as si lexim, as si përmbajtje e kuptim, as si origjinalitet e aktualitet dhe as si drejtësi e vlefshmëri, por çdo ditë që kalon, shpirtrave, ndërgjegjeve, mendjeve dhe zemrave u fryn frymëzime të reja, u ofron ide dhe njohuri të një niveli më të përparuar dhe e ruan rininë e freskinë duke u bërë çdo ditë më i ri e më i freskët!

9. Edhe me aspektin që e trajton njeriun me të gjitha anët e tij materialo-shpirtërore, që hap diskutime mbi çdo fushë dhe faqe të jetës, që sjell parime zgjidhëse për të gjitha problemet shoqërore, ekonomike, juridike, politike e administrative dhe që vendos parime që përmbajnë, pranë lumturisë së kësaj bote, edhe lumturinë e botës tjetër, pranë kënaqjes së mendjes, edhe kënaqjen e shpirtit, është krejt e qartë se Kurani nuk mund të jetë fjalë njeriu. Sigurisht, është e pamundur që një njeri të jetë specialist dhe prijës në çdo fushë. Parashtrimi i parimeve që do të zgjidhnin vështirësitë e njeriut të çdo shekulli, nën të gjitha kushtet dhe të çdo niveli nuk mund të përfshihet kurrë brenda mundësive dhe kapaciteteve të një njeriu. Parimet e dala nga mendja e asnjë njeriu nuk mund t'u japin kënaqësi e lumturi kontinenteve për shekuj të tërë. Sistemet njerëzore që nuk mbështeten në librin hyjnor e që nuk i referohen revelacionit hyjnor, nuk mund të qëndrojnë në këmbë as pesëdhjetë vjet pa u ndryshuar e revizionuar. Rregullat, sistemet, idetë, mendimet dhe ideologjitë si produkte njerëzore, vjetrohen, mbeten të pamjaftueshme, shfaqin ndikime anësore dhe rinojnë, madje tregojnë nevojë ndryshimi e ndërrimi. Kurse është e pamundur të gjenden të meta dhe aksidente të tilla në asnjë temë të Kuranit, në asnjë rregull dhe parim dhe në asnjë çështje të tij. A nuk janë argumente të qarta të faktit që Kurani është fjalë e Krijuesit të urtë e mëshirues, rregullat dhe parimet themelore e të pavdekshme, sipas të cilave "kapitali ndalohet të kthehet në një forcë që qarkullon vetëm në duar të të pasurve" (Hashr, 9), "njeriu do të marrë si shpërblim vetëm atë për të cilën ka punuar dhe është përpjekur" (Nexhm, 39), "detyrat dhe përgjegjësitë duhet t'u jepen vetëm atyre që janë kompetentë dhe e meritojnë dhe se duhet gjykuar me drejtësi" (Nisa, 58), "vrasja e një njeriu është si vrasja e gjithë njerëzimit" (Maide, 32), veçanërisht ndalimi i kamatës, bixhozit, pijeve alkoolike, të gjitha llojeve të prostitucionit, gënjeshtërs, shpifjes, luksit dhe mbishpenzimit që konsiderohen vrasës për individin, familjen dhe shoqërinë, adhurimet si namazi, agjërimi, haxhi, zekati, etj., të urdhëruara që njeriu të fitojë cilësi

njerëzore dhe që, në jetën individuale dhe shoqërore të jetojë parajsën duke qenë ende në këtë botë, orientimi i rregullave morale më të mira e më të bukura, i mendjeve dhe zemrave drejt parajsës dhe botës së amshuar për të vendosur në çdo zemër frikën ndaj Allahut e, në anën tjetër, për të nxitur dashurinë ndaj Tij, kriteret, rregullat dhe parimet ideale të vendosura për lumturinë e individit dhe shoqërisë?

Vepër e kujt të jenë njeriu dhe gjithësia, edhe Kurani fjalë e tij është. Sepse Kurani e korrigjon njeriun me njeriun dhe e interpreton librin e gjithësisë. Kurani, e lexon, nga njëra anë, njeriun me të gjitha dobësitë dhe virtytet dhe, nga ana tjetër, edhe gjithësinë me të gjitha të fshehtat dhe imtësitë, kështu që është e pamundur që Kurani të jetë fjalë e një personi që s'e administron dhe që s'vëpron mbi tërë gjithësinë!

10. Në veprën e vet, njeriu nuk mund të tregojë për veten e vet duke folur për të gjitha anët e veta, nuk mund t'i hedhë në shkrim idealet dhe mendimet, karakterin dhe moralin e vet në tërë lakuriqësinë e tyre pa mbajtur fshehur asgjë. Edhe sikur ta mendojmë për një çast se mund ta bëjë këtë, në këtë rast nuk do ta kishte të lehtë të mos ndryshonte në ide, moral e sjellje. Mirëpo, le të shohim Kuranin, le të shohim edhe jetën, moralin dhe karakterin e Profetit si dhe mendimin e tij mbi kauzën që përfaqësonte. Dhe nuk do të vëmë re vetëm se kjo dyshe përputhet identikisht me njëri-tjetrin, se të vërtetat kuranore kristalizohen në personalitetin e tij të zgjedhur dhe jetën e tij shembullore, por edhe se gjatë 23 vjetëve me radhë, në fjalët, sjelljet, karakterin, moralin dhe idealet e tij nuk pati ndodhur edhe ndryshimi më i vogël, se çdo shprehje e Kuranit pati gjetur me të gjithë kuptimin e fjalës reflektim dhe zbatim në jetën e tij, dhe se ç'pati thënë ai ditën e parë, po atë pati thënë edhe ditën e fundit! Po qe se, ta supozojmë, duke i kërkuar falje për këtë supozim, se ai do të ishte dikush që do ta kishte sajuar Kuranin nga mendja e vet, kurrë nuk do të kish shfaqur dot aftësinë dhe kapacitetin që, në jetën e tij aktive të kaluar me luftëra e përpjekje, të mund ta përsëriste fjalën e fillimit edhe në ditën e fundit, të mund ta rregullonte çdo fjalë e veprim sipas atyre që kishte shkruar dhe të mbetej gjer në fund po ai, pa bërë asnjë ndryshim! Në është kështu, Hz. Muhamedi (s.a.s) është një profet që vepron nën mbështetjen dhe edukimin e Allahut, është kryeprofeti. Dhe Kurani është një libër hyjnor i dërguar atij nga Allahu!

11. Një autor cilido, në veprën e vet, përgjithësisht mbetet në ndikimin e kushteve dhe të mjedisit ku jeton si dhe të ngjarjeve të jetuara pa mundur të dalë jashtë një kuadri kohor të ngushtë. Edhe nëse del, kjo ndodh duke nxjerrë nga duart një vepër ose utopike, ose antiutopike, ose fantastiko-shkencore. Kurse kur shohim nga Kurani, vëmë re se ai përdor shprehje kategorike mbi fillimin dhe fundin e gjithësisë, mbi krijimin e njeriut dhe jetën e tij të ardhshme dhe, duam apo s'duam, mbetemi të detyruar të themi se *"kjo s'mund të jetë fjalë njeriu"*!

12. Një autor jep më shumë vepra në fushën e vet. Veçanërisht sot kur specialitetet janë shtuar dhe ngushtuar tejet, secili është njeriu i fushës së vet tejet të ngushtë. Kurse Kurani parashtron parime në sociologji, ekonomi, drejtësi juridike, psikologji, politikë, ushtri, mjekësi, fizikë, biologji, shkurt në çdo fushë, flet për të vërtetat themelore të asaj fushe dhe diskuton për të shkuarën e për të ardhmen. Cila mendje e pranon se një libër të tillë e ka shkruar një person pa shkrim e këndim e pa asnjërin prej mundësive të sotme teknike e shkencore?

Kurani vetë i drejtohet Profetit, duke deklaruar se ai s'dinte shkrim e këndim, me këto fjalë: *"Para kësaj, ti as ke lexuar ndonjë libër, as ke shkruar me dorën tënde. Po të qe kështu, të këqijtë do të ndjenin dyshim!"* (Ankebut, 48) Gjithashtu: *"Ti (më parë) s'dije ç'është libri, ç'është besimi!"* (Shura, 52) Edhe politeistët që e njihnin për së afërmi Profetin i cili ishte rritur mes tyre, qoftë edhe një herë

të vetme nuk pretenduan se ai dinte shkrim e këndim dhe se, duke u mbështetur në këtë, e kishte sajuar Kuranin!

13. Cili autor mund të pretendojë se veprës së tij nuk do t'i bëhet asnjë kritikë, se të vërtetat që përmban vepra e tij do t'u rezistojnë shekujve pa u vjetruar aspak dhe se mbi to, pas veprës së tij, nuk do të shkruhet më asnjë vepër në asnjë fushë? Edhe po të jetë ky autor filozof, shkencëtar, shkrimtar apo një gjeni, përfundimi nuk ndryshon. Çdo vepër e dalë nga pena e njeriut nuk shpëton dot, siç nuk kanë shpëtuar dot as Dhiata dhe Ungjilli me format dhe aspektet e tyre të korrigjuara, nga veprimi gërryes e kohës, për pasojë, nga humbja e vlerave. Është vetëm Kurani që, pavarësisht nga çdo lloj përpjekje kundër tij, pavarësisht nga shpifjet, nga përpjekjet për të gjetur në të gabime e kundërshti, pavarësisht nga preokupimi me përsëritjet, shprehjet dhe shkrimin e tij dhe pavarësisht nga fyerjet e herëpashershme ndaj të vërtetave që përmban, është tek hyn ndër mendje e zemra çdo ditë e më i freskët, çdo ditë e më i thellë e çdo ditë e më i kuptueshëm dhe e është tek e vazhdon zotërimin e tij absolut. Është vetëm e vetëm i zoti i gjithësisë, Allahu, që e ka ndezur atë dritë që ndriçon çdo ditë e më shumë në gjithësi, dhe sigurisht që askush s'do të ketë fuqi për ta shuar atë!

14. Jeni një esnaf, një mësues, një tregtar, një oficer. A mund të shkruani një libër, të flisni, të nxirrni ligj apo vendim në emër të themeluesve të esnafëve, në emër të të gjithë mësuesve e pedagogëve të të gjitha fushave e niveleve, në emër të industrialistit apo të importuesit dhe eksportuesit më të madh, në emër të presidentit, kryeministrit apo shefit të shtabit të përgjithshëm? Le ta pranojmë se thatë "po". Në këto kushte, a është e mundur që të gjitha shprehjet tuaja të jenë të vetë personit që pretendoni se e përfaqësoni? Pra, a mund të bëni që shprehjet e përdorura prej jush të jenë nga çdo aspekt të tij, që urdhrat, ndalimet, premtimet, të tij? A mund ta bëni këtë gjë? Sidomos, a mund ta bëni këtë gjë i njohur nga gjithë mjedisi juaj si njeri që s'ka gënjyer kurrë? Ajo ç'ka mund të bëni ju kur ta keni në dorë një libër të tillë, t'u thoni masave: "*Ky është një libër që më është dërguar nga ai Person për t'jua mësuar dhe vënë në jetë juve*"!

Dhe tani shihni deklaratat e nderuara të Profetit dhe shprehjet e Kuranit: A mund të mendohet që shprehjet që i kanë hije vetëm Individualitetit që mban në dorë administrimin e gjithësisë, t'i shprehë dhe thotë, t'i sajojë një njeri, qoftë ai edhe profet?

15. Askush me mend në kokë nuk mund të përdorë në emër të Allahut shprehjet që kanë të bëjnë me *krijimin, me dhënien e jetës dhe të vdekjes*, akte, këto, që i përkasin Pozitës Hyjnore, nuk mund të flasë kurrë mbi krijimin e qiejve, tokës, yjeve, maleve, pemëve, kafshëve dhe njerëzve, si dhe mbi *jetën* e cila ende qëndron si një enigmë më vete para shkencëtarëve. Edhe nëse flet, nuk mund të mbledhë asnjë përkrahës dhe fjalët kurrë nuk mund t'i kenë jetë të gjatë. Gjendja e profetëve të rremë dhe e shkencëtarëve që prodhojnë teori pas teorie është një shembull krejt e qartë i kësaj.

16. Disa forma të drejtimit në vetë të dytë tregojnë se Allahu i është drejtuar disa herë Profetit për ta njoftuar për diçka. Forma "*thua*" përsëritet në Kuran 332 herë. As prijësi më i madh me përmasa botërore nuk mund të përdorë në komunikim dhe orientim këto forma komunikimi me karakter dekretues që janë të posaçme vetëm për Allahun.

Në këto lloj drejtime në vetën e dytë të Kuranit ka shpesh mësim, këshillë dhe ngushëllim, ka përgjigje për pyetjet e ardhura nga jashtë, ka formim të rregullave juridike dhe zgjidhje të vështirësive që sjell jeta, ka, për politeistët dhe ndjekësit e librit, diku ftesë e, diku, hedhje poshtë të

pretendimeve të tyre dhe mbyllje goje, ka parashtrime mbi natyrën, ndjenjat dhe aftësitë e njeriut dhe analizë të strukturës së shpirtit të tij, ka aludime për botë të panjohura, paralajmërime për botën e përjetshme, pengim ndaj moralit të keq dhe nxitje ndaj moralit të mirë, ka çështje lidhur me botën femërore, nxitje për adhurim dhe frikësim me ndëshkim, ka deklarata, aludime dhe simbole mbi të ardhmen dhe aludime për të vërteta shkencore. Cili njeri mund të ketë guximin të flasë në emër të Allahut duke i mbledhur këto çështje e të ngjashme nën urdhrin “*thuaj*”?

17. Cili autor e kërcënon veten në veprën e vet qoftë edhe në emër të dikujt tjetër ose me gojën e dikujt tjetër? Për më tepër, ndërsa pretendon se flet në emër të Allahut, a mund të bëjë ndonjë deklaratë që do t’i sillte dëm pretendimit të vet? Gjithashtu, a fut në librin e vet shprehje akuzuese ndaj vetes? Kurse në Kuran thuhet: “*Po qe se (Muhamedi) do të shtonte fjalë kundër Nesh, do ta mbërthenim me forcë e do t’ia këpusnim damarin e qafës!*” (Hakka, 44-46). Në Kuran, Profetit i tërhiqet vërejtja për mospjesëmarrësit e fushatës së Tebukut: “*Pse u dhe leje atyre?*” Në Kuran tregohet për martesën me Zejnebin, etj. Pra, në Kuran ka deklarata dhe shprehje që është e pamundur që njeriu t’i fusë në librin që e ka shkruar vetë. Kjo do të thotë se Kurani kurrë s’mund të jetë fjalë e Profetit; ai është absolutisht fjalë e Allahut!

18. A mund të ndodhë që një autor, në veprën e vet ku bën për objekt çështje të së shkuarës e të së ardhmes, ku flet për fillimin dhe mbarimin, ku vë rregulla dhe parime të përgjithshme mbi çdo fushë të jetës, ku vë gishtin mbi zbulime shkencore e teknike të qindra viteve më vonë, ku shprehet dhe deklaron në një mënyrë që, në fakt, duket e pamundur për një njeri, a mund të ndodhë, pra, që ky autor të thotë për vete, “*ti s’ke lexuar e s’ke shkruar*”, gjë që do ta vinte në kontradiktë me vetveten dhe do ta bënte ta merrnin nëpër gojë të tjerët? Do të flisni me shprehje shumë të prera mbi disa ngjarje të së kaluarës para një shoqërie që ka njohuri historike dhe para një të ardhmeje kur do të bëhen kërkime zbuluese dhe pastaj do të thoni: “*Unë po i tregoj këto, por as mora pjesë në ato ngjarje, as lexova gjë mbi to!*” A është e mundur një gjë e tillë? Mirëpo në Kuran tregohet edhe se Profeti s’ka ditur shkrim e këndim, për pasojë, gjer atëherë as ka lexuar, as ka shkruar ndonjë libër (Ankebut, 48), edhe se as ka marrë pjesë në ato ngjarje, as ka ditur gjë mbi to gjer atëherë (Al Imran, 44; Hud, 49; Kasas, 44). Nëse një njeri që s’ka ditur të shkruajë e të lexojë, që s’ka prekur libër me dorë, që, natyrisht, s’ka marrë pjesë në ngjarjet e së shkuarës, që s’ka dëgjuar dhe mësuar gjë nga të tjerët, nëse një njeri i tillë, pra, jep të dhëna shumë të prera në çdo fushë, a nuk tregon kjo se ai person është i dërguari dhe përfaqësuesi i Allahut, njohësit të së fshehtës?

19. Asnjë autor nuk mund të thotë me një gjuhë të prerë në veprën e vet se vepra e tij do të ruhet dhe se të vërtetat mbi të cilat bën fjalë, do të vijë një ditë që të përhapen në të gjitha horizontet. Edhe duke qenë në vazhdim të një jete në shtretër të rehatshëm, me makina dhe me të gjitha mundësitë, a mund të themi se do të mbetemi të paprekshëm dhe të mbrojtur nga të gjitha rreziqet dhe do ta plotësojmë detyrën tonë? Sigurisht që jo, sepse ashtu siç nuk mund të japim garanci për jetën tonë, ashtu dhe s’mund të garantojmë se vepra jonë do të ketë jetë pak a shumë të gjatë. Shumë shkrime e artikuj, libra, këngë dalin, për një çast, “në krye të listës”, bëhen rend dite, pastaj shuhën e harrohen sepse në vend të tyre dalin të tjera, të reja të cilat, edhe ato, pastaj, zbehen, shuhën e shkojnë për t’ua lënë vendin të tjerave dhe kjo kështu vazhdon gjithmonë. Mirëpo në Kuran thuhet: “*Allahu do të të mbrojë ty nga njerëzit!*” (Maide, 67) Dhe: “*Kuranin Ne e zbritëm dhe Ne jemi garant për të!*” (Hixhr, 9) Me këto fjalë shpallet se edhe Profeti, edhe Kurani janë të mbrojtur dhe garantuar nga çdo lloj rreziku, dëmtimi, atentati dhe nga çdo sulm dhe kurth

materialo-shpirtëror. Kjo mbrojtje dhe garanci është vërtetuar gjer më sot dhe do të vazhdojë të vërtetohet gjer në kiamet!

20. Një autor që në veprën e vet bën përshkrim natyre, na njeh kryesisht me mjedisin që njeh e që e ka shëtitur, me format natyrore, klimën, formën e tokës dhe mbulesën bimore të tij. Kurse në Kuran, më shumë se përshkrimi i jetës së shkretëtirës, shohim të flitet për lumenj që rrjedhin me vrull, për pamje të gjelbëruara, për re të ngarkuara me shi që i japin jetë tokës, për kopshte e vreshta, për male e dete. Bie fjala, në ajetin e 40 të sures Nur bëhen përshkrime dhe metaforizime me të vërtetë interesante, si errësirat e thella të detit, ardhja e njëpasnjëshme e dallgëve, mbulimi nga sipër i dallgëve prej reve dhe mosdukja e dorës brenda gjithë këtyre errësirave, gjë që s'ka lidhje as me gjeografinë arabe të asaj kohe, as me literaturën detare të periudhës. Pastaj, Profeti i cili qe lindur e rritur në shkretëtirë dhe pati udhëtuar vetëm një a dy herë për në Siri duke kaluar përmes shkretëtirës, as pati parë pamjet dhe mbulesat bimore për të cilat bën fjalë Kurani, as pati bërë udhëtim detar. Në këto kushte, si mund të kenë buruar përshkrime dhe metafora të tilla nga përfytyrimi dhe gjenialiteti i një njeriu të rritur në shkretëtirë?

Në ajetin e 125-të të sures En'am, gjendja e mohuesit përngjasohet me gjendjen e njeriut që i ndrydhet zemra duke u ngjitur lart drejt qiellit. Përshkrimi i njeriut me gojë hapur që mezi mbushet me frymë, bëhet me mjete të caktuara gramatikore (fonetike) të arabishtes që krijojnë të njëjtat vështirësi artikulimi e shqiptimi. Kur erdhi koha, zhvillimet shkencore treguan se, me ngjitjen në lartësi, oksigjeni rrallohet, shtypja atmosferike bie dhe njeriut i vështirësohet frymëmarrja dhe se, ngjitja e mëtejshme pa mjete oksigjeni pas një caku të caktuar, bëhet e pamundur. Kjo e vërtetë kuptohet në ngjitjet me balona në qiell ose në ngjitjet alpinistike në male të larta. Në kohën e Profetit, për mjete dhe mundësi ose përvoja të tilla as që mund të bëhej fjalë sepse, veç të tjerash, gjeografia e Gadishullit Arabik s'kishte male të larta. Kështu që, shprehje, përshkrime, metaforizime e përngjasime të tilla mund t'i përkasin vetëm Allahut që di çdo gjë!

21. Autori e shkruan veprën më shumë në çastet e ndjeshmërisë dhe përqendrimit më të madh dhe pa i anashkaluar ngjarjet që i kanë shkaktuar dëshpërim apo gëzim. Veprat letrare më të bukura janë shkruar në kohët kur zemrat janë mbushur me ndjenjat më të holla e më të mprehta dhe kur janë zhvilluar ngjarjet kur i kanë hapur rrugë kësaj gjendjeje ndjesore. Shumica e veprave letrare flasin për të dashurit dhe miqtë ose për bijtë. Vuajtjet e hequra në qeli, kujtimet e kurbetit apo emigracionit, përvojat e jetës profesionale dhe çastet e hidhura e të ëmbla të saj janë temat e zgjedhura të tyre. Nuk është aq e lehtë të veçohesh nga ngjarjet që ushtrojnë ndikime të thella në zemra e shpirtra.

Tani shqyrtojeni jetën e Profetit të mbushur plot me vuajtje, ankthe, luftëra e përpjekje, shqetësime e dëshpërime, mbani parasysh se si e përgatiti atë bashkësinë e tij të zgjedhur ndërsa bënte një luftë të rëndë ndaj faktorëve të jashtëm dhe shihni, a do të mund të gjeni në Kuran ajete lidhur me vuajtjet e tij, me kohët e kokëçarjeve e fatkeqësive, madje, me jetën dhe vdekjen e fëmijëve të vet? A janë hapur në to diskutime mbi Hatixhen e cila pati ndarë me të hidhërimet e ditëve më të vështira dhe qe bërë mbështetësja e tij më e madhe, mbi vitin e quajtur "viti i zymtë" për shkak të vdekjes së saj e të mbështetësit tjetër të madh të tij, Ebu Talib? A janë hapur në to diskutime mbi bojkotimin trevjeçar të ushtruar mbi hashimitë nën diellin përvëlues, mbi vrasjen e të ungjit Hamza dhe mbi politeistët kriminelë që e patën përdhunuar kufomën e tij? Sigurisht që jo! Sepse ky libër s'është i tiji. Ai është vetëm një ndërmjetës që e ka përcjellë Kuranin te njerëzit ashtu siç i ka ardhur!

22. Duke e shkruar veprën e tij, autori gjithsesi mendon përfitimet që do të ketë prej saj: pasuri, post, popullaritet ose kumtim dhe lartësim i idealit të vet ose shërbim ndaj gjërave të shenjta ose mendimeve negative të veta. Ndërkaq, a mund të themi se, “duke e shkruar veprën e vet”, Profeti bartte qëllimin për t’u pasuruar? Kur të hidhni një vështrim mbi jetën e tij 23-vjeçare, do të vëreni se ai kurrë nuk preku në dheun dhe pluhurin e kësaj bote, se e la faljen në mes për të shkuar në shtëpi për të shpërndarë katër-pesë monedha, se pati kohë kur pati mbetur pa ngrënë tri ditë me radhë, se, kur i patën kërkuar gratë që të bënin një jetë disi më të mirë pas përmirësimit të përgjithshëm të jetës së myslimanëve, ai i pati vënë para alternativës për të zgjedhur ose atë vetë, ose botën materiale dhe se, ndërsa në luftën e Hunejnit, pasi gratë kishin zgjedhur atë vetë, ai shtiu në dorë në emër të shtetit si plaçkë lufte 8 mijë okë argjend dhe me qindra deve e mijëra dhen, personalisht nuk ishte në gjendje të merrte prapë mburojën që e pati lënë peng për të blerë ushqime për shtëpi! Pas gjithë këtyre, a mund të thoni se qëllimi i tij ka qenë pozita, posti, fama dhe popullariteti? Në asnjë mënyrë! Ishte ende fillimi i detyrës profetike në Mekë kur atij iu propozuan kryesia e Mekës, pasuri që s’i kishte kush dhe vajza më e bukur e Mekës me kusht që të hiqte dorë nga kumtesa profetike, kurse ai i pati hedhur poshtë të gjitha propozimet duke thënë: *“Edhe sikur të m’i vënë diellin mbi pëllëmbën e djathtë dhe hënën mbi të majtën, unë s’heq dorë nga çështja ime!”* Pastaj, njeriu që vrapon pas popullaritetit, a s’bën fjalë fare në veprën e vet për vete? Kurse, po ta vëmë re me kujdes, do të dallojmë se në Kuran, ndërsa emrat e profetëve të tjerë përmenden rreth 500 herë, emri *Muhamed* përmendet vetëm në katër vende (Al Imran, 144; Ahzab, 40; Muhamed, 2; Fet’h, 29) dhe para atij personalitetit të madh përkulemi me nderim të thellë duke thënë edhe një herë tjetër: *“Eshhedu enneke Resulullah”, “Dëshmoj se ti je i dërguari i Allahut!”*

23. Fusha e shkencës teologjike që merret me shkaqet e zbritjes (revelacionit) së Kuranit, trajton shkaqet dhe kushtet e zbritjes së çdo ajeti me radhë. Në Kuran, në gjer pesëmbëdhjetë vende, Profetit i thuhet “të pyesin ty për ...” dhe i jepen përgjigje që fillojnë me urdhrin “thuj”. Është krejt e qartë se është Allahu që u jep përgjigje pyetjeve për çështje të tilla si haramet dhe hallallet e ndryshme, ndarja e plaçkës së luftës, hëna e re, kiameti, Dhulkarnejni, forma e dhurimit, shpirti, etj., që një njeri e ka krejt të pamundur t’u japë përgjigje të specializuara veç e veç. Sepse dhënia e përgjigjes më të përshtatshme për çdo pyetje dhe dërgimi i një ajeti të lidhur me një ngjarje, i cili të përmbajë zgjidhjen më të mundshme e të përshtatshme, kurrë nuk mund të jetë brenda mundësive të një njeriu. Ndërkaq, ndodhte edhe që në rastin e pyetjeve të tilla, Profeti heshte sepse priste ajetin që do të zbriste si përgjigje. Kështu pati ndodhur, për shembull, kur e patën pyetur për shpirtin.

24. A mund të ndodhë që një njeri, një autor të trondisë e të vërë në dyshim besimin e krijuar ndaj tij duke thënë “gabim” për një gjë që e ka quajtur më parë të drejtë ose, duke ndryshuar, kohë pas kohe, pikëpamje, të bëjë rregullime të sjelljeve të veta, sidomos nëse ky ka dalë me pretendimin se po i ofron gjithë botës një mesazh? Kurse Muhamedi i dërguar si “mëshirë” jo vetëm për mekasit apo medinasit, jo vetëm për popullsinë e Gadishullit Arabik apo për njerëzimin e kësaj bote, por për tërë botën, herë pas here, me tërheqjen e butë të vëmendjes që i bënte Kurani, i ndryshonte veprimet që kishte planifikuar ose kishte për qëllim të bënte dhe i orientonte sjelljet e veta sipas Kuranit.

Profeti ishte dërguar për orientimin e njerëzve në rrugën e drejtë. Kështu që ishte mjaft normale që ai të dëshironte orientimin edhe të të ungjit Ebu Talib, i cili ishte edhe i ungji, edhe personi që e kishte mbajtur nën kujdesin dhe mbrojtjen e vet për 40 vjet me radhë. Vetëm se thelbësore ishte që këtë gjë ta dëshironte Allahu! Ja, pra, i Dërguari i Allahut i thoshte me këmbëngulje të ungjit në

prag të vdekjes që të thoshte *la ilahe il'lallah, nuk ka zot tjetër veç Allahut* se do të ndërhynte për të për falje në jetën tjetër, kurse Ebu Talibi nuk pranonte. Dhe ajeti që bënte analizën e kësaj çështjeje, duke iu drejtuar Profetit, theksonte *“Ti nuk mund ta vësh në rrugë të drejtë atë që do. Vetëm Allahu e vë në rrugë të drejtë atë që do!”* (Kasas, 56).

Shihni shembuj të tjerë. Profeti do të qëndronte për t'ia falur namazin e të vdekurit kreut të hipokritëve, Ibni Thelulit, meqë e njihte për mysliman, por e la sepse e paralajmëroi Allahu. (Teube, 84) Profeti i thoshte “bir” librit të vet, Zejd, por Allahu, me anë të një ajeti, e hoqi birësimin. (Ahzab, 4) Megjithëse nuk e kishte shkuar kurrë nëpërmend, me urdhër të Allahut u martua me Zejnebin, gruan e ndarë nga liberti i vet Zejd. (Ahzab, 37). Mendohej që robërit e Bedrit të faleshin e të lëshoheshin. Pas paralajmërimit të Allahut, ata u lanë të lirë kundrejt shpërblimit. Të gjitha këto dhe urdhra apo ndalime të ngjashme tregojnë se ai kurrë nuk vepronte në kokë të vet, se ai ishte një përfaqësues që vetëm zbatonte urdhrat e Allahut. Edhe sjelljet nuk i ndryshonte sipas vetes, por pas paralajmërimit ose tërheqjes së vëmendjes së Allahut dhe *“asnjë herë nuk fliste sipas dëshirës, por vetëm sipas vahjit, zbulesës hyjnore!”* (Nexhm, 4)

25. Asnjë njeri s'dëshiron ta njollosë nderin e vet dhe të përflitet në këtë drejtim. Sidomos nëse ky njeri është një monument nderi dhe virtyti i njohur gjatë gjithë jetës si emin, i besueshëm! Ndërsa e vërteta qëndron kështu, bëhemi dëshmitarë të ngjarjes së shpifjes ndaj nderit të bashkëshortes së tij të shquar, Aishes, për shkak të së cilës ai vuajti për një muaj me radhë së bashku me të, me të atin e saj dhe mikun e tij më të madh, Ebu Bekrin dhe të gjithë myslimanët gjersa doli e vërteta në shesh. Po qe se do ta kishte shkruar Kuranin vetë, a do të priste një muaj me radhë për të shpallur pafajësinë e saj, për të mbrojtur nderin e vet dhe për të shpallur se mbi nderin e vet nuk ka asnjë njollë? Veç kësaj, a ka njeri që dëshiron t'i popullarizojë disa gjëra që kanë të bëjnë me shtëpinë dhe familjen e vet? Kurse Kurani përmban vërejtje e urdhra lidhur me gratë e tij, si “rrini në shtëpi dhe mos u hapni siç hapeshin gratë e kohës së injorancës” (Ahzab, 33) dhe “mos bisedoni me fjalë tërheqëse (përkëdhelëse)” (Ahzab, 32). A s'mjafton vetëm kjo, madje, për të vërtetuar se Kurani është fjalë hyjnore?

II. KURANI DHE TË VËRTETAT SHKENCORE

Ndërsa shkenca i konsideron “shkencore” çështjet që fitojnë vlerë kategorike pas provave dhe eksperimenteve, çështjet që s’kanë mundur të fitojnë vlerë kategorike, i sheh vetëm si teori ose hipoteza.

A. Ç’ka në Kuran, sa ka dhe në ç’përpjestime ndodhet?

1. Në Kuran i cili, si një libër që tregon për gjithësinë dhe njeriun, shprehet për gjithçka, nuk është lënë mangët asgjë (En’am, 59), çdo gjë e njomë dhe e thatë është përfshirë në përmbajtjen e tij. Ndërsa ibni Mes’udi thotë se *“edhe nëse në Kuran është zbritur dije për çdo gjë dhe është shprehur çdo gjë, dija jonë nuk mjafton për ta kuptuar çdo gjë në të”*, Ibni Abasi thotë se *“po t’i humbë litari i devesë, gjithsesi e gjej në librin e Allahut”*, kurse Sujutiu pohon se në Kuran zënë vend të gjitha dijet. (el-Itkan).

Meqë është libri i Islamit, fesë së përsosur, të realizuar si e tillë me Profetin e Fundit dhe, për rrjedhojë, meqë është universal, Kurani u përket të gjitha kohërave dhe hapësirave. Ai u jep mësim të gjithëve, njerëzve të çdo shekulli, shtrese e niveli, nga komentuesi i Kuranit, te juristi, nga sociologu, te psikologu, nga mistiku, te filozofi, nga fizikani, kimisti, etj. Njeriu që e lexon Kurandin duke e kërkuar veten në të, thotë: *“Kurani më drejtohet mua, ai më tregon mua për mua!”* Pa le sikur të mund ta lexojë duke e zbritur poshtë grykës, mu atëherë do t’i zbulojë në të të gjitha ç’i kanë rënë e kanë për t’i rënë në kokë, zigzagët në jetë, të gjitha situatat e errëta e të ndriçuara dhe sëmundjet dhe, përsëri, në farmacinë e tij mundet t’i marrë ilaçet shëruese për lëngatat shpirtërore dhe sëmundjet trupore. Në Kuran ndodhen edukimi i vetvetes, pastrimi i zemrës dhe shpirtit, llogaridhënia e ndërgjegjes, administrimi i familjes, edukimi i fëmijëve, marrëdhëniet shoqërore, rregullat e sjelljes e të edukatës, çështjet morale, e drejta juridike, ekonomia, aktet, ligjet që veprojnë në gjithësi, parimet e shkencave teorike e të natyrës, indeksi i mrekullive të qytetërimeve dhe sa e sa gjëra të tjera!

2. Në Kuran ka çdo gjë sipas përbërjes, rëndësisë dhe vlerës së saj.

a) Po, në Kuran ka çdo gjë, por sipas madhësisë, madhësisë, rëndësisë, përbërjes dhe vlerës. Cila është çështja më e rëndësishme? Besimi në një Zot të vetëm (teuhid), profetësia, ringjallja dhe grumbullimi pas vdekjes, adhurimi, fitimi i lumturisë së përjetshme, ruajtja nga ndëshkimi hyjnor, etj. Veç këtyre, veprimtaria e Allahut në gjithësi, ekspozimi i arteve të Tij, shfaqjet e attributeve dhe emrave të Tij, shprehja e këtyre nga sistemet dhe planetet përmes një rregullsie dhe harmonie të shkëlqyer. Të gjitha këto janë treguar krejt hapur gjer në imtësitë e tyre. Veçanërisht edhe zhvillimet shkencore dhe gjetjet teknike që do të dalin në shesh në periudha të caktuara kanë marrë vendin e tyre në Kuran sipas rëndësisë dhe vlerës që kanë si dhe, në mos hapur, ose në mënyrë analogjike, ose simbolike. Po pse jo hapur? Sepse, për shembull, po qe se gjëra që i sheh shumë të rëndësishme njeriu, si rryma elektrike, avionët, raketat, etj., pyesin se *“pse nuk përmenden hapur në Kuran”*, u dalin para menjëherë dielli, hëna dhe yjet, galaktikat dhe kuasarët dhe ua mbyllin gojën duke u thënë: *“Njiheni veten se kush jeni, se një krah mize, madje, është shumë më i rëndësishëm, shumë më*

artistik e shumë më i mrekullueshëm se ju! Pra, mos e ngatërmoni vendin tuaj në protokoll, se ju mund të zini vend në Kuran vetëm sa ta keni hapin!”

b) Në Kuran ka çdo gjë, por ka në gjendje parimesh shoqërore dhe ligjesh shoqërore e kozmike në nivele të ndryshme dhe identitete të ndryshme. Dhe shumë gjëra ndodhen në gjendje embrionesh, farash e bërthamash që u takojnë punës e përpjekjeve të njerëzve.

Në një hadith profetik të rrëfyer nga Dejlamiu, Profeti thotë: *“Pa diskutim, çdo ajet ka anën e jashtme, anën e brendshme, një cak dhe kuptim; veç këtyre, secili nga këta elementë ka degë dhe sythe!”*

c) Në Kuran ka çdo gjë, por çdo njeri nuk mundet ta shohë çdo gjë siç ndodhet në Kuran. Siç e thekson Gazaliu në veprën e tij, “Ihja”, kuptimet e hapura e të jashtme të Kuranit mund t’i kuptojë si shtresa e lartë, ashtu dhe populli i thjeshtë, kurse kuptimet e brendshme e të fshehta janë të posaçme për njerëzit e dijes që meditojnë dhe hulumtojnë çdo gjë me imtësi. Zhytësit e cilësuar nga Kurani si *“ata që lëshojnë rrënjë e thellohen në dituri”* (Al Imran, 7), zhyten në oqeanin kuranor dhe nxjerrin prej tij perla e margaritarë. Mirëpo çdokush nuk mund të zhytet në atë oqean, nuk mundet t’i shohë dhe vlerësojë perlat në të. Një sendi antik, në tregun e hekurishteve, i japin vlerë sa ç’peshon, kurse po ai send antik, pranë antikuarit ka vlerë të pallogaritshme! Kjo do të thotë se në Kuran ka shumë gjëra, por në gjendje shenjash, mbresash, treguesish dhe fijesh orientuese që mund t’i kuptojnë vetëm njerëzit kompetentë me përpjekje, meditim dhe frymëzim!

d) Në Kuran ka çdo gjë, por jo si qëllim dhe synim në vetvete, por në emër të aftësisë dhe madhësisë së Zotit. Ashtu siç shkronja “a” që, më tepër se veten, tregon artin dhe kapacitetin e atij që e ka shkruar, ashtu dhe ajetet e Kuranit ekzistojnë që të bëhen nga një premisë dhe argument për ta njohur dhe gjetur Zotin, për të marrë mësim me anë të meditimit dhe gjykimit të gjithanshëm mbi to, sepse detyra esenciale dhe më e parë e Kuranit është t’ia bëjë të njohur njeriut edhe veten e tij, edhe të Zotin e gjithësisë, t’ia mësojë detyrat e kuadrit të adhurimit, t’ia rregullojë jetën individuale, familjare e shoqërore, të bëhet pretekst që ai të fitojë lumturinë e përjetshme duke përfshirë në këtë funksion tërë jetën dhe njerëzimin. Po që se s’do të kishte ndodhur kështu, por Kurani do të kishte bërë fjalë hapur dhe me hollësi mbi disa mrekulli qytetërimi të kthyer në tabu të shek. XX dhe mbi zhvillimet shkencore, atëherë do të ishte eliminuar e drejta e shumë synimeve shumë të rëndësishme për t’u diskutuar dhe njeriu, qenia më e përsosur dhe zëvendësi i Zotit mbi tokë do të ishte nënvleftësuar dhe lënë mënjanë, gjë që do të ishte krejt në kundërshtim me synimin esencial të Kuranit dhe frymën e tij.

Me anë të Kuranit, Allahu bën interpretimin e librit të gjithësisë. Për rrjedhojë, edhe çështjet lidhur me njeriun i cili, si qenia më e përsosur, i përfton gjithësisë kuptimin e saj të vërtetë, edhe të vërtetat shkencore gjithësi nuk lihen mënjanë, por zënë vend në Kuran sipas përbërjes dhe rëndësisë që kanë. Megjithatë Kurani nuk është libër fizike, astronomie apo mjekësie, çështjet lidhur me këto shkencë, zbulimet, përcaktimet dhe konkluzionet shkencore që kanë për t’u bërë gjer në kiamet si dhe mjetet teknike të lidhura shumë ngushtë me jetën e njeriut, zënë vend nëpër faqet e tij, sipas peshës dhe rëndësisë që kanë, në formë dhe përmbajtje të ndryshme, herë si një farë, herë si një shenjë, herë si hipotezë, herë si simbole dhe herë si ligje dhe parime të formuluar. Duke mos e nënvleftësuar dhe lënë mënjanë asnjërën prej dijeve dhe shkencave që do të kenë marrëdhënie me njerëzit gjer në kiamet, Kurani ka thënë fjalën e fundit duke vënë në çdo fushë gurët shenjues dhe, duke ngulur flamurin në majat ku kanë për të arritur njerëzit, e nxit njeriun të

cilit i është dhuruar mendje, aftësi njohëse dhe arsyetuese, të bëjë kërkime dhe përpjekje në këto fusha!

B. Pse Kurani nuk bën fjalë hapur për të gjitha shkencat?

1. Po qe se mendohet se, nëse Kurani do të bënte fjalë hapur për të gjitha shkencat, kjo do të përbënte një argument më të qartë se është fjalë e Allahut, do të ishte gabim, sepse, para së gjithash, Kurani, jo vetëm që s'është libër shkencash moderne, por edhe objekti bazë që ndjek, siç e prekëm më lart, është jeta e njeriut në tërësinë e saj të plotë për t'ia përfutur lumturinë e kësaj bote, veçanërisht të ahiretit, jetës së pasme. Ç'vend zënë shkencat në jetën e njeriut të çdo kohe e vendi, të çdo niveli e kushtesh, në raport me lumturinë e tij të të dy botëve, që Kurani t'ua kushtojë faqet e tij një për një? Veçanërisht, diskutimi i detajuar i shkencave do të binte në kundërshtim me karakterin konciz të një libri si Kurani. Prandaj, shumë tema shkencore e teknike, si rrumbullakësia dhe rrotullimi i tokës, forma e shtypur e poleve, krijimi i njeriut dhe fazat që kalon fëmija në barkun e nënës, atomet dhe gjurmët e gishtave, formimi i shiut, formimi i reve dhe transmetimi i zërit dhe pamjeve të cilat preken ose për të cilat aludohet shumë shkurt dhe në mënyrë koncize në Kuran në kuadër të synimeve themelore si njohja e Zotit dhe afërsia intuitive hyjnore, monoteizmi, profetësia, ringjallja dhe adhurimet, kanë zënë vend në mënyrë të mjaftueshme pa e cenuar aspektin konciz dhe mrekullor të tij.

Edhe me këtë aspekt, Kurani e shpall dhe e vërteton se është fjalë hyjnore.

2. Krejt si njerëzit, edhe shkencat jetojnë periudhat e lindjes, foshnjërisë, ngritjes në këmbë, fëmijërisë, rinisë dhe pjekurisë. Në fillim parashtrohen teori, pastaj, pas vëzhgimeve, provave dhe eksperimenteve si dhe krahasimeve e gjykimeve, teoritë ose hidhen poshtë, ose pranohen në kuadër dhe në përputhje me njohuritë dhe zhvillimet bashkëkohore. Shpesh herë ndodh që edhe ky pranim, madje, është i dënuar të mbetet i kufizuar për një fragment kohor të kufizuar, sepse ndodh që kërkimet dhe zhvillimet e mëpastajme i përgënjeshtrojnë ato të vërteta për të nxjerrë në shesh të vërteta të reja. Ndërkaq, ka ndodhur dhe ndodh shpesh që edhe këto të vërteta të përgënjeshtrohen me kohë dhe vendin e tyre ta zënë të vërteta të reja. Në fakt, ka edhe të vërteta të pandryshueshme si ligji i tërheqjes dhe shtytjes së përgjithshme (ligji i gravitacionit universal), por këto janë shumë pak, kurse e përgjithshmja është se shkencat zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të vërtetat shkencore, me kohë e humbin vërtetësinë. Për shembull, një kohë është pranuar si e drejtë fizika e Njutonit, pastaj, bashkë me të, është pranuar si e drejtë edhe fizika e Ajnshtajnit, pastaj vetëm fizika e Ajnshtajnit, për të cilën sot është kuptuar se përmban gabime! Po e nesërmja, ç'do të sjellë? Këtë sot s'mund ta dimë. Të njëjtat dukuri i hasim edhe në kimi, biologji, astronomi, etj. Në këto kushte, për cilën periudhë të zhvillimit të shkencave do kishim dëshirë të fliste Kurani?

3. Po të thuhej që t' fliste, bie fjala, njeriut të shekullit XX për zhvillimet e atij shekulli, atëherë do të shfaqeshin këto probleme:

a) Kurani nuk është libri i një periudhe të caktuar, por i të gjitha kohërave dhe vendeve, i të gjithë njerëzimit, madje, së bashku me njerëzit, edhe i xhindeve.

b) Kënaqja vetëm e njeriut të një shekulli të caktuar bie në kundërshtim me universalitetin dhe synimet kryesore të Kuranit.

c) Po qe se Kurani do të bënte fjalë për pikën ku kanë arritur shkencat sot, ç'do të kuptonte njeriu i djeshëm nga kjo? Të flisje për nivelin dhe zhvillimet shkencore të sotme në një shekull kur në Perëndim njerëzit hidheshin në qelitë e errëta ose çoheshin në gijotinë vetëm pse thonin se toka rrotullohet, a nuk do të thoshte t'i shtyje njerëzit e atij shekulli në mohim, fanatizëm dhe vlerësime shumë të gabuara? Veçanërisht, një libër që do të fliste për të sotmen, si do të mund të shpëtonte, në atë kohë, nga evaziviteti, paqartësia dhe pamundësia për t'u kuptuar?

d) Po qe se Kurani do të fliste për zhvillimet dhe nivelin shkencor të shekullit XX, a nuk do të ndodhte që, pastaj, në shekujt XXI ose XXII, njerëzit ta shihnin si *librin e shekullit XX të dalë jashtë mode*?

e) Po qe se do të vinte një ditë që të dilnin në shesh anë të gabuara të shumë tezave shkencore të pranuarat sot si të drejta, gjë që është jo vetëm krejt e mundshme, por edhe diçka e zakonshme në historinë e zhvillimit të shkencave, siç u prek kjo gjë edhe më lart, a nuk do të binte Kurani në gjendjen e një libri që përmban pasaktësi e gabime? E kush do ta pranonte, atëherë, se një libër me pasaktësi dhe gabime është libër hyjnor?

Kurani u drejtohet dhe u flet të gjitha kohëve dhe vendeve dhe të gjithë njerëzve të niveleve dhe kushteve të ndryshme, kështu që edhe gjuha, stili, temat dhe çështjet që përmban dhe trajton, janë në funksion të kësaj veçorie të tij.

4. Sa libra mund të lexoni nga biblioteka juaj apo, diçka tjetër, sa herë mundeni ta rilexoni një libër të bibliotekës suaj pa u ngopur dhe mërëzitur? Veçanërisht, a keni menduar, ndonjëherë, se sa libra ka në botë të shkruar mbi fusha të ndryshme të shkencave? Po qe se Kurani do të fliste në çdo faqe për shkencat, sa vëllimesh do të dilte dhe sa biblioteka do të mbusheshin me vëllimet e tij? Dhe, atëherë, kush do ta lexonte dot këtë libër shumëvëllimësh dhe si mund të bëhej ai për njerëzit burim orientimi dhe lumturie në të dy botët?

5. Po qe se njeriut, të cilit i janë dhënë sa e sa ndjenja e aftësi tejet komplekse e që kërkojnë të zhvillohen, si mendje, arsye, njohje, gjykim, dëshirë dhe aftësi hetimi e kërkimi, ndjenjë e kërshtërie e nevojë, si dhe i cili është vënë në provë me jetën e kësaj bote, do t'i parashtrohej me hollësi çdo gjë që ka të bëjë me shkencat, atëherë, ç'kuptim do t'i mbetej formimit të një njeriu të pajisur me kaq aftësi e dhunti? Pastaj, po qe se, si pasojë, mendja do të mbetej e detyruar ta pranonte gjithçka të dhënë duke ia hequr edhe vullnetit mundësinë e parapëlqimit dhe zgjedhjes, atëherë, a do të kishte më shkak dhe kuptim ekzistenca e kësaj bote?

6. Jo çdo njeri mund të merret me shkenca dhe hollësi shkencore dhe as që ka nevojë për këtë. Veçanërisht, këtë gjë e pengojnë edhe dallimet në zgjuarsin, në aftësinë kapëse e konceptuese, në nivelin arsimor e kulturor, si dhe kërkesat e jetës shoqërore. Pastaj, shkencat nuk përbëhen vetëm prej shkencave eksperimentale. Jo vetëm që ka degë shkencore shumë më të çmuara se to, por edhe më të dobishme për jetën e njeriut, por dhe numri i njerëzve që merren me shkencë, pavarësisht nga dega, është i pakët. Kurse Kurani nuk i drejtohet dhe flet një pakice të caktuar, por fëmijës dhe plakut, mashkullit dhe femrës, bujkut dhe artizanit, shkollarit dhe atij që s'di shkrim e këndim dhe, përgjithësisht, nëntëdhjetëpërqind, popullit të thjeshtë. Në këto kushte, të kërkosh nga Kurani që ta lërë mënjatë njeriun me shpirtin, zemrën, mendjen, ndjenjat komplekse, dëshirat dhe kërkesat, qëllimin final, jetën materiale dhe shpirtërore, problemet e shumëllojshme, adhurimin, marrëdhëniet dhe nevojat e shumanshme të tij për të bërë fjalë hapur dhe me hollësi për një pjesë çështjesh shkencore të shfaqura në një periudhë të caktuar dhe në çdo kohë të dënuara për

ndryshim, do të thotë të mos e njohësh Kuranin, por të mos e njohësh as njeriun, jetën e njeriut dhe gjithësinë. Ç'të drejtë kanë shkencat që t'u jepet vend në tërë Kuranin?

Kurani bën fjalë për çdo gjë në drejtim të qëllimit final të krijimit të njeriut dhe synimeve kryesore që bart ai, me aq sa ç'e kanë ato gjëra fuqinë, vlerën dhe kuptimin. Kurani u jep vend rrëfimeve mbi profetët dhe popujt e vjetër si ekspozime shembujsh mësimdhënës që e interesojnë tërë jetën e njeriut, dhe si gurë themelorë të jetës së individëve e popujve, shkurt, të jetës së njeriut me të gjitha anët e saj individuale e shoqërore. Ai i prek të vërtetat shkencore si rrezatime të njohjes hyjnore, të besimit monotesit, të të vërtetave besimore, të shumë veçorive të njerëzve dhe të kuptimeve kryesore të librit të gjithësisë dhe, me anë të metaforave, alegorive, simboleve e paralelizmave, në një mënyrë që të mos i hapë rrugë mohimit, ngopjes bezdisëse, mënjanimi të arsyes dhe vullnetit, vjetërimit, pamundësisë për t'u kuptuar dhe shpenzimit të tepër të fjalëve, ia parashtron çështjet njeriut të çdo periudhe, të çdo vendi, të çdo shtrese dhe të çdo niveli – nëse mund të shprehemi kështu - në gjendje koncentresh, përmbledhjesh të ngjeshura e thelbësore. Kurani është si dielli: nuk u dërgon dritë të veçantë atij që është rritur në shpellë e, dritë të veçantë, atij që është rritur në universitet, por as këta nuk munden ta marrin dritën e njëjtë të diellit për të gjithë, në të njëjtin nivel. Gjithashtu, nga dielli përfiton ndryshe njeriu në ekuator dhe ndryshe njeriu në pole. Meritat e njeriut që hedh farën në arë dhe të atij që ha në tryezë frytet e asaj fare, janë të ndryshme. Urdhri për sulm drejt një objekti të caktuar që jep komandanti i gradës më të lartë mund të jetë i njëjtë me urdhrin për sulm drejt të njëjtit objekt që japin komandantë të gradave dhe funksioneve më të ulëta, por mes tyre ka dallime të mëdha niveli kompetence e kulture, konsiderate, kapaciteti për zbatim praktik, universaliteti në njohjen e çështjeve ushtarake dhe peshe të personalitetit.

Për shembull, 14 shekuj më parë, Kurani ka thënë “fik”. Fiku përbën një të tërë me farën e mbjellë, rrënjët dhe kërcellin apo trungun, me degët dhe gjethet, me lulet dhe, më në fund, me frytin e vet. Mirëpo, le ta zëmë se njeriu i periudhës së parë, me fjalën fik ka kuptuar vetëm farën e fikut. Pastaj, njerëzit e periudhës tjetër, kanë kuptuar edhe rrënjët, pasardhësit e tyre, trungun, të mëvonshmit, degët, lulet dhe, më në fund, njeriu i sotëm, kur përmendet fjala fik, kupton, së pari, fikun si frut. Ja, pra, të vërtetat kuranore, duke iu drejtuar syrit dhe zemrës së çdo njeriu të çdo kohe gjer në kiamet, ka cilësinë për ta kënaqur çdo njeri. Në çdo periudhë, njerëzit do të kërkojnë dhe marrin nga tërësia e të vërtetave të parashtruara nga Kurani, pjesë-pjesë dhe aq pjesë sa t'ua lejojë kapaciteti i tyre.

Kësaj ne i themi *hollësi në esencë*, me fjalë të tjera, ky është aspekti *edhe i lehtë, edhe i vështirë* i Kuranit. Ta tregosh dhe shprehësh frutin te fara. Të krijosh një diell dhe të sigurosh që t'i ndriçojë gradualisht sytë e çdo gjallese, edhe të mos e lësh asnjë gjallesë pa ngrohtësinë e tij, edhe ta ushqesh dhe rritësh pa e djegur e pa e përvëlur nga nxehtësia e tij...

Dielli është një burim i tillë drite që nuk fiket e nuk vjetrohet. Njerëzit lindin dhe rriten, plaken dhe vdesin. Bota ndryshon, popuj e kombe duken në skenë të historisë e zhduken, kurse dielli është po ai diell dhe do të mbetet shembull rinie e bukurie gjer çastin kur do të shkatërrohet.

Kurani është më i shkëlqyer dhe më i gjallë se dielli. Për të s'ekziston ndonjë çështje si ruajtja e rinisë. Përkundrazi, Kurani, me kalimin e shekujve dhe zhvillimin e shkencave, rinohet, drita dhe nxehtësia i shtohen edhe një herë më shumë. Shkencat janë kah vrapojnë për të arritur flamurin e ngulur prej tij në majë, në horizont!

Si shprehje e ligjeve që veprojnë në gjithësi, Kurani ka zbritur gradualisht ose, e thënë nga e kundërta, ecuria e materies dhe e dukurive në natyrë është bërë e kuptueshme fund e krye duke u përputhur me Kuranin dhe ky botëkuptim është kryer dhe kryhet gradualisht dhe dalëngadalë nga sperma te njeriu dhe nga fara te pema, siç është shndërruar toka nga gjendja e zjarhtë, në gjendjen e sotme. Duke zbritur për 23 vjet, Kurani ka zgjedhur rrugën më të përshtatshme të sugjerimit ndaj natyrës dhe krijimit të njeriut dhe, siç e racionon mjeku dozën e ilaçit për të sëmurin, ka hequr, sipas nevojës dhe gradualisht, moralin e keq, konsideratat dhe botëkuptimet e gabuara dhe bindjet bestypte dhe ka shtresuar në vend të tyre ato më të drejtat, të mirat dhe të bukurat. Edhe dituritë dhe shkencat zhvillohen duke fituar nivel në tërësinë e tyre në këtë drejtim dhe sipas këtij rregulli të përgjithshëm.

C. A mos Kurani dhe shkenca ose feja dhe shkenca janë gjëra të ndryshme që e hedhin poshtë njëra-tjetrën?

Para së gjithash, duhet ta sqarojmë se gjëja për të cilën e kanë fjalën ata që pretendojnë për kontradiktën fe-shkencë nuk është *shkenca në përgjithësi në kuptimin e dijes*, por ajo pjesë e dijes së përgjithshme ku futen *shkencat e natyrës* ose, edhe më ngushtë, *vetëm shkencat. Dije, dituri*, është një fjalë që i vjen era “ndriçim”, që i vjen era “besim”. *Ditura* është një varg, një vargëzim poetik të vërtetash që frymëzon të vërteta dhe një burim drite që e çon personin në Rrugën e Drejtë. Kurse gjëja e quajtur *shkenca eksperimentale*, me rrobën që i është prerë, me funksionin që i është ngarkuar dhe me kuptimin që i është përfutur, është një varg errësirash, kaosi dhe vrimash të zeza. Ndërsa dituria ka lindur dhe është rritur tek ne dhe e ka marrë farën dhe esencën tek ne, shkencat pozitive, me racionalizmin dhe pozitivizmin e tyre, janë produkt i Perëndimit. Ato e fillojnë punën me mohimin e të vërtetës absolute, burimit të të vërtetës dhe të gjitha të vërtetave dhe përpiqet kinse të arrijë të e drejta hap pas hapi duke u mbështetur mbi gabimet, të metat dhe mundësitë. Mirë, po si mund të arrihet te e drejta pa pasur në dorë një të vërtetë ku të goditen të gjitha gabimet, ku të peshohen të gjitha të shtrembrat? Shkencat eksperimentale që e shohin çdo gjë të ndryshueshme, si mund të punojë mbi ndryshimet dhe gjërat që ndryshojnë pa pranuar ekzistencën e një *të pandryshueshmeje*? Pa rregullat e pandryshueshme dhe të vërtetat e qëndrueshme (konstante), vëzhgimi, prova dhe eksperimentimi nuk mund të zgjidhin asgjë! Me to është e pamundur ta ndriçosh botën e njeriut!

Gjithësia mbi të cilën shkencat e natyrës përpiqen e studiojnë me mundësitë e veta, në fakt, është libri i materies dhe dukurive të shkruar nga Zoti me fuqinë dhe vullnetin e Tij dhe të rregulluar sipas një plani, programi, mase dhe ekuilibri, kurse shkencat e vërteta janë raporte të nxjerra nga veprimtaria e Allahut në gjithësi, nga marrëdhëniet mes ligjeve hyjnore në gjithësi dhe materies dhe dukurive. Veç kësaj, është edhe libri i Kuranit i ardhur nga atributi *Fjalë* i Allahut, me të cilin Allahu tregon se ç’është gjithësia dhe u bën dritë materies dhe dukurive në gjithësi. Krijuesi që e ka ngritur gjithësinë brenda një rregullsie dhe harmonie, e shpreh këtë rregullsi me anë të Kuranit. Edhe njeriu është forma e shkruar ndryshe e këtyre dy librave: librit të gjithësisë dhe librit të Kuranit. Kurani, gjithësia dhe njeriu si vendshfaqja, në këtë mënyrë, e emrave dhe attributeve të Allahut në forma të ndryshme, janë tre përshkrues të përgjithshëm, tre libra të përgjithshëm me një lidhje të brendshme të jashtëzakonshme me njëri-tjetrin, që e sqarojnë dhe e shpjegojnë njëri-tjetrin dhe, në përfundim, e bëjnë të njohur Allahun, Zotin e vetëm të gjithësisë. E, tani, këta të tre, si

mund të jenë të kundërt me njëri-tjetrin, si mund ta kundërshtojnë njëri-tjetrin dhe si mund të mendohen veç njëri-tjetrit?

Diturinë e vërtetë, njeriu mund ta fitojë duke e lexuar gjithësinë dhe Kuranin dhe, si rezultat i kësaj diturie të fituar, e njeh veten ose, me një rrugë tjetër, në fillim e njeh veten, pastaj i lexon gjithësinë dhe Kuranin. Krejt si shikimi i njeriut me anë të dy syve, gjithësia, dituritë dhe Kurani bashkohen në një pikë të avancuar. Ashtu siç sytë e njeriut nuk shohin tjetër për tjetër dhe nuk janë të aftë për të parë secili gjëra të tjera, edhe Kurani dhe dituritë apo shkencat e vërteta nuk ndryshojnë nga njëri-tjetri. Ndryshimi që pretendohet në këtë çështje, nxjerr në pah vetëm vëngërsinë e atij që bën një pretendim të tillë. Atëherë, gjëja që duhet rregulluar e para janë këto lloj shtrembërime shikimi. Njerëzit e kuptimit dhe dritës, të cilët janë në gjendje që në laboratorë t'i shohin gjithësinë, materien dhe dukuritë me lenten e Kuranit, do t'i vënë diturinë dhe shkencat në vendin e vet të vërtetë, do t'i shpëtojnë dituritë dhe njeriun nga rruga pa krye ku e kanë lënë shkencat eksperimentale dhe do t'u japin fund materializmit çifut dhe spiritualizmit krishter. Ne jo vetëm s'do ta lexojmë dot Kuranin duke lënë mënjanë librin e gjithësisë, por dhe s'do t'i hapim dot rrugë materializmit vulgar, të ngurtë e të ftohtë duke i mbytur mendjet në gjithësi.

Kjo është sinteza e Islamit që i jep jetës jetë. Nga njëra anë, përqafim i të gjitha degëve të shkencave që janë interpretë të shfaqjeve të emrave të Zotit dhe, nga ana tjetër, lidhje pas Kuranit që i ndriçon me rrezet e veta të rrugës së drejtë të gjitha rrugët që çojnë në lumturinë e kësaj bote e të jetës së pasme pas ringjalljes. Ja, pra, kjo sintezë është përmbledhja më e thjeshtë e më e shkurtër e idealit të lartë që kërkon Islami t'ia përftojë njerëzimit.

Në Perëndim feja kurrë nuk ka mundur ta përfshijë jetën tërësisht dhe të bëhet për jetën jetë. Edhe dje, edhe sot, ajo çka del nga kisha, zhytet përsëri në botën e vet të mohimit, blasfemisë dhe perversitetit. Si rezultat i mbylljes së krishterizmit nga Konstantini brenda mureve të mugëta dhe të pakëndshme të kishës pas periudhës treshekullore të puritanizmit dhe pranimi, krahas Ungjillit të korrigjuar, edhe të Testamentit gjithashtu të korrigjuar, si Libër i Shenjtë, fesë krishtere s'i ka mbetur gjë për t'i dhënë gjë njeriut europian përveç disa rregullave morale ditore. Për këtë shkak, duke e marrë diturinë (shkencat teorike dhe të natyrës) prej nesh, njeriu perëndimor i mori duke i zhveshur prej kuptimit dhe përmbajtjes së vërtetë dhe, bashkë me Rilindjen, i burgosi brenda kallëpeve të ngushta dhe të ngurta të një bote krejtësisht materiale. Sigurisht, njeriu perëndimor që e pranon se e ka marrë diturinë prej nesh, siç e pohojnë edhe mendimtarë dhe shkencëtarë si Moris Bukejl, Aleks Karrel, Karlajl dhe Garodi që e mohanin më parë një gjë të tillë, duke e lënë mënjanë cilësinë e saj si dritë që të çon te Zoti, e shndërroi shkencën në një mjet të ftohtë të një jete krejtësisht materiale e të errët. Për pasojë, përplasja mes fesë së larguar prej kuptimit dhe përmbajtjes së saj të vërtetë dhe shkencës së bërë rob të pasioneve materiale, është mjaft e natyrshme dhe normale.

Çështja ka edhe një anë tjetër. Testamenti dhe Ungjilli të korrigjuar përmbanin shumë gabime si fjalë e Zotit. Libri i Shenjtë i shkruar nga burrat e fesë për t'u sjellë zgjidhje çështjeve fetare të kohës së vet dhe për t'u folur besimtarëve, me ta humbur karakteristikën si bashkëbisedues i çdo kohe, i çdo niveli dhe i çdo vendi si dhe gjuhën hyjnore, iu nënshtrua, përballë zbulimit të të vërtetave hyjnore të pastra nga ndryshimi dhe korrigjimi në gjithësi, pluhurit të dyshimit dhe erës së mohimit. Për shembull, Libri i Shenjtë jepte një numër vitesh të caktuara për krijimin e botës dhe ardhjes së njeriut mbi tokë, krijimin e gjithësisë e shprehte me ditët e javës dhe marrëdhëniet Zot-njeri, në rrëfimin e nxjerrjes së Adamit prej parajse e paraqiste si marrëdhënie të dy mbretërve

kundërshtarë. Në fakt, ky libër nuk kishte ç't'i jepte njeriut të drejtuar për zbulimin e gjithësisë. Nga ana tjetër, njeriu perëndimor nuk ishte fort i gatshëm të pranonte që feja t'i ndërhynte në jetë qoftë edhe nga ana morale. Ja, pra, shkaqe të tilla i tërhoqën në Perëndim fenë dhe shkencën në dy drejtime të ndryshme të kundërta dhe armiqësore dhe në dy pole të ndryshme. Përballë kushteve jetësore në zhvillim e sipër dhe përparimeve të shënuara në emër të shkencës, krishterizmi, si një gjethe e mbetur nën gur që nis të zverdhet e të kalbet në pamundësi për të siguruar nevojat e saj themelore për ngrohtësi, dritë dhe ujë, nuk po gjente dot mundësi për ta bërë të pranueshme ekzistencën e vet të mefshët e të mangët. Dhe, kur deshi të dilte në sy të ditës, ishte shumë vonë: shkenca po përparonte me shpejtësi pa parë më pas, materia dhe dukuritë e refuzonin. Krishterizmit i kishte mbetur vetëm një element force në dorë: çkishërimi! Si përgjigje ndaj kësaj, njeriu perëndimor që e kishte futur dikur me duart e veta krishterizmin nën gur duke e izoluar nga jeta dhe, si rezultat duke e zbehur, përsëri me duart e veta, me anë të reformës, e nxori krishterizmin mbi platformën e ekzekutimit me vdekje. Dhe ky ishte shpagimi me të njëjtin mjet i shkishërimit që kishte ushtruar kisha mbi të!

Mirë, po mendimi për ta ekzekutuar edhe Islamin mbi të njëjtën platformë, pse? A mos ka ndodhur ndonjëherë në historinë e Islamit që dikush të nxirret nga feja pse ka thënë që bota rrotullohet? A mos ka ardhur ndonjë sistem i dytë veç Islamit që t'i tregojë njerëzimit për 11-12 shekuj me radhë se ç'është jeta? Ta nxjerrësh Islamin që ka qenë mësues i shkencave për shekuj me radhë për njerëzimin, në platformën e ekzekutimit me akuzën se është kundër shkencës dhe pengesë për zhvillimin, a nuk është, kjo, mungesë maturie, padrejtësi dhe shfaqje e një marazi armiqësor? Apo shkaku i kësaj është që, duke e izoluar Islamin nga jeta, të bëhet një jetë sensuale e orientuar nga dëshirat dhe pasionet? Apo mos po bëhemi vegël e stërkëmbëzës së qëllimshme të hedhur nga Perëndimi për interesat e veta?

Pa dyshim, ne kurrë nuk u shmangëm asnjë fije në emër të shkencës nga besimi, adhurimi dhe besnikëria ndaj Allahut dhe të të Dërguarit të Tij, përkundrazi, dituritë dhe shkencat u dhanë forcë besimit, adhurimit dhe besnikërisë sonë ndaj Allahut dhe të të Dërguarit të Tij! Ne kishim pikëdaljet tona të ndriçuara, ne vepronim me mendimin për ta zbuluar gjithësinë në emër të Zotit. Çdo zbulim i ri na krijonte në shpirta një besim, pasion dhe emocion të ri, na e nxiste sërish shpirtin e veprimit dhe, duke thënë "a s'ka më?", zhyteshim gjithnjë e më thellë në kërkim dhe zbulim. Dhe ato që nxirrnim, ishin gjithmonë perla e margaritarë. Edhe binim në sexhde, edhe vraponim në observator, duke i harmonizuar besimin me diturinë dhe shkencat, krijonim rrathë të hapur, me zgjidhje, jo rrathë viciozë! Ne shkruanim, vizatonim, projektonim, kërkonim e studionim po me atë dëshirë dhe hare që adhuronim sepse i quanim ato punë si pjesë të adhurimit. Në qiellin tonë të shkencës nuk kishte kaos, vrima të zeza dhe ngecje apo bllokim. E besonim miraxhin përtej një fantazie shkencore, përpiqeshim të udhëtonim në të njëjtën rrugë duke e konsideruar namazin bazën këtij udhëtimi, i njihnim dhe i pranonim mrekullitë dhe vazhdimisht ndiqnim synimin për t'iu afruar Allahut. *Po, tek ne, qëllimi final i diturive dhe shkencave të zhvilluara mbi këto baza, ishte njohja (intuitive) e Zotit, kurse përfundimi, konfidenca dhe dashuria hyjnore, kënaqësia shpirtërore.*

Njëri prej gabimeve serioze e të rrezikshëm të menduar mbi marrëdhëniet mes Kuranit dhe shkencave është vrapimi me Kuranin pas shkencave aktuale për t'ia përshtatur atyre. Vështrimi i shkencave veç, të shkëputura dhe të ndara nga Kurani, feja dhe besimi, është një qëndrim ekstremist; po kështu, edhe vënia e Kuranit pas shkencave për ta përshtatur me to dhe vështrimi i tij pothuaj si

një libër fizike, kimie, mjekësie, astronomie, matematike, etj., është një qëndrim ekstremist në kah të kundërt.

Si mund ta bëni diellin shumë të madh e të ngarkuar me energji, satelit të një meteori të vogël e të zbehtë? Si mund ta shihni Kuranin që i trajton dhe shqyrton gjithësinë dhe njeriun nga fillimi gjer në kiamet me të gjitha aspektet duke ua bërë hartën, më të vogël se një hartë e vogël e botës apo vizatimi i një vargmali? Sa e gabuar që të jetë të thuash “ja lumi” duke e parë vetëm aty ku del nga burimi dhe t’i vlerësosh kuptimin, dobinë dhe sipërfaqen që zë vetëm nga një kopsht që ujit apo nga shtresat e arit në një pjesë të shtratit të tij, pa marrë parasysh luginat dhe fushat nga kalon e që i ujit, kopshtet e vreshtat që u jep jetë, malet dhe kodrat nga zbret në formë ujëvarash, detet apo oqeanet ku arrin duke formuar delta, *po aq gabim është ta identifikosh Kuranin me shkencat aktuale që janë në ndryshim të vazhdueshëm, madje, t’i bësh shkencat ende të pavërtetuara dëshmuese të Kuranit dhe të përpiqesh të gjesh zbatimin e ajeteve të Kuranit në këto zbulime dhe teori shkencore, madje gabim shumë më i madh!* Nuk duhen bërë përpjekje për t’ua përshtatur ajetet e Kuranit zhvillimeve dhe teorive shkencore. Sigurisht, të përpiqesh që, për hir të dinjitetit të Kuranit, të kërkosh menjëherë mbështetje dhe përforcime shkencore, pajandra dhe paterica, do të thotë ta nënvleftësosh e ta ulësh atë. Gjithashtu, të përpiqesh për të gjetur në Kuran argument për një çështje shkencore të caktuar gjatë shekullit XX duke thënë “Kurani fliste për këtë”, ta bësh Kuranin që t’i mbështesë me çdo kusht shkencat eksperimentale, të bësh pretendime të tilla, si “edhe kjo ishte në Kuran; ky ajet kishte lidhje me këtë e atë”, etj., të gjitha këto janë shprehje të një kompleksi ndaj shkencave dhe të shikimit të Kuranit në shkallë të dytë. Shkencat dhe teknologjia ndryshojnë vazhdimisht, shumë gjëra të pranuar si të drejta sot, nesër del në shesh se janë të gabuara, vazhdimisht prodhohen teori dhe ajo që një shkencëtar e paraqet si të vërtetë, një tjetër e hedh poshtë shumë mirë. Kurse të vërtetat e shprehura nga Kurani janë të qëndrueshme, konstante, të pagabueshme dhe të përjetshme.

Megjithëse nga dita kur u zbrit e gjer më sot kanë kaluar 14 shekuj, në Kuran ka çështje aq të virgjëra e të pashembullta, sa jo vetëm që duart shkencave nuk i janë afruar ende të vërtetës së tyre, por dhe niveli shkencor ndodhet shumë pas tyre. Gjersa t’u afrohen horizonteve të treguara nga Kurani, shkencat eksperimentale kush e di sa herë do të tronditen, sa herë do të ndryshojnë! Në historinë e njerëzimit ka shumë e shumë teori që janë imponuar si të pranueshme, por që, me kohë, janë harruar dhe vendin e tyre e kanë zënë të tjera. Po kështu, do të vijë një ditë që edhe këto do të hidhen patjetër jashtë nga dera e çerdheve shkencore dhe në këtë mënyrë, me tronditje të njëpasnjëshme, shkencat do t’i arrijnë të vërtetat që përmban Fjala e patronditshme dhe e pandryshueshme e Allahut. Për këtë shkak, nuk duhet vrapuar me atë deklaratë madhështore që s’di se ç’është tronditja dhe ndryshimi, në dorë pas shkencave eksperimentale që tronditen e ndryshojnë vazhdimisht dhe nuk duhen bërë përpjekje për ta rregulluar atë sipas tyre. Po ç’duhet bërë, atëherë?

* Duhet të ndjekim jo përputhjen e Kuranit me zhvillimet shkencore, por përputhjen e zhvillimeve shkencore me Kuranin.

* Duhet t’i bëjmë gjetjet dhe zhvillimet shkencore të vrapojnë pas Kuranit.

* Kuranin duhet ta vëmë si një pasqyrë në këmbë përballë gjetjeve dhe zhvillimeve shkencore, pra, duhet t’u themi atyre: *“O shkenca, ja, shihni, ju do ta gjeni bazën dhe thelbin tuaj te ky Kuran! Sepse Kurani lajmëron formën tuaj finale dhe të vërtetën ku do të arrini dhe vizaton fatin tuaj! Vështroni dhe shihni në këtë Kuran veten tuaj me formën dhe përbërjen e vërtetë tuaj! Nëse s’keni*

ardhur ende në këtë nivel, ejani përpikuni dhe shihni të fitoni formën finale dhe përbërjen e vërtetë që keni në Kuran!”

Edhe sikur të shohim që një çështje e parashtuar nga shkencat përputhet identikisht me një ajet të Kuranit, duhet të themi, brenda mundësive, mund të jetë edhe kështu, mund të jetë edhe ashtu, dhe s’duhet të nxitohemi për ta komentuar dhe interpretuar ajetin në favor dhe mbështetje të çështjes shkencore në fjalë. Edhe sikur të shihet një përputhje e plotë mes një të vërtete shkencore ose një çështjeje të pandehur si e vërtetë, dhe një ajeti ose hadithi, jemi të detyruar që të tregohemi shumë të vëmendshëm e të matur duke futur në llogari edhe ndryshimet e mundshme në çdo kohë si dhe botëkuptimin dhe nivelin tonë vetjak. Dhe, tani, le të japim një shembull për ta konkretizuar çështjen edhe më shumë.

Në ditët tona është në rend të ditës çështja e identifikimit të AIDS-it me dabbetul ard që përmendet në Kuran. Në Kuran deklarohet se, kur të jepet urdhri përkatës i Allahut, do të shfaqet dabbetul ard (Neml, 82) dhe, qoftë nga mënyra e shprehjes, qoftë nga ecuria e saj, kuptohet se dabbetul ard është shenjë kiameti. Thuhet se bashkë me shfaqjen e tij mbi tokë, jeta besimore do të shuhet plotësisht dhe do të nisë një ecje me shpejtësi drejt një periudhe mosbesimi. Me fjalë të tjera, kur të shfaqet dabbetul ard, toka do ta ketë plotësuar detyrën dhe ata që thotë Allah, do të jenë pakësuar gjer në fund. Dhe në një periudhë të tillë kur shpirtrat e margaritartë do të kenë ikur, kurse shpirtrat e qymyrtë do të jenë përhapur gjithandej, dalja e dabbetul ard do të jetë urdhër asgjësimi dhe shpirtrave të qymyrtë do t’u thuhet se këtej e tutje, njerëzit do të rrinë larg besimit dhe se besimtarëve nuk do t’u tregohet asnjë shenjë mbi besimin. Dhe, tani, me këtë informacion të shkurtër të dhënë nga Kurani dhe në kuadër të haditheve përkatëse, le t’i kërkojmë përgjigje pyetjes se a është, me të vërtetë, AIDS-i dabbe?

Para së gjithash, megjithëse dabbetul ard do të dalë patjetër, cilësia e tij është e paqartë. Duke parë hadithe të ndryshme dhe kuptimin e fjalës, mund të thuhet se dabbe mund të ketë natyra të ndryshme, nga virusi, gjer te rinoceronti.

Dabbe mund të jetë mikrob që shkakton sëmundje epidemike mes njerëzve, por nuk mund të thuhet se patjetër është AIDS, sepse nuk ka ndonjë pengesë që edhe sëmundje veneriane të tilla si sifilizi që ka shkaktuar daljen jashtë kufijve të shënuar nga Kurani, madje dhe sëmundje të tilla si malaria, murtaja dhe tuberkulozi që dikur shfarosnin njerëzimin, të trajtohen në të njëjtin kuadër. Pastaj, në hadithet që përshkruajnë gjendjen fill pas shfaqjes së Mesihut, flitet për sëmundje aq të rënda që do të bien mbi njerëzimin, saqë edhe mikrobeve të tyre mund t’u thuhet dabbe. Fundja, si tuberkulozi dje, edhe kanceri të cilit, me gjithë zhvillimet në mjekësi, ende nuk i janë zbuluar të gjitha shkaqet dhe mjekimi, dhe i cili është një anarki qelizash, është, të paktën, po aq sa AIDS-i i rrezikshëm, vrasës dhe akoma më i përhapur. Po qe se AIDS-in e quani dabbe sepse s’ka shërim, tani për tani edhe kanceri s’ka shërim, kurse të pretendosh se në të ardhmen nuk do t’u gjendet shërimi as AIDS-it, as kancerit, s’është e drejtë. Ndërkaq, një pretendim i tillë bie në kundërshtim me hadithin e Profetit që thotë se, me përjashtim të vdekjes, çdo sëmundje e lëngatë ka shërim.

Prandaj, kufizimi i dabbes vetëm te AIDS-i ose te një sëmundje tjetër e ngjashme, bie në kundërshtim me pamjen e objektive dhe shumëdimensionale të gjerë, të gjithanshme dhe që i përfshin të gjitha kohët, të ajetit dhe e ngushton kuptimin.

Deklaratat e ndritshme dhe gjithmonë të freskëta të Kuranit dhe haditheve profetike nuk kanë nevojë për mbështetëse dhe paterica. Edhe nëse s’shfaqen jashtë, në ndërgjegjen e njeriut ato janë të

ndritshme sa të ndjehen krejt qartë. Këto lloj rezultate dhe deduksione pozitive mund të jenë, më e shumta, fshesa të afta për të fshirë pluhurin dhe dheun të vënë mbi mendjen tonë të mjerë. Këto çështje të brishta nuk kanë fuqi për të mbajtur mbi supe ato të vërteta të larta!

Pastaj, përqendrimi dhe kufizimi i ajetit të AIDS-i apo ndonjë sëmundje tjetër, do të thotë goditje mbi shpresat tona, sepse në ajet thuhet se, pas daljes së *dabbetul ard*, vendin e besimit dhe bindjes së plotë do të zënë heshtja, regresi dhe humbja. Mirëpo, nën njoftimet përgëzuese të haditheve profetike, ne besojmë nga zemra se Islami do të zotërojë edhe një herë mbi botë, se do të hapë edhe një herë tjetër flatrat në horizontet e gjithësisë dhe do të rifitojë peshë në ekuilibrin e botës, se, pasi krishterizmi të kthehet në origjinën e vet, do të lidhet pas Islamit dhe njerëzit e të katër anëve të botës do ta përmendin Profetin tonë! Nga ky këndvështrim, *dabbetul ard* e presim në kohët e errëta kur kiameti do të shpërthejë mbi kokat e mohuesve. Në këto kushte, nëse edhe në çështjen e *dabbetul ard* duhet të vëmë ekuilibrin mes dy qëndrimeve ekstreme, mund të themi kështu: “Si një sëmundje tjetër e rrezikshme, edhe AIDS-i mund të jetë një individ i *dabbetul ard*. AIDS-i mund të jetë njëri ndër shumë individët që do të kryejnë një pjesë të detyrave të *dabbetul ard*, një kuptim nga kjo e vërtetë si dhe një individ i këtij lloji që i përket çdo shekulli. Por nuk mund të thuhet se *dabbetul ard* është patjetër dhe absolutisht AIDS!”

Po që se e shohim çështjen nga një tjetër këndvështrim, sot, teknologjia, teknologjia e kozmosit dhe sistemet kompjuterike u zhvilluan aq shumë, sa, si fabrikat dhe orët e dorës që janë bërë pjesë e jetës sonë, krahas rrezeve lazer që gjer dje kanë qenë temë e fantazive shkencore, edhe robotët që kanë filluar dalëngadalë ta zënë në shumë gjëra vendin e njeriut, janë bërë, tashmë, temë e biseduar nga të gjithë. Ata që e kanë në dorë njerëzimin e ditëve të sotme dhe, veçanërisht, teknologjinë, çdo gjetje dhe zbulim shkencor e përdorin menjëherë në dëm të njeriut dhe për ta asgjësuar atë. Atëherë, kush mund të thotë se një ditë nuk do të formohen toga ekzekutimi me robotë të programuar, se një robot i vetëm do të administrojë dhe drejtojë mijëra njerëz dhe mijëra institucione dhe se do të vijë një ditë që në krye të institucioneve të shohim robotë-drejtorë me puro në gojë? A mund të pretendohet se nuk do të bëhen *dabbetul ard* robotë të pamatur, të pamëshirshëm e të paarsyeshëm që bisedojnë, sipas nevojës, me mikrofonë, kompjuterë, me një teknikë tjetër kozmike ose me anë të telepatisë?

Dikur, në një film fantastiko-shkencor, dy-tre shkencëtarë hipnin nëpër anije mikroskopike njerëz mikroskopikë dhe, duke hyrë në enët e gjakut të një njeriu, përpiqeshin të rregullonin një prishje në trurin e tij. Mësojmë se një mendim i tillë që të sjell ndërmend hadithin sipas të cilit, “*djalli përsillet bashkë me gjakun nëpër damarët e njeriut*”, tani sikur po vihet në fushën e zbatimit. Me përpjekjet për të rritur njeri në inkubator dhe për të bërë ndërhyrje të caktuara të spermatozoidet, njeriu planifikon të zhvillojë një aparat, siç thuhet sot se po bëhet në Japoni, në dimensione disa të mjtat e milimetrit me qëllim për të hyrë brenda enëve të gjakut për hapjen e bllokimeve në to dhe për të realizuar brenda trupit çdo lloj operacioni me urdhër nga jashtë. Ndërhyrjet me aparate të tillë që do të bëhen në të ardhmen ndoshta gjer në tru ose në spermatozoidet, do ta shtojnë njeriun ta teprojë aq shumë sa të pretendojë se “*ka krijuar një gjallesë dhe se ka krijuar njeri me anë të kablllove*”, duke u bërë shkak për shpërthimin e kiametit. Dhe, tani, po të thuhet *dabbetul ard* për aparate të tillë, a mund të kundërshtohet duke thënë “*nuk ka mundësi*”? Gjithashtu, po të ngrihet dikush e të thotë se komunizmi i dalë nga Lindja është më i madhi *dabbetul ard*, si do t’i përgjigjemi? Atëherë, të thuash në mënyrë të prerë “*kjo është*” për një qenie që Kurani e emërton në një formë tejet të përgjithshme dhe lakonike, flet vetëm për një

fragment të funksionit të tij dhe nuk ia shpjegon natyrën dhe përbërjen, a nuk është një konkluzion i dhënë në nxitim e sipër dhe tejet i gabuar?

Gabimet që bëhen sot nuk mbeten të kufizuara vetëm me *dabbetul ard*. Del një shkencëtar dhe, me mendimin se po tregon mjeshtëri në shkencë, e komenton kështu hadithin profetik *“ikni nga lebra si nga luani”*: *“Mikrobi i lebrës i ngjan krejt luanit. Këtë të vërtetë të zbuluar sot me anë të mikroskopit, Profeti e ka parë 14 shekuj më parë!”* Mirëpo ai mikrob nuk i përngjan aspak luanit! Dhe, pasi të kuptohet gabimi i një shpjegimi të tillë, a nuk do të krijohet mbresa se Profeti ka bërë një deklaratë kontradiktore? Atëherë, duke u përpjekur për t'i shpjeguar ajetet dhe hadithet sipas shkencave, nuk duhet ta lëmë pas dore maturinë, por duhet të mendojmë gjithmonë se mund të ketë edhe mundësi të tjera. T'i zbatosh ajetet dhe hadithet te shkencat eksperimentale dhe të vraposh me ajetet dhe hadithet pas tyre sot, kur pozitivizmi është vendosur në platformën e ekzekutimit me vdekje dhe këpucët e racionalizmit janë hedhur në çati, jo që s'u përfton shkëlqim ajeteve dhe haditheve, por është krim kundër tyre! Dhjetë-pesëmbëdhjetë vjet më pas do të dalë në shesh në të gjithë qartësinë e saj se mbi ç'themele të gabuara janë shkruar sot shumë vepra me këtë temë dhe atëherë, autorët e tyre do të mbeten të detyruar të heqin dorë nga fjalët dhe pretendimet e tyre! Kurse nuk ka asnjë çështje që Kurani ta ketë trajtuar në emër të së vërtetës dhe pastaj të ketë hequr dorë prej saj, dhe nuk mund të ketë. Po që se një çështje shkencore e shohim në Kuran si kontradiktore, ose ne jemi duke e kuptuar gabim Kuranin, ose shkenca është duke u gabuar në atë çështje!

Është një e vërtetë e padiskutueshme se, kur të kuptohen të vërtetat shkencore që Zoti i ka mbjellë në gjithësi të mbështjella në gjendje farërash e bërthamash dhe kur, në këtë fushë, të jenë arritur maja, Kurani do të rinohet edhe një herë më shumë, do të hapet si një lule që merr çdo ditë më shumë ujë, dritë e ngrohtësi, dhe do të përhapen ndër mendje e zemra me një pranueshmëri dhe shkëlqim edhe më të madh. Dhe, kushedi ç'të vërteta dhe të panjohura që i bart në gjoks do t'ua paraqesë njerëzve dhe kushedi ç'argumente rreth kësaj çështjeje do të ekspozohen! *“Dhe do t'ua tregojmë atyre argumentet tona në botën e jashtme dhe në veten e tyre që të kuptohet qartë se Kurani është i vërtetë! A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?”* (Fussilet, 53) Po të bëhet një analizë e hollësishme gramatikore e këtij ajeti, nga përdorimi i disa fjalëve të caktuara, kuptohet se sahabëve u thuhet: *“shumë argumente tonat ju ende nuk i dini, ato do t'jua tregojmë më pas”*; *“do t'ua tregojmë jo juve, por të tjerëve, atyre që do të vijnë më vonë”* dhe *“ndoshta jo menjëherë, por në përfundim të kërkimeve të njëpasnjëshme e plotësuese të njëra-tjetrës dhe të plotësimit të kuadrit ideor, do të dalë në shesh se Kurani është i vërtetë”*.

Tani për tani, shkencat ende përpiqen të shpëtojnë nga heqja këmbadoras për të qëndruar në këmbë. Nga shumë teori të parashtruara gjer tani, ndoshta shumë pak prej tyre ka dalë në shesh si e vërtetë dhe ka mundur të përputhet me Kuranin. Me përparimet në çdo fushë që do të bëhen në të ardhmen, do të realizohet një afrim më i madh ndaj të vërtetave të Kuranit dhe të vërtetat që do të parashtrinë shkencat, duke gjetur shprehjen e vet në Kuran, do të mbeten, më në fund, si të vërteta të pandryshueshme. Sot, bie fjala, fjalët e thëna mbi yjet apo yjësitë shumë të largëta tani për tani mund të jenë larg nga e vërteta sa ç'jemi ne larg tyre. Por, ndoshta, me kohë, kur njerëzit t'u afrohen atyre, njohuritë dhe fjalët tona mbi to do t'i jenë afuar të vërtetës po aq dhe, si rezultat, do të qëndrojnë si të vërteta të pandryshueshme. Me afrimin, në këtë mënyrë, të shkencave të e vërteta, për rrjedhojë të Kurani, do të dalin në shesh të vërteta të pandryshueshme dhe përsëri Kurani do të jetë ai që thotë të vërtetën. Atëherë njeriu do të flasë jo për hipotezat, por për të vërtetat dhe objekti

i diskutimit të tij do të jenë *argumentet e krijimit*. Atë ditë do të dalë në shesh në mënyrë krejt të hapur e të qartë se Kurani, njeriu dhe gjithësia që duket sikur ecin në tri rrugë të ndryshme dhe pa ditur gjë për njëri-tjetrin, bëjnë fjalë, në themel, për të njëjtat të vërteta dhe se pulsi i Kuranit rreh për njeriun dhe gjithësinë, kurse pulsi i gjithësisë rreh për Kuranin. Sigurisht, atë ditë, ai që e kupton gjithësinë, do të fitojë botën, ai që e kupton Kuranin, do të fitojë përjetësinë, kurse ai që u vë supet të dyve së bashku, do të fitojë edhe botën, edhe përjetësinë!

Dhe tani le të vështrojmë të sotmen dhe historinë dhe le të shohim se ç'fatkeqësi i ranë në kokë njerëzimit si individë dhe kombe kur Kurani, gjithësia dhe njeriu u shkëputën nga njëri-tjetri, si dhe, në kundërshtim me këtë, ç'lule lumturie çelën në tokën e njerëzimit në ato shekuj të ndritshëm të Islamit, kur këta tre elementë u afruan me njëri-tjetrin dhe kur u siguria harmonia e tyre në praktikë. Dhe, pas kësaj, le të vendosim, duke dëgjuar ndërgjegjen, se ku janë e vërteta dhe lumturia!

Me që i erdhi vendi, le ta mbyllim këtë diskutim duke iu përgjigjur një pyetjeje të bërë shpesh.

“A është e nevojshme të përfitojmë nga shkencat për të treguar për Zotin dhe fenë tonë? Po qe e nevojshme, cilat janë anët justifikuese të kësaj? Cili duhet të jetë orientimi në këtë çështje?”

Gjithsesi do të ishte me vend që kësaj pyetjeje t'i jepej kjo përgjigje: “Në tri drejtime, e nevojshme, dhe në tri drejtime, e justifikueshme!” Pra, edhe e nevojshme, edhe e justifikueshme. Sepse:

1. Ashtu siç u japim drejtim mendimeve, ndjenjave, bindjeve dhe veprimeve tona duke lexuar Kuranin, librin e Zotit tonë, ashtu dhe në rreshtat, fjalitë dhe faqet e librit të gjithësisë, nga njëra anë gjejmë dhe e njohim veten tonë, nga ana tjetër, me shikimet, mendimet dhe shkencat, sodisim me habi dhe mahnitje veprimtarinë, urtësinë dhe artin e Zotit tonë dhe themi: *Allahu Ekber, Allahu është më i Madhi!* Adhurim është ky, madje, me një orë meditim të tijin, ndoshta më i lartë se dy mijë sexhde!

2. Në fakt, çdo shkencë, si një gjuhë e veçantë, flet për Zotin, për rrjedhojë, edhe ne, me anë të atyre gjuhëve, në një aspekt, i bëhemi intepretë Zotit. Pastaj, sot jemi të detyruar nga çdo këndvështrim t'i përdorim shkencat, sepse as jetojmë në kohën e Fatihut apo Sulejmanit, as ndodhemi në një kohë kur sundojnë dhikri dhe dallditë mistike! Ne sot jetojmë në një ditë të tillë kur veprimtaria dhe arti i Zotit tonë pothuaj përdoret kundër Tij! Edhe shkenca të tilla si mjekësia që karakterizohen si altari i besimit, janë duke u konsideruar si mjete për mohimin e Allahut dhe gjërave të shenjta dhe duke sulmuar Kuranin që sot u prin shkencave dhe njofton të panjohurat. Për këtë shkak, në kundërshtim me përdorimin e materies dhe shkencave nga materialistët në emër të mohimit, përdorimi në emër të besimit i fizikës, astrofizikës, kimisë, biologjisë, mjekësisë, matematikës, shkurt, i të gjitha shkencave të formuara nga shfaqjet e emrave të Allahut dhe të përbëra nga fryma e ligjeve të vëna prej Tij, si dhe i të vërtetave shkencore duke u dhënë kuptimet dhe funksionet e vërteta, duhet të jetë një shërbim me përfitime shpirtërore!

3. Ashtu siç ndodh që shkencat, me nivelin e tyre të sotëm, nuk janë të vërteta bazë dhe përfundimtare, ashtu do të ndodhë që, edhe nesër, kur, ndoshta, do të arrijnë nivelin e tyre më të lartë, nuk do të përbëjnë dot çudi, por vetëm do të jenë mjete që e tregojnë Zotin dhe pretekste për të fshirë pluhurin nga kokat, prandaj dhe duhet të mbeten mjete dhe pretekste, nuk duhet t'u jepen

detyra bazë veç si fshirës të dyshimeve dhe lëkundjeve drejtuar atyre vetë, vënës në mendime dhe dhënës idesh dhe kurrë nuk duhet të zënë vendin e rregullit që e mban në këmbë njeriun, domethënë, vendin e Kuranit dhe besimit. Dhe për sa kohë që të përdoren në këtë kuadër, ne mund të përfitojmë në çdo kohë nga shkencat në emër të Islamit dhe besimit.

Tre lloj dëmsh të rëndësishme që mund t'u hapë rrugë përdorimi i shkencave.

1. Për shkencat nuk mund të flitet për të bërë shkencë dhe duke shitur mend. Sigurisht, nuk mund të flitet për të vërtetat shkencore në emër të Kuranit dhe besimit me një frymë dhe pamje për të bërë origjinalitet. Një qëndrim i tillë, siç do të jetë mëkat për folësin, s'do të ketë dobi as për dëgjuesin, sepse një qëndrim i tillë do të bartë synimin për ta zënë mat dëgjuesin, për ta detyruar, për t'ia mbyllur gojën dhe për ta burgosur brenda paditurisë së vet. Edhe bashkëbiseduesi, përballë një qëndrimi të tillë, do të ndjejë nevojën për ta mbledhur veten, për ta plotësuar dijen e vet dhe për t'u përgatitur për kundërpërgjigje me ndjenjën e papranueshmërisë së faktit që ia mbyllën gojën.

2. Në themel të shembjes së pësuar nga bota islame në shekullin e fundit dhe të krizës ideore e shpirtërore ku u rrokullisën edhe personalitete shumë të rëndësishëm, në një aspekt, qëndron rënia në kompleksin e inferioritetit ndaj shkencave eksperimentale. Sigurisht, rënia në qëndrime e sjellje të buruara nga kompleksi i inferioritetit, si *"kjo e vërtetë shkencore përmendet edhe në Kuran; këtë gjë Kurani e ka thënë 14 shekuj më parë"*, etj., është një gabim i madh i bërë në emër të Kuranit dhe besimit. Kjo gjendje ndodh edhe me ne që herë pas here bëjmë të njëjtin gabim duke kërkuar mbështetje në ndonjë shkencëtar amerikan apo europian dhe, për rrjedhojë, bëjmë gabimin e madh të peshimit të të vërtetave kuranore dhe besimore në peshoren e shkencave që s'kanë arritur ende te të vërtetat përfundimtare. Në ditët tona, nxjerrja e shkencave në plan të parë duke e menduar Kuranin në plan të dytë dhe duke e treguar atë sikur të ishte nevojtar për mbështetjen dhe miratimin e shkencave, është aq i përhapur, sa njeriu ikën ashtu i dëshpëruar thellë kur e sheh dhe e dëgjon një gjë të tillë.

3. Nuk duhet ta humbim veten në shkencat duke e harruar Zotin në zemrat dhe ndërgjegjet. Preokupimi vetëm me shkencat pa i vizituar herë pas here shtresat e zemrës dhe ndërgjegjes, mund ta shtrëngojë njeriun brenda një lëkure materialiste dhe natyraliste. Pamundësia për t'u shmangur nga shkencat pas përdorimit të tyre të rregullt si fshesë, si çelës, si shkallare e si mjet, bëhet pengesë për përparimin ndjesor dhe shpirtëror. Duhet të jetë parim që, pas një pike të caktuar, të lihet çdo gjë dhe, drejtpërdrejt nën rrezet ndriçuese të Kuranit, të ecet në klimën e ndritshme të Kuranit, të bëhen përparime dhe të mbetet kokë më kokë me besimin te Allahu!

PJESA E TRETË

PËRQENDRIMI METAFIZIK, VETËDIJA E BASHKËSISË, XHIHADI DHE DISA PARIME

I. RUAJTJA E PËRQENDRIMIT METAFIZIK DHE MUNDËSITË E KAPËRCIMIT TË PENGESËS SË AMBIENTIMIT

A. AMBIENTIMI DHE PERQENDRIMI METAFIZIK

Ambientim do të thotë që njeriu të mësohet me një gjë, t'i bëhet shprehi një gjë, për pasojë, të mbetet i paprekur dhe i painteresuar për gjëra shumë origjinale e të mrekullueshme që sheh djathtas e majtas, para e pas vetes. Një çështje e dëgjuar për herë të parë, është e gjallë dhe që ngjall interes, por, pasi të kalojë një farë kohe, na mbetet në kokë vetëm si një ngjarje me linjat dhe format e saj të ngrira. Pastaj, dallgëzimet e para në shpirtin tonë, valët e emocionit, zbutjet e zemrës dhe, madje, përлотjet bëhen, më në fund, iluzione dhe çështje shumë serioze fillojnë të realizohen vetëm si nga një formulë më vete, në shpirt sundon një thatësi, një shpërftyrim dhe përsjellje brenda lëkure, ashtu që tashmë zemrat bëhen krejt të ngurta, kurse njeriu, i mefshët dhe indiferent.

Tendosja dhe përqendrimi metafizik, entuziazmi i brendshëm, potenciali emocional dhe dëshirues, gjendja e vazhdueshme aktive e ndjenjave tona moralo-shpirtërore janë një burim force që na shtyn e na bën të vrapojmë ne te feja dhe adhurimet. Gjendja e vazhdueshme energjike e qendrës sonë ndjesore do të thotë një gjendje shpirtërore e pandërprerë e gjallëruar dhe e vrullëzuar me shpirt aksioni dhe veprimi. Por ç'e do se, me kohë, edhe ky gjallërim dhe kjo gjallëri mund të mbulohet me anë të pluhurit dhe dheut të afërsisë dhe ambientimit, prushi zë hi, ndjenjat, ndjenjat e holla dhe gjetet mund të shuhen. Dhe, si përfundim, mund të hyhet në fazën e shuarjes së plotë, zhvokjes, madje shpërbërjes dhe marrjes erë.

Në të vërtetë, humbja e tendosjes dhe përqendrimit metafizik për shkak të afërsisë dhe ambientimit është domosdoshmëri e natyrës dhe krijimit tonë, pra, diçka e bashkëlindur. Ashtu siç nuk ardhja e dyshimit dhe lëkundjes nuk është në dorën tonë, shpesh herë nuk e kemi në dorë ta kundërshtojmë ambientimin. Kapërcimi i këtij ligji të krijimit është i mjaft i vështirë dhe pothuaj i pamundur veçanërisht për personat që nuk ka bërë dot përparime në besim, që nuk e ka realizuar dot jetën ndjesore dhe shpirtërore. Një radhë, Handhale shkon te Profeti dhe Ebu Bekri dhe u thotë

duke iu drejtuar Profetit: *“Handhale u bë hipokrit, o i Dërguari i Allahut! Ato që ndjej pranë teje, s’i ndjej dot jashtë dhe nuk jam në gjendje të jem çdo çast po aq i përqendruar sa ç’jam pranë teje!”* Dhe Profeti i përgjigjet: *“Po qe se në çdo pjesë të kohës do të ishit siç jeni pranë meje, engjëjt do të viheshin me ju për dore në një radhë!”* Çdo ngjitje ka një zbritje dhe asgjë në gjithësi nuk është e qëndrueshme!

Shërbimet fetare janë një pengesë me rëndësi ndaj ambientimit. Me anë të shërbimit, krahas preokupacionit të vazhdueshëm, njeriu meriton mbështetje hyjnore të papritur dhe mbetet gjithmonë i gjallë, vital. Kështu, duke kapërcyer lëkundjen dhe vdekshmërinë e përkohshme, mund të arrijë një ringjallje të re. Ndryshe, kushdoqoftë që nuk tregon zell në këtë kuptim, e ka në çdo çast krejt të mundur, madje të paracaktuar, që, si rrjedhojë e ngurtësimit të zemrës, tharjes së syve dhe humbjes së gjallërisë dhe tendosjes së brendshme me anë të afërsisë dhe ambientimit, të bjerë në kurthin e dredhive dhe lëkundjeve të djallit dhe të goditet nga e majta me anë të mëkateve. Kurse disa prej rrugëdaljeve që duhen përdorur, janë si më poshtë.

B. ÇËSHTJE TË BOTËS SË BRENDSHME

1. Kapërcimi i vetëdijes së unit

Para së gjithash, njeriu duhet të bëjë një evakuim pastrues të brendshëm nga gjërat e këqija. Parcela e caktuar për mbjellje, në fillim pastrohet nga gurët, nga ferrat dhe barërat, në mënyrë që të bëhet e gatshme për t’u punuar dhe përgatitur për mbjellje. Veçanërisht me kujdes përgatiten lehet e luleve ku s’lihet as edhe një fije bari dhe ku dheu thërrmohet hollë e bëhet i butë si mëndafsh. Të marrësh krahë me adhurimet, të stolisesh me dhikër dhe ide kur në zemër ke plagë, në kokë ke dyshime e lëkundje dhe, në duar, në gjuhë, në sy e në përfytyrim, mëkate, është shumë e vështirë! Hapja e flatrave drejt Zotit vjen pas pastrimit prej ndjenjave dhe pasioneve të këqija. Në të kundërt, pretendimet e tipit “u mbusha, arrita, njoha” janë mërmëritje të unit, pa le fjalët dhe mendimet e tipit “unë isha këtu, isha atje, shpëtova vetë, shpëtova të tjerë”, duhet të jenë, gjithsesi, gërhima vdekjeje në rrjetën e djallit! Në fakt, mendimi “Unë” është çaklli dhe gjembi më i rrezikshëm që duhet hequr i pari nga parcela. Në ka gjë në natyrën e njeriut që duhet hequr dhe hedhur e para, është uni, egoizmi. Ai që nuk heq dorë nga uni, e ka të pamundur ta dëgjojë thirrjen “Unë jam” që vjen nga botët e tjera!

2. Lufta për të pasur një vullnet të fortë

Çdo gjymtyrë dhe shqisë ka qëllimin e vet final të krijimit. Sytë janë krijuar për të parë në atë drejtim që do Zoti, duart, gjithashtu për të kapur në atë drejtim, këmbët, për të ecur dhe veshët për të dëgjuar në atë drejtim. Kështu mund të radhiten edhe shqisa të tjera dhe të tregohet qëllimi final i krijimit të tyre. Gjendja është po kjo edhe për vullnetin. Edhe vullneti ka qëllimin e vet final të krijimit. Vullneti është krijuar që, si një pengesë dhe mburojë përballë të gjitha llojeve të dredhive dhe intrigave të ardhura nga uni dhe djalli, t’i kalojë në jetë dhe t’i bëjë të jetueshme me mbështetjen dhe ushqyerjen e ndërgjegjes gjërat që përcillen nga revelacioni në mendim. Ndërsa vullneti e kryen këtë detyrë, uni dhe djalli që janë armiqtë e tij më të mëdhenj, do t’i nxjerrin para shumë pengesa dhe përrenj të pakalueshëm. Lufta kundër armiqve të vet në këto kushte është, për vullnetin, shkak ekzistence. Po qe se mendimi nuk është i hapur ndaj revelacionit, ndërgjegjja është

e fikur dhe vullneti, i paralizuar, atëherë do të thotë se djalli ka gjetur një skenë të mrekullueshme për ta luajtur i qetë rolin e vet! Njeriu që nuk harron kurrë t'ia japë hakun stomakut, a nuk duhet t'ia japë edhe vullnetit?

3. Heqja dorë nga të shtënë pas dëshirave trupore

Kërkesat, dëshirat dhe shprehitë e unit janë si helme vrasës për njeriun dhe si pesha që e tërheqin njeriun poshtë. Shpirti zhvillohet dhe lartësohet në kahje të kundërt me unin. E kundërta, kur uni ushqehet, shpirti zvogëlohet, tkurret, rëndohet. Dhe, si rezultat i kësaj, në zemër, ndjenja dhe gieste shfaqet një rëndim. Ndër thëniet e Profetit është edhe ajo, sipas së cilës, djalli qarkullon nëpër damarët e njeriut. *“Atëherë, thotë Profeti, ngushtojini pak vendet nga kalon ai!”* Po, shtrëngojeni atë me uri, etje dhe duke mos ia plotësuar kërkesat dhe dëshirat. Është mjaft normale që njeriu i cili ha ç't'i shkojë nëpërmend dhe ushqehet me lloj-lloj gjërash, të jetë i shtënë pas epshit. Prandaj është shumë e rëndësishme që, duke ia dhënë hakun vullnetit e duke luftuar për të, të mbyllen pjesërisht rubinetat e ushqyerjes së unit. Në të kundërt, uni do të jetë vazhdimisht një portë e hapur për djallin, ndërkaq që nga uni si djall nuk i vjen miqësi as njeriut. Njohja e faktit se uni është një armik i madh që të çon në të këqija dhe ndaj të cilit duhet bërë “xhihadi më i madh” (lufta më e madhe), është një ndër hapat e parë të hedhur për të shpëtuar prej tij dhe prej djallit, për rrjedhojë, për t'u afruar te Zoti! Thënia e Profetit, *“armiku yt më i madh është uni yt mes dy vetullave”*, thënia tjetër e tij duke u kthyer nga një luftë, *“po kthehemi nga lufta e vogël për te lufta e madhe”* si dhe shprehja në Kuran, me gjuhën e profetit Jusuf, *“pa dyshim, uni urdhëron për të keq”*, janë mësimë të rëndësishme për ne që të frikësohemi prej tij dhe të jemi vazhdimisht syçelë ndaj tij!

4. Domosdoshmëria e arritjes së njohjes intuitive të Zotit

Duke u thelluar në njohjen intuitive të Zotit, duke e njohur shumë mirë Atë, për rrjedhojë, duke arritur kënaqësinë e gjetjes dhe njohjes së Tij brenda vetes tonë, do t'i kemi kapërcyer të gjitha shijet dhe kënaqësitë e rreme të premtuara nga uni dhe djalli dhe do të kemi dalë mbi ta. Të gjitha shijet dhe kënaqësitë e huaja të propozuara një zemre të kënaqur pasi është ngopur me afërsinë ndaj Zotit, i vijnë asaj shumë të zbehta e të shuara. Në vetvete, fundja, as që mund të mendohet që njeriu që ka arritur ndriçimin e brendshëm, të ndjejë shije nga gjërat e propozuara nga djalli për unin. Kurse gjendja e atyre që nuk kanë mundur të arrijnë njohjen e Zotit në vetvete, është si gjendja e atij që, i izoluar nga dielli, përpiket të ngushëllohet me dritën e qiriut e të xixëllonjave. Njeriu që ka arritur njohjen dhe afërsinë intuitive të Zotit, për rrjedhojë, që e ka gjetur edhe dritën e vet, nuk do të mashtrohet nga gjërat boshe e të përkohshme të ofruara atij prej unit dhe djallit dhe nuk do të bjerë në kurthin e tyre. Ndërkaq, rruga për të fituar njohjen dhe afërsinë intuitive të Zotit kalon nga zbatimi i specifikave që po shtjellojmë këtu me radhë.

5. Operacion në zemër dhe shpirt

Çdo njeri, duke u dimensionuar çdo ditë edhe ca më shumë në mendim dhe meditim dhe duke mbledhur, krejt si një bletë, tufat e njohjes dhe afërsisë intuitive të Zotit nga libri i gjithësisë të shtruar para nesh, duhet të ndjekë rrugën e hapur nga profetët e dërguar nga Zoti dhe të urtët. Në sajë të kësaj rruge njeriu do t'i përftojë vitalitetet shpirtit dhe çdo hap i hedhur do të jetë për të një

burim force. Sigurisht, ndërsa bisturia e Librit dhe Sunetit që nuk bien nga dora e ndërgjegjes sonë, i pret dhe i hedh tutje të gjitha plagët tona moralo-shpirtërore, veprat e prijësve dhe novatorëve me mënyrat e mjekimit që ndryshojnë sipas shekujve, si dhe të vërtetat e pavdekshme në këto vepra, duhet të na ndodhen vazhdimisht nën dorë si ilaçe, si melheme për të cilat nuk ka dyshim se do të na i shërojnë plagët në kohën më të shkurtër, dhe duhet t'i studiojmë me këmbëngulje duke e rregulluar shumë mirë radhën e përparësisë brenda kriterëve dhe parimeve të përshkruara. Ja, pra, është pas këtij operacioni të domosdoshëm për t'u përsëritur çdo ditë në zemër dhe shpirt, që ne fitojmë qëndrueshmëri ndaj dredhive dhe intrigave të djallit. Në të kundërt, biem në pasojën e njerëzve që nuk lexojnë, që nuk mendojnë dhe që nuk e rinojnë vetveten, zbehemi, zverdhemi, na merr era dhe humbemi!

6. Domosdoshmëria e ushqimit të zemrës dhe mendjes me meditim

Në Kuran mund të gjeni shumë ajete mbi meditimin. Për shembull, në njërin prej tyre trajtohen me miratim ata që e përmendin Allahun në këmbë, ulur dhe mbështetur, si dhe ata që përqendrohen në njohjen e krijimit të tokës dhe qiejve duke e studiuar krijimin e tyre në mënyrë të përsëritur. (Al Imran, 199) Profeti ynë, disa herë, në kohën e namazit të pasmesnatës (tehexhud), e këndonte këtë ajet, qante dhe thoshte kështu: *“Turp për ata që e këndojnë këtë ajet dhe nuk meditojnë mbi të!”* Ka hadithe profetike që thonë se një orë meditim vlen sa një vit adhurim suplementar.

Nuk ka mundësi që njeriu që s'ka dije të meditojë. Për të medituar, duhen ditur ca gjëra. Njeriu arrin në sinteza të reja me aq sa ç'di, këto sinteza ai i përdor si premisa për konkluzione dhe përmbledhje të reja dhe ja tek formohet vazhdimësi dhe shumëdimensionalitet në botën e tij të meditimit.

Meditimet vulgare e injorante të mangëta nga informacioni dhe dija nuk zbresin dot në thelb, mbesin në shtresat e sipërme e në lëkurë dhe, në të njëjtën kohë, krijojnë ambientim. Dhe, meqë nuk japin mundësi për t'u zhytur në thellësi për të nxjerrë margaritarë të vlefshëm, zvarrisin në vulgaritetin e çështjeve iluzive dhe, me kohë, nga meditari s'mbetet gjë. Një meditim injorant i këtij lloji nuk sjell asnjë përfitim për afërsinë dhe njohjen intuitive të Zotit!

Le ta bëjmë të ditur menjëherë këtë pikë që, me informacionin dhe dijen që të çojnë në meditim, kemi parasysh veprat që analizojnë librin e gjithësisë, që tregojnë marrëdhëniet dhe vartësinë mes Kuranit dhe gjithësisë, si dhe, në këtë mes, informacionin enciklopedik të ditëve tona mbi shkencat eksperimentale. Sa poetë dhe shkrimtarë ka që, kur ua lexoni shkrimet, e pandehni veten mes kopshteve të varura të Babilonisë ku ndjeni dhe dëgjoni epopetë e pemëve, zogjve, luleve, pranverave, por, mes aq shumë fjalëve, nuk gjeni dot as edhe një gjethe të vetme luleje mbi jetën tuaj ndjesore. Sepse ata janë marrë vetëm me artin, me natyrën, por gjithsesi nuk kanë shkuar dot përpara, nuk kanë bërë ndonjë përparim si artistë, veçse kanë ardhur rrotull duke përsëritur të njëjtat gjëra. Edhe informacioni i tyre nuk vlen gjë për meditimin. Prandaj meditimi i orientuar ose orientimi në meditim do të bëhen të mundur vetëm duke i shkoqur materien dhe dukuritë nën dritën e revelacionit hyjnor!

7. Orientimi në përfytyrim

Përfytyrimi është një funksion përtej projektimit dhe të vërtetës, krahu i shpirtit i zgjatur përtej e më përtej dhe një prizëm kuptimi që u jep formë sipas vetes dritave të së vërtetës. Përfytyrimi është shfaqja e pamjes së të jashtmes brenda dhe përvijimit të së ardhmes në pasqyrat e së kaluarës. Përfytyrimi është një veprimtari e trurit që nuk njeh kufirin e logjikës dhe të së pamundurës, që nuk kushtëzohet nga koha dhe hapësira. Disa herë, duke u dhënë formë materies dhe dukurive nën ndikimin e pesë shqisave, përfytyrimi vë në shesh të gjitha motivet që s'bien në kundërshtim me natyrën e materies.

Një pamje çfarëdo që na bie në sy, krijon në përfytyrimin tonë një sërë figurash dhe pamjesh. Në zërat që na vijnë në vesh, dalin në pah një sërë skenash, shëmbëllimesh dhe tablosh. Gjërat që shijojmë me gjuhë, madje një sërë faktorësh që kanë ndikim mbi trupin tonë, bie fjala, vështirësia për të urinuar ose prerja e zorrëve, bëhen shkak për përfytyrime që janë të posaçme për to. Një ngjarje që po na tregon një shok, na sjell ndërmend një ngjarje tjetër që e kemi jetuar vetë ose një ndodhi të ngjashme me atë që po na tregon ai, dhe ne kapemi pas përfytyrimit të ngjarjes tjetër duke mos ia vënë veshin më tregimit të shokut! Kur shohim një ballë të mësuar me sexhde, në përfytyrim na reflektohen kuptime dhe tablo të sahabëve dhe kridhemi në vetvete në një sërë mendimesh dhe mendimi na mbushet aty për aty me detyrat ndaj kombit dhe shërbimet që do të bëjmë për të!..

Përfytyrimi duhet përdorur në drejtim të dobishëm. Për shembull, ndërsa falim namaz ose bëjmë lutje, shohim rrathët e njerëzve përreth Shtëpisë së Allahut ose, duke u ndodhur mes atyre rrathëve, përfytyrojmë, një linjë vertikale, se si falet namaz dhe bëhet lutje nga thellësitë e nëntokës gjer në Sidretul Munteha, se si bëhet tavaf duke arritur në një vijë me shpirtrat. Në të njëjtën mënyrë, edhe duke falur namaz më vete, madje, e shohim veten mes miliona myslimanëve dhe, duke hapur duart e thënë “*Amin*”, përfytyrojmë sikur miliona gojë thonë, në të njëjtin çast “*Amin*”! Në sajë të një fryme dhe vetëdijeje të tillë, megjithëse ndodhemi vetëm, ky përfytyrim na jep një forcë të tillë, që na duket sikur flasim me gojën e milionave, lutemi me gjuhën e milionave, mbajmë përmendësh me mendjen e milionave dhe me përfytyrimet e tyre përfytyrojmë. Ja, kështu, adhurimi ynë brenda një bashkësie të tillë shumë të madhe dhe një kuadri shumë të gjerë thellohet aq shumë dhe fiton një përgjithshmëri, sa që adhurimet tona, si në dhomat e pasqyrave ku njëshi bëhet një mijë, arrijnë në mijëra dhe na bëjnë ne të ndjejmë kënaqësitë e pafundme të ndodhjes në adhurimin në bashkësi. Ja, ky është përfytyrimi i besimtarit dhe përfytyrimi që fiton mirësi e shpërblim!

Përfytyrimi mund të përdoret edhe për të keq dhe mëkat. Njeriu që jeton i vetmuar pa marrë pjesë në bashkësi, mund të bëhet viktimë e përfytyrimeve që e shtyjnë në perversitet dhe mëkat. Në sa përfytyrime thellohem ne me një shikim, me një dëgjim, prandaj dhe përfytyrimi i mëkateve mund të përgatisë në të ardhmen edhe terrenin e praktikimit të tyre. Siç e thamë më lart, çdo skenë e vogël, çdo kuadër i vogël i hedhur nga djalli në përfytyrim, bëhet film në kamerën e përfytyrimit, u jep shkak oleandrave të prostitucionit dhe, sidomos, po qe se bie në dorë të unit, kthimi në praktikë bëhet shumë i lehtë. Prandaj, edhe sikur të mos jetë me të vërtetë pervers e mëkatar, bëhet pervers në përfytyrim ngaqë përfytyrimi i pushtohet prej mendimeve mëkatarë! Prandaj, duke i quajtur si gjarpërinj e akrepa këto lloje mendimesh, pamjesh e idesh që na vijnë në përfytyrim, duhet të përpiqemi që, me mënyrat që i parashtroam, të mos biem në rrjetën e këtyre zvarranikëve dhe insekteve dhe, nëse kemi rënë, të shpëtojmë!

Në atmosferën e kujt apo të ç'gjëje të jemi, nën ndikimin e kujt apo të ç'gjëje të jemi dhe brenda fushës magnetike të kujt apo të ç'gjëje të jemi, edhe pamjet dhe figurat që do të na gjallërohen në

përfytyrim, do të jenë më shumë të atij lloji. Le ta supozojmë se mbetet tri ditë pa ngrënë. Në këto kushte, a mos do të përfytyroni dyqanet e sarrafëve apo ndonjë udhëtim kozmik me raketa, apo një shtambë ujë, një bukë të tërë e një pjatë gjellë? Jeni shtrirë në tavolinën e operacionit dhe prisni t'ju presin me thikë dhe, në këtë mes, ju flasin për tepsi të tëra me bakllava; po ju, ç'përfytyroni? Jeni ulur në sallën e kinemasë apo para ekranit të televizorit dhe po shihni pamje që i pëlqejnë unit tuaj si dhe ju ftojnë për epsh. A është e mundur që, në ato çaste të bëni të reflektohen në përfytyrimin tuaj rrathët e njerëzve që bëjnë tavaf rreth Qabes? Atëherë, ata që duan të përfytyrojnë kuptimet mbi Allahun, duhet të hyjnë në fushën magnetike të shtëpive ku bashkohen e shkrihen me njëra-tjetrën këto kuptime!

Sa karat të ketë njeriu, edhe përfytyrimet të asaj cilësie do t'i ketë. Përfytyrimet që e mbështjellin dhe do ta mbështjellin njeriun, do të paraqesin ndryshime sipas nivelit të njohjes së Allahut dhe Profetit dhe besimit të ringjalljes pas vdekjes, si dhe sipas asaj nëse do t'i japë apo jo vlerë kësaj bote. Thellësia e botës ndjesore, dimensionet dhe gjerësia e botës së projektimit dhe meditimit, pasuria e shqisave dhe ndjenjave do ta pasurojnë botën përfytyrimore të personit me ngjyrat e tyre. Përfytyrimet do të vizatojnë grafikë sipas diturisë, nivelit kulturor dhe idealeve të tij.

Njeriu që, duke ndjekur lëkundjet ekonomike të përditshme, mbetet nën ndikimin e tyre, do t'ju sjellë para përvijimet e botës ekonomike që ia kanë mbushur banesën e përfytyrimit. Gjuha e një njeriu të shtënë pas epshit që e ka bërë për parim filozofinë e të jetuarit të ditës, është interpreti më i dukshëm i përfytyrimeve të tij. Kurse kur të keni nderin të njiheni me një figurë që bëhet pjesëtar i vuajtjeve të brezit të vet dhe ia ka kushtuar jetën shërbimit ndaj kombit, do të merrni mesazhe nga rrezatimet e përfytyrimeve të klimave të ndriçuara. Përfytyrimet e niveleve të larta kurrë nuk i shkaktojnë njeriut zhgënjim!

Kur themi përfytyrim, njeriut mund t'i shkojnë në mendje edhe iluzione të zbrazëta dhe mendime të pakuptimta. Vetëm se, meqë përfytyrimet e besimtarit, sikurse fjalët dhe punët e tij, janë të ngjyrosura me ngjyrën e Allahut, janë gjithmonë të orientuara kah e drejta. Stolitë dhe zbulimet e përfytyrimit të tij janë suneti i Profetit. Dhe rregulluesi i këtyre përfytyrimeve janë të gjitha parimet e Islamit.

Po të dojë, njeriu mund ta mbajë nën kontroll botën e tij të mendimit dhe përfytyrimit. Sigurisht, kjo është një gjendje e varur nga vetëdija dhe vullneti. Ashtu siç mundet t'i këpusë e t'i hedhë tej dyshimet e lëkundjet, njeriu mund t'u japë fund edhe mendimeve dhe përfytyrimeve ku është zhytur pa e pasur në dorë. Ndërkaq, edhe kjo varet nga fakti se sa do ta përdorë dot vullnetin, se sa do të jetë në gjendje ta tregojë veten me aftësinë njohëse, vetëdijen dhe ndjenjat e veta dhe, duke i zhvilluar gjetet, se sa do të jetë në gjendje ta kapërcejë anën e vet lëndore. Në emër të së kaluarës së largët dhe të së ardhmes së largët gjer në konceptet e së përjetshmes, Kurani hap para nesh portën e vëzhgimit dhe udhëtimit me meditim, mendim dhe përfytyrim dhe na tregon ne tablo të jetës së pasme, ahiretit, xhenetit dhe xhehenemit. Edhe Profeti e praktikon këtë me deklaratat e tij të ndritshme. Nga ana tjetër, në një çështje kaq të ndjeshme, janë vënë edhe kufij të caktuar se ç'duhet dhe si duhet menduar kur të jetë e nevojshme dhe e domosdoshme. Për shembull, me pretekstin e meditimit, nuk mund të bëjmë supozime të ndryshme dhe komente mbi Personin e Allahut, mbi esencën dhe natyrën e shpirtit dhe mbi ngjarjet e pakuptueshme lidhur me botën e përjetshme siç mund të bëjmë për gjëra konkrete. Por mund ta sjellim përfytyrimin tonë në gjendjen më produktive duke i rregulluar funksionet e mendimit me ndihmën e prijësve të përkryer udhërrëfyes dhe me ndihmën e veprave të zgjedhura që përhapin dritë. Le të themi se po rrini mes

një ekstaze serioze ndjenjash duke pritur namazin. Në këtë mes, në botën tuaj të përfytyrimit shfaqen tri të vërteta. Që të mos ju preokupojnë në namaz, dy prej tyre i regjistroni në kujtesë me kodin *“inshaallah”*, *“në dashtë Allahu”*. Pas namazit, kur kërkon përfytyrimet t’ju kthehen prapë, ato të dyja që i regjistruat me *“inshaallah”*, ju kthehen, e treta s’ju kujtohet dot më! Sigurisht, regjistrimi i përfytyrimeve në kujtesë me *“inshaallah”*, është shumë i rëndësishëm, vetëm se është më e rëndësishme që përfytyrimet të sillen në gjendje të përshtatshme me çështjen përkatëse!

8. Domosdoshmëria e kujtesës së shpeshtë të vdekjes

Mes shprehjeve të çmuara të Profetit është edhe domosdoshmëria e kujtesës së shpeshtë të vdekjes që i hidhëson shijet. Veç kësaj, Profeti i ka vizituar varret dhe ka dhënë porosi për t’i vizituar ato. Po qe se njeriu, ashtu siç i beson të vërtetës së vdekjes, e bën atë sunduese në botën e vet të mendimit dhe përfytyrimit duke e ngulitur në shqisa, ndjenja dhe mendje, si dhe po qe se e bind veten për jetën e varrit që do të vazhdojë gjer në kiamet, atëherë, vështrimi dhe qëndrimet e tij ndaj kësaj bote dhe tjetrës ndryshon dhe bëhet diçka tjetër. Prandaj Profeti ka thënë: *“Po t’i dinit ato që di unë, do të qeshnit pak e do të qanit shumë!”*

Mendimi për vdekjen është si një antikorp që, së bashku me ambientimin dhe lëkundjet që mund të shfaqen në damarët moralo-shpirtërorë të njeriut, i shfaros të paktën edhe ndikimet dhe dëmet e virusit të mëkatit dhe mikrobeve të ngjashëm që djalli na i tregon të stolisur. Vdekja brenda mendimit se *“meqë do të vdesim dhe pas saj do të na kërkohet llogari, shtënia pas kënaqësive të kësaj bote dhe mëkati nuk kanë kuptim”*, ka, në një anë, një ndikim të fuqishëm shmangës dhe, në anën tjetër, një ndikim të fuqishëm fuqizues e nxitës. Por po qe se damarët moralo-shpirtërorë na janë mbushur me mëkate në atë masë që të mos kenë ç’t’u bëjnë antikorpët, dhe me mikrobet e shijeve të ndaluara të kësaj bote dhe po qe se, më në fund, në çdo anë të trupit na është shfaqur një anarki qelizash dhe na është formuar një mur të cilit s’kanë ç’t’i bëjnë as antikorpët e vdekjes, atëherë as vdekja vetë, as dhe ata që vdesin nuk do të na zgjojnë dot asgjë në shpirt dhe ikja një e nga një e të afërmve tanë do të na shkaktojë vetëm një dhimbje kalimtare disaditëshe. Dhe ne do të themi, “të vdekurit, me të vdekurit, të gjallët, me të gjallët”, do të shtojmë, “gjersa të gjithë e kemi vendin atje, shkofshim me besim” dhe, me të tilla ngushëllime të kthyer në klishe, do të kthehemi sërish në indiferentizmin e së përditshmes!

Pse nuk kujtohet vdekja? Vdekja nuk dëshirohet të përmendet sepse ia prish shijen gojës duke i hidhësuar shumë kënaqësi të ndaluara që i pëlqejnë unit, sepse na e prish qejfin, sepse e shtrëngon njeriun të heqë dorë nga dëshirat subjektive e të shkëputet nga një sërë kënaqësish dhe shprehish trupore, sepse, përkundër shijeve të çastit, i fut njeriut dëshirën për adhurim për llogari të botës tjetër, sepse, me aspektin e saj lëndor, e ndrydh zemrën dhe sepse, duke e turbulluar mendimin, ia nxin njeriut botën e zbukuruar e të stolisur!

a) Jeta sikur nuk do të vdesësh kurrë, të bën ta harrosh vdekjen

Prej se nuk ndikon vdekja? Prej ndjenjës iluzive të përjetësisë. Prej lidhjes pas botës sikur nuk do të vdesësh dhe prej jetesës për jetesë. Prej vetëmashtimit me shpërblime të çastit por të madhësive të lojërave të fëmijëve. Prej mbylljes së syve të zemrës dhe mendimit ndaj të shkuarës dhe të ardhmes!

Mendoni një njeri që hyn në një dhomë gjashtëkëndshe të veshur nga të gjitha anët me pasqyra në këmbë. Hedh vështrimin pas dhe sheh një korridor pasqyrash që pasojnë njëra-tjetrën duke u zgjatur pa fund, domethënë një jetë e tërë e jetuar gjer atë çast dhe njeriu fluturon me krahët e kujtimeve të kaluara. Pastaj kthehet për të parë në drejtim të së ardhmes. Në të njëjtën mënyrë, një jetë që e pret për t'u jetuar, zgjatet para pa fund. Dhe njeriu mendon: "Jam ende i ri dhe s'i kam punët keq në krahasim me bashkëmoshatarët! Kam mall e pasuri, të ardhura të mira, një grua të bukur, miq e rreth, profesion e punë..." Në fakt, megjithëse ndodhet i mbyllur brenda katër mureve të një dhome, e sheh veten mes një jete të gjerë e shumëngjyrëshe, prandaj e sheh me ftohtësi vdekjen, madje as që do të mendojë për të! Përtej kësaj, në jetën e përditshme, ai mundohet ta mbysë mendimin mbi vdekjen mes mendimeve të tjera si dhe përmes hajeve, pijeve, drogës, duke marrë pjesë në botën e modës e të dëfrimit...

Në jetën tonë myslimane ne kemi dy festa që karakterizohen nga edukata dhe etika si dhe nga dobi të mëdha për këtë botë dhe për botën e përjetësisë: bajramin e ramazanit dhe të kurbanit. Tani shihini këto dy festa si dhe, për shembull, ditët e dëfrimit të gjermanëve. Festat ne i kremtojmë, kurse ata i kanë për dëfrim. Dhe festat e tyre të dëfrimit vijnë me radhë me javë dhe muaj. Po t'i shqyrtoni këta njerëz nga ana psikologjike, shihni se secili është një njeri qejfi dhe pandehni se janë tejet të gëzuar, të hareshëm dhe si të krijuar për të buzëqeshur... Kurse kjo dhe dukuri të ngjashme shfaqen gjithë tjetër veç mendimit për ta vrrarë vdekjen dhe përpjekjes për ta harruar atë. Edhe myslimani ka një jetë gëzimi dhe hareje brenda linjave të veta dhe brenda një kuadri legjitim, ndërkaq që edhe në botën e tij të gëzimit, madje, ka frymëzime, kuptime dhe jehona drithëruese mbi vdekjen, por edhe zilindjellëse. Në fund të fundit, bota e brendshme dhe lumturia shpirtërore e myslimanit nuk ndjen nevojë, madje, për dëfrime të kësaj bote!

b) Porta e pallateve të lumturisë së përjetshme hapet me vdekjen

Ne e puthim vdekjen në ballë dhe i themi: "Ç'shok dhe shoqërues i bekuar që je ti!" Le të të shohin të tjerët si gjemb, ti je vetë trëndafil! Le të të thonë të tjerët "fytyrë e zezë", ti je për ne dritë me dy flatra që na merr fluturim për të na çuar në botët e përtejme të dritës! Mos i shih ata që të thonë "fytyrë e ftohtë", ti je për ne e bardhë dhe e tejdukshme si flokët e borës! Ata të thonë "gropë" ty, kurse ne të themi "korridor i hapur për në pallatet e lumturisë së përjetshme. "I ndan njerëzit nga njëri-tjetri", thonë për ty, por, ti je vetë ajo që i bashkon në botën e përjetshme shokët, miqtë, të afërmit e të dashurit. Ti je ajo që na çon ne te profetët që ua kanë zilinë engjëjt, te sahabët, te prijësit, te njerëzit e mirë, te të afërmit! Ti na afron ne te Bukuria Hyjnore! Po, ti na ndan, por na ndan nga kjo botë ngarkuar me dhimbje, vuajtje, shqetësime dhe mall ndarjeje duke na dhënë "fletëkalimin" për në botën e përjetshme që është jeta e vërtetë! Ti je një sherbet që, në emër të kthimit tonë te Ai që na ka dërguar, na e mbush trupin me dritë! Dhe ti nuk je një fund, por fundi i fundit, një mbarim që të çon në fillimin e përjetësisë! Ti je vija e horizontit ku bashkohen buzë më buzë mbarimi i kësaj jete me fillimin e përjetësisë dhe një makijazh për sytë që hapen për të parë Bukurinë Hyjnore! Dhe, gjithashtu, ti je ajo që e bën Interpretin e vuajtur të një brezi të vuajtur të thotë në mëngjes, "ajme, prapë sot s'paskam vdekur"! Ja, pra, dy anët e vdekjes: në fillim të frikëson, pastaj të bën që ta kërkosht!

Siç e parashtroam këtu, mendimi mbi vdekjen me aspektet e tij edhe si pengues, edhe si nxitës, ndërsa nga njëra anë na bën të trembemi e të kërrusemi nga pesha e të këqijave që kemi bërë, nga ndjenja e përgjegjësisë dhe frika se kemi për t'i dhënë llogari Zotit për ato që kemi bërë, nga ana tjetër na e ngre peshë zemrën e na jep gjallëri përmes marrëdhënies frikë-shpresë dhe ushtron një

ndikim pozitiv mbi ndjenjat, mendimet, sjelljet dhe veprimet tona! Duke e kujtuar vazhdimisht vdekjen, duke marrë mësim nga vizita në varre si dhe nga të sëmuret dhe të gjymtuarit, në dashtë Zotit, do të shpëtojmë nga ambientimi, do ta ruajmë tendosjen dhe gjallërinë e brendshme dhe do të mbrohemi nga dëmet e djallit e të mëkateve!

9. Rëndësia e madhe e delikatesës dhe zbutjes së zemrës

Zbutja dhe delikatesa e zemrës dhe ndjenjave, shmangia dhe çlirimi i shpirtit nga opakësia e lëndës për të bërë vëzhgime dhe udhëtime përtej distancave të mendimit dhe përfytyrimit janë shumë të rëndësishme për njerëzit e ndjenjës. Sigurisht, si në çdo çështje, edhe këtu, nën udhëzimin e thënieve të ndritshme të Profetit tonë, ashtu siç në këtë botë ecim me këmbët e kësaj bote dhe shohim me sytë e kësaj bote, në të njëjtën mënyrë, është shumë e rëndësishme që, duke u ndodhur ende në këtë botë, të përpiqemi të ecim dhe shëtisim në distancat e ahiretit, jetës së pasme, dhe, duke u përpjekur për ta jetuar atë jetë, të fitojmë përvojë shpirtërore. Ndërkaq, edhe për një veprimtari të tillë është i domosdoshëm një meditim i orientuar, për rrjedhojë, aftësi dhe njohuri përkatëse.

Kam vdekur! Mbi krye janë mbledhur e më qajnë njerëzit e shtëpisë, të afërmit dhe miqtë. “Oh, nuk jeni ju që duhet të qani tani, por unë! Eh, sikur të kisha qarë sa isha në botë e tani të qeshja!”

Më kanë shtrirë për të më larë. Ai që po më lan, më kthen nga të dojë dhe ma pastron trupin. “Eh, sikur të isha larë vetë në kohë nga ndyrësitë, të isha pastruar me pendim dhe pendesë dhe të mos kisha bërë mëkate! Eh, sikur të isha mbrujtur në duart e bekuara të Profetit dhe të kisha marrë formën e përshtatshme për këtë!”

Pa shih, po më mbështjellin me qefin të bardhë që të kem mundësi edhe një herë të shoh bardhësinë para se të zhytem në errësirën e varrit! “Ah, sikur të isha ngjyer me ngjyrën e Allahut që do të ma ndriste varrin, të isha shkëlqyer me abdes, të isha zbukuruar me namaz, dhe ta kisha zbardhur faqen me shërbim në rrugën e Allahut!”

Ajme, ja tek më vunë në tabutin e thatë të bërë me katër copë dërrasa! “Pse atëherë kur shtrihesha në shtretër të butë, ulesha në kolltukë dhe zgjatja këmbët duke e shijuar jetën, nuk e mendova këtë ditë kur do të shtrihesha në këtë tabut të fortë? Kurse këtë gjë ia patën bërë edhe tim eti!”

Ja tek më vendosën në gurin e faljes dhe ma falën namazin e të vdekurit! Ja tek më ngritën në supe e më futën në varr! Ej, ku jeni ju, ime shoqe, fëmijët, miqtë e mi! Ç’po ndodh me ju? Pse po më ktheni shpinën e po më lini vetëm në këtë vend të ngushtë? Ku janë gjërat e mia, ku është pasuria ime? Po trupi im, sytë e mi të bukur, duart, këmbët, edhe ju po më lini? Eh, sikur të mos isha lidhur pas jush, o gjërat e mia më të dashura të kësaj bote, por të kisha bërë punë që do të më duheshin tani këtu!”

Engjëjt Munkir-Nekir do të vijnë e do të më bëjnë pyetje. Në jetën e varrit do të sodis xhenetin dhe xhehenemin. Do të bëhet ringjallja, do të mblidhen njerëzit e do të çohen në vendin e dhënies së llogarisë. Atëherë, secili do të shohë të shpëtojë kokën! Njerëzit s’do të duan t’ia dinë për prindër, fëmijë e të afërm. Secili do të kërkojë një dorë ndihme dhe atëherë do të zgjatet dora e Profetit do të prekë disa nga duart që i zgjaten, do t’i njohë portretet e ndritshme dhe do t’i mbledhë pas vetes duke thënë: *“I njoh që nga larg ata që i kanë të ndriçuara duart e krahët me abdes dhe ballët me*

sexhde...” Ah, sikur edhe unë të kisha lënë adresë, të isha njohur me të dhe të mblidhesha bashkë me të tjerët rreth tij! Ja tek fluturojnë librat e llogarisë, peshorja është ngritur, po bëhen llogaritë! Të fshehtat derdhen jashtë, në vend të gjuhëve flasin duart e këmbët!..

Me të tilla mendime e meditime duhet zbutur zemra e duhet bërë delikate ajo!

10. Lot dhe namaz mes në errësirën e natës

Për njerëzit e sinqertë e parimorë, për njerëzit zemërdjegur, loti është zbrazje e vuajtjeve, është lehtësim! Ndërsa në këtë botë loti qetëson, qoftë edhe për një çast, ankthin e zjarrit të dashurisë pasionante për Zotin në zemër, në jetën tjetër do të jetë i vetmi eliksir që do t'i shuajë flakët e xhehenemit. Prandaj, në lidhje me këtë çështje, Profeti shprehet kështu: *“Pas ringjalljes, në kushtet kur shkëndijat e xhehenemit do të ndjekin njerëzit, Xhebraili do të duket me një gotë ujë në dorë. Unë do ta pyes: “Po kjo?” Dhe ai do të më përgjigjet: “Këtu janë lotët e besimtarëve që kanë derdhur me frikën ndaj Allahut dhe kjo është e vetmja gjë që mund t'i shuajë këto shkëndija të frikshme!”*

Përsëri, në një hadith tjetër, derdhjen e lotëve me frikën ndaj Allahut, Profeti e vlerëson njëlloj me rojen e luftëtarit në front që armiku të mos na sulmojë e të na pushtojë. *“Dy sy s'kanë për ta parë xhehenemin, - thotë Profeti, - i pari, syri i atij që loton me frikën ndaj Allahut, i dyti, syri i atij që i rreh zemra përballë rreziqeve ku mund të bjerë vendi dhe që bën roje atje ku pritet të na hyjë armiku për të na shkatërruar!”* Sytë që jashtë vëzhgojnë të jashtmen dhe brenda, të brendshmen! Po, triumfi i brendshëm me triumfin e jashtëm janë të barasvlershëm.

Në Kuran kjo çështje përmendet me miratim në disa vende. *“Ata, kur dëgjojnë ajetet e Allahut, bien me nofullat në tokë!”* (Isra, 107) Kurse në një vend tjetër, Kurani paralajmëron: *“Të qeshin pak e të qajnë shumë!”* (Teube, 82) Kjo ka këtë kuptim: “Mendoni dhe le t'ju hidhet zemra përpjetë për disa gjëra që keni fituar! Vrajeni mendjen për vdekjen, për ato që do t'ju ndodhin pas saj dhe në ç'gjendje do të ndodheni në vendin e llogaridhënies dhe qeshni pak e qani shumë!” Me këtë aspekt të tij, loti mbahet i barasvlershëm me të mirat e xhenetit. Profeti lutet: *“Allahu im, mbështetem tek Ti nga zemra që nuk dridhet, nga syri që nuk përletet!”* Në sytë e atyre që u janë ngurtësuar zemrat, që u kanë zënë ndjenjat pezhishka merimangash, nuk duken lot!

a) Nuk duhet qarë me shtrëngime artificiale pa zjerë përbrenda

Çështja ka edhe një aspekt tjetër. Profeti ynë (s.a.s.) thotë: “Njeriu që qan kur të dojë, është hipokrit!” Është i dyshimtë edhe personi që përpiqet të derdhë lot duke ndenjtur, pa zierë përbrenda, pa pasur ndonjë shtrëngim nga brenda, pa iu ngushtuar zemra ose me shtrëngime artificiale. Sepse të qarët është një zbrazje dhe lehtësim si rezultat i ndodhjes nën presionin e emocionit të zemrës dhe ndjenjave. Disa herë ndodh që zemra është jashtëzakonisht besnike, e vendosur gjer në fund dhe e gatshme për t'i zbatuar urdhrat e fesë dhe për t'u ruajtur prej ndalimeve të saj. Ajo s'e di se ç'është kthimi pas, por dhe në sy s'i vijnë lot. Ndërkaq, besnikëria e saj siç e përshekruam, është shumë me rëndësi. Ajo është si një vorbull, s'është bosh. Të dyja këto lloj zemrash janë të pranueshme, sepse s'duhet harruar se besnikëria rrjedh nga dashuria! Të mos keqkuptohemi! Kjo asnjëherë s'do të thotë se nga sytë e besnikut s'derdhen lot! Edhe Ebu Bekri, edhe Omeri kanë qenë besnikë. Kur ndodheshin pranë ndonjë zemërthyeri, qanin me ngashërime si fëmijë. Të gjithë e dimë se e qara e tyre në namaz dëgjohej në rreshtat e pasëm. Nisur nga kjo, ashtu siç nuk i lihet mungesa e lotëve gjithmonë mungesës së dhimbjes së zemrës, ashtu dhe rrjedhja e lotëve si lumë

nuk i lihet rregullisht dhimbjeve apo gëzimeve të zemrës! Sigurisht, disa herë njeriu nuk mundet ta kontrollojë veten, e mundin ndjenjat dhe qan. Po qe se i mungojnë besnikëria dhe vuajtja e brendshme, kjo për të bëhet e rrezikshme. E qara është e pranueshme dhe e vlefshme dhe, te Zoti, vlen sa botët, kur është një zbraze e papërballueshme e shtyrë nga shtysa të brendshme dhe e kryer në linjë legjitime.

Në veprën e tij “Ihjau ulumiddin”, Gazaliu thotë: *“I penduar edhe ai që qan, edhe ai që s’qan!”* Njeriu, po s’qau, një ditë do të pendohet, sepse para ka shumë shkaqe që mund ta bëjnë të qajë. Nga ana tjetër, ka shumë që qajnë, por jo për mëkatet, por për gjëra të tjera, ndoshta thjesht nën veprimin e ndjenjave. Kjo do të thotë se edhe e qara është e pranueshme dhe me vlerë nëse niset nga motive dhe synime legjitime.

Njeriu jobesnik, me zemër ku s’ka lot legjitimë, me zemër të pandjeshme e ku s’ka mbetur drithërimë ndaj mëkateve, do të thotë se është bërë shenjë goditjeje për djallin dhe në gjendje të përshtatshme për t’u guajtur dhe marrë viktimë. Sepse një njeri i tillë nuk trembet nga mëkatet, për rrjedhojë, nuk bart në ndërgjegje peshën e mëkatit dhe ankthin për të mos hyrë më në mëkat. Mbi njeriun me zemër të ngurtë nuk ndikon as frikësimi, as inkurajimi. Ai shëtiti qetësisht në çdo vend, nuk frikësohet fare nga rreziqet e rënies në mëkat dhe indiferentizmi i tij i pëshpërit vazhdimisht se ndodhet në siguri edhe nëse ndodhet në një fushë të minuar!

b) Namazi tehexhud, feneri ndriçues i netëve të errëta

Ata që i ndriçojnë netët e tyre me fenerin e namazit tehexhud, quhet se e kanë ndriçuar edhe jetën e tyre të varrit. Namazi tehexhud është, përballë errësirës së varrit, një blind, një armë, një pishtar dhe një mjet sigurie që e mbron personin nga vuajtja e errësirës së varrit. Çdo namaz është dorëzanësi për ndriçimin e një cope të jetës së botës tjetër të atij njeriu, kurse namazi tehexhud është ushqimi dhe ndriçimi i asaj jete. Për namazin tehexhud është aluduar në disa vende të Kuranit. (Isra, 79; Sexhde, 16; Insan, 26). Siç mund të falet me dy rekate, mund të falet edhe me tetë rekate. Sipas rrëfimit të Buhariut dhe Muslimit, ibni Omeri i tregon Profetit një ëndërr ku sheh se i shkojnë dy persona me pamje të tmerrshme, e kapin për krahësh, e çojnë në buzë të një grope me zjarr dhe, pasi trembet se mos e hedhin, ata i thonë të mos ketë frikë se për të s’ka rrezik. Profeti e komenton këtë ëndërr me këto fjalë: *“Ç’njeri i mirë është Ibni Omeri! Sikur të falte edhe namazin tehexhud!”* Kështu, Allahu i ka treguar Ibni Omerit një tablo xhehenemi të jetës së varrit dhe, duke ia kujtuar një të metë, ka siguruar mbylljen e saj me anë të këshillës së Profetit!

Në prishjen e ambientimit, në zbutjen e zemrës dhe në mbrojtjen nga ndikimet e djallit e të mëkateve, gjërat që i përftojnë zemrës disa pika lot të derdhura në errësirën e natës nga frika e Allahut, nga impresionimi prej Allahut dhe dashuria e afërsia ndaj Tij, si dhe dhikret, tesbihet, namazet dhe mësimet e kryera me sytë e zgjuar në orët kur të gjithë flenë, kuptohen vetëm në praktikë dhe duke i shijuar. Njerëzit me netët të ndriçuara, a mund të mos i kenë të ndriçuara edhe ditët?

11. Duhet martuar, nëse s’është e mundur, duhet agjëruar

Profeti porositi: “O të rinj! Martohuni, por, në mos paçi mundësi, agjëroni sepse agjërimi është mburojë ndaj mëkateve!” Po qe se një të ri fillojnë me të vërtetë ta shtyjnë dëshirat sensuale, ai këshillohet të martohet pa humbur kohë. Por edhe nëse nuk ekziston një rrezik i tillë dhe mendohet

që personi duhet të mbetet beqar për shkak të detyrave që duhet të kryejë dhe ai është i mbrojtur ashtu si edhe profetët dhe burrat e shquar si dhe nga atmosfera që e rrethon, duhet nxitur për t'u martuar, veçanërisht në ditët tona për të mos u bërë mjet për djallin, dhe duhet futur nën këtë mburojë dhe blind mbrojtës. Në të kundërt, si mburojë duhet përdorur agjërimi.

12. Duhet jetuar si sahabët

Për ta orientuar dhe mbajtur vitale zemrën dhe mendimin tonë, duhen marrë si shembull jeta e nderuar e Profetit, e sahabëve, e pasardhësve të tyre dhe e të gjithë njerëzve të shquar të Islamit që u kanë bërë dritë shekujve, duhet dëgjuar dhe studiuar ajo. Njeriu që e ballafaqon veten dhe jetën e vet me ata modele të mëdhenj, do t'i kërkojë llogari vetes duke menduar, “ata ishin të tillë, po ne, si jemi” dhe, kështu, do të ketë para vetes një forcë tërheqëse, kurse pas, një forcë shtytëse.

Leximi dhe dëgjimi rrëfimeve mbi të kaluarën me një zemër plot emocione jo sa për kujtesë, për jubile ose për kënaqësi, por me mendimin dhe dëshirën për t'u bërë me të vërtetë si ta dhe, si konkluzion, për ta rregulluar jetën tonë sipas jetës së tyre, është një specifikë mbi të cilën duhet qëndruar me forcë. Po qe se dalim para popullit dhe flasim e mbajmë fjalime duke u krenuar me arritjet dhe historinë tonë duke thënë se “ne jemi nipërit e një kombi fisnik e të shquar që u përhapëm në botë si rrufe duke çuar kudo përparimin”, ç'përgjigje do të japim po të na pyesin se “ata ashtu ishin, po ju ku jeni, ç'bëni”? E rëndësishme është të mund t'i japim përgjigje kësaj pyetjeje!

Te çdo njeri ekziston një dëshirë e bashkëlindur për imitim dhe përngjasim. Po qe se çdo baba do ta vëzhgojë fëmijën me vëmendje, do të vërë re se ai përpiket t'u ngajë atyre, prindërve. Po, ne shohim se si një fëmijë shtatë vjeç përpiket të heqë tespihe si i ati dhe t'i përngjasë atij në çdo gjë, gjer te mënyra e krehjes së flokëve! Në mosha më të përparuara, pastaj, shohim se fëmijët përpiqen të imitojnë dikush sportistët, dikush artistët e filmave. Madje, sikur pak të bisedohet me fëmijët, kuptohet menjëherë se ç'probleme ka në familjen e tyre. Këtu dëshiroj të përcjell një vëzhgimin tim.

Shoku i të atit e pyet djalin: “Kë do më shumë, nënën apo babanë?” Përgjigja e djalit është e tillë që ndoshta ka për ta çuditur edhe të atin: “Unë dua më shumë Allahun dhe të Dërguarin e tij!” Edhe një vëzhgim tjetër. Në Gjermani, një fëmijë mysliman shtatë vjeç, nxënës i shkollës fillore, futet në ujë së bashku me shokët e vet gjermanë, por, meqë ka turp të zhvishet, futet me gjithë rroba. Pastaj, kur shkon në shtëpi me pantallona të lagura dhe gjunjët me baltë, e ëma e pyet: “Ç'është kështu?” Përgjigja e djalit është interesante: “Nënë, e fala ikindinë në bar!”

Një mënyrë për të mbetur vazhdimisht vital dhe dëshirues, është jeta si sahabët, shokët e Profetit. Ashtu siç na e tregon Kurani Profetin si shembull, edhe Profeti na i ka paraqitur shokët e tij si drita të rrugës së drejtë, duke u shprehur për ta: “Janë si yjet!”

13. Duhet bartur shqetësimi për dyfytirësi dhe për hyrje në mëkat

Disa herë është mirë që, edhe pa ndodhur ndikimi i djallit, edhe pa pasur dyshim e lëkundje, edhe pa ndodhur ngurtësimi i zemrës dhe ambientimi, njeriu të bartë frikën dhe shqetësimin se mos ka dyfytirësi tek ai apo se mos po hyn në mëkat. Hz. Omeri, ibni Mesudi, Abdullah ibni Omeri dhe Hz. Aishja, madje, sipas përcaktimit të disa biografëve, rreth njëzet sahabë, shokë të Profetit, kishin frikë se mos tek ta kishte shenja dyfytirësie. Në fakt, lëkundja dhe dyshimi nuk patën vend

në personalitetin e tyre të shquar, megjithëkëtë, me ta ndodhte kështu për shkak të vetëdijes shumë të thellë të besimit që kishin dhe përgjegjësisë që ndjenin. Por kjo mund të ndodhë edhe me besimtarët e zakonshëm. Njeriu me një botëkuptim të tillë, e sheh vendin ku shkel si fushë të minuar. Në fakt, ky shqetësim dhe kjo frikë janë shfaqje të luftës së brendshme që bën njeriu me vetveten, me unin e tij, me dëshirat trupore e sensuale. Në qoftë se njeriu tregohet syçelë, i qëndrueshëm e i vendosur dhe i gjykon me kujdes të gjitha sjelljet dhe veprimet e veta, uni sprapset i mundur, gjë që do të thotë se njeriu e ka fituar luftën!

C) ÇËSHTJE TË BOTËS SË JASHTME

Gjer këtu qëndruam më shumë mbi çështjet që i përkasin botës së brendshme ose subjektive të njeriut dhe u dhamë peshë specifikave mbi përpjekjet e tij individuale dhe personale. Kurse tani të përpiqemi të merremi me specifikat që kanë të bëjnë me anën e jashtme të individit si pjesëtar i një kolektivi dhe me veçoritë e bashkësisë.

1. Jetesa në formë bashkësie është domosdoshmëri jetësore

Allahu e ka krijuar njeriun si një qenie që ka për të jetuar në kolektiv dhe e ka “lëshuar” atë në mesin e individëve të tjerë të të njëjtit lloj. Me aspektet e tij materialë e shpirtërorë, njeriu mundet të jetojë vetëm e vetëm në shoqëri e në bashkësi. Prandaj, qysh nga Ademi, njeriu i parë, në plan të parë ka dalë gjithmonë bashkësia, kurse individ ka mbetur në plan të dytë. Për më tepër, në disa periudha dhe fragmente kohore të caktuara, kjo çështje ka fituar rëndësi më të madhe në raport me të tjerat dhe pothuaj është kthyer në një domosdoshmëri. Ndërkaq, në shumicën e madhe të tyre, edhe kafshët jetojnë në bashkësi, pra, njeriu që është qenia më e përkryer, është i detyruar që në çdo faqe të jetës të jetojë në bashkësi dhe shoqëri. Ndërkaq, Islami i jep përparësi kësaj çështjeje dhe e përforcon edhe më shumë, aq sa edhe kur falet individualisht, myslimani lutet në shumës e jo në njëjës: “*Ijjake na’budu ue ijjake nestain!*”, “Vetëm Ty të adhurojmë dhe ndihmën vetëm prej Teje e kërkojmë!” Në çdo çështje, nga punët e veta të përditshme gjer te adhurimet, Kurani dhe Suneti e shtojnë besimtarin mysliman në bashkësi, i tregojnë avantazhet e bashkësisë dhe ia lidhin një pjesë të madhe të jetës me bashkësinë.

a) Lidhja në bashkësi, sot më e detyrueshme se kurrë

Sot globi tokësor ka marrë pamjen e një kombi dhe shteti të vetëm. Me anë të mjeteve të ndryshme, komunikacioni dhe ndërlidhja janë bërë shumë të shpejtë dhe, në sajë të lidhjeve dhe marrëdhënieve shumë të afërta e të ngushta ku ndodhen sot popujt, kombet dhe shtetet dashje pa dashje, dallimet teknologjike, ekonomike, politike e ushtarake, duke shkuar drejt zbutjes dhe rrafshimit, i ka sjellë ata në gjendje të krahasueshme e të konkurueshme me njëri-tjetrin. Kjo gjë e ka çuar çdo popull dhe komb në grupime brenda vetes, madje, si një rrjedhojë e domosdoshme e shekullit, brenda frymës dhe vetëdijes së këtij ballafaqimi, njerëzimi e ka ndjerë veten si një të tërë.

Në përmasa botërore, ideologjitë, nga shekulli XVIII e gjer më sot janë shtuar e rritur si degët e reja të një peme dhe, duke fituar origjinalitet, kanë gjetur përkrahës e mbrojtës, veç të tjerash, edhe si reaksion ndaj krishterimit. Për t’i forcuar dhe rrënjosur ideologjitë në fjalë, pothuaj në të gjitha vendet e botës, përkrahësit dhe mbrojtësit e tyre janë përpjekur me të gjitha mundësitë dhe forcat për të krijuar grupime e kolektiva. Ndërkohë, edhe të mundurit e luftërave botërore i kanë hyrë një

grupimi të veçantë me dëshirën, ambicien dhe vendosmërinë për t'i arritur fituesit dhe kryesuesit, madje për t'i kaluar. Fushatat kryqtare të zhvilluara kundër shtetit të madh osman kanë përbërë, në fakt, gjithashtu, modelet e formimit të shoqërisë duke kaluar nga popullata dhe shteti i copëtuar në një bashkim më të lidhur e të njësuar siç është kombi dhe shteti kombëtar. Sot, të njëjtët popuj, janë duke e paraqitur dhe bërë të ndjeshëm veten me emra dhe tituj të ndryshëm, të bashkuar në formë paktesh, tregjesh dhe blloqesh. Përtej kësaj, kombet që e kanë përfunduar ose duken sikur e kanë përfunduar brenda vetes procesin e natyrshëm të bashkimit e njësimit, kanë filluar të depërtojnë me anë të krahëve të dukshëm e të padukshëm brenda popujve apo kombeve të tjerë me qëllim për të formuar atje grupe që "të këndojnë këngët e veta"! Këtu, duke u mbështetur në mirësinë dhe tolerancën tuaj, dua të marr për shembull Rusinë dhe Kinën, armiqtë e mëdhenj, përfaqësuesit e mohimit hyjnor. Në këtë kohë kur ata po kthehen pas dhe po zbresin nga maja poshtë, në dashtë Zotit, kemi për t'i parë me kokë poshtë si ndëshkim të të këqijave që i kanë bërë kombit tonë! Ju, po të doni, me kolegjet e hapura në vendin tonë, me lëvizjet kulturore, me veprimtaritë e kolonës së pestë, me të gjitha llojet e botimeve si dhe me mënyrën e tyre të jetesës, mund të mendoni Amerikën, Anglinë, Francën dhe Gjermaninë, po ashtu edhe të tjerë me ato që kanë bërë e që u kanë rënë në kokë, pastaj!

Vendi ynë është rrugëkalimi i ideve, domethënë, vendi i takimit të kulturave të Lindjes dhe Perëndimit. Ashtu siç u bë, me Rrugën Tregtare të Lindjes, epiqendër tregtare për shekuj të tërë, vendi ynë u bë edhe vendi ku erdhën e kaluan ose u vendosën të gjitha idetë. Sikur çdo udhëtar është larguar pasi ka hedhur në këtë tokë pjellore ca fara.

Dhe, tani, thoni ju, po qe se ne nuk do të ishim të bashkuar e në unitet përballë shumë goditjeve nga e majta e nga e djathta, nga para e nga pas, përballë zemrave armike që rrihnin së bashku me ide dhe mendime me burim historik, kombëtar dhe fetar, si dhe përballë dallgëve dhe erërave të tmerrshme të prodhuara prej tyre, a do të ishte e mundur të arrinim gjer në ditët e sotme? Këtë pyetje mund ta bëjmë edhe në këtë formë: Për të mundur të qëndrojmë përballë sulmeve të njëpasnjëshme e të pamëshirshme të dhëmbëve dhe shumëdhëmbshve të panumërt (njëdhëmbshit, ata që kanë mbetur me një dhëmb, në gjendje grupimesh dhe bashkësish bëhen shumëdhëmbësh), për të mundur ta ruajmë tërësinë tonë kombëtare, për të mundur ta vazhdojmë jetën dhe vitalitetin tonë, madje duke u fryrë jetë dhe vitalitet edhe të tjerëve, a kemi apo s'kemi nevojë për t'u bashkuar në grup, në bashkësi, për të formuar një bashkësi të shëndoshë e të palëkundur? Ndërsa bota na hidhet sipër e organizuar dhe me njësi të mekanizuara, si mund të dalim para tyre si individë dhe të armatosur me pushkë? E vërteta është se zemrave që rrahin bashkë, as topi s'ka ç'u bën, prandaj, kur të mos kemi topa e pushkë, të paktën zemrat t'i kemi të forta me anë të bashkimit dhe njësimit!

Nga kulturat e ndryshme krijohen grupe e bashkime të ndryshme. Meqë në periudhat e mëparshme nuk pati e nuk u zhvilluan doktrina të ndryshme, rryma dhe kultura të ndryshme ideore si dhe meqë mbi njerëzit sundoi kultura e një tipi ose një tip kulture, një njeri të vetëm mund ta ndiqnin – në emër të së drejtës ose të së shtrembrës – masa të mëdha e të tëra njerëzish. Njerëzit e rritur e të formuar brenda një kulture dhe botëkuptimi, duke qenë më naivë, mund të drejtohen më lehtë, për rrjedhojë, me ta mund të përfitohet shumë më lehtë dhe qetë në krahasim me mendësinë e sotme, nga gjendja shpirtërore e masës, domethënë, nga psikologjia shoqërore. Dhe kështu ndodhte atëherë.

Kurse sot, siç e prekëm pjesërisht edhe më lart, secili përfiton nga kultura të ndryshme dhe botëkuptime shumë të ndryshme përhapen mes njerëzve shumë lehtë. Një vepër çfarëdo e shkruar

në skajin tjetër të botës, e shkruar në çdo nivel dhe botëkuptim, me çdo bindje dhe mendim, gjen në çast marrës dhe lexues në skajin e kundërt të botës dhe ushtron ndikimin e vet të caktuar. Kjo ka këtë kuptim: Në një periudhë të tillë të jetesës së ndërthurur me njëra-tjetrën të kulturave të ndryshme, njerëzit janë të shkëputur nga njëri-tjetri; në vend të jetës shoqërore, sundon jeta individuale. Me mendësinë “edhe Unë” të lindur nga vetëdija individuale e njohjes dhe kompetencës mbi dijen dhe kulturën e përgjithshme e të specializuar, secili është pothuaj një luan. Njerëzve të tillë u duket sikur janë të barabartë me të tjerët në njohjen e botës, në mos më të lartë se ta. Ndërkaq, të barabartët e shtyjnë njëri-tjetrin. Në një mjedis të tillë, secili individ, me bindjen se dija e vet, pushteti i vet, kapaciteti i vet janë të mjaftueshëm për të, thotë “pylli është imi” dhe kërkon të shëtisë nëpër të i vetëm si pronar që mendon se është, nuk i shkon mendja të hyjë nën kujdestarinë dhe mbrojtjen e dikujt tjetër, madje e sheh të panevojshme një gjë të tillë.

Së pari, duhet ditur se individi s’mund të bëjë qëndresë i vetëm përballë grupeve, bashkimeve dhe bashkësive perverse e destruktive. Një njeri, edhe sikur të jetë një “kulm”, nuk mund të jetojë vetëm me gjenialitetin e vet, me botën e vet të dijes dhe kulturës, madje me zbulimet dhe parashikimet e veta i vetëm përballë tufaneve të perversiteteve dhe mëkateve të këtij shekulli, edhe sikur të jetojë, mund të bëhet në çdo kohë pré e ujqe sepse është ndarë nga tufa! Veçanërisht, ai mbetet i privuar nga begatitë që do t’i sjellë, nga avantazhet që do t’i sigurojë dhe favorët që do t’i bëjë të qenët pjesëtar i një bashkësie. Njeriu, këmbët e të cilit s’shkelin mbi truall bashkësie, është si një gjethe e rënë nën këmbë dhe një pendë që e lehtë. Që të dyja shkelen me këmbë ose i merr me vete era nga të dojë. Prandaj sahabët, njerëzit më të fuqishëm e më të pushtetshëm të asaj kohe, madje, patën ndjerë nevojën për t’u organizuar në bashkësi e për të formuar një unitet. Prandaj, strehimi më i rëndësishëm që do të na mbrojë ne nga kurthet e ngritura prej armiqve tanë me anë të kanaleve dhe degëve shoqërore në rrugët nga do të kalojmë ne, si dhe nga sulmet e tyre kolektive, veçanërisht nga rënia viktimë e djallit, unit dhe tufaneve të mëkatit që janë armiqtë tanë moraloshpirtërorë, është bashkimi dhe uniteti në bashkësi. Ftesa për ta pranuar dhe përvetësuar këtë ide është një ndër çështjet më jetësore të ditëve tona.

b) Në bashkim ka kurdoherë fuqi

Ndërsa dy individë të veçuar nuk e kapërcejnë dot 1-shin, kur vendosen pranë e pranë, bëjnë 11, kurse kur vendosen pranë e pranë tre njësha, arrijnë në 111. Dhe tani, këtë gjendje që u përpoqëm ta shprehim në mënyrë vulgare me një lojë shifrash, mendojeni duke e krahasuar ndriçimin që do të bëjë një njeri duke mbajtur në dorë një pishtar në errësirë, me ndriçimin që do të bëjnë 11 ose 111 vetë. E njëjta gjë ndodh edhe kur duhet ngritur ndonjë peshë. Shtojini fuqisë së thjeshtë fizike edhe aleancën e mundësive dhe aftësive mendore e shpirtërore me dijen, njohjen, mendimin dhe arsyen. Veçanërisht, në qoftë se në këtë mes ka edhe unitet qëllimi e ideali si dhe përpjekje e vendosmëri të njëjtë, atëherë zemrat me të vërtetë fillojnë të rrahin me një forcë të tillë që s’kanë ç’u bëjnë as topat! Po kështu si kjo, po të mendoni se jeni ndriçuar nën shikimet plot dritë të stolisura me mëshirë, dhembshuri dhe buzëqeshje drite të shokëve me nivel shumë të lartë jetësor të botës së brendshme, të botës ndjesore e shpirtërore dhe në fytyrat e të cilëve do të mund të sodisni figura engjëjllore, do ta kuptoni akoma më mirë se në ç’atmosferë kundër mashtrimeve të djallit dhe aftësisë djegëse të mëkateve ndodheni! Brenda kësaj atmosfere do të shtohet edhe forca e vullnetit dhe e zemrës suaj të dobët e cila do të fitojë rezistencë. Si rrjedhojë, do të bëheni zotër të një fuqie të dyanshme.

c) Në bashkësi ka mëshirë dhe në lutjet e bëra në bashkësi ka miratim dhe pranim

Siç shprehet porosia profetike, mëshira e Allahut është me bashkësinë. Reja që përsillet mbi bashkësinë, pothuaj lëshon mëshirë mbi atë që hyn nën të! Lutja e një personi të vetëm si lutje e një individi, bart aq pika mëshire sa ç'mund të bartë. Kurse kundërvlera e një lutjeje të një bashkësie me një bashkim të plotë e të vërtetë dhe në një gojë, është shumë herë më e madhe se shumëfishi i mëshirës së zbritur mbi një individ dhe nuk pikon, por zbret me rrëke! Po qe se dëshironi të jeni një pemë prodhimtare e hapur ndaj mëshirës (hyjnore), shihni të bëheni një pemë brenda pemëtores ose një dru brenda pyllit. Po të mbeteni vetëm, s'ju bie asnjë mëshirë, pra, mund të thaheni e të merrni fund, kurse mbi pemëtoren ose pyllin do të bjerë mëshirë patjetër dhe edhe ju do të përfitonit me shumicë nga ajo mëshirë. Prapë, le të themi se jeni një qytetar civil, nuk keni armë, kurse fuqinë dhe forcën i keni sa dhe kapitalin. Por po të ndodheni në ushtri, qoftë edhe i vetëm, krahas armës, forcës, aftësive individuale dhe guximit, gjeni pranë edhe forcën dhe fuqinë e njësisë ushtarake ku merrni pjesë dhe mund të ndodhë që të kapni rob edhe një gjeneral, madje, edhe një ushtri!

Qoftë për të mirë, qoftë për të keq, në të gjitha kushtet, fuqia dhe ndikueshmëria e bashkësisë janë tej çdo përfytyrimi. Ndërkaq, është shumë e rëndësishme që një personalitet i tillë moralo-shpirtëror i bashkësisë t'i drejtohet dhe lutet Allahut për ta vënë në veprim mëshirën hyjnore e për t'u bërë pretekst për ndihmën hyjnore. Kjo është aq e rëndësishme, saqë edhe njerëzit perversë, madje, të bëjnë lutje në bashkësi, në disa raste mund t'i prapësojë lutjet tuaja të vetmuara. Në këto kushte, për të fituar mundësi për t'iu përgjigjur bashkësive të perversitetit e për të qëndruar përballë tyre, edhe besimtarët kanë nevojë të lidhen në bashkësi, të mbrohen si bashkësi dhe të luten me frymë bashkësie!

Një dobi e madhe e pjesëmarrjes në bashkësi është edhe kjo: të këqijat dhe mëkatet e personit mund të bëhen pengesë që lutjet e tij të ngjiten në qiellin e pranimit, kurse është pothuaj e padiskutueshme që lutjet e individëve të lidhur në bashkësi, lutjet e bashkësisë, pranohen. Në një hadith kudsî, Allahu thotë: *"Humul kaumu la jeshka bihim xhelisuhum"*, "Ata janë një bashkësi e tillë që ai që ndodhet mes tyre nuk bëhet i pafat!" Sigurisht, ai që ndodhet në trëndafilishte, të paktën përfiton nga aroma e trëndafilave!

d) Bashkësia është si rrufepritëse

Bashkësia jo vetëm është mjet për ta ftuar mëshirën hyjnore me lutjet dhe forcën tërheqëse të saj dhe për t'ua çuar zemrave, por edhe një pretekst i rëndësishëm për përzënien e shqetësimeve, kokëçarjeve dhe fatkeqësive. Qielli është shumë i lidhur me zemrat dhe duart e fytyrave qiellore të hapura ndaj tij. Po, lutjet dhe përgjërimit si bashkësi, ndërsa tërheqin buzëqeshjet qiellore në pëllëmbët e hapura ndaj Mëshirës, në të njëjtën kohë shkaktojnë edhe përzënien dhe largimin e fatkeqësive të afuara në tokë. Atyre që kanë mbetur larg nga rrufepritësi, mund t'i qëllojnë çdo çast shigjetat prej rrufeje të djallit. Disa herë ndodh që ai që largohet nga bashkësia për dy ditë, bëhet sikur të jetë larguar katër ditë, ai që largohet katër ditë, bëhet sikur të jetë larguar tetë ditë dhe ta ndjejë veten në boshllëk dhe të ndrydhur. Kjo është krejt si puna e errësirës që, sa më shumë të largohet nga burimi i dritës, bëhet më e thellë.

2. S'duhet mbetur vetëm, patjetër duhen bërë shokë të mirë

Siç u theksua më lart, Allahu e ka krijuar njeriun si një qenie shoqërore. Njeriu që jeton vetëm, mund të mbetet edhe i pafuqishëm e pa mbështetje përballë erërave të perversitetit që e sulmojnë

nga të katër anët, edhe i privuar nga avantazhe të tilla si pranimi i lutjeve. Përtej kësaj, ai mund edhe të bëhet objekt goditjeje për shigjetat e helmuara të djallit. Nisur nga kjo, Profeti (s.a.s.) thotë: *“Ai që jeton vetëm, është djall!”* Po, njeriu që jeton vetëm, herët a vonë mund të bjerë në kurthin e djallit, mund të bjerë në dorë të djallit dhe mund të bëhet gjah i kthetrave të kuqe të djallit! Çdo mendimi i keq i hedhur nga djalli në mendje dhe përfytyrim, është si një farë që do të mbijë dhe hedhë shtat në dheun e vetmisë dhe shqetësimit shpirtëror. Te njeriu i vetmuar, mendjen, zemrën dhe shpirtin e të cilit e mbushin farat e të keqes dhe mëkatit, është pothuaj e pamundur që të mos vijë një ditë që këto fara të zhvillohen, të përhapen duke shpërthyer jashtë tij, pra, duke u bërë të dukshme e të japin fryte të mëkatit. Çdo njeri, kushedi sa herë e ka ndjerë se si e kanë shtypur këto lloj mendime e përfytyrime që e vënë në vështirësi herë pas here, se rrënja e këtyre mendimeve të këqija duhet tharë qysh kur janë ende farë, dhe është përpëlitur me pendesë. Vëllezërit dhe shokët tanë të shërbimit ndaj kauzës së përbashkët, janë ndihmësit tanë tejet të dobishëm që mendja, zemra dhe shpirti të mos na pushtohen prej farërave të së keqes që vijnë prej djallit dhe që këto të pastrohen qysh në krye.

Kur njeriu flet, dëgjon ose sheh, veprimtaritë e mendjes dhe përfytyrimit të tij marrin forma dhe ngjyra lidhur dhe në vartësi të këtyre ndjenjave. Duke i kryer këto tri veprimtari menjëherë, pra, duke biseduar me shokët në fjalë, duke u bërë pyetje e duke marrë përgjigje prej tyre, domethënë, edhe duke folur, edhe duke dëgjuar, edhe duke menduar, ju nuk mund të organizoni udhëtime në botën tuaj të përfytyrimit, sepse veprimtaria mendore dhe vëmendja ju është përqendruar në bisedë, dëgjim dhe mendim (arsyetim) duke u burgosur në një farë mënyre. E kundërta e kësaj, njeriu i shkëputur prej shokësh, me mendjen e tij të mbetur lirë, sidomos “po të hyjë nën jorgan”, zhytet e humbet në botët e përfytyrimit që dëshiron ose ku e zvarrit djalli dhe ndodh që nuk mund të kthehet pa marrë plagë nga ai udhëtim iluziv me pamje rrëqethëse...

Njeriu duhet të ikë nga të mbeturit vetëm siç ikën nga gjarpri, sepse vetmia i hap rrugë tronditjes së shpirtit të njeriut nga mendimet prej gjarpri. Të njëjtat rreziqe ekzistojnë edhe kur janë dy vetë, sepse është gjithsesi e mundur që dy vetë të merren vesh për të bërë një të keqe. Kurse, sipas llogaritjeve, është pothuajse e pamundur që tre vetë të merren vesh për të bërë të këqija dhe mëkate. Duke e vënë gishtin mbi këtë të vërtetë, Profeti (s.a.s.) ka thënë: *“... edhe dy vetë janë djall (djaj), kurse tre vetë janë xhemaat (bashkësi)!”* Tre vetë përbëjnë xhemaat dhe, me ta, vrimat nga mund të hyjë djalli për të zënë vend te njeriu, zvogëlohen shumë! Edhe në qofshim të martuar, edhe në qofshim beqarë, nevoja jonë për shokë me shpirt dhe vullnet të fortë që do të na merrnin pranë në shtëpi, në shkollë, në vendin e punës, në rrugë e në treg për të na i mbrojtur ndjenjat dhe mendimet nga frymëzimet djallëzore, është sheshit.

Shumë herë dhe në shumë vende, zemra dhe fuqia mund të mos na mjaftojnë për të na mbajtur të gjallë e vitalë. Vështirimet mund të na mjegullohen, gjoksin mund të na e mbështjellin mjegulla dhe tymi, zemra mund të na ngurtësohet dhe dashuria me emocionin mund të nisin të treten e të humbin mes punëve të përditshme dhe kësaj jete të shumëngjyrshme dhe, si rezultat i një bllokimi që mund të shkaktohet për pasojë, Zoti na ruajt, mund të biem në mjerim. Por po të jemi të paktën tre vetë, në mos nga të dy shokët e tjerë, nga njëri, kemi mundësi të ushqehemi me mëshirë, të freskohemi me frymëzime e, kështu, kemi mundësi të vazhdojmë marrim frymë në një atmosferë pasioni dhe dëshire të lartë!

a) Shoku i mirë të çon në xhenet

Meqë është vendi, këtu duhet ta bëjmë të qartë edhe këtë specifike të rëndësishme: Shoku na duhet, por jo çdo shok! Duhet të zgjedhim shok të mirë! Sa të bukura janë fjalët e të parëve tanë që s'i vjetron koha: *Më thuaj ç'shok ke (me kë rri), të të them cili je! Shih rrushi rrushin e piqu! Trëndafili rritet e çel mes trëndafilash! Shoku i mirë e çon njeriun në xhenet, shoku i keq, në xhehenem! Shoku i mirë është si shitësi i parfumeve, të paktën ke qejf t'i rrish pranë se i vjen erë e mirë; kurse shoku i keq është si fryrësi i calikut të farkëtarit, i cili, edhe në mos pastë asnjë anë të keqe, të shqetëson me erën që kundërmon!* Sigurisht, çdo njeriu i ngjitet diçka e mirë apo e keqe nga shoku me të cilin rri!

b) Duhet ndodhur mes shokësh të mirë

Ka miq e shokë të cilët marrin frymë përjetësie në rrugën e përjetësisë, fytyra e të cilëve rrezaton vërtetësi dhe në vullnetin e të cilëve ndjehet vullneti i Allahut, të tillë që, kur u shkon pranë dhe hyni në atmosferën e tyre, fitoni fuqi sikur të jeni ulur gju më gju me një profet dhe mbusheni me dashuri e hare. Fjalët dhe sjelljet e tyre që janë si eliksir, i fshijnë me një lëvizje mendimet dhe ndjenjat e këqija që kanë nisur të gjelbërojnë si alga brenda vetes suaj. Shoku i mirë është si një mik prej drite i cili, me këshillat e tij, do t'ju ngrejë peshë zemrën, do t'ju lëshojë në shpirt pasion dhe emocion dhe do t'i sjellë mendimit tuaj ndriçim. Ja, pra, miqtë e ndriçuar e dritëdhënës dhe shokët e vërtetë na duhen nevel!

Po të hidhni një monedhë mbi një truall ku ka shumë magnete, ajo do të tërhiqet nga magneti më i fuqishëm dhe do të ngjitet pas tij. Edhe meteorët drejtohen andej nga është trupi me vëllimin më të madh dhe fuqia tërheqëse më e madhe!

A dëshironi, pra, që bijtë tuaj të bëhen njerëz të drejtë, të virtytshëm, të sakrificës, me zemrën plot besim, me mendjen të ndriçuar, të bindur ndaj prindërve dhe shërbyes ndaj atdheut dhe popullit? Atëherë duhet t'ua lini amanet shokëve të mirë e të pastër që do t'u japin atyre formën që dëshironi siç i japim dyllit. Kështu, në mjedisin e njerëzve që do t'u shërbejnë si shembuj dhe bashkëmoshatarëve të të njëjtit nivel, bijtë tuaj do të marrin, sipas moshës dhe nivelit të tyre, formën e mjedisit ku ndodhen. Ta zëmë se një nxënës të tetëvjeçares e ulni në tavolinat e universitetit dhe bëni të gjitha përpjekjet dhe shpenzimet që ai të mësojë diçka, mirëpo me një trajtim të tillë, as atij mundet t'i jepni diçka, as vetë mundeni të arrini diçka! Po kështu, po qe se e kapni nga krahu një të ri dhe e çoni në xhami ku ndodhen njerëz shumë më të mëdhenj në moshë se ai, madje edhe nëse ia dorëzoni një njeriu të shquar që di t'i lexojë mendimet, nuk do ta mbani dot aty, nuk do t'ia kënaqni dot mendjen dhe zemrën. Para së gjithash, ai do të shohë nëse ndodhen aty të rinj të moshës së tij, që mendojnë e sillen si ai. Kur të mos i gjejë ata, vështrimet do t'i hasin vazhdimisht fytyra që do t'i duken aspak të këndshme dhe, kështu, do të mbetet i pakënaqur. Ai do të mendojë se “të jesh mysliman është bukur, mirëpo feja islame qenka feja vetëm e pleqve, e atyre që shkojnë në xhami për të gogësitur e dremitur dhe e atyre që s'marrin vesh nga çështjet shkencore” dhe atëherë do ta keni të pamundur të ndikoni mbi të! Prandaj, kur të kërkohet t'i jepen një të riu ca gjëra në emër të besimit dhe fesë, jo vetëm duhen mbajtur parasysh niveli i tij mendor dhe logjik si dhe shkalla e zhvillimit të tij arsimor, por edhe duhet t'i tregohet se Islami është i jetueshëm dhe i mundshëm për t'u praktikuar, në mënyrë që ai të ndjejë dëshirën për ta jetuar dhe të thotë: “Ata bëjnë, unë pse të mos bëj? Ata falen, unë pse të mos falem? Ata përpiqen, unë pse të mos përpiqem? Ata lexojnë, unë pse të mos lexoj?” Të thotë kështu, ta vrasë mendjen për ta jetuar Islamin dhe të veprojë. Krijimi i një gjendjeje të tillë shpirtërore bëhet i mundur vetëm mes shokësh që shkëlqejnë nga të gjitha drejtimet dhe hapin rrugën për në xhenet, parajsë. Ndërkaq, në anën e

kundërt është një brez të rinjsh që s'duam aspak ta përfytyrojmë, një brez me shprehi pijesh dhe dëshira e sjellje të ulëta, një brez aventuresk të pangopur e të pakënaqur që vërtitet në boshllëk. Po qe se nënat e baballarët që thonë se i duan fëmijët e tyre dhe se kanë mëshirë e dhembshuri për ta, janë krejtësisht të sigurt e të sinqertë në ndjenjat e tyre, duhet t'ua dorëzojnë fëmijët kalorësve të dritës!..

Edhe dëgjimi i atyre që na japin këshilla është një nga mënyrat mbrojtëse dhe ushqyese që na japin mundësi ta prishim ambientimin dhe humbjen e qartësisë, ta zbusim zemrën dhe t'u kundërvihemi shtytjeve të djallit për të dyshuar e për t'u lëkundur, dhe nxitjeve të mëkatit. Siç është një qenie krejt e veçantë me mendjen, logjikën dhe gjykimin e tij, njeriu, me zemrën që i ngrihet peshë, me ndërgjegjen që i rrëqethet, me sytë që i lotojnë, është një lëmsh ndjenjash sentimentale e shpirtërore. Prandaj njeriu ka nevojë të thellohet në ndjenja, të pasurohet në botën shpirtërore e të zgjerohet në jetën meditative. Sigurisht, ashtu siç ka nevojë për shkrirjen e ajsbergëve të formuar aty-këtu brenda tij, njeriu ndjen një dëshirë të fortë për çezmat që lëshojnë qumësht moralo-shpirtëror me të cilin të plotësojë ushqimin e vet moralo-shpirtëror. Me herë të tëra i thotë Kurani Profetit që të flasë e të tregojë dhe ai thotë se *“feja është këshillë”*. Nga ana tjetër, gjithashtu sipas shprehjes së porosisë profetike, Profeti është këshilluar të jetë *ose mësues, ose nxënës, ose dëgjues*, por kurrësi “një i katërt”! Në këtë mënyrë, të tre momentet pothuaj bashkohen në një pikë dhe vëmendja tërhiqet për të folur atje ku duhet dhe kur duhet, si dhe për të dëgjuar atje ku duhet dhe kur duhet. Sa kuptimplot është fakti që Profeti, duke ua mësuar shokëve Kuranin, u thoshte: *“Lexoni që të dëgjojmë!”*

Atëherë, themi se dëgjimi i predikuesve dhe këshilltarëve që do t'ia ngrenin zemrën peshë e do t'i zbusnin, që do t'ia hiqnin papastërtinë dhe ndryshkun e reflekseve dhe ndjenjave, që do t'ia nxisnin dëshirën për botët e përjetshme e, që, në këtë mes, me anë të trajtimit të çështjeve aktuale fetare e shkencore, do t'ia ndriçonin botën mendore, është për njeriun një nevojë me po aq rëndësi sa dhe buka dhe ajri! Prandaj njeriu kurrë nuk duhet të thotë për diçka se e di, prandaj s'ka pse ta dëgjojë përsëri. Ashtu siç përsëriten etja dhe uria dhe njeriu ka nevojë në mënyrë të përsëritshme për të ngrënë e për të pirë, ashtu dhe dëgjimi i predikimeve dhe këshillave që konsiderohen ushqim i zemrës dhe shpirtit dhe luajnë rol mbrojtës sidomos nga e keqja e djallit dhe mëkatit, është për njeriun nevojë e përsëritshme dhe e domosdoshme një mijë herë më e madhe se uji e buka! Ju dëgjoni vazhdimisht nga goja e njerëzve të thjeshtë të popullit për persona që e kanë lënë pijen dhe shumë e shumë shprehi të tjera të këqija dhe janë kthyer në njerëz që vrapojnë e përpiqen për të bërë të mira si rrjedhojë e pjesëmarrjes së rregullt në biseda e predikime. Edhe sikur folësi të mos jetë njeri pasionant dhe emocionues, edhe sikur të mos jetë i aftë për të treguar krejt sinqerisht dhe duke i prekur dëgjuesit, prapëseprapë mund të ndikojë mbi ta, sepse është Allahu që e bën ndikues. Sipas meje, kjo është një nga mungesat tona më të mëdha të ditëve të sotme. Kur predikonin të parët tanë, pjesëmarrësit në xhami emocionoheshin, zemrat mbusheshin me pasion dhe emocion, gjer atje sa, shpesh herë, predikimi ndërpritej. E përgjithshmja ishte se dëgjuesi kthehej me botën e brendshme të larë e të pastruar. Megjithatë, nuk jemi pesimistë. Ne kemi besim të plotë se Allahu i cili pas çdo mbarimi nis një lindje, do t'i dërgojë përsëri mes nesh ata njerëz zemërdjegur e sypërlotur që u ngrihet peshë zemra me emocion!

c) Duhet të bërë shokë që këshillojnë dhe tërheqin vërejtjen

Këtu duhet të pohojmë edhe se sa i rëndësishëm është shoku që të këshillon, të tërheq vërejtjen dhe të paralajmëron. Në lidhje me diskutimet që bëme gjer tani, është shumë e rëndësishme që të

gjejmë dhe caktojmë për vete si vërejtës një shok të mirë që të na bëhet kujdestar dhe roje, duke i dhënë atij kompetencë dhe autorizim të plotë. Ai duhet të jetë një shok i tillë që, sapo të vërejtë tek ne një lëshim, një ambientim dhe humbje kujdesi, pak prirje për mëkat dhe pak rrëshqitje, menjëherë të na tërheqë vërejtjen e të na paralajmërojë, po të duhet, të na e tërheqë fort veshin dhe, kur ne ta tundim kokën me kundërshtim, të na kapë për dore e të na nxjerrë në një breg shpëtimi. Edhe ne, kur të jemi mërzitur, kur të vërejmë një shuarje në vetvete dhe këmbën të na ketë rrëshqitur, të vrapojmë në prehrin e këtij miku të besueshëm e besnik e të këtij shoku të mirë e t'i themi: "Ti je një kopshtar, një lulishtar, shëtitmë mua në lulishte e trëndafilishte e më trego! Më nxirr nga vorbullat e kësaj jete e nga labirintet e mëkatit e më ço në klimat e ndritshme!" Ashtu siç vrapojmë menjëherë te miku më i afërt e i besueshëm kur të na ketë dalë në shesh ndonjë çështje në lidhje me familjen ose kur të na ketë pësuar tronditje tregtia, ashtu siç nisemi menjëherë për te mjeku kur të ndjejmë therje në stomak ose në mëlçinë e zezë, ashtu duhet të vrapojmë për tek shokët tanë që i kemi ilaç dhe shërim dhe mbështetje për fuqinë moralo-shpirtërore përballë mikrobeve të mëkatit dhe dyshimeve dhe gënjeshtreve të djallit që na e kërcënojnë jetën shpirtërore!

3. Në mjedisin e jashtëm duhet t'i ruajmë sytë nga pamjet haram

Sa herë që dalim jashtë, mund të na hyjnë në sy një sërë haramesh, gjërash të ndaluara e mëkatore. Po t'i mbyllim sytë, nuk do të kemi mundësi të ecim, kurse po t'i mbajmë hapur, atëherë, skena të padëshiruara do të na e turbullojnë botën shpirtërore, do të na e mjegullojnë qartësinë e gjykimit dhe do të na fusin në mëkate.

Njeriu që mbyll sytë para gjërave të konsideruara haram, domethënë, të pamiratuara, të pabekuara, të dëmshme e të ndaluara, kurrë nuk pëson humbje materiale e moralo-shpirtërore. Njëkohësisht nga një njeri i tillë nuk i vjen dëm askujt. Një njeri i tillë që punon me rendiment, me drejtësi dhe sinqeritet dhe që me të vërtetë shërben, kurrë nuk bie viktimë e jetesës djallëzore. Nga ana tjetër, seksi i kundërt që e ekspozon veten ndaj vështirësive të uritura, fundi i fundit nuk ka asnjë përfitim! Lëre përfitimin, po llogarit humbjet e veta, të partnerëve, të shoqërisë dhe të vendit duke pasur parasysh spitalet, burgjet, korridoret e gjykatave dhe shtyllat e gazetave që janë dëshmitarët më të mëdhenj të këtij realiteti. Nuk duhet të harrojmë se frytet më prodhimtare i japin sipërfaqet tokësore të mbrojtura nga rrezatimet e dëmshme. E ç'mund të pritët nga zemrat e shkatërruara si rezultat i mbetjes pa mbrojtje nga shikimet djegëse dhe rrezet vrasëse dhe nga vullnetet e paralizuara?

a) Është gjithmonë e mundur që në mjedisin e jashtëm të na bien në sy pamje haram

Profeti ynë (s.a.s.) thotë: *"Do të vijë një kohë e tillë kur mbrojtja e besimit do të jetë si mbajtja e prushit në pëllëmbë!"* Po, ta mbash në pëllëmbë, të djeg, ta hedhësh, të ikën dore!

Gjithashtu, Profeti thotë: *"Shikimi është nga shigjetat e helmuara të djallit!"* Po të ngulet në zemër ose po të zbresë te ajo përmes shikimit, njeriut i merren mendtë, i turbullohet gjykimi. Dhe, pastaj, Profeti i bëhet interpret Krijuesit të Botëve: *"Kush e kundërshton shikimin nga frika ndaj meje, i lëshoj në zemër një gëzim dhe hare besimi, kënaqësinë e të cilit ta ndjejë në thellësitë e zemrës!"*

Shihni, tani, se ç'bën Profeti ynë (s.a.s.) i cili mban qëndrim kundër këtyre shigjetave të helmuara të djallit dhe, si në çdo punë tjetër, edhe këtu, e fillon nga të afërmit e vet!

Ndërsa ndodhej në haxh dhe po zbriste nga Arafati shaluar dhe me kushëririn, Fadlin, të birin e të ungjit Abas, në vithe, Profeti ia kthente kokën djalit sa nga njëra anë në tjetrën që të mos i kapej syri pas grave që kalonin nga të dyja anët! Le ta shohim ngjarjen me vëmendje: E para, ngjarja ndodh në haxh, kur është pothuaj e pamundur të shfaqet një ndjenjë e tillë. E dyta, siç shprehet nëna e myslimanëve, Hz. Aishja, në një kohë kur femrat kalonin veç meshkujve dhe pa e kthyer fytyrën nga ta, Profeti ia kthen kokën sa andej-këtej kushëririn të vet Fadl që e kishte pranë në vithe të kalit dhe për të cilën nuk mund të dyshohej kurrë për një gjë të tillë. Dhe një ngjarje e tillë ndodh në atmosferën dhe klimën vazhdimisht përkëdhelëse, zemërzbutëse të Shekullit të Lumtur që kundërmonte fjalë hyjnore dhe frymë Xhebraili dhe i bënte shpirtrat ta jetonin jetën tjetër që në këtë botë! Ju lutem, kur sot, madje, nuk mund të mendojmë, edhe sikur të duam, gjëra të këqija kur hyjmë në xhami ose në një kuvend, si do ta vlerësojmë gjestin e Profetit për t'ia kthyer kokën kushëririn sa nga njëra anë, në tjetrën, me qëllim që në shikimin e tij të mos hyjnë iluzione të tjera, që të mos vijë ndonjë shigjetë endacake e t'ia shpojë zemrën, që në botën e tij të brendshme të mos përkatet farë faji e mëkati në një kohë kur kjo s'ishte aspak e mundur?

Kuptimi që shpreh kjo ngjarje, është ky: Të mos lejosh të hidhet në pyll qoftë edhe një fije shkrepëse e djegur për ta parandaluar plotësisht djegien e pyllit, të mos e dobësosh sadopak shërbimin e rojës dhe të mos i mbyllësh sytë edhe në kohë paqeje kur të mos ekzistojë as dhe mundësia për ndonjë sulm të armikut. Po, të eliminosh të gjitha shkaqet që çojnë në haram, prostitucion, dhunë, krim, etj., t'i mbyllësh të gjitha vrimat me mendimin se mos një ditë aty kalon gjarpri, të ngresh prita të pakalueshme që të mos shuhen sa e sa jetë e të mos shemben sa e sa fole familjare vetëm nga një vështrim, nga një buzëqeshje, nga një prekje, pra, të eliminosh shkaqet që shtynjë te të këqijat dhe t'i parandalosh mëkatet që në krye. Ja kjo është rruga e vizatuar nga Allahu!

Gjithashtu, Profeti i thotë kështu Aliut, të nipit që qe bërë mysliman fëmijë shtatëvjeçar, që qe rritur në frymën e tij dhe dhëndrit që do ta vazhdonte brezin e tij të pastër: “O Ali, shikimi i parë është në favor tënd, kurse i dyti, në dëm tënd!” Domethënë se, ndërsa në shikimin e parë të ngulur në mënyrë të pavullnetshme, nuk ka mëkat, shikimi i dytë dhe shikimet e tjera në vazhdim, ku ka hyrë në veprim dhe vepron vullneti, janë haram, sepse aty luan rol uni, ndjenjat, gjë që i bën ato hallkën e parë të zinxhirit që do ta lidhë dhe do ta humbë njeriun. Kështu e parandalonte qysh në fillim Profeti rrugën që çon në haram duke mos u dhënë mundësi kalimi mëkateve!

b) S'duhet të dalim në rrugë sa herë që të mërzitemi

Ai që i mërzitet shpirti, mos duhet të dalë në rrugë? Ç'mendësi e shtrembër! Një e çarë nga mund të kalojë me lehtësi djalli për t'u futur brenda... Njeriu që pandeh se mund ta kapërcejë mërzitjen në rrugë, e pëson si ai që i ikën shiut e bie në breshër!

Mërzitja dhe shqetësimi ndodhin kur zemra s'është e ngopur dhe e kënaqur, kur nuk ka krijuar lidhje me Allahun dhe Profetin, kur nuk është e lidhur ngushtë me adhurimet, kur njeriut i mungon shoku dhe shoqëria, kur njeriu nuk lexon dhe mediton, kur nuk preokupohet me diçka dhe kur nuk kryen ndonjë shërbim. Njerëz të tillë janë për djallin të çara dhe objekte që mund t'i shtjerë në dorë e të bëjë si të dojë. Shëtitja e njeriut të djegur një herë nga djalli përsëri në ato vende ku bien shigjetat e djallit, i ngjet veprimit të njeriut i cili, pasi është përvëlur një herë pasi ka pirë ujë të kripur deti, shkon përsëri në det për ta shuar etjen me ujë deti!

Çështja ka edhe një aspekt tjetër: Mërzitja dhe shqetësimi mund të kuptohen edhe si pasoja të veprimit mbi njeriun të atributit të Allahut “*Kabû*”, kapës, shtrëngues, rrëmbyes, pra, si një provë

për njeriun. Në përfundim të kësaj prove a të këtij provimi, del në shesh shkalla e besnikërisë dhe qëndresës së njeriut, robit të Zotit. Duhet ditur mirë edhe kjo që namazi i falur me këtë gjendje shpirtërore është shumë më i çmuar se namazi plot dëshirë e hare i falur nga shokët në atmosferën dëshiruese të xhematit, sepse në atë gjendje shpirtërore njeriu është pothuaj në vijën e frontit. Pastaj, si fshehja e diellit pas reve, edhe kjo gjendje është kalimtare. Me atributin e tij *Bast*, shtrues, hapës, zgjerues, prehës, qetësues, Allahu ia zgjeron dhe lehtëson njeriut zemrën dhe i jep hare. Me aq sa ç'u shtrëngua e ç'vuajti njeriu, merr shpërblim dhe mirësi!

c) Duke dalë jashtë, u duhet kushtuar kujdes disa gjërave të veçanta

Edhe largimi i njeriut nga mëkatet me të cilat është mësuar, shkakton shqetësime shpirtërore të fuqishme si rënia e narkomanit që s'ka gjetur dot një tabletë tjetër, në krizë, kështu që, sapo t'i krijohet një atmosferë mëkati, bie brenda menjëherë. Për rrjedhojë, qoftë për mëkatarët, qoftë për ata që ikin nga mëkati sikur të iknin prej gjarprit dhe akrepit, janë disa gjëra të veçanta që duhen bërë kujdes në daljet jashtë që pandeh se është me vend t'u hedhim një sy.

** Nuk duhet dalë jashtë pa nevojë dhe duhen bërë përpjekje për t'i mbaruar të gjitha punët me një të dalë si dhe duhet qëndruar larg vendeve ku mëkatet rrjedhin si përrua kur nuk na shtrëngon ndonjë punë ose detyrë ose ndonjë shërbim në emër të besimit për të kaluar andej.*

** Duhet menduar për ta bërë rrugën siç duhet.* Sahabët shpesh herë dilnin jashtë në rrugë ose në treg për të folur dhe për t'u treguar njerëzve për të drejtën dhe të vërtetën. Këtë e bënin edhe Ebu Bekri, Omeri dhe Ebu Dherri (Allahu qoftë i kënaqur me ta!). Ata që dalin jashtë me një synim të tillë, duke u sjellë dhe duke vepruar siç duhet, mbrohen nga mëkatet. Profeti ua ndalonte shokëve të uleshin dhe rrinin nëpër sokakë e në anë të rrugëve. Kur shokët i thoshin se ulja dhe ndenja kishte dobi e përfitim, atëherë Profeti u thoshte: "Atëherë, jepjani hakun rrugës!" Me këto fjalë ai u thoshte të pastronin gurët dhe ferrat e rrugës, të merrnin e jepnin përshëndetjet e kalimtarëve dhe t'u tregonin atyre për të drejtën dhe të vërtetën duke i penguar nga të këqijat e duke i këshilluar për të bërë të mira. Ja, pra, kur të ekzistojnë ky qëllim i pastër, të këqijat dhe mëkatet mund të kthehen në mirësi dhe bukuri!

** Duhet dalë jashtë vigjilent dhe i pajisur.* Siç ecën në fushë të minuar, siç vërtitet i pajisur dhe i armatosur në zonën ku ndodhen armiqtë e tij për vdekje, njeriu duhet të jetë i pajisur dhe i armatosur edhe në rrugë e në treg ku e rrethojnë mëkatet nga të gjitha anët. Ndryshe, po të dalë vetëm për vetëm me ndjenjat e veta, pa bërë përgatitje, i paarmatosur, krejtësisht i shkujdesur dhe pa përgatitur mburojën shpirtërore kundër shigjetave të helmuar të djallit dhe plumbat shpirtërorë kundër atij vetë, atëherë shpirtin mund t'ia mbështjellin të këqijat, pamjet mëkatore dhe çdo lloj shëmtie tjetër. Pa le sikur kjo gjendje të përsëritet disa herë. Atëherë ai do të vërtitet nëpër rrugë e treg me ndjenjat të vdekura, indiferent ndaj mëkateve dhe të këqijave, gjë që është pikërisht ajo që kërkon djalli...

** Para daljes jashtë duhet të kalohet në gjendje të përqendruar.* Para se të dalim jashtë, duhet të lexojmë disa gjëra, duhet të vështrojmë disa gjëra, duhet të dëgjojmë disa gjëra që të na e hedhin zemrën përpjetë, që të na emocionojnë, që të na i njomin sytë dhe të na i vënë ndjenjat në lëvizje me qëllim që kjo përgatitje dhe ky tensionim të na shërbejnë si pengesë ndaj mëkateve.

** Jashtë duhet shoqëruar me shokë të mirë.* Duke menduar se jashtë ka një sërë armiqtë që na presin ne, ndërsa po bëhemi gati për të dalë jashtë, duhet të dalim së bashku me një a dy roje, domethënë, shokë tanë. Është kusht që, duke dalë jashtë, të kemi patjetër me vete një a dy shokë që

të na e mbajnë në këmbë botën tonë shpirtërore. Vetëkontrolli i brendshëm i njeriut shpesh herë mund të mos jetë i mjaftueshëm për ta frenuar dhe mbrojtur veten. Besimin duhet ta kemi të pastër e të kulluar me plot kuptimin e fjalës në mënyrë që ta mendojmë dhe ndjejmë se ndodhemi çdo çast nën kontrollin e Allahut, gjë që mund të mos jetë e mundur gjithmonë. Disa herë na ndodhin çaste të tilla dobësie që nuk e zotërojmë dot veten dhe shikimi mund të na rrëshqasë në haram, në shpirt mund të na hapet një plagë, mendimet e këqija mund të na përhapen në mendje si farëra të hedhura në tokë dhe në shpirt mund të na tharmohen mëkate. Por po të kemi pranë një dy shokë, mund të themi gjëra të bukura e të diskutojmë për gjëra të bukura. Ndërkaq, e mbajmë veten nën kontrollin e shikimeve të shokëve dhe u kushtojmë vëmendje shikimeve dhe veshëve. Disa herë ndodh që të mos e mendojmë dot se në atë çast po na kontrollon Zoti, por e ndjejmë të nevojshme të rregullohemi për të mos u turpëruar para shokëve. Ndoshta kjo mund të jetë si një farë dyfytërsie, por s'ka gjë, sepse kjo është më e mirë se veprimet e këqija dhe hyrja në mëkat. Gjithashtu, edhe nëse në veprimet pozitive dyfytërsia e dëmton shpirtin, një gjë e tillë nuk ndodh në veprimet negative. Për shembull, po që se njeriu nuk kryen një marrëdhënie të paligjshme vetëm për hipokrizi, domethënë vetëm nga drojtja se po e shohin të tjerët, në fund të fundit, nuk e kryen këtë faj. Po që se nuk vjedh se mos e shohin të tjerët, do të thotë se nuk vjedh. Sigurisht, për sa kohë që adulteri i syrit, adulteri i veshit, adulteri i duarve dhe këmbëve, adulteri i mendimit, përgjithësisht çdo gjë që do ta tërhiqte perversitetin dhe mëkatin në përfytyrimin e njeriut dhe çdo mendim i keq braktisen qoftë edhe vetëm nga frika e demaskimit ose për t'u dukur dhe perversiteti ose mëkati përkatës nuk na i lëshojnë kthetrat në shpirt, quhemi se jemi të shpëtuar. Ne do të dalim nga shtëpia pasi të kemi dëgjuar një fjalë apo këshillë të mirë, pasi të kemi lexuar një shkrim të mirë, pasi të kemi vështruar një gjë të bukur ose të kemi menduar një pamje të bukur, pra, të mbushur me mirësi e bukuri, do të shkojmë nën ndikimin e tyre në punë, në shkollë, në shërbim, në krye të detyrës, do të vazhdojmë ta ndjejmë ndikimin e tyre në shpirt dhe, kështu, do të mbrohemi nga djalli dhe mëkatet!

* *Duhet pastruar gjërat e ngjitura jashtë vullnetit.* Me gjithë këto përpjekje, mund të ketë edhe baltëra dhe njolla që të na jenë ngjitur majtas e djathtas jashtë vullnetit e që të na e kenë plagosur shpirtin. Në situata të tilla duhet hyrë menjëherë në mbrojtjen e adhurimeve dhe duhet kthyer nga Zoti. Një ditë, një shok shkon te Profeti tejet i tronditur, bie në tokë dhe rënkon duke i thënë: “U shkatërrova, o i Dërguari i Allahut, pashë në rrugë një grua dhe u lëngova!” Mu atë çast zbriti ajeti që thotë: “*Falni namaz në dy skaje të ditës se, pa dyshim, mirësitë i fshijnë të këqijat!*” (Hud, 114) Po, para Allahut, namazet janë veprime që i fshijnë e i pastrojnë mëkatet. Në një hadith, porosi profetike, thuhet se namazet janë dëmshpërblime për mëkatet e vogla të kryera mes namazeve. Në dashtë Zoti, namazet, lutjet, përgjërimet dhe të gjitha adhurimet që kemi bërë për Të, do të na bëhen dëmshpërblime për mëkatet që na janë përplasur sipër pa dëshirën tonë, duke e kapërcyer vullnetin tonë! Veçanërisht, çdo mbyllje sysh ndaj mëkatit i përfton njeriut një mirësi sikur të kishte plotësuar një domosdoshmëri fetare.

* *Mëkatet duhen pastruar me pendim dhe pendesë.* Në çdo mëkat ka një rrugë që shkon në herezi dhe mohim. Para së gjithash, mëkat do të thotë që njeriu të dalë jashtë atmosferës së mirësisë së Zotit dhe ta kundërshtojë garancinë hyjnore. Në mënyrë të veçantë, duke kryer mëkat, njeriu konsiderohet se është bërë plotësisht objekt i synimit të djallit. Me shtimin e mëkateve, pakësohet edhe mbrojtja e Zotit!

Mëkati është ndyrësi, njollë dhe ndryshk. Sipas shprehjes së hadithit, porosisë profetike, po qe se njollat e grumbulluara njëra mbi tjetrën, po s'u pastruan menjëherë me anë të pendimit dhe pendesës, futen mes jetës sonë ndjesore dhe vështrimit të Zotit mbi ne, i ndërpresin shfaqjet e ardhura prej Tij, u bëhen pengesë frymëve të mëshirës dhe na privojnë ne nga favori i Tij. Dhe zemra e mbetur pa mbrojtje, si rezultat, fiton një gjendje të mundshme për t'u goditur nga djalli me anë të mohimit.

E dyta, njeriu që kryen një mëkat që do ta turpëronte para të tjerëve, nuk do t'ia shohë e t'ia marrë vesh askush. Por ai e di se Allahu dhe engjëjt e shohin se ç'bën ai. Dhe djalli që ruan gjithmonë këtë çast dobësie të tij, e bën të thotë: "Ah, sikur të mos ma shihte kush këtë mëkat!" Ose: "Ah sikur kjo gjë të mos ishte mëkat!"

Edhe këmbëngulja në mëkat dhe nënvleftësimi i mëkatit mund ta shtyjë njeriun në mohim. Po qe se njeriu është mësuar me mëkate dhe nuk mundet të shkëputet prej tyre, mund të ndodhë që, në vend që ta shpëtojme nga ato fëlliqësi, e shtyjme edhe më keq. Për shembull, dikush që do t'i thonim "mos pi", mund të thotë se "një gotë nuk është haram" dhe se "një ndalim kaq të ngurtë e sheh të tepërt", pastaj, me fjalë të ngjashme mohuese mund të bëhet viktimë e atij mëkati. Po kështu, dikush që s'fal namaz, përballë këmbënguljes sonë për të ardhur në falje, mund të këmbëngulte për të mos ardhur e, më në fund, të thoshte se s'kishte për të ardhur!

Në fakt, mëkati bëhet mëkat nëse këmbëngulet në të, nëse vlerësohet i padëmshëm, nëse s'pastrohet me pendim dhe pendesë. Por nëse njeriu nuk këmbëngul në mëkat, e njeh dëmin e tij dhe frikësohet dhe heq dorë prej tij me pendim dhe pendesë të sinqertë, siç shprehet Kurani, në dashtë Zoti, do të falet. Përveç politeizmit dhe herezisë nuk ka mëkat që të mos e falë Allahu sikur edhe të jetë sa malet. Mjafton që njeriu të shkojë në portën e Tij të mëshirës dhe faljes!

4. Njeriu s'duhet të mbetet pa preokupim

Njeriu i papreokupuar, që s'merret me asgjë, jeton i zbuluar ndaj perversitetit, fajit dhe mëkatit, për rrjedhojë, i jep rast djallit. Prandaj nuk duhet të rrimë kot, duhet të vrapojmë për të shërbyer, kështu edhe mbetemi gjithmonë të freskët, plot emocione dhe mbrohem nga mëkatet.

Djalli i sulmon më shumë përtacët, meskinët, ata që rrinë kot. Ai u bie në qafë më shumë njerëzve që s'bëjnë asnjë punë, që e kalojnë kohën duke gjuajtur miza e duke u përsjellë më kot andej-këtej dhe merren me llafe të kota për orë të tëra në mjedise të tymosura. Gjithashtu, djalli merret me individë që nuk bëjnë asgjë në shërbim të besimit, fesë, atdheut e popullit, që jetojnë të mbyllur ndaj shërbimeve për besimin dhe fenë dhe ua prish mendjen, sepse njerëz të tillë janë gjahe që djalli i kërkon e nuk i gjen dot!

Meqë djalli përfiton më shumë nga meskiniteti dhe dembelizmi ynë si dhe nga mungesa e preokupimit tonë, meqë nuk i pëlqen që ne të gëzohemi e shqetësohemi për shërbimin ndaj besimit dhe fesë dhe meqë kur rrimë kot na hedh në shpirt mendime të papërshtatshme dhe fantazira, na e preokupon për vete përfytyrimin tonë të papreokupuar me gjëra të tjera dhe, duke na bërë të mendojmë për mëkatet, na shtyn të bëjmë mëkate, atëherë edhe ne t'i mbushim vendet ku mund të fusë gishtin djalli, me preokupacion të vazhdueshëm, me aksion, me veprimtari dhe shërbime dhe duke u djersitur në rrugën e orientimit, në mënyrë që edhe ne të jemi në rregull, edhe ai të mos e gjejë atë që shpreson. Hekuri që punon, nuk zë ndryshk. Te njeriu që është në lëvizje të

vazhdueshme, që vrapon pa u ndalur për ta bërë të njohur të drejtën dhe të vërtetën, do të ketë, njëkohësisht, edhe në trup, edhe në shpirt, gjallëri e hare dhe, siç shprehet hadithi, porosia profetike, meqë ai pengon të keqen dhe këshillon për mirë, do të ndjejë frymëzime përmes begatisë së revelacionit hyjnor, do t'i shtohet begatia, kurse foleja familjare do t'i kthehet në një kënd xheneti, parajse. Përsëri sipas tregimit të porosisë profetike, kur të ndërpriten këto detyra dhe shërbime, edhe begatia e revelacionit hyjnor do të ndërpritet dhe ata që do të mbeten të privuar nga begatia e revelacionit hyjnor, sikur të ishin të paralizuar, do të mbyten në errësira dhe shqetësime!

5. Atë që i jep ndihmë fesë së Allahut, edhe Allahu e ndihmon

Përballë çdo të riu e plaku, femre e mashkulli, nxënësi e mësuesi, përballë profesionistëve të çdo moshe dhe të gjithë njerëzve në krye të tyre, të cilët ia kanë kushtuar veten shërbimit ndaj Zotit dhe të të Dërguarit të Tij, qëllimit për t'u bërë interpretues të së drejtës e të së vërtetës si dhe veprimtarisë orientuese, pra, të cilët kanë zbatuar kërkesat dhe kushtet që i përkasin anës tonë të marrëveshjes mes Zotit dhe nesh, përballë tyre, pra, edhe Allahu, në emër të anës së vet të kësaj marrëveshjeje, do të thotë kështu: *"In tensurullahe jensurkum"* (po ta ndihmoni Allahun, edhe Allahu ju ndihmon ju) (Muhamed, 7), pra, po ta ndihmoni fenë e Allahut, po t'i bëheni interpretë fesë dhe t'i qëndroni besnikë fjalës se do t'ua kumtoni atë zemrave, edhe Allahu do t'ju ndihmojë ju. Po qe se ju, duke i dalë për zot besimit dhe Kuranit, përpiqeni të mos shtypeni nën këmbët e tyre, edhe Allahu nuk ka për t'ju lënë ju të bini dhe të shtypeni nën këmbët e djallit dhe unit. Kjo është e dyanshme; po të veprosh ti, edhe Ai do të veprojë, po të vraposh ti, edhe Ai do të vrapojë... Po si? Sipas shprehjes së hadithit, porosisë profetike, po t'i afrohesh ti Atij një pëllëmbë, Ai të afrohet ty një hap; atij që i shkon duke ecur, Ai i afrohet duke vrapuar, atij që i zgjat një dorë, Ai ia zgjat të dy duart!

Përsa kohë që ne të tregohemi besnikë e t'i vëmë supet fesë së Allahut, Allahun do ta gjejmë gjithmonë besnikë ndaj nesh dhe Ai s'ka për të na lënë neve vetëm për vetëm me dyshimet e djallit dhe dëshirat e vetvetes sonë. Po, Ai nuk ka për të na braktisur të prishemi, të shuhemi, të kalbemi dhe të vdesim në duar të huaja, por do të na thotë, *"o robi im!"* Pa shihni kah kjo fjalë e ëmbël: *"Mbajeni ju fjalën para meje, ta mbaj edhe unë para jush!"* (Bekare, 40). A mund të ndodhë që, pasi ju ta keni ndihmuar fenë e Allahut, Ai t'jua lëshojë sipër djallin për t'ju shkatërruar? A mos pandehni se, ndërsa ju vraponi, djersiteni e lodheni për vdekje për t'i bërë zemrat ta ndjejnë Allahun dhe të qetësohen me Të, duke e bërë këtë punë me pasion, Zoti juaj do t'jua përplasë syve mëkatet që i bëtë me dashje a pa dashje jashtë, në rrugë a në treg, do t'ju lërë në baltovinë e në duar të djallit dhe do t'jua llogarisë të mirat vetëm një për një? Kurrsesi! Ndërsa ju vraponi në rrugën e Tij sikur të kalonit nëpër një det gjaku, ndërsa përballeni çdo çast me baltërat e mëkatit që ju spërkasin e ju ngjiten për trupi, Ai s'do t'ju lërë vetëm për vetëm me dëshirat tuaja egoistike në këtë atmosferë dhe klimë mëkati ku shpirti ju tronditet dhe zemra me ndjenjat ju rrihen sa e sa herë, pa dyshim që do t'jua zgjasë dorën e ndihmës dhe do t'jua dërgojë provën evidente! Në fakt, secili prej nesh, përsa kohë që, në jetën personale, nuk ka këmbëngulur për ta përdorur vullnetin për të keq dhe nuk ka thënë "unë do të hyj në mëkat", është bërë shumë herë dëshmitar i mirësive dhe favoreve të tilla të Zotit. Ne kemi vënë re se në çastin kur kemi ardhur mu në skaj të greminës dhe kur kemi mbetur ballëpërballë me një mëkat, na kanë zbritur dy duar nga qielli dhe na kanë shpëtuar nga rrëzimi! Për shembull, mu kur keni qenë duke plasur nga mërzitja apo vetmia dhe keni dashur të dilni jashtë, se nga ka dalë një shok i mirë e ju ka shpëtuar nga hyrja apo rënia

brenda sajimeve e gënjeshtreve. Madje, disa herë, pa e kuptuar as vetë, disave prej nesh u ka dalë në buzë një lutje, një ajet ose një dritë dhe kanë shpëtuar nga rreziku për t'u bërë shenjë dhe objekt i shigjetave të djallit dhe viktimë e dëshirave egoistike. Sigurisht, ftuesi më i madh i ndihmës dhe mbrojtjes së Allahut është, në kuadër të besnikërisë ndaj marrëveshjes me Allahun, Zotin tonë, ndihma ndaj fesë së Tij!

Pa dyshim, ka fitim në raport me humbjen dhe shpërblim, në raport me rrezikun. Sa më të mëdha të jenë vështirësitë dhe shqetësimet me të cilat përballet njeriu, aq më të mëdha dhe qetësuese janë të mirat që merr. Një orë roje e ushtarit besimtar në kufi përballë armikut, në borë dhe ngricë, i përfton atij të mirat e adhurimeve suplementare që nuk do të mund t'i kryente për vite me radhë! Sigurisht që të njëjtat të mira nuk do t'i fitojë ai tjetri që atë kohë e kalon në shtratin e ngrohtë në kaponon! Nga ana tjetër, të mirat në fjalë nuk do të jenë aq sa të mirat e atij korrespondentit që futet mu në vijën e zjarrit. Po kështu, shërbimi ndaj fesë dhe orientimi janë detyra numër një e profetëve, prandaj, siç shprehet edhe hadithi, porosia profetike, janë pikërisht profetët që vuajnë më shumë se kushdo nga ngatërresat dhe fatkeqësitë. Ajo që e pati bërë të madh Hamzanë dhe që qe bërë shkak të shkruhej në qiej "Luani i Allahut", qe trimëria e tij, përbuzja e vdekjes, jetesa me mendimin e përjetësisë. Njeriu fiton vlerë në raport me vështirësitë që përballet dhe që i vuan. Po qe se njeriu e ruan ndjeshmërinë fetare në kohët kur dëshirat egoistike e shtrëngojnë më shumë se kurdoherë tjetër dhe kur djalli i hedh shigjeta vdekjeprurëse nga të gjitha anët, lartësohet më shumë se kurdoherë tjetër. T'i dalësh fesë për zot e të zhvillosh veprimtari orientuese si trashëgimtar i Profetit, ka përparësi sa ç'ka edhe rreziqe e vështirësi. Sado që këto avantazhe ndjehen pjesërisht qysh në këtë botë, do të shfaqen dhe zhvillohen me tërë madhështinë dhe shkëlqimin në botën përtej duke dhënë si fryte xhenetin dhe Bukurinë Hyjnore!

II. ORIENTIMI, KUMTIMI DHE RRUGA PËR TË MBETUR VITAL ME ANË TË SHËRBIMIT NDAJ FESË

Në lidhje me këtë temë, do të jepet vetëm një përmbledhje pa ndjekur ndonjë radhitje të caktuar.

1. Allahu urdhëron orientimin dhe kumtimin. Para së gjithash, Zoti ynë që na ka krijuar nga hiçi dhe na ka pajisur me dhunti të pakufishme, na urdhëron ta vazhdojmë dhe mbajmë gjallë detyrën e orientimit dhe kumtimit.

“Le të jetë prej jush një grup që fton për te e drejta, që këshillon për mirë dhe pengon të keqen!” (Al Imran, 104)

“Ju jeni bashkësia më e dobishme e formuar ndonjëherë për njerëzit, sepse ju këshilloni për mirë, pengoni të keqen dhe i besoni Allahut!” (Al Imran, 110)

“Ju bëmë ju një bashkësi të zgjedhur dhe të nderuar që të bëheni shembull drejtësie dhe dëshmitarë të Zotit për të gjithë njerëzit!” (Bekare, 143)

“O ju që keni besuar! A t’ju tregoj një tregti që do t’ju shpëtojë nga ndëshkimi zemërpërvëlues? Besojuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe luftoni në rrugën e Allahut me mallrat dhe jetën tuaj! Sikur ta dinit, kjo është më e dobishme për ju!” (Saff, 10-11)

“O ju që keni besuar! Po të kthehet ndonjëri prej jush nga feja, Allahu sjell në vend tuaj një bashkësi të tillë që edhe Allahu i do ata, edhe ata e duan Allahun. Ata janë të thjeshtë me besimtarët, por të ashpër ndaj mohuesve. Ata luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk druhen t’u përgjigjen atyre që i dënojnë!” (Maide, 54)

2. Nuk ka detyrë më të madhe se shërbimi ndaj fesë. Nuk ka mbi tokë detyrë më të madhe se orientimi, kumtimi, lufta në rrugën e fesë dhe shërbimi ndaj fesë. Po të kishte, Allahu do t’ua ngarkonte profetëve që i pati zgjedhur dhe dërguar si përfaqësues të Tij në tokë. Me kuptimet dhe veçoritë e tij si dielli që lind dhe e ndriçon njerëzimin, si mjet për ta bërë të njohur Allahun dhe për

t'i pastruar njerëzit e për t'i kthyer në origjinë, orientimi në rrugën e drejtë është rangu më i lartë për profetët, profesioni dhe detyra më e shquar para Allahut dhe çdo njeri që i ka dalë dhe i del për zot kësaj detyre qysh nga profeti Adem duke iu përgjigjur kësaj ftese, në këtë pikë konsiderohet sikur është bashkuar me profetët dhe është ulur në një sofër me ta. Çdo punë u caktohet për ta kryer njerëzve që janë të pajisur me aftësitë përkatëse dhe që i përgjigjen rëndësisë dhe dimensioneve të saj. Ja, pra, pikërisht pse s'ka detyrë më të madhe se ajo, lartësimi i Fjalës së Allahut është përfaqësuar përparësisht me profetët.

3. Orientimi dhe kumtimi janë tregues të Islamit. Ashtu siç njihet oficeri nga yjet dhe shenjat e tjera të spaletave, *këshillimi për të mirë dhe pengimi i të keqes* është, si ezani, xhemati, haxhi dhe shenjat e tjera të ngjashme islame, një nga shenjat dhe treguesit islamë më të rëndësishëm që nxjerr sheshit gradën e myslimanëve. Këto lloj detyrash që përmbajnë brenda tyre të drejtën juridike publike, janë, në mos nga këndvështrimi i përgjegjësisë, nga ai i fitimit të mirësive, më me vlerë se farzet (detyrimet fetare) personale.

4. Ata që e kanë braktisur këtë detyrë, janë poshtëruar dhe shkatërruar. Allahu i ka poshtëruar dhe shkatërruar popujt dhe kombet që e kanë braktisur këtë detyrë dhe janë zhytur në dëfrim dhe perversitet. Ky është një ligj hyjnor. (Hud, 102) Ja Bizanti dhe Pompei dhe ja Greqia dhe Andaluzia! Sipas një transmetimi që regjistrohet te Muslimi, Profeti thotë: "Po qe se një njeri vdes pa treguar në jetën e tij asnjë përpjekje për besimin dhe fenë dhe pa luftuar për to, është sikur vdes nën një dyshim për hipokrizi (besimore)!" Ata që e braktisin këtë detyrë profetike me frikën nga ndonjë dëm material, moral ose temporal, konsiderohen sikur, duke ikur nga kafshimi i mizës, kanë rënë në gojë të gjarprit.

5. Orientimi dhe kumtimi janë të një niveli më të lartë se farzet, detyrimet fetare. Sado që është konsideruar si *ndihmëse*, kjo detyrë, me cilësinë e një detyrimi fetar mbi të gjitha detyrimet që e ka fituar në ditët tona, i takon çdo besimtar. Po qe se kjo detyrë s'kryhet, me shumë gjëra të tjera të pakryera, edhe detyrimet fetare braktisen. Edhe në periudhën kur kjo detyrë e bekuar ishte farzi kifaje (detyrim i mjaftueshëm), madje, ishte një detyrim i mjaftueshëm i tillë që çdo njeri vraponte për ta kryer sikur të donte të bënte garë me të tjerët!

6. Shërbimi ndaj fesë nuk mund të jetë monopol i personave apo grupeve të caktuara. Kjo detyrë nuk mund t'i lihet monopolit të personave apo grupeve të caktuara. Po qe se një besimtar përpiqet ta hedhë prej supesh këtë detyrë duke menduar se ka të tjerë që e bëjnë, mbi të lind dyshimi se mos e ka nxjerrë prej zemre besimin dhe Kuranin.

7. Qëllimi final është fitimi i pëlqimit të Allahut. Synimi dhe qëllimi ynë më i parë s'është asgjë tjetër, por vetëm e vetëm të flasim për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, t'i bëjmë ata të dashur për njerëzit dhe, në sjelljet dhe veprimet tona, të kërkojmë pëlqimin dhe kënaqësinë e Allahut! Kësaj mund t'i themi edhe principialitet dhe sinqeritet. Orientimi dhe kumtimi të kryer pa synuar

pëlqimin e Allahut, janë si një kufomë pa shpirt. Fundja, as që mund të bëhemi të ndikueshëm pa patur thellësi shpirtërore, vetëkontroll dhe marrëdhënie të fuqishme me Zotin tonë. Ne duhet të mendojmë kështu: “Po qe se unë nuk i bëj dot të njohur e të dashur Zotin tim dhe Profetin e Tij sipas pëlqimit të Tij, për mua, më mirë nën dhé se sa mbi dhé!”

8. Kushti themelor në këtë detyrë është vuajtja. Sigurisht, po qe se nuk vuajmë si Profeti ynë dhe shokët e tij, po qe se në emër të kësaj detyre nuk pranojmë shqetësime të paktën aq sa pranojmë në emër të një pune, të një profesioni, të një tregtie apo të një pozite e posti, po qe se nuk pranojmë të përballojmë shqetësime dhe nuk vuajmë, nuk kalojmë agjitime me mendimin se *si, kujt dhe në ç’vend mund të flas për Zotin tim*, si dhe nuk bëhemi të pasionuarit e kësaj detyre aq sa ta ngatërrojmë edhe rrugën e shtëpisë sonë, është e pamundur të bëhemi bindës e ndikues tek të tjerët!

9. Një parim tjetër i kësaj detyre është uniteti i fjalës dhe veprimit. Gjërat që themi, do t’i jetojmë, gjërat që jetojmë, do t’i themi. Para së gjithash, është kusht që të përpiqemi që urdhrat e Zotit t’i përfaqësojmë në nivelin më të lartë në veten tonë. Pa tjetër, Kurani duhet të ndriçojë plot shkëlqim në jetën tonë dhe, gjërat që do të themi, duhet t’u bëhen interpretë atyre gjërave që jetojmë. Duhet të jemi dritëshpërndarës që t’i ndriçojmë edhe të tjerët. Jo vetëm të bëjmë shkencë, të skedojmë ose të shkruajmë libra duke cituar dhe huazuar nga librat. Të bëjmë shkencë e të shkruajmë libra duke i përcjellë gjërat që shkruajmë në sjelljet dhe veprimet tona, duke i jetuar ato! Në vend që të tregojmë për jetën dhe veprat legjendare të të tjerëve, të bëhemi vetë temë e bëmave legjendare për botët tejqiellore. Përndryshe, ashtu siç u vërejt në Miraxh, buzët na grihen me gërshërë prej zjarri, trupat na rrokullisen në xhehenem si trungje drush dhe bëhemi për faqe të zezë para turmave!

10. Ideali më i lartë është përçimi në zemra i emrave të Allahut dhe Profetit. Ideali më i madh i kryerjes së kësaj detyre është që, nga toka në qiell, të mos lëmë zemër ku të mos arrijnë emrat e bekuar të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Ashtu siç thuhet edhe në ajetin, “*Ju bëmë ju një bashkësi të zgjedhur dhe të nderuar që të bëheni shembull drejtësie dhe dëshmitarë të Zotit për të gjithë njerëzit!*” (Bekare, 143), këta njerëz të shenjtë që përbëjnë bashkësinë e mendimit, që janë sunduesit, gjykatësit e tokës dhe elementë ekuilibri për të, që janë instanca e fundit në çështjet ndërkombëtare, mbrojtësit e të dobtëve dhe viktimave, si dhe ata që kanë marrë mbi vete përgjegjësinë për ta ndryshuar fatin e prapë të botës islame, kanë për ta ringjallur botën së dyti, kanë për t’i mbështetur shkallët në qiell dhe kanë për ta bërë të njohur emrin e lartë të Allahut në yjësitë dhe galaktikat qiellore!

11. Kjo luftë shumëdimensionale duhet kryer në përputhje me kushtet përkatëse të rrethanave. Emri i detyrës sonë është xhihad. Ky është një koncept shumëdimensional. Si njëra prej hallkave të zinxhirit të përpjekjeve që do të vazhdojnë gjer në vdekje, shpata nuk përdoret pa i ardhur koha dhe vendi. Kur të jetë koha dhe vendi i shpatës, damarët e dorës që ka për ta përdorur atë, ushqehen nga zemra. Kur të jetë koha dhe vendi i logjikës, lufta bëhet me anë të saj dhe, kur të

jetë koha dhe vendi i ndjenjës, bëhet me anë të ndjenjës. Si logjika, ashtu dhe ndjenja nuk janë më pak të mprehta dhe të efektshme se shpata, përkundrazi.

Sipas shprehjes së hadithit, porosisë profetike, xhihadi është dy llojesh: “i madh” dhe “i vogël”. Njëri prej këtyre është material dhe i drejtuar jashtë, kurse tjetri, moralo-shpirtëror dhe i drejtuar brenda. Njëri është syri që qan për shkak të vetëllogarisë, tjetri, syri që vëzhgon dhe kontrollon armikun jashtë. Njëri xhihad bëhet brenda vetes, tjetri, brenda shoqërisë. Njëri synon brenda vetes, fitoren e arritjes në origjinë, tjetri synon jashtë triumfin e zemrave dhe, po të duhet, triumfin e kalave dhe kështjellave. Në fakt, tek të dy llojet e xhihadt përmbahet procesi i brendshëm moralo-shpirtëror i pastrimit, purifikimit dhe kthimit në origjinë, sepse esenciale është bota e brendshme. Ashtu si valët e ujit që përhapen nga qendra në periferi, edhe në çështjen e xhihadt, çdo gjë fillon nga zemra dhe përhapet në të gjithë qenien. kjo do të thotë se lufta e jashtme është nevojtare për mbështetjen e luftës së brendshme e cila është një burim i begatë për të dhe të dy llojet e xhihadt janë si dy flatra. Po të ndodhë ndonjë prishje në njërin flatër, edhe tjetra s’vlen gjë dhe njeriu i cili, për pasojë të dëmtimit të njëres flatër, s’qëndron dot gjatë në qiejt e njerëzores, bie poshtë!..

Sot, kur thuhet xhihad, kuptohet goditje dhe shkatërrim dhe përhapje frike në të katër anët. Jeta ndjesore dhe shpirtërore, thellësia e brendshme dhe marrëdhënia me Allahun kurrësi s’mendohen. Po qe se s’është krijuar vetëdija e duhur, po qe se bota e brendshme s’është ndriçuar dhe po qe se nuk është nxitur dot pasioni për adhurim dhe bindje dhe ndjenja e neverisë ndaj mëkateve, po qe se kur namazet pakësohen dhe fillohet hyrja në mëkate, shtohet oreksi për të ngrënë e për të pirë, pra, po qe se zbritja drejt botës së brendshme, maturimi dhe formimi moralo-shpirtëror janë nënvleftësuar dhe lënë mënjanë, si dhe, ndërkaq, po qe se të gjitha përpjekjet janë përqendruar dhe izoluar në dialektikë, debat, polemikë, kritikë, hedhje poshtë e tjetrit për të triumfuar mbi të, do të thotë se njëra anë e trupit është paralizuar, kurse ne jemi gënjyer! Nga ana tjetër, po qe se, duke u parapëlqyer vetëm edukimi i vetes, kënaqësia e zemrës, dhikri dhe tesbihet, nuk bëhet asnjë përpjekje për t’i orientuar dhe maturuar zemrat dhe po qe se, duke i parë çështjet me një këndvështrim mistik, ndodh largimi nga shoqëria dhe institucionet shoqërore braktisen në fatin e tyre, do të thotë se është paralizuar ana tjetër e trupit. Ashtu si në të gjitha fushat e tjera, edhe këtu, ekuilibrin duhet ta mësojmë nga mjeshtri i saj, Profeti, dhe, me këtë qëllim, duhet t’i studiojmë dhe kuptojmë shumë mirë periudhat e Mekës dhe Medinës.

Xhihadi është shumë i gjerë dhe i shumëllojshëm. Xhihadi mund të bëhet në një kuadër shumë të gjerë dhe me mënyra e metoda të ndryshme, nga marrja e dikujt në makinë për ta sjellë në bisedë me qëllim për ta afruar ndaj besimit dhe adhurimit, te mbështetja për ata që e bëjnë xhihadin me anë të pasurisë; nga blerja e armëve për ushtarët, gjer te dhënia e bursës për nxënësit; nga hapja e kurseve për përgatitje universitare, gjer te hapja e shkollave. Shkurt, për çdo situatë dhe kërkesat e saj ka një formë të veçantë xhihadi: me shkrim, me gojë, me makinë, me mjete materiale, me qëndrim, etj.

12. Çështja më e rëndësishme e kohës sonë është shpëtimi i besimit. Çështja më e rëndësi në kohën tonë është shpëtimi i besimit, sigurimi i paqes së zemrës, ushqimi i ndërgjegjes së përgjithshme me besim, ngopja dhe kënaqja e zemrave dhe shpëtimi i brezave nga zjarri. Sapo zemrat të paqëtohen, në duart e zemrave të paqëtuara shumë institucione rregullohen dhe bëhen burim i besimit, sigurisë dhe kënaqësisë. Në një periudhë kur bazat e fesë nënvleftësohen e lihen

mënjatë, për rrjedhojë, edhe zemrat janë të uritura, më parë duhet qëndruar mbi këtë çështje jetësore. Ashtu siç njeriut të uritur i jepen, në fillim jo bakllava, por lëndë ushqimore bazë si uji dhe buka për të cilat ka më shumë nevojë, ashtu dhe zemrave të uritura, para së gjithash u duhen shtënë ato gjëra që i fuqizojnë shpirtat dhe i ngrënë peshë zemrat, besimi te Allahu, Profeti dhe ringjallja, dashuria për Allahun dhe Profetin. Në fakt, njeriu i privuar nga këto i ka të errëta si botën tjetër, ashtu edhe këtë botë. Prehja dhe kënaqësia vijnë nga besimi, prandaj, nëse mendojmë t'u çojmë njerëzve dhe sidomos të rinjve prehje dhe siguri, zemrat e tyre duhet t'i pajisim me besim dhe t'i frymëzojmë me dashuri hyjnore dhe kënaqësi shpirtërore.

13. Dija dhe shkenca janë mjeti i orientimit, kumtimit dhe luftës në kushtet e kohës sonë.

Është esenciale që shkencat e natyrës që po bëhen shënjë që po përdoren në duart e mohuesve si një armë për mohimin e Allahut, të ndërthuren me shkencat fetare e të parashtrihen brenda nivelit të logjikës, kulturës dhe mendimit të kohës.

Në kohën e tij, imami i madh Gazali zhvilloi atë luftë që kërkonte ajo kohë, ajo periudhë. Ai shkroi vepra që nxirrnin në shesh anët e çala të filozofisë, kundër platonizmit, aristotelizmit dhe sokratizmit që e kishin mbështjellë Islamin, e tronditi nga themelet mendimin grek dhe më pas, me veprën Ihjau Ulumiddin (Rilindja e Shkencave Fetare), u fryu zemrave besimtare frymë Muhamedane.

Kur Imam Rabbani doli në Indi, u ndodh ballëpërballë me një sërë rrymash si ajo e unifikimit të të gjitha feve, të shfaqura në ndikimin e filozofisë indiane dhe, ndërsa luftonte, nga njëra anë, me këto rryma të shtrembra, nga ana tjetër hidhte dorë mbi Alemgirin, të birin e Ali Ekber Shahut, përfaqësuesin e një pjese të këtyre rrymave, duke u bërë për vite e vite të tëra zëri dhe frymëmarrja e myslimanëve në atdheun e Budës dhe Brahmanëve.

Kur shohim periudhën e tabiinëve, vëmë re një lëvizje adhurimi dhe devocioni të thellë. Kjo është periudha e kokave të mëdha si Ebu Hanife, Esved, Alkame, Sufjan Theuri, Ibrahim Et'hem dhe Bishri Hafi. Pastaj vjen periudha e tarikateve (sekteve) që bëjnë punën e tyre duke ndezur për zemrat pishtarë të pavdekësisë dhe duke tharë në masat idenë e përjetësisë. Kurse në periudhën apo kohën tonë, panorama është seriozisht e frikshme. Lidhjet analitike në besim janë zgjidhur dhe zbërthyer, shkencat që kanë marrë zhvillim, janë kthyer në rrugë që çojnë në mohim, fizika, kimia, mjekësia, biologjia, etj., janë bërë pretekste për mohim dhe libri i gjithësisë, i shkruar nga Allahu me fuqinë dhe vullnetin e Tij, është përpjekur të tregohet në kundërshtim me legjislacionin e ardhur nga Fjala e Tij dhe të gjitha të vërtetat janë paraqitur përmbys. Natyrisht, edhe lufta e zhvilluar në këtë periudhë duhet të karakterizohet si korrektuese e gabimeve të ditëve tona dhe shërim për lëngatat e sotme. Dhe kështu ndodhi.

Pra, koha jonë nuk është as koha e Fatihut dhe e Javuzit, as koha e shpatës dhe topit, as dhe vetëm e entuziazmit të zemrave me frymëzim dhe pasion. Koha jonë është koha e frymëzimit krahas shkencave të natyrës dhe, krahas këtyre, e mendimit dhe kulturës. Vetëm si engjëjt me katër-pesë dimensionet do të mundet njeriu i sotëm ta kapë kohën në raport me sa do ta përfaqësojë tërësinë e kulturës së kohës, do të mundet të lajë llogaritë me kohën, do ta bëjë kohën t'ia dëgjojë fjalën, për rrjedhojë, nuk do të eliminohet dhe lihet mënjatë nga koha. Pra, do t'i japë rëndësi frymëzimit sa dhe mendimit, përvojës sa dhe frymëzimit, pasionit dhe entuziazmit sa dhe përvojës, sistematikës sa dhe pasionit dhe entuziazmit dhe do të dijë që, brenda kuadrit të shkaqeve, përse u

përket marrëdhënieve me Shkakun e shkaqeve, të mbetet i mbyllur ndaj të gjitha stonimeve dhe fiaskove. Dhe njeriu ynë, me favorin e Allahut, do ta arrijë këtë. Në këto kushte, pse të mos bëhet çdo shtëpi një shkollë? Po, edhe të lexojmë, edhe të dëgjojmë duke krijuar një vetëdije të përgjithshme.

14. Duhet të shpëtojmë patjetër nga faqja e zezë e quajtur injorancë. Siç e kemi prekur shpesh, Kurani që filloi të zbritej me urdhrin “lexo”, kërkon prej nesh ta lexojmë librin e gjithësisë dhe veçanërisht njeriun si një libër dhe ta njohim Hz. Muhamedin (s.a.s.) që na udhëzon ne se si duhet t’i lexojmë këta libra. Ky është qëllimi final i krijimit të njeriut. Do të shohë, do të vëzhgojë, do të mendojë, do t’i ngarkojë trurit çdo ditë gjëra të reja dhe do të udhëtojë gjithmonë në klima të ndryshme sepse ky është horizonti që duhet arritur. Dhe rruga e arritjes në këtë horizont kalon nëpër rrugën ku ndërthuren shkencat fetare me shkencat e natyrës. Nisur nga kjo, çdo besimtar duhet t’i lexojë dhe studiojë edhe shkencat fetare, edhe shkencat e natyrës dhe duhet të pajiset patjetër me shkencë e kulturë fetare e të përgjithshme. Në vendin e punës, në shtëpi, në dyqan, në ngrënie, në stacion duke pritur mjetin e komunikacionit, në makinë dhe në rrugë, duhet patjetër të lexojmë, të mendojmë duke mos lënë të na shkojë kot edhe pjesa më e vogël e kohës. Sepse njeriu i zbrazët nuk ka se ç’t’u japë të tjerëve! Po qe se s’njohim të paktën filozofinë, themelet logjike dhe ideore dhe, si enciklopedi, tezat e shkencave të tilla si fizika, kimia, astronomia, mjekësia dhe botanika, po kështu, po qe se s’kemi njohuri të paktën po kaq nga shkencat fetare, atëherë, jo vetëm që s’do të kemi mundësi t’u tregojmë diçka të tjerëve e t’i bindim, por do të jemi të paracaktuar për të na marrë me vete erërat e perversitetit. Atëherë le të përpiqemi së bashku për të shpëtuar nga faqja e zezë e quajtur “injorancë”! Ndërkaq, këtu duhet bërë e qartë edhe kjo pikë: Dituri do të thotë që, para së gjithash, njeriu ta njohë veten dhe Zotin e vet. Sigurisht, zemra duhet të jetë gjithmonë para kokës dhe jeta praktike, para llafeve! Ndryshe, *dituria e vëllimeve* mbetet vetëm një barrë!

15. Duhet lexuar librat që janë shpëtim për lëngatat e ditëve tona. Kur themi dituri, para na del problemi i leximit dhe, kur themi lexim, para na del problemi se si duhet të lexojmë. Para së gjithash, ka tema, leximi i të cilave është jetësor. Aq sa ç’do të ishte absurde që një të sëmurit zemre ose me kancer t’i bëhej mjekim duke ia futur krahun në allçi, ose të sëmurit me hemorragji t’i injektohej penicilinë për t’ia ndaluar hemorragjinë, ose kapiteni i anijes që po mbytet, t’u jepte marinarëve bojë e furça e t’u thoshte të lyenin direkët e anijes, aq pa kuptim do të ishte që të shihej gjendja e stomakut dhe e zorrëve e dikujt që po humb gjak në jetën ndjesore e shpirtërore. Po qe se në një shoqëri nuk njihen Allahu dhe i Dërguari i Tij, Kurani dhe Islami, po qe se në jetën ideore të asaj shoqërie sundojnë dyshimet e lëkundjet dhe ne i këshillojmë asaj libra që përmbajnë doktrina dhe parime shoqërore, ekonomike e politike, kjo gjë nuk do të kishte asnjë vlerë dhe nuk do të zgjidhte dot asnjë prej problemeve në mendjet dhe shpirtrat e njerëzve. Të dalësh para njerëzve që bartin në kokë shumë lëkundje mbi shkencën dhe mendimin, duke lexuar vepra filozofike e të ngjashme me to, ose vetëm me të dhënat e gazetave të përditshme, ose me komentet e çështjeve aktuale, ose dhe me tregimet legjendare mbi të vjetrit, është sikur t’i përgjigjesh pushkës automatike me pushkë me mbushje nga gryka! Prandaj, duhet lexuar me përparësi libra që të jenë shërim për lëngatat e ditëve tona, për sëmundjet e zemrës dhe ndërgjegjes së brezit tonë dhe për dëmtimet ideore.

16. Ne jemi të detyruar t'i njohim çështjet tona si bukën me djathë dhe të përgatitemi për t'i parashtruar ato me lehtësi. Duke i kuptuar dhe përvetësuar fort mirë çështjet tona me anë të rrugës së shkencës, ne duhet t'u japim bashkëbiseduesve tanë gjëra të gatshme për t'u tretur, por ama si qumështi që i jep delja qengjit e jo si të vjellat e zogjve me të cilat ata i ushqejnë të vegjlit e tyre!

Në ditët tona, rruga më efektive e ndikimit të njerëzve që lexojnë, dinë dhe mendojnë, është bindja. Krahës dërgimit të zemra e këtyre njerëzve e tufave të rrezeve të principialitetit, dhembshurisë dhe dashurisë, ne duhet të bëhemi miq të ftuar të shpirtrave të tyre duke ua ngopur në kuptimin pozitiv me anë të bindjes mendjen, mendimin dhe logjikën.

Të gjitha çështjet tona, para gjyqit të arsyes dhe logjikës, gjithmonë "kanë fituar pafajësinë". Ndoshta do të ishte gabim të përdornim për të gjitha çështjet cilësimin "të arsyeshme" (racionale), megjithëkëtë, të gjitha ato janë të arsyeshme, të logjikshme dhe të mbështetura nga vahji, revelacioni apo zbulesa hyjnore. Meqë s'janë kapur pas pengesave si konkluzioni apriori, kushtëzimi, mendjemadhësia dhe krenaria duke ngecur në to, janë rubinete që e ushqejnë mendimin dhe u japin zhvillim aftësive për të arritur në sinteza ideore. Prandaj, e kanë hak jo thjesht "pafajësinë", por medaljen!

17. Ata që i shërbejnë fesë, duhet t'i njohin kushtet e kohës dhe s'duhet t'ia kthejnë shpinën shoqërisë. Ata që e kryejnë këtë detyrë, duhet t'i njohin kushtet e kohës dhe ta kenë kuptuar absolutisht edhe gjendjen e botës aktuale. Ata s'duhet të mbeten pas shoqërisë mes së cilës jetojnë, s'duhet të kapen pas aktualitetit të shtresës së rrugës së shtrembër dhe s'duhet t'i nënvleftësojnë dhe lënë mënjanë parimet dhe detyrën e tyre të përhershme duke mbetur nën ndikimin e ndodhive ditore e të paqëndrueshme që vijnë e kalojnë si era.

18. Orientimi dhe kumtimi, lufta dhe përpjekjet mund të bëhen të qëlluara e me ndikim vetëm duke e njohur strategjinë e ndjekur nga Profeti. Për ta njohur strategjinë e ndjekur nga Profeti, duhen rrokur dhe kuptuar me të gjitha aspektet periudhat e Mekës dhe Medinës. Jeta e nderuar e Profetit bashkë me shokët e tij, përfaqëson në mikroplan të gjitha ngjarjet që do të zhvillohen gjer në kiamet. Në periudhën 13-vjeçare të Mekës, të gjitha përpjekjet e veta Profeti i shpenzoi për t'ua shpëtuar besimin njerëzve, për t'ua treguar rrugën që shkon në xhenet dhe për t'ua përgatitur zemrat. Në këtë periudhë kur u hodhën themelet e shëndosha të besimit, kur "u meremetuan" koka dhe zemra, ende nuk kishte një xhemaat të formuar në kuptimin e plotë të fjalës, zekati, agjërimi dhe haxhi në periudhën e Mekës akoma nuk qenë bërë farz, për më tepër, namazi si një parim i rëndësishëm i diferencimit mes besimit dhe mohimit, si shtyllë e fesë dhe miraxhi i besimtarëve, që bërë farz në vitin e tetë të dërgesës profetike të Muhamedit, pra, pasi kishte kaluar një e treta e periudhës profetike të tij. Myslimanët e parë mblidheshin në grupe 5-6 vetash në shtëpinë e Erkamit dhe në çdo veprim silleshin jashtëzakonisht të matur. Në atë kohë kur njerëz si Ebu Dherri që bërtiste "*La ilahe il'lallah*" në mes të politeistëve, rriheshin, Profeti i këshillonte vazhdimisht shokët që të prisnin me durim. Kurse në periudhën e Medinës shohim se dalin në rend të ditës çështje të ekonomisë dhe sociologjisë, drejtësisë juridike dhe luftës dhe se

nisin përpjekjet për ngritjen e një shteti-qytet. Ky ligj i pandryshueshëm për të gjithë profetët, edhe në periudhat e ardhme nuk do të ndryshojë.

19. Ne na takon të kumtojmë me principialitet dhe sinqeritet gjer në frymën e fundit, kurse realizimi i orientimit dhe rezultati varen nga Allahu. Detyra që na bie ne është vetëm kumtimi (Maide, 59). Ne kujtojmë, këshillojmë, por nuk detyrojmë (Gashije, 21), as njeriun tonë të dashur, madje, nuk mund ta orientojmë (ta fusim në rrugë të drejtë) sado me zemër ta dëshirojmë këtë gjë (Kasas, 52) dhe mund të bëhemi pretekst për orientim për ta e për të tjerët vetëm me favorin e Allahut (Shura, 52). Më në fund, meqë do të ishte mungesë edukate ndaj Zotit, rezultatet nuk ua dedikojmë punëve dhe shërbimeve tona.

Kanë ardhur e kaluar profetë të tillë që, megjithëse e kanë harxhuar tërë jetën për të treguar për Zotin dhe për ta kumtuar të vërtetën, kanë arritur të kenë vetëm nja dy ndjekës. Po si kjo, edhe nëse ne flasim një jetë të tërë pa gjetur miratim nga asnjë njeri, prapëseprapë detyrën e kemi bërë, ndërkaq që edhe nuk mungojmë t'i kërkojmë llogari vetes duke menduar se mos ndodh kështu ngaqë na mungon sinqeriteti ose diçka tjetër. Veç kësaj, mendojmë se mos kemi bërë ndonjë gabim dhe, nëse kemi bërë, përpiqemi ta rregullojmë. Ndryshe, të mendosh se, sapo të tregosh për diçka, njerëzit menjëherë do të të mblidhen rrotull, s'është gjë tjetër veçse mungesë principialiteti dhe sinqeriteti. Ndërkaq, mund të ndodhë që një fjalë e hedhur nga thellësitë e zemrës në hapësirat e kozmosit, të lëshojë mijëra e qindramijëra filiza në një çast krejt të papritur.

20. Në fjalorin tonë nuk ka thyerje, zemërim dhe pesimizëm. Duke u mbështetur në të vërtetën për të cilën folëm më sipër, në fjalorin tonë nuk ka vend për fjalët thyerje, zemërim dhe rënie në pesimizëm. Edhe sikur të mos gjejmë miratim dhe të vuajmë si Profeti dhe shokët e tij, prapëseprapë do t'i pranojmë torturat, do t'i presim me të qeshur fyerjet që na përplasen syve dhe do të vazhdojmë ta kryejmë detyrën me dëshirë duke vepruar krejt si burrat e shquar të vendosmërisë së lartë...

21. Në detyrën tonë, këshillimi është parim, kurse veprimi individual nuk ka vend. Njëri prej preteksteve për të mos bërë gabim dhe zbritjen e mundësisë për të gabuar në minimum, është këshillimi dhe vlerësimi i mendimit të të tjerëve. Mendimet e tipit “unë jam mjaft, njerëzit mund të mblidhen rreth meje” janë mendime që i sjellin dëm edhe vetes sonë, edhe mjedisit tonë. Veç kësaj, ndodh që gjërat që ne kemi vite që përpiqemi t'i tregojmë me fjalët më të bukura duke menduar se askush tjetër s'do ta bënte dot këtë më mirë se ne, del një shoku ynë i aftë e kompetent që i tregon me një fjalë!

Tjetër gjë, burrat e orientimit s'duhet të presin gjë prej askujt. Ata duhet të jenë të parët në dhënien e shërbimit e të fundit në pritjen dhe marrjen e shpërblimit. Ata s'duhet të mendojnë për familje e për shtëpi, por duhet të thonë, “mua më mjafton një qefin”. Ata duhet të jenë jashtëzakonisht të kënaqur me atë që u jepet, jashtëzakonisht bujarë dhe kurrsezi të mos vrapojnë pas postit e pozitës. Moskërkimi i shpërblimit (Shuara, 109), madje shmangia nga shpërblimi i ardhur pa e kërkuar, mospranimi i të mirave të ardhura prej njerëzve duke u treguar i ngopur, jonevojtar dhe për të mos rënë nën detyrimin e mirënjohjes, janë domosdoshmëri të detyrës

profetike. Është, gjithashtu, po kaq e rëndësishme që të mbetemi siç jemi, t'i kundërvihemi efektit ndryshues të botës, të mbetemi të lirë nga kushtëzimet materiale dhe vullnetarë gjer në fund. Të çlirohesh plotësisht nga akuzat e interesaxhiut, t'i mohosh gjer në fund interesat materiale duke jetuar pa plan e pa shtëpi dhe të largohesh nga kjo botë si një i vetmuar pa lënë gjë pas, të parapëlqesh t'u flasësh për të drejtën dhe të vërtetën vetëm pesë a dhjetë vetëve ndaj të gjitha pasurive dhe të mirave të kësaj bote dhe, po të jesh i pasur, ta shpenzosh atë në rrugën për ringjalljen e një brezi me kokën dhe zemrën të pangopur, siç e patën shpenzuar Hz. Ebu Bekri, Hz. Osmani dhe Hz. Hatixhja, dhe, më në fund, edhe të harrosh çdo gjë që ke bërë, të gjitha këto janë nga domosdoshmëritë esenciale të kësaj detyre!

22. Në dhembshuri, mëshirë, dashuri dhe mirëkuptim duhet të jemi gjithmonë në krye. Duke e kryer këtë detyrë, duhet qenë jashtëzakonisht i dhembshur, i mëshirshëm, i butë dhe lëshues. Veçanërisht në shekullin tonë ka turma të tëra njerëzish që kanë nevojë të kapen për dore, që gjërat që do t'u tregohen, t'u tregohen ëmbël e t'i vënë në mendime dhe, më në fund, që kanë nevojë të orientohen në rrugën e drejtë. Të sillesh ashpër me një brez të përbërë prej qeniesh në dukje të çuditshme, i cili, në shumicën e tij, ushqehet në prehrin e kushteve ekzistente, është njëlloj si të thuash rri aty ku je (rri në vendnumëro)! Në Kuran, profeti Musa urdhërohet të sillet me fjalë të buta edhe para faraonit, madje. (Ta-Ha, 44) Në ajetin e zbritur pikërisht pas luftës së Uhudit, Profetit i thuhej: *“Është për shkak të mëshirës së Allahut që ti u solle butë me ta. Po qe se do të tregoheshe i ashpër e zemërgur, ata do të largoheshin prej teje e do të shpërndaheshin!”* (Al Imran, 159) Në shumë vende ku bëhet fjalë për orientimin e njerëzve, stili i Kuranit është i njëjtë.

Profeti ynë, diku porositi, *“përgëzoni, mos neveritni, lehtësoni, mos vështirësoni”*, kurse diku tjetër, *“unë jam urdhëruar për t'i drejtuar njerëzit”*. Është shumë me rëndësi të sillesh butë, me mirëkuptim dhe virtytshmërisht me besimtarin dhe personin e përshtatshëm për t'u fituar, kurse në mënyrë të logjikshme e njerëzore, me mohuesin dhe njeriun zemërgur duke ditur ta trajtosh dhe drejtosh ashtu siç kërkon. E veçanta që duhet bërë kujdes në të gjitha situatat, është që patjetër të mbash një të çarë dhe një dritare të hapur nga ku t'u përcjellësh të tjerëve të drejtën dhe të vërtetën. Para se t'ia numërosh dhe derdhësh fytyrës personit që të del para, të gjitha të vërtetat fetare menjëherë sikur ta qëlloje me pushkë të mbushur me saçma nga gryka, duhet ta dëgjosh, t'ia kuptosh gjendjen e brendshme dhe gjërat për të cilat ka nevojë, t'ia tregosh me një mënyrë që ia kërkon ndërgjegjja dhe shpirti, në mënyrë që të mos e humbësh në vend që ta fitosh atë njeri. Ky nuk është lëshim. Le ta kujtojmë edhe një herë se namazi u bë detyrim vetëm tetë vjet pasi Profetit iu dha detyra profetike. Siç është kusht që fëmijës duhet t'i jepet ai ushqim që ia kërkon mosha dhe ai mësim që ia kërkon mosha, ashtu dhe është esenciale që në fillim duhet ngopur dhe kënaqur zemra e zbrazët. Ndryshe, ashtu siç nuk mund të vëmë si kusht për një person që ta pranojmë vetëm nëse i pranon të gjitha gjërat, ashtu dhe nuk mund t'i themi se mund të mos falë namaz. Krahas ndjenjës jomiqësore ndaj një mohuesi për shkak të mendimit të tij mohues, duhet të dimë se është e domosdoshme se duhet të jemi në çdo kohë të hapur ndaj tij për dialog. Si sakrifikantë të afërsisë dhe konfidencës, jemi të detyruar të mos i përgjigjemi me dorë atij që na bie me dorë, të mos i përgjigjemi me fjalë atij që na shan me fjalë, por, në të njëjtën kohë, të mos e miratojmë me zemër. Lëreni përgjigjen me grushta, ne duhet ta vëmë veten në marrëdhëniet “bilbil-trëndafil” në mënyrë që në mendime dhe ndjenja të çelin trëndafila. As te Profeti ynë, as te të gjithë profetët e tjerë pa përjashtim s'është parë që t'i kenë sjellë në rrugë njerëzit duke i rrahur ose i vvarë. Kjo

mënyrë sjelljeje është parë dhe mund të shihet vetëm te njerëz si faraoni i kohës së profetit Musa, i cili, pasi e mori vesh nga orakujt se do të lindte fëmija që do të rrëzonte nga froni, pra, Musai, urdhëroi vrasjen e qindra foshnjave meshkuj për të parandaluar realizimin e parashikimit të orakujve! T'i tregosh grusht dhe urrejtje brezit tonë me zemrën dhe mendjen të pakënaqur, do të thotë që, në vend që t'i zbutësh zemrat dhe mendjet e mangëta nga çdo gjë, t'u vësh dinamitin! Ilaçet me efekt shërues shpirtëror në ditët tona janë mësimet e besimit dhe fesë.

23. Ashtu siç janë orientimi dhe kumtimi detyrë, është detyrë edhe kryerja e tyre në përputhje me metodën përkatëse. Edhe në punët më të thjeshta, si, për shembull, në tregti e në bujqësi, kërkohet një synim, një qëllim final, një fleksibilitet, një plan dhe një projekt. Atëherë, a mund të mendohet të mos ketë plan, projekt, qëllim e synim të përcaktuar në çështje tejet serioze si shpëtimi i besimit që është çështja më e madhe, si qetësimi i zemrave, hapja e rrugëve të xhenetit, parajsës, dhe shpëtimi e lumturia e një kombi? Në një specifikë të tillë të rëndësishme, është e kotë të presësh dobi dhe sukses në hapat e hedhur pa llogari e në mënyrë të papërshtatshme me mënyrën se si duhen hedhur. Në gjithësi ka një ekuilibër, plan dhe program të caktuar. Atëherë, edhe besimtari, në detyra si kjo duhet të jetë tej pamës, duhet të veprojë me vetëdije dhe në mënyrë sistematike.

24. Është kusht që të kuptohet mirë mënyra e veprimit të Profetit. Për ta kryer këtë detyrë në përputhje me teknikën e saj, ndjekja e arritjes së rezultatit të drejtë me anë të preteksteve gjithashtu të drejta, është specifikë e rrugës Muhamedane dhe shumë e rëndësishme veçanërisht për ne. Në jetën e Profetit nuk ka ndodhur qoftë edhe një herë të vetme që të ketë thënë një fjalë apo të ketë bërë një veprim të paqëndrueshëm ose të paqëlluar. Prandaj dhe në jetën e tij kurrë nuk ka ndjerë nevojën për të hedhur hap prapa.

Nëse besimi islam është një kauzë e drejtë, dhe ashtu është, edhe fitorja e saj në të katër anët e botës do të bëhet me pretekste jo të shtrembra e bestyte, por të drejta! Ta shohësh si normal çdo pretekst që të çon në rezultat dhe të kërkosh rezultat me mjete të shtrembra e të padrejta, është atribut mohues(ish) e heretik(ësh). Njëri prej attributeve më të para të komunizmit ka qenë justifikimi i çdo preteksti ose mjeti që jep rezultat. Ç'e do se koha e ka treguar dhe do ta tregojë gjithmonë se sa të dëmshme janë rezultatet dhe përfundimet e arritura me pretekste dhe mjete të padrejta por të para si të justifikueshme vetëm për shkak të rezultatit të çastit.

Meqë është vendi, le të kujtojmë duke e theksuar fort këtë gjë, se as në periudhën e lumtur të Profetit, as në periudhat e sahabëve dhe tabiinëve dhe as në periudhat pasuese nuk janë njohur dhe përdorur mjetet e shkrimit të parullave nëpër mure, e hedhjes së sloganeve, e bojkotimit dhe demonstratës!

Stabiliteti dhe qetësia nuk sigurohen me anë të destabilitetit dhe rrëmujës. Paqja dhe qetësia e zemrave arrihen duke hyrë në zemra dhe duke vepruar si Mbreti i Zemrave. Për ata që kërkojnë të hyjnë në zemra, ka shumë rëndësi që dashuria dhe afërsia ndaj njerëzve të mos u lërë kohë për zemërim dhe që të bëhen mbrojtësit dhe ruajtësit e paqes, rendit e qetësisë. Detyra jonë s'është të bëjmë kritikën e herezisë, perversitetit dhe mëkateve të të tjerëve, përkundrazi, është të shqetësohemi se si ta bëjmë sa më mirë dhe drejt detyrën tonë duke e filluar me vetëllogari. Fundja, është urdhri i ajetit kuranor që të mos preokupohemi shumë me perversitetin e të tjerëve, por të

përpiqemi ta përmirësojmë gjendjen tonë. (Maide, 105) Po, përsa kohë që të përpiqemi ta përmirësojmë veten tonë, perversiteti i të tjerëve s'ka për të na shkaktuar dëm. Nga ky aspekt, ne jemi të detyruar të jemi përhapësit e pozitives dhe bukurisë. Po të lexoni librat biografikë, do të shihni se, në kohët kur ka munguar ekuilibri i fuqisë mes besimtarëve dhe mohuesve, vazhdimisht ka kërkuar rrugët për të hyrë në zemra dhe ka kaluar nga një llogore në tjetrën. Mendoni Taifin! Sidomos mendoni se si i Dërguari i Allahut e fshinte me dorën e vet emrin e vet në marrëveshjen e Hudejbijes kur ishin me qindra sahabë që ishin gati të hidheshin drejt vdekjes për të! Mendoni myslimanët që, pasi kishin shkuar gjer pranë Qabes për ta vizituar, ktheheshin prapë pavarësisht nga mendimet dhe qëllimet e tyre! Mendoni se si i kthente Profeti pas, sipas marrëveshjes së Hudejbijes, mekasit që ishin bërë myslimanë, dhe se si ajo marrëveshje e dukur si humbje dhe disfatë, brenda disa vjetëve ishte kthyer në një *triumf të së vërtetës*! Pastaj mendoni Ebu Sufjanin dhe shokët e tij që nuk e kishin kuptuar dot strategjinë e lëvizjes që kishte vënë në zbatim Profeti pavarësisht nga dhjetëra shikime tradhtare dhe, pasi qenë përballur me ushtrinë islame dhjetëmijëshe, kishin shprehur dashje pa dashje besimin ashtu, të tronditur e të pashpresë nga ç'kishin ndodhur! Mendoni dhe përpiquni ta vëzhgoni me habi dhe mahnitje atë aksion të jashtëzakonshëm të zhvilluar nën atë heshtje të sipërfaqshme! Kjo është, siç shprehet Kurani, si habia dhe mahnitja e bujkut që vëren se si farërat e hedhura prej tij, pasi kanë ndenjur një kohë nën tokën e mbuluar nga bora, kanë mbirë dhe kanë hedhur shtat! Dhe prapë kjo është rezultati i fjalës enigmatike *telattuf*³⁴ të përdorur në suren Kehf të Kuranit! (Kehf, 19)

25) Për ta kryer këtë detyrë, duhen përgatitur individë të aftë e të posaçëm. Një tjetër parim detyrë që na e ka mësuar Profeti, është krijimi i lidhjeve me njerëz të çdo pikëpamjeje dhe botëkuptimi dhe, në vend të përgatitjes së turmave të dobëta, përgatitjen e individëve të formuar e të palëkundur.

Siç dihet, në Mekë, pranë Profetit kishte njerëz nga të gjitha moshat, gjendjet dhe nivelet, si dhe sklevër. Parësia e politeistëve i thoshin t'i largonte sklevërit dhe njerëzit e nivelit të ulët në mënyrë që të uleshin e të bisedonin me të dhe kërkonin të krijonin marrëdhënie të veçanta me të. Meqë Profeti e dinte se bazën e grupit të njerëzve që e mbështesnin, e përbënin të varfrit të cilët, ndërkaq, ishin persona me cilësi të veçanta, jo vetëm që i pati hedhur poshtë kërkesat e politeistëve, por dhe që shprehur konkretisht se propozime të tilla nuk duhet të merren në konsideratë.

Me të vërtetë që Profeti ka për t'u krenuar me shumicën tonë, por, prapë, denjësia jonë është parim për krenimin e tij. Në kohët e para, pranë Profetit, në shtëpinë e Erkamit kishte 4-5 vetë. Pastaj ky numër arriti në 40. Ata të 40 vetët janë bërthama e të shquarve të parë. Mirëpo sa rrugë të ngushta u kaluan, sa ujëra të thella u kapërcyen gjersa u arrit të formohej ajo bërthamë prej dyzet vetësh! Ata që u përgatitën në këtë periudhën më të vështirë pa u kthyer pas, pa e braktisur frontin, sigurisht që janë ata që në Bedër dhe Uhud qëndruan gjer në fund pa e braktisur pozicionin! Ashtu siç qenë Ali-të me Hamza-të e të dyzetëve të parë që u erdhën hakut politeistëve në Bedër dhe Uhud, ashtu dhe qenë Omer-ët e tyre që u erdhën hakut Iranit e Bizantit dhe kjo gjë është tejet e rëndësishme. Në periudhën e dyzet të parëve, mes sahabëve nuk haset në ndonjë hipokrit apo munafik, sepse ishte e pamundur që mes tyre të ndodheshin apo të strehoheshin të tillë. Në atë periudhë torturuese, të thoshe La ilahe il'lallah, Nuk ka zot tjetër veç Allahut, jo vetëm që s'të sillte

³⁴ *Telattuf*: delikatesë lëvizjeje, veprimi e sjelljeje, sjellje e hollë e delikate, mirësi. Shën. i perkthyesit.

asnjë përfitim nga ato gjëra që i përkasin kësaj bote, por mund të bëhej shkak për shumë dëmtime materiale e fizike. Prandaj, në një periudhë të tillë durimi e qëndrese nuk mund të bëhej fjalë për hipokrizi! Duket se ne nuk e kemi hallin të shumica dhe masa, por të bërthamat dhe individët e shquar që ta bleronin sërish botën!..

Personat e pangopur si zemër, mendje, logjikë e ndjenja, jo vetëm që do të rrinë në boshllëk duke u tundur si hije, por dhe para një ere të lehtë do të rrëzohen menjëherë. Prandaj ata nuk janë kredia jonë. Sigurisht, pa pjekurinë e arritur në Taif dhe pa përvojën e jetuar në Hudejbije dhe hapin e hedhur atje, as triumfi i Mekës do të ishte i mundur, as dhe hyrja masive e njerëzve në Islam!

Pastaj, nëse është gjithmonë e mundur për t'u ulur gju më gju me individë për të biseduar e qarë hallet me ta, për t'ua hequr dyshimet dhe zgjidhur nyjet, si dhe për t'ua pajisur zemrat me bukuritë e Islamit, është e pamundur të mendohet dhe realizohet një gjë e tillë me masat. Edhe nëse masat mund të entuziazmohen dhe ngrihen peshë me ide e ndjenja të caktuara, askush nuk mund ta ketë avantazhin për të komunikuar individ për individ për të drejtuar ndjenjat dhe mendimet e çdo individi veç e veç!

26. Ose duhet folur për mirë, ose duhet heshtur! Njëri nga parimet e kësaj detyre është ndjekja e rrugës së drejtë edhe në gjuhë. Po që se mospërdorimi i gjuhës si interpret i të drejtës e i të vërtetës është qëndrim i skajshëm, edhe përdorimi i saj me fjalë të kota, me fjalë në erë, është qëndrim i skajshëm. I tillë është të folurit me ironi apo sarkazëm, me anekdota, të folurit kritizues, llafazanëria dhe shakatë e pavend. Njeriu ose duhet të flasë për mirë, ose të heshtë dhe gjuha gjithmonë duhet të jetë interpretuese e të vërtetës!

27. Po që se heqim vështirësi për ta parashtruar një gjë, duhet t'ia lëmë dikujt tjetër për ta parashtruar. Të hidhesh në mes për çdo temë, të pretendosh t'i japësh përgjigje çdo çështjeje, do të thotë të mbetesh e të shtypesh nën egoizmin tënd. Po që se një çështje që na parashtrohet ne, nuk hyn në fushën tonë, ka mundësi që të mos e trajtojmë dot atë çështje në përputhje me dimensionet e saj. Ndërkaq, si rrjedhojë e hyrjes në një fushë të huaj, sado të sinqertë që të jemi, ndaj nesh mund të krijohet reaksion, mund të zgjojmë tek të tjerët shqetësim, madje urrejtje dhe, në këtë mes, edhe e vërteta mund të dëmtohet, edhe bashkëbiseduesi ynë mund të mbetet në boshllëk. Në kushte të tilla, fjalën duhet t'ia lëmë shokut që është kompetent dhe të mjaftohemi me parashtrimet e tij, duhet ta mbështesim atë, ta duartrokasim suksesin e tij dhe të dimë të lavdërohemi me të!

Veçanërisht, nëse ka edhe persona dhe grupe që vrapojnë pas kësaj detyre, të dalësh në shesh me qëndrimin “vetëm unë e përfaqësoj të vërtetën, vetëm unë mund të flas për të”, edhe sikur në thelb të këtij qëndrimi të ketë sinqeritet, do të jetë i papranueshëm te Allahu ngaqë, në një pamje, një qëndrim i tillë konsiderohet egoizëm, prandaj edhe nga një qëndrim i tillë duhet ndenjur sa më larg. Veç kësaj, çdo njeri që i shërben të vërtetës në vijën e sunizmit, duhet duartrokitur. Askush nuk duhet kritikuar e denigruar në emër të respektit për të vërtetën dhe në emër të shërbimit ndaj të vërtetës. Dhe duhet përfituar nga energjia e çdokujt për llogari të së vërtetës.

28. E drejta dhe të vërtetat duhet t'u parashtrohen dhe shpjegohen më parë atyre me natyrën, gjendjen dhe bindjet më të përshtatshme. Duke e kryer detyrën për t'ua kumtuar zemrave Zotin

dhe të vërtetën, është me vend t'u drejtohem me parë atyre me natyrën, gjendjen dhe bindjet të përshtatshme si dhe ballin të rënë pak a shumë në sexhde, pastaj atyre që thonë se kanë dëgjuar për Profetin ose se e pranojnë atë dhe, më në fund, atyre që, pasi të dëgjonin ç'u thuhet, të shprehnin pranim. Shpresojmë se brezi ynë që, në fakt, në 80 përqind të tij përbëhet nga njerëz të tillë, para një tërheqjeje të sigurtë do të tregojë mirëpëlqim.

Preokupimi me njerëz me ballin të fëlliqur e që u ka zënë kallo, me zemrën të vulosur, të vendosur për të mos bërë kthesë dhe me qëndrim armiqësor, është i kotë. Madje, preokupimi me ta është edhe i dëmshëm, sepse, *e para*, u sugjeron të tjerëve idenë se mund të rrihet dhe bisedohet me njerëz të tillë dhe, *e dyta*, ata mund ta dëmtojnë botën shpirtërore të personit që ulet me ta, të ndikojnë negativisht me atmosferën e tyre negative mbi ndjenjat e bashkëbiseduesit, madje, t'ua heqin kënaqësinë e namazit. Në Kuran urdhërohet: "*Mos u prirni ndaj mizorëve qoftë edhe me prirjen më të vogël!*" (Hud, 113) Ndërkaq, nuk është pa dobi të mbahet një derë hapur vetëm për njerëzit, biseda me të cilët mendohet si e dobishme, të cilët dëgjojnë kur u flitet për të drejtën dhe të vërtetën, e gjitha kjo me mendimin se mund të vijë e të bashkohen me ne, sidomos kur biseda me ta të jetë krejt e sigurtë, e butë, pa inate dhe larg çdo mendimi për ndonjë lloj përfitimi.

Janë edhe disa njerëz jo krejt të ngarkuar me mohim, por egoistë dhe të zhytur në pije e mëkate të tjera. Interesimi ynë ndaj tyre me një *tungjatjeta* është domosdoshmëri e respektit ndaj besimit të tyre, e dëshirës për t'i çuar më tej marrëdhëniet me ta dhe e besimit tonë. Përsa kohë na dëgjojnë dhe përfitojnë, duhet të ulemi e të bisedojmë me ta, por, nëse nisin të ironizojnë e të tallen me gjërat për të cilat ne u flasim, duhet që, sipas urdhrit të Kuranit, ta ndërpresim prirjen ndaj tyre dhe të ngrihem i ikim por pa u nxehur, pa u folur me fjalë të këqija dhe pa u sjellë në mënyrë të shëmtuar e fyese për ta, si dhe pa e mbyllur derën e tungjatjetës.

Përcaktimi që më parë i gjendjes së personave të cilëve do t'u ofrojmë shërbimet tona në emër të orientimit dhe kumtimit, ka shumë rëndësi.

Qysh në njohjen e parë, fytyra e personit, mënyra se si përshëndet, si bisedon dhe sillet janë tregues që na japin një ide paraprake për të. Vlerësimi i preteksteve të tilla mund të ndihmojë për krijimin e dialogut.

Një marrëdhënie e parë me një pamje që i sugjeron bashkëbiseduesit siguri, me një pamje simpatike, të butë, të natyrshme e të sigurtë është shumë e rëndësishme. Edhe përpjekja për ta bërë veten të dashur për llogari të përpjekjeve për ta bërë të dashur Profetin, është e justifikueshme, madje, mund të quhet e dobishme. Krijimi i afërsisë në emër të shoqërisë dhe njerëzores si dhe bujaria, siç e kemi mësuar nga Profeti ynë, kanë rëndësi të madhe për të hyrë në zemra. Kurrë nuk duhet të harrojmë se, ashtu siç kemi ne vetë mendimet dhe opinionet tona, madje, fiksime tona, edhe bashkëbiseduesi ta ato të vetat, për ç'shkak është krejt e mundshme që mund të kemi një sërë reaksionesh. Jemi të detyruar ta dimë dhe pranojmë se është krejtësisht e pamundur që një njeri t'i heqë nga koka e t'i hedhë brenda një çasti dhe me një lëvizje të vetme mendimet, idetë, bindjet dhe opinionet që i ka bartur për vite me radhë. Mendoni se Kurani e realizoi transformimin e tij të madh për 23 vjet, se disa gjëra i vuri para e disa të tjera i la për më pas, se ato që duheshin thënë në fillim, i tha në fillim e, ato që duheshin thënë më pas, i tha kur u erdhi koha, duke e vënë çdo gjë në vend në mënyrë graduale.

Edhe ne, para se të hyjmë menjëherë në temë e t'i derdhim gjërat në shesh krejt hapur, duhet të përpiqemi që, me biseda personale, ta njohim bashkëbiseduesin me anë të temave dhe çështjeve që

do të bisedojë ai vetë. Ashtu siç vepron mjeku që në fillim bën anamnezën e sëmundjes, pra bisedon drejtpërdrejt me të sëmurin për historikun e sëmundjes dhe ankesat e tij, pastaj sheh analizat, vendos diagnozën dhe vetëm pas këtyre përgatitjeve fillon mjekimin, ashtu dhe ne në fillim duhet t'i japim mundësi të sëmurit me ateizëm dhe mohim që të na flasë për bindjet, dyshimet dhe lëkundjet e veta ose të na bëjë pyetje në lidhje me çështjen. Dhe kurrë nuk duhet të tregojmë reaksion sapo të na tregojë mendimet dhe dyshimet e veta. Nuk duhet të harrojmë se, meqë çështjet besimore dhe kuranore janë të huaja për brezin tonë, ai mund t'i dalë kundër çdo gjëje që dëgjon prej nesh. Në këtë rast, po qe se kundërveprimi ynë nuk do të jetë i butë dhe i përshtatshëm, mund të bëjmë që ai të largohet edhe më shumë nga Allahu. Prandaj, përcaktimi i gjendjes kulturore, arsimore dhe besimore i bashkëbiseduesit tonë është shumë i rëndësishëm. Për shembull, po qe se bashkëbiseduesi ynë ka nivel më të lartë arsimor e kulturor se ne, si dhe mbahet disi egoist dhe i ditur, kurse ne, ndërkaq, i dalim para me ca gjysmënjohuri të katekizmit, e kemi krejt të pamundur të komunikojmë me të dhe të ndikojmë mbi të. Në raste të tilla, duhet të nxjerrim para personin e të njëjtit nivel e t'ia lëmë në dorë atij.

Edhe mosha dhe karakteri i bashkëbiseduesit tonë kanë rëndësi. Kur është vendi, mund t'u flasim për besimin dhe fenë prindërve, xhaxhait apo dajës, si dhe personave më të mëdhenj në moshë se ne. Ndërkaq, duhet ditur se, për shkak të natyrës njerëzore, njeriu tregon gjithmonë reaksion ndaj më të vegjëlve, me përjashtim të njerëzve të virtytshëm e të çmuar të cilët tregojnë pjekurinë për t'i dëgjuar të vegjlit. Megjithëkëtë, duke u nisur nga e përgjithshmja, ne duhet ta njohim bashkëbiseduesin me bashkëmoshatarë ose më të mëdhenj në moshë, të cilët të mund t'i flasin në një mënyrë të kuptueshme e të pranueshme për të.

Një specifikë tjetër e orientimit është shëtitja dhe njohja e xhamive dhe institucioneve ku ndodhen persona të shquar si dhe njohja e bashkëbiseduesit me bashkëmoshatarët.

Sado që t'i flisni bashkëbiseduesit, madje edhe sikur t'i hyni në zemër e të ngrini për vete fron në të, ai do ta ndjejë veten të vetmuar e të shtypur nën peshën e vetmisë nëse nuk do ta shohë të bashkëmoshatarët zbatimin praktik të gjërave që ia keni mësuar. Trëndafil mbijnë e rritet në trëndafilishte. Edhe i riu ndikohet nga bashkëmoshatarët që falin namaz, bien në sexhde dhe janë të ditur, ndryshe, as i madhi kërkon këshillë prej të voglit, as i vogli ndikohet shumë prej të madhit. I vogli e respekton të madhin, por ndikohet nga bashkëmoshatarët, bën siç bëjnë ata.

Një tjetër specifikë është leximi i librit dhe organizimi të paktën i një bisede në javë.

III. SPECIFIKAT QË E DËMTOJNË VEPRIMTARINË ORIENTUESE

1. Nuk është e lejueshme që çështjet fetare të parashtrohen në formë debati dhe polemike me qëllim për ta heshtur dhe vënë poshtë bashkëbiseduesin. Po qe se në një vend ku flasim për fenë, ka kundërshtime dhe ide antagoniste, jemi të detyruar ta ndërpresim bisedën. Po qe se vazhdojmë të flasim, edhe vetë hyjmë në mëkat, edhe besimin e bashkëbiseduesit apo auditorit e hedhim në rrezik. Qëllimi ynë s'është kurrë t'ia presim fjalën bashkëbiseduesit apo auditorit, t'i zëmë mat ose të sigurojmë epërsi ideore mbi ta; qëllimi ynë është ta bëjmë të dashur Zotin tonë!

Disa herë, polemizimi me bashkëbiseduesin mund ta shtyjë atë të këmbëngulë në kryeneçësi, për më tepër, të studiojë dhe kërkojë t'i shtojë njohuritë mbi mohimin. Po qe se mendimi për t'ia mbyllur gojën dhe për ta vënë poshtë dhe polemizimet ideore e shtyjnë bashkëbiseduesin në kundërshtim kryeneç, duhet shmangur patjetër nga polemika. Pa dyshim, në këto raste, bashkëbiseduesi, jo vetëm që s'ka për të na dëgjuar, por ka për të ardhur i përgatitur për të na bërë pyetje e kundërshtuar dhe, më në fund, ka për t'u ndarë prej nesh i mbushur me pakënaqësi dhe zemërim.

2. Orientimit dhe kumtimit nuk i duhet lëshuar hije me opinione dhe qëndrime politike. Njëra prej pikave që duhen bërë kujdes në lidhje me orientimin dhe kumtimin veçanërisht në ditët e sotme, është domosdoshmëria për t'u shmangur nga idetë dhe mendimet politike që do t'i lëshonin hije detyrës sonë, që do të zgjonin antipati ndaj nesh dhe që, ndërsa do t'i linin të kënaqur disa persona të caktuar, do ta zemëronin shumicën, sidomos nëse masat do të kishin nevojë për besim. Kurse brezi ynë sot jo vetëm që s'i njeh dhe kupton çështjet administrative dhe politike, por është edhe larg njohjes dhe kuptimit të çështjeve besimore themelore që kanë të bëjnë me Allahun, Profetin dhe Kuranin. A ka ndodhur ndonjëherë që dikush me një opinion politik çfarëdo të bëhet që t'i pranojë çështjet fetare në atmosferë politike? Jo! Përkundrazi, ka ndodhur që të fryhen meritë,

neveritë dhe urrejtjet e lidhura me debatet, polemikat dhe përpjekjet për ta heshtur dhe vënë poshtë kundërshtarin! Prandaj, duke folur për të vërtetat si perla mbi Allahun dhe Profetin, bashkëbiseduesi do t'i shohë ato si copa xhamash, njerëzit si engjëj do t'i vlerësojë me vështrim tjetër duke konkluduar prerazi se, meqë s'janë të një mendimi me të, s'vlejnë për të, dhe do të largohet duke i akuzuar se "e përdorin fenë si mjet politik". Dhe ju, duke dashur të flisni për 3-5 përqind të çështjeve fetare, me opinionin tuaj politik do të bëheni shkak për shkatërrimin e 98 përqind të çështjeve besimore e adhurimore. Këto që po themi nuk janë kritikë ndaj opinionëve politike. Edhe besimtarët mund të kenë opinionet dhe pëlqimet e tyre politike. Ajo që kritikojmë ne është përljerja e metodës së orientimit me politikë. Opinioni politik duhet të mbetet një ngjarje e kufizuar në javën e zgjedhjeve elektorale, kurse e gjithë koha duhet kaluar duke ua përçarë brezave të vërtetat besimore dhe adhurimore!

3. Nuk duhet shmangur nga përdorimi i aftësive dhe mundësive personale e rrethanore. Ne duhet të mendojmë për çdo fjalë që na del prej goje. Çdo besimtar, brenda parimit të kursimit maksimal, duhet t'i përdorë mundësitë dhe aftësitë e tij gjer në pikën më të fundit dhe të përpiqet që rastet që i bien në dorë gjatë gjithë jetës, t'i vlerësojë dhe përdorë në mënyrën më ideale. Së bashku me njerëzit që u dalin për zot atdheut, kombit, kulturës kombëtare, historisë dhe brezave të rinj, të vrapojë atje ku e thërret detyra gjer në frymën e fundit!

IV. SI DUHET T'I KENË MARRËDHËNIET ME NJËRI-TJETRIN PERSONAT DHE GRUPIMET QË I SHËRBEJNË FESË?

1. Rrugët e ndryshme (*meshreb*) janë ndryshimi botëkuptimor mbi detajet e të njëjtës së vërtetë. Duke e patur fjalën veçanërisht për sot, duhet të theksojmë se, krahas synimit dhe qëllimit të përbashkët që kanë bashkësitë, grupimet ose organizatat, institucionet dhe fondacionet e ndryshme që zhvillojnë veprimtari në shërbim të besimit, fesë, Kuranit, atdheut dhe popullit, rrugët, metodat dhe mjetet që përdorin ato janë të ndryshme.

2. Ekzistenca e rrugëve të ndryshme është domosdoshmëri e të vërtetës së krijimit. Të thuash se pse ka më shumë se një rrugë (mënyrë, metodë, mjet) veprimi, do të thotë të mos e njohësh krijimin e njeriut, të mos i kuptosh dot të vërtetat krijimore, njerëzore, historike dhe ideore. Ndërkaq, duhet bërë menjëherë e qartë se të kërlesh të ketë mendime të ndryshme është tjetër gjë dhe të ketë mendime e gjykime të ndryshme si rezultat i domosdoshëm i materies dhe dukurive është krejt tjetër gjë.

Ekzistenca e mendimeve të ndryshme është përfundim i kuptimshëm i krijimit dhe natyrës së njeriut si dhe i vitalitetit ideor të tij. Si dhe gjallesat e tjera, njerëzit nuk ecin gjithnjë në të njëjtën vijë. Edhe kafshët kanë mënyra të ndryshme lëvizjeje e sjelljeje që janë të posaçme për botët e tyre. Dihet se amebat shumëzohen me anë të ndarjes. Amebat bija të krijuara nga një ndarje, largohen nga njëra-tjetra, bashkohen me ameba të tjera "të huaja" dhe formojnë koloni me to! Këtu unë

dëshiroj t'ju kujtoj një realitet që përbën shembull referimi për ne. Në kohën e Profetit vëmë re se shumë shokë të Profetit, duke përfshirë këtu edhe kalifët rashidinë (katër kalifët e parë), paraqesin krijime dhe natyra të ndryshme. Mendoni një herë Omerin dhe, pastaj, Ebu Dherrin. Ndërsa ishin unikë në besim dhe në rrugë, Profeti nuk pati kërkuar prej tyre të mendonin njëlloj. Si do ta shpjegojmë se nuk janë katër fraksione juridike-fetare, por, ndoshta, njëqind e katër dhe po kaq imamë e muxhtehidë? Ne jemi të detyruar t'i pranojmë të vërtetat historike. A është e mundur t'i hedhim poshtë me një të rënë dore përvojën e grumbulluar e të sjellë nga sa e sa imamë e ideatorë të mëdhenj duke nxjerrë nga deti i Hz. Muhamedit (s.a.s.) ujë me kova e me qepshe?

Gjithashtu, duke përfaqësuar një të vërtetë në fushën e vet, çdo rrugë zhvillon dhe zbaton një drejtim të caktuar. Për shembull, nëse penat e Egjiptit trajtojnë dhe zhvillojnë çështjet që kanë lidhje me jetën shoqërore, mendimtarët e vendeve të tjera punojnë mbi çështje të tjera. Çdo bashkësi dhe grupim ka strategjinë e vet të veçantë.

Veçanërisht, çdo individ dhe bashkësi ka një mjedis dhe një strukturë kulturore të vetën dhe kjo është kështu jo vetëm për ne, por edhe për të gjithë popujt dhe bashkësitë apo grupimet e tjera.

Krahas këtyre, çdo udhëheqës që del në një popull, komb, apo grupim, del me një sërë mendimesh dhe pikëpamjesh të ndryshme, njihet me to dhe i udhëheq përkrahësit e vet me to. Po kështu, dalin në shesh edhe natyra të veçanta e përjashtuese përsa i përket botëkuptimit fetar dhe mënyrës së të menduarit, të cilët parashatrojnë vlerësime të tjera dhe gjëra mjaft të ndryshme nga botëkuptimi i epokës. A nuk pati thënë Profeti se në çdo shekull ka për të ardhur një ideator? Ja, Imam Gazaliu, Imam Rabaniu, Bediuzzamani, Hasan el Bena e shumë të tjerë!

A ka gjë më të natyrshme për njeriun se puna dhe përpjekja në raport me madhësinë e suksesit dhe shpërblimit, se gara në gjëra të mira, të bekuara e të dobishme? Kush nuk dëshiron ta mbajë flamurin në luftë ose të marrë medaljen e artë në një garë? Në është kështu, do të thotë se rrugët dhe mendimet do të paraqesin ndryshime nga njëra-tjetra. Të kërkoshtosh ta kundërshtosh këtë, do të thotë të kundërshtosh krijimin, natyrën dhe të vërtetat historike. Ndërkaq, esenciale është të mos bëhet presion mbi muret ndarëse të së drejtës dhe së vërtetës e të mos goditen e dëmtohen ato, që dallimet në mendime dhe metoda të mos rrafshohen gjer në thjeshtëzim dhe unifikim me bazat, që në synimet dhe qëllimet të mos ndodhin shmangie e devijime dhe që të mos braktisen pretekstet dhe mjetet e vërteta duke u kapur ndaj preteksteve të shtrembra e perverse. Brenda deklaratës së një miku të Allahut, rrugët që shkojnë për te Allahu janë sa frymëmarrjet e krijesave. Para jush, njëqind piktorë po pikturojnë njëqind tablo të veçanta pranvere me elementë të ndryshëm arti. Çdo tablo reflekton vështrimin, ndjenjën dhe vlerësimin e piktorit të saj, por, si përfundim, të gjithë piktorët kanë pikturuar të njëjtën gjë: pranverën! Dhe ajo pranverë është brenda kornizës së shenjtë të përvijuar nga i Dërguari i Allahut dhe shokët e tij!

3. Mes ecurive nuk ka ndryshime në çështjet themelore. Mes rrugëve, në çështjet themelore dhe në metodë, jo vetëm që s'ka ndryshime, por pikat e përbashkëta janë jo një, por një mijë! A mos ka kontradikta në besimin monoteist te Allahu si Zoti i vetëm i gjithësisë, te profetësia dhe ringjallja? A mos ka kontradikta në lidhje me qenien e engjëjve dhe xhindeve? A mos ka kontradikta për librin tonë të shenjtë dhe për orientimin (kiblen) tonë? A mos ka kontradikta për detyrimin e namazit, zekatit, agjërimit dhe haxhit, madje, për rekatet e namazeve, masën e zekatit

dhe personat që u jepet? Ezanin që lartësohet nga minaret në të katër anët e botës, e kemi të njëjtë, idealin dhe shpresën, të njëjtë! Po, një mijë e një gjëra të përbashkëta!

4. Duke i lënë çështjet që përbëjnë hollësi, duhet qëndruar në unitet ndaj rreziqeve që vijnë prej jashtë. Si duhen parë çështjet që kanë të bëjnë me hollësitë për të cilat nuk kemi mundur të jemi në një mendje? Para së gjithash, ndërsa kemi kaq gjëra të përbashkëta të rëna nga qielli e që na e rrethojnë botën tonë, të preokupohesh me çështje mbi hollësira e imtësira që s'bëhen as sa një farë fiku, do të thotë të merresh me gjëra të kota, të pakuptim. Nuk duhet mbajtur çështja në rend të ditës duke u kapur pas imtësirave pa rëndësi dhe ata që përpiqen ta mbajnë, duhet t'i paralajmërojmë. Sot janë dy tipa njerëzish që e stërmadhojnë ndryshimin mes mendimeve, që e bëjnë këtë çështje dhe që, për pasojë, e thellojnë ndarjen mes bashkësive dhe grupimeve: tipi i parë, njerëzit që veprojnë kështu me qëllim të keq, me prapamendim dhe tradhtisht; tipi i dytë, me shprehjen dhe cilësimin më të butë për ta, njerëzit që e bëjnë këtë nga injoranca. Si rezultat i kësaj pune përçarëse, brezat që s'munden ta kuptojnë e konceptojnë çështjen me fytyrën e saj të vërtetë, e shohin botën islame të copëtuar. Kurse të gjithë njerëzit që i qëndrojnë besnikë deklaratës *La ilahe il'lallah, Nuk ka zot tjetër veç Allahut*, do të jenë së bashku në xhenet, parajsë! Prandaj askush nuk duhet nxirë me hollësira. Allahu do të na ringjallë dhe mbledhë ditën e ringjalljes dorë për dorë, do të na i fshijë të gjitha pakënaqësitë e zemrave dhe, pastaj, do të ulemi në frone përballë njëri-tjetrit e do të bisedojmë. (Hixhr, 47)

Shërbimi ndaj popullit i ngjet bartjes së një thesari të madh e të rëndë. Sa më shumë njerëz t'i vënë supet, aq më lehtë dhe shpejt bartet. Ja, kështu do ta shohim ne çështjen dhe do të përpiqemi gjithmonë për ta ruajtur këtë këndvështrim. Edhe vëllezërit e një shtëpie mund të ngatërrohen me njëri-tjetrin, por e rëndësishme është ta harrosh menjëherë ngatërresën dhe të bashkohesh dorë për dorë ndaj rreziqeve që vijnë prej jashtë!

5. Kokat që mendojnë dhe zemrat që derdhen nga ndjenjat, duhet të bashkohen dhe njësohen përreth një fryme. Në ditët tona, fjalët dhe ankesat e tipit “jemi bërë copa-copa, duhet të bashkohemi, pse s'bashkohemi”, etj., janë fjalët dhe ankesat më të zakonshme e më të shumta që hasen në të gjitha shtresat dhe nivelet dhe që të gjithë i kanë në majë të gjuhës! Në fillim, besimtarit që flet me këtë gjuhë, në atmosferën e një bisede të ëmbël, i duhen bërë pyetjet: “Ç'kupton ti me bashkimin dhe unitetin dhe si e mendon bashkimin e njësimin? Cilat janë shkaqet e copëtimit tonë?” Pastaj i duhet bërë ky propozim: “Në fillim ta njohim dhe diagnostikojmë dukurinë, pastaj të shohim se cila është zgjidhja!” Ky qëndrim dhe kjo mënyrë trajtimi gjithsesi është më e suksesshme.

Sëmundjes së padiagnostikuar nuk i shkruhet recetë! Veç kësaj, kur i pyesim besimtarët që i kanë në majë të gjuhës këto fjalë sot në këto kushte, se cila është diagnoza dhe cili është mjekimi i kësaj, marrim si përgjigje jo diagnozën dhe mjekimin e gjendjes së keqe sipas tyre, por mendime e ide të tjera të tyre që u shtohen mendimeve e ideve “copa-copa” sikur këto të mos ishin mjaft! Dhe nuk është aspak e tepruar po të thuhet se dalin aq formula bashkimi sa ç'është numri i njerëzve dhe i mendimeve që kërkojnë të thonë mendimin e tyre duke pretenduar se ai është më i drejt!

Megjithëkëtë, le të themi se çdo njeri me mend, arsye e logjikë gjeti një formulë bashkimi e uniteti të përshtatshme sipas tij. Në këto kushte, do të dalin ose do të nxirren një nga një individë ose liderë që do të pretendojnë duke thënë: “Edhe unë kam idenë dhe logjikën time, diturinë dhe

kulturën time, mënyrën time të të menduarit dhe kriteret e mia"! Jo, jo kështu! Gjithsesi, më e drejtë do të ishte të trajtohej çështja brenda realiteteve natyrore dhe jetësore dhe, ashtu siç rrotullohen mijëra njerëz rreth Qabes me të njëjtat ndjenja e mendime, të bëheshin përpjekje që mijëra koka që mendojnë dhe zemra që ndjejnë të bashkohen dhe njësohen rreth një "Njëshi"!

6. Trazimet shoqërore do të qetësohen në bregun e Islamit. Zemrat ngopen duke u kthyer dhe orientuar plotësisht nga Allahu që është "ehad", i vetëm, dhe arrijnë në teuhid, besimin monoteist në Allahun si Zoti i vetëm i gjithësisë. Po që se në mendjet dhe zemrat do të sundojnë ndjenjat dhe lidhja ndaj Profetit (s.a.s.), atëherë, pa dyshim, do të vijë një ditë që të gjithë rrugët të afrohen dhe bashkohen në një pikë, në portën e tij! Do të vijë një ditë që, të zhvilluara e zgjeruara në gjuhë e degë të ndryshme, dituritë dhe shkencat të thonë me një zë: "Kurani!" Dhe trazimet shoqërore do të kërkojnë zgjidhje, do të kërkojnë dhe, më në fund, do ta gjejnë te Islami dhe do të qetësohen.

7. Për një vëllazëri ku zemrat rrahin së bashku, kriteret e Allahut dhe të Profetit duhet të jenë pika jonë orientuese. Kurani na urdhëron: "*O ju që keni besuar, kini frikë Allahun ashtu siç duhet, kapuni pas Kuranit (që është litari i fortë e pacopëtueshëm i Allahut) e mos u copëtoni!*" (Al Imran, 102-103) Dhe pas kësaj bën fjalë për këshillimin për të mirë dhe pengimin e të keqes. Gjithashtu, Kurani urdhëron: "*Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit e mos u shtyni me njëri-tjetrin se pastaj dobësoheni, ju zë frika e humbisni fuqinë!*" (Enfal, 46) "*Besimtarët janë vëllezër, pajtojini vëllezërit!*" (Huxhurat, 10) Dhe, në vazhdim të kësaj, na këshillon: "*Mos u tallni me njëri-tjetrin, mos e nënvleftësoni, mos e dënoni dhe mos e turpëroni njëri-tjetrin dhe mos i ngjitni nofka njëri-tjetrit!*" Gjithashtu, me ajetin si më poshtë, Kurani tregon se kush i bashkon zemrat: "*Edhe sikur ti të shpenzoje gjithçka ndodhet mbi tokë, nuk do të mundje t'i bashkoje zemrat e tyre, kurse Allahu i bashkoi ata!*" (Enfal, 63)

Në veprat bio-bibliografike shohim se si u realizua kjo çështje në jetën e ndritshme dhe praktikën e Profetit. Këtu do të mjaftohemi vetëm me nja dy shembuj.

Në ngjarjet Buas, fiset Evs dhe Hazrexh patën sulmuar njëri-tjetrin, lufta për jetë a vdekje mes tyre pati vazhduar për vite, prandaj këto dy fise që do të bëheshin më vonë dy mbrojtës së fuqishëm të Islamit, ishin bërë armiq të më të mëdhenj të njëri-tjetrit. Por pastaj, pas hixhretit, këto dy fise u bashkuan e u bënë vëllezër me dorën e ndritshme të Profetit në mënyrë të tillë që mund t'ia jepnin me gjithë dëshirë njëri-tjetrit gjysmën e mallit dhe pasurisë, një pjesë të kopshtit, njëren dhomë të shtëpisë, që mund të luftonin së bashku sup më sup e të vdisnin për njëri-tjetrin, që e fushnin dhe nxirrnin lugën bosh nga ena e supës me mendimin që të ngopej vëllai besimtar, që mund t'ia binin ndër këmbë njëri-tjetrit për t'ia kërkuar falje dhe që, në fushën e luftës, duke vdekur vetë për një pikë ujë, t'ia linin vëllait enën e ujit...

Atëherë, për të arritur bashkimin, unitetin, aleancën dhe një vëllazëri ku zemrat të rrahin së bashku, në vend të qindra mendjeve, ideve dhe filozofive, duhet të kemi për orientim kriteret e Allahut dhe të Dërguarit të Tij! Në vend që të pyesim pse jemi bërë copa-copa, të shmangemi nga fjalët, sjelljet dhe veprimet që çojnë në copëtim dhe, në vend të këshillave për bashkim, të themi fjalë e të bëjmë veprime që çojnë në bashkim.

Prandaj duhen duartrokitur të gjithë ata që zhvillojnë veprimtari orientuese e kumtuese dhe duhet bërë lutje për ta. Sigurisht, çdo njeri që i do Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe që flet për ta, duhet të miratohet, të duhet dhe të nderohet për hir të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Njeriu s'duhet të pretendojë se vetëm rruga e tij është e drejtë dhe, kështu, të mos u njohë të drejtë jete të tjerëve. Besimtari mund të thotë se rruga e tij është e drejtë, e bukur, e mirë, e pëlqyeshme, e goditur, por nuk mund të thotë se vetëm e tija është e drejtë dhe e vërtetë. Është mjaft e natyrshme që njeriut t'i duket më e mirë dhe më e bukur rruga e tij sepse e ka me zemër dhe njeriu bëhet i suksesshëm dhe rezultativ në një punë me aq sa e bën të vetën dhe e dashuron atë!

Është gabim t'i nxish të tjerët, t'i damkosësh ata si të metë dhe të shëmtuar. Duhet të dish se si të ulesh e bisedosh me çdo njeri, zemra e të cilit rreh me dashurinë për atdheun dhe popullin, ta miratosh dhe përgëzosh atë pa i dhënë rast hapjes së portës së kritikës dhe t'u përgjigjesh gjërave të bukura me fjalë të bukura.

Kushdo që thotë se vetëm rruga e tij është e drejtë dhe e vërtetë, kurse të tjerat, të shtrembra e të gabuara, pavarësisht se kush është, u hap rrugë pakënaqësive dhe dasive serioze. Jo rrugën, por edhe veshjen dhe makinën t'ia kritikosh dikujt do të thotë ta bësh të pashmangshme ftohjen me të. Ndërsa edhe në çështje të zakonshme e të thjeshta, të mos i njohësh të drejtën e fjalës tjetrit çon në armiqësinë me të, mendoni ju se sa do ta dëmtonte besimin e dikujt cilësimi negativ i parimeve dhe metodave të cilave ai u ka kushtuar jetën, se ç'ftohje, armiqësi dhe mëkate do të shkaktonte!

Besimtari duhet të jetojë me dashurinë për rrugën dhe profesionin e tij dhe s'duhet të merret me gabimet dhe të metat e të tjerëve. Në vend të përpjekjes për ta nxjerrë gabim tjetrin, për ta mundur, për ta hedhur poshtë, duhen bërë përpjekje për të nxjerrë në pah anët e mira e të bukura të tij, në pastë.

Ai që merret me të metat e të tjerëve, nuk i sheh dot të metat e veta dhe nuk i tregon dot bukuritë e veta. Ndodh shpesh që kritika e shpejtuar ndaj edhe një gabimi të thjeshtë të japë si rezultat kundërveprim me të njëjtën monedhë.

Të përpiqesh për ta rrëzuar dhe shembur tjetrin dhe, pastaj, për të ngritur mirëqenie mbi gërmadhat e tij është punë dhe mjeshtëri jo e profetit, por e faraonit. Profeti ynë është përpjekur gjatë gjithë jetës vetëm për t'i rregulluar zemrat dhe mbushur ato me bukuri, ndërkaq që, edhe ndaj armiqve të tij më të egër, madje, s'ka treguar asnjë përpjekje për t'i goditur duke përdorur dobësitë e tyre personale. Sa domethënëse janë fjalët që pati thënë Profeti për Halidin në një kohë kur ky tundte shpatën kundër tij: *"... si ndodh që një njeri si Halidi ngul këmbë kaq shumë në politeizëm!"* Kur dikush nga sahabët i pati folur keq për një shok tjetër që kishte pirë disa herë, Profeti i qe përgjigjur me këto fjalë: *"Hesht! Ai i do Allahun dhe të Dërguarin!.."* Kur i biri i dikujt që pati shpifur për Hz. Aishen duke intriguar rëndë me këtë veprim mes myslimanëve, dhe i biri i pati kërkuar Profetit ta lejonte ta vriste me dorën e vet të atin, Profeti i pati thënë: *"Unë nuk lejoj që të tjerët të thonë se Muhamedi i vret shokët!"* Fjalët që pati thënë Profeti për Ebu Sufjanin që s'patën ç't'i bëjnë vitet, për birin e Ebu Xhehlit, Ikcrime, për Vahshiun që ia pati copëtuar trupin Hamzait, ungjit shumë të dashur të Profetit, për Hindin e të tjerë duke u shprehur për ta ditën e triumfit të Mekës, *"për ju sot s'ka qortim"*, duke shpalosur një mirëkuptim dhe falje të gjerë, duhet të jenë parim për ne!

Puna jonë nuk është t'i shembim zemrat, por t'i rregullojmë. Zemërimi dhe qortimi ynë drejtohen jo ndaj të tjerëve, por ndaj vetes sonë. Jo të kapemi pas të metave të të tjerëve,

përkundrazi, t'ua pastrojmë ato. Ne kemi për parim jo t'i ekspozojmë shëmtitë e të tjerëve, por t'i përhapim mirësitë dhe bukuritë tona. Armiqësi i duhet bërë armiqësisë, jo besimit dhe besimtarit. Edhe pse njerëzve u jepet vlerë sipas atributëve, ne nuk mundemi ta dimë vlerën e vërtetë që kanë ata te Zoti. Atëherë, në gjokse duhet të bartim zemra të pastruara veçanërisht nga komplekset ndaj zemrave të tjera!

Myslimanit s'i ka hije as të bëjë armiqësi, as të bëhet viktimë armiqësie. Sigurisht, besimtarit mysliman i cili duhet të jetë përfaqësues i dhembshurisë dhe dashurisë, urrejtja nuk i përshtatet aspak. Por nëse duhet treguar urrejtje, duhet treguar jo ndaj myslimanëve, por ndaj mendimit të armiqësisë që na e mbështjell shpirtin, ndaj neverisë dhe urrejtjes, mosmarrëveshjes, paafësisë për mirëkuptim, ndaj mohimit dhe herezisë, ateizmit, armiqve të besimit dhe Kuranit. Ndërkaq, është e pamundur të kuptohet se si mund të ushqehet armiqësi ndaj myslimanëve ndërsa lihen mënjana ose u tregohet mirëkuptim mijëra e miliona armiqve të besimit dhe Kuranit!

Jo vetëm që s'duhet të tregojmë armiqësi ndaj myslimanëve, por edhe në armiqësinë ndaj mohuesve, madje, duhet të kemi një masë, një kriter. Urrëjtja e kuptuar kështu do të na nxisë dhe shtyjë ne për punë të mira dhe do të bëhet pretekst dobish, do të bëhet pretekst që edhe në zemrën më të nxirë të mbijë trëndafil!

Shenja dalluese e besimtarit mysliman është jo urrejtja, por dashuria dhe miqësia: *"Allahu i do ata, edhe ata e duan Allahun. Para besimtarëve janë kokulur, kurse ndaj mohuesve, kryelartë e të ashpër. Ata luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk kanë frikë nga urrejtja e urrejtësit!"* (Maide, 54)

Të zësh me top frontin e besimit nuk ka asnjë kuptim dhe vlerë. Kjo s'ka asnjë ndryshim nga kthimi i grykave të topave kundër reparteve të tua në fushën e betejës!

Nëse një ditë përballemi me një mysliman që bën armiqësi kundër besimtarëve myslimanë, i dalim para me Kuranin dhe, siç e kërkon urdhri i tij, *"ti fto në rrugën e Zotit tënd me urtësi e fjalë të mirë"* (Nahl, 125), përpiqemi ta bindim me fjalët më të mira dhe, nëse ai përsëri nuk merr vesh, vazhdon me thashetheme, armiqësi dhe tund grushtin, ne, duke iu bindur ajetit që thotë se *"e keqja nuk barazohet me të mirën..., ti mbrohu ndaj të keqes në mënyrën më të mirë"* (Fussilet, 34), sillemi ndaj tij sipas parimit *"pa fjalë atij që shan dhe pa dorë atij që godet"*, por ftohtë dhe duke u lutur për të mirë për të. Ndërkaq, me qëllim që të mos i sjellë dëm anës sonë, nuk i kundërpërgjigjemi të keqes së tij, nuk merremi me të dhe zbatojmë urdhrin hyjnor, *"ktheju shpinën injorantëve"* (Araf, 199).

Dëmi i kundërpërgjigjes i mbetet nëntëdhjetë e nëntë përqind atij që kundërpërgjigjet dhe vjen një largim i tillë që është shumë i vështirë për t'u rikthyer në pikën e bashkimit.

Po, ne jemi duke u ngjitur në një të përpjetë. Ngarkesën e kemi shumë të rëndë dhe në majë, një sërë armiqsh që s'na durojnë dot. Në këto kushte, jemi të detyruar të jemi të paqtuar me vëllezërit, ta mbylлим në vetvete çdo mosmarrëveshje e grindje dhe kurrë të mos kundërpërgjigjemi.

Me të gjithë myslimanët kemi një sërë gjërash të përbashkëta të rëndësishme dhe në shumë specifika jemi të njëri-tjetrit, në unitet me njëri-tjetrin, jo të huaj për njëri-tjetrin. Ne kemi Zotin, Profetin, Kuranin, Qaben, historinë dhe shumë vlera të tjera që na lidhin e bashkojnë, të cilat është e pamundur të gjenden në bashkësi apo grupime të tjera. Dhe, ndërsa puna qëndron kështu, si mund ta quajmë normale që, duke i nënvleftësuar shumë e shumë gjërat e përbashkëta, të zhvillojmë armiqësi kundër njëri-tjetrit për gjëra të vogla e të parëndësishme?

Ndërsa bota krishtere dhe ateiste ka bërë gjithmonë përpjekje për t'u bashkuar mes vedi dhe ka arritur të bashkohet, ne, myslimanët, jemi prirur për t'u ndarë dhe për të dalë secili me flamur, në vend që, duke hequr dorë nga gjërat që na ndajnë, të bashkoheshim rreth vlerave që na bashkojnë.

Prandaj, besimtarët myslimanë duhet të përpiqen për t'u bashkuar me vëllezërit e tyre rreth bindjeve dhe ideve të përbashkëta dhe për t'i ruajtur ato. Kështu, duhen bërë përpjekje që fusha e veprimit të përbashkët jo të ngushtohet, por të zgjerohet dhe në asnjë mënyrë të mos shmanget nga vija e paqes.

Besimtari i mençur e i pjekur nuk ngrihet të bëjë duel me vëllain besimtar. Ndërsa jemi duke e bartur bjer e ngrihu thesarin që përpiqemi ta bartim së bashku duke u qëndruar besnikë vlerave të përbashkëta, çdo besimtar duhet ta kuptojë dhe e kupton se nuk është aspak koha për të bërë duel!

Të ftosh për bashkim, unitet dhe aleancë, t'ua sugjerosh të tjerëve këto dhe ta tharmosh këtë ndjenjë në shpirta, është gjë e bukur, por e pamjaftueshme. Esenciale është, siç u theksua në vendin e duhur, të thuash fjalë e të bësh veprime që çojnë në bashkim. Ndërkaq, në emër të aleancës, t'i ftosh të tjerët për aderencë, do të thotë që, në vend të zbatimit në praktikë të këtyre koncepteve kaq të larta, të mos bësh gjë tjetër veç apostolizmit dhe llafazanërisë së bashkimit dhe unitetit!

Kur themi "të bashkohemi", s'duam të themi aspak që të gjithë të bashkohen nën çatinë tonë, të hyjnë nën çadrën tonë, të aderojnë në sektin ose rrugën tonë. Mendime dhe synime të tilla jo vetëm që s'kanë për të sjellë kurrë bashkim, por thirrja "eja" do të gjejë si përgjigje gjithmonë një "jo" të fortë e të vendosur. Është jashtëzakonisht e gabuar të mendosh dhe shpresosh se njerëzit do t'i braktisin aq lehtë idetë, mendimet dhe ndjenjat që kanë ushqyer për vite me radhë e që u janë bërë natyrë e dytë. Një bashkësi nuk është ndërtesë që ta shembësh e, në vend të saj, të ndërtosh një të re! Ndërkaq, bashkësia ndryshon, por përmes ideve, mendimeve dhe ndjenjave të njerëzve që e përbëjnë atë, gjë që është një proces i ngadaltë e i gjatë. Prandaj, t'i ftosh të tjerët që të aderojnë tek ti duke i braktisur menjëherë idetë, mendimet dhe ndjenjat e ushqyera për vite me radhë, të bësh përkrahës me anë të presionit ideor, nuk jep asnjë rezultat tjetër veç largimit më të madh dhe përçarjes. Ftesa për bashkim duhet të bëhet për hir të Allahut, pra dhe duhet të jetë vëllazërore, duke respektuar idetë, mendimet dhe ndjenjat e tjetrit. Kjo është rruga e bashkimit të vërtetë.

Ndërkaq, nëse nuk arrihet bashkim dhe aleancë, përse duhet të pasohet, kjo, nga kontradikta dhe zemërimi? Pse duhet t'i kundërvihem dikujt vetëm e vetëm se nuk mendon si unë? Dhe pse duhet të zemërohem me të ngaqë s'më ndjek mua?

Bashkimi dhe uniteti janë një specifikë e varur nga pjekuria jonë dhe, në dashtë Zotit, një ditë do të bëhen realitet, mjafton që ne, duke respektuar parimet që u përpoqëm t'i parashtrojmë si dhe shumë parime të tjera të bukura, të lutemi çdo ditë për bashkimin dhe unitetin tonë si pretekste të përkrahjes hyjnore dhe t'ua hapim zemrën të gjithë besimtarëve me dashuri e respekt!

Përmbajtja

PREZANTIM

A. TEURATI DHE UNGJILLI JANË ARGUMENTE TË PROFETËSISË SË MUHAMEDIT (S.A.S)

B. EDHE JETA E HZ. MUHAMEDIT PARA PROFETËSISË ËSHTË ARGUMENT I PROFETËSISË SË TIJ

C. EDHE ARMIQTË E HZ. MUHAMEDIT JANË DËSHMITARË TË DREJTËSISË SË TIJ

Ç. EDHE JETA E HZ. MUHAMEDIT PAS SHPALLJES SË PROFETËSISË ËSHTË NJË DËSHMITAR TJETËR I PROFETËSISË DHE DREJTËSISË NË ÇËSHTJEN E TIJ

D. EDHE INDIVIDUALITETI I HZ. MUHAMEDIT DËSHMON PËR DREJTËSINË DHE PROFETËSINË E TIJ

DH. EDHE MORALI I PASHOQ I HZ. MUHAMEDIT ËSHTË DËSHMITAR I PROFETËSISË DHE DREJTËSISË SË TIJ

E. TRANSFORMIMET E KRYERA NGA HZ. MUHAMEDI NË ÇDO FUSHË JANË ARGUMENTE TË PROFETËSISË SË TIJ

Ë. NJOFTIMET E HZ. MUHAMEDIT MBI TË KALUARËN JANË ARGUMENTE TË PROFETËSISË DHE TË DËRGIMIT TË TIJ SI PROFET

F. NJOFTIMET E HZ. MUHAMEDIT MBI TË ARDHMEN JANË ARGUMENTE TË PROFETËSISË DHE TË DËRGESËS SË TIJ PROFETIKE

G. MREKULLITË E HZ. MUHAMEDIT JANË DËSHMITARE TË PROFETËSISË DHE TË DËRGESËS SË TIJ PROFETIKE

2. SHEMBUJ TË MREKULLIVE TË PROFETIT MUHAMED

Mrekullia e miraxhit

Begatimi i të ngrënave

Mrekullia e ndarjes së hënës në dy pjesë

Mrekullitë me ujin

Shërimi i të sëmurëve dhe i të plagosurve

Njohja e Profetit nga kafshët

Dëshmimi i maleve dhe gurëve për Profetin

Mbrojtja e Profetit si një mrekulli

Pranimi i lutjeve të Profetit

Dukja e engjëjve dhe xhindeve për Profetin dhe bisedimi me të

Shëmbëllimet dhe mrekullitë e Profetit lidhur me të fshehtën

Dëshmimi i pemëve për Profetin

MBI MREKULLITË

Mrekullitë nuk mund të mohohen

ÇËSHTJA E MARTESËS SË PROFETIT ME SHUMË GRA

PJESA E DYTË

KURANI

INTRODUKTE

I. ARGUMENTET MBI FAKTIN SE KURANI ËSHTË FJALA E ALLAHUT DHE DËSHMIA MË E MADHE E PROFETËSISË SË HZ. MUHAMEDIT

KURANI

II. KURANI DHE TË VËRTETAT SHKENCORE

A. Ç'ka në Kuran, sa ka dhe në ç'përpjestime ndodhet?

B. Pse Kurani nuk bën fjalë hapur për të gjitha shkencat?

C. A mos Kurani dhe shkenca ose feja dhe shkenca janë gjëra të ndryshme që e hedhin poshtë njëra-tjetrën?

Tre lloj dëmesësh të rëndësishme që mund t'u hapë rrugë përdorimi i shkencave.

PJESA E TRETË

PËRQENDRIMI METAFIZIK, VETËDIJA E BASHKËSISË, XHIHADI DHE DISA PARIME

I. RUAJTJA E PËRQENDRIMIT METAFIZIK DHE MUNDËSITË E KAPËRCIMIT TË PENGESËS SË AMBIENTIMIT

A. AMBIENTIMI DHE PERQENDRIMI METAFIZIK

B. ÇËSHTJE TË BOTËS SË BRENDSHME

1. Kapërcimi i vetëdijes së unit

2. Lufta për të pasur një vullnet të fortë

3. Heqja dorë nga të shtënë të dëshirave trupore

4. Domosdoshmëria e arritjes së njohjes intuitive të Zotit

5. Operacion në zemër dhe shpirt

6. Domosdoshmëria e ushqimit të zemrës dhe mendjes me meditim

7. Orientimi në përfytyrim

8. Domosdoshmëria e kujtesës së shpeshtë të vdekjes

a) Jeta sikur nuk do të vdesësh kurrë, të bën ta harrosh vdekjen

b) Porta e pallateve të lumturisë së përjetshme hapet me vdekjen

9. Rëndësia e madhe e delikatesës dhe zbutjes së zemrës

10. Lot dhe namaz mes në errësirën e natës

a) Nuk duhet qarë me shtrëngime artificiale pa zjerë përbrenda

b) Namazi tehexhud, feneri ndriçues i netëve të errëta

11. Duhet martuar, nëse s'është e mundur, duhet agjëruar

12. Duhet jetuar si sahabët

13. Duhet bartur shqetësimi për dyfytirësi dhe për hyrje në mëkat

C) ÇËSHTJE TË BOTËS SË JASHTME

1. Jetesa në formë bashkësie është domosdoshmëri jetësore

a) Lidhja në bashkësi, sot më e detyrueshme se kurrë

b) Në bashkim ka kurdoherë fuqi

c) Në bashkësi ka mëshirë dhe në lutjet e bëra në bashkësi ka miratim dhe pranim

d) Bashkësia është si rrufepritëse

2. S'duhet mbetur vetëm, patjetër duhen bërë shokë të mirë

b) Shoku i mirë të çon në xhenet

b) Duhet ndodhur mes shokësh të mirë

c) Duhet bërë shokë që këshillojnë dhe tërheqin vërejtjen

3. Në mjedisin e jashtëm duhet t'i ruajmë sytë nga pamjet haram

a) Është gjithmonë e mundur që në mjedisin e jashtëm të na bien në sy pamje haram

b) S'duhet të dalim në rrugë sa herë që të mërzitemi

c) Duke dalë jashtë, u duhet kushtuar kujdes disa gjërave të veçanta

4. Njeriu s'duhet të mbetet pa preokupim

5. Atë që i jep ndihmë fesë së Allahut, edhe Allahu e ndihmon

II. ORIENTIMI, KUMTIMI DHE RRUGA PËR TË MBETUR VITAL ME ANË TË SHËRBIMIT
NDAJ FESË

III. SPECIFIKAT QË E DËMTOJNË VEPRIMTARINË ORIENTUESE

IV. SI DUHET T'I KENË MARRËDHËNIET ME NJËRI-TJETRIN PERSONAT DHE
GRUPIMET QË I SHËRBEJNË FESË?